



**RAPORT AUDITIMI TEMATIK  
PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE  
TË LËNA NË AUDITIMET E  
PERFORMANCËS TË EVADUARA NË 6  
MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021**

**për auditimet performancës sipas temave:**

1. “Efektiviteti i situatës pandemike COVID-19”
2. “Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”
3. “Efektiviteti i Bibliotekës Kombëtare”
4. “ekonomia rurale me fokus agroturizmin”
5. “Menaxhimi i mbetjeve plastike”
6. “Efektiviteti dhe efica e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e Qytetit të Tiranës dhe Korçës”
7. “Zhvillimi i turizmit malor”
8. “Pastrimi i qytetit”

**Tiranë, Tetor 2022**

## PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
2- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: .....	6
3- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I MASAVE TË MARRA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT NGA ABUZIMET ME PESHËN DHE MATJET” .....	26
4- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I BIBLOTEKËS KOMBËTARE” .....	58
5- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EKONOMIA RURALE ME FOKUS AGROTURIZMIN” .....	82
6- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “MENAXHIMI I MBETJEVE PLASTIKE” .....	94
7- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI DHE EFICENCA E MENAXHIMIT TË PARKIMEVE TË MJETEVE MOTORIKE NË RRUGËT E QYTETIT TË TIRANËS DHE KORÇËS” .....	112
8- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “ZHVILLIMI I TURIZMIT MALOR” .....	140
9- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “PASTRIMI I QYTETIT” .....	170
10- ANEKSE .....	185

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021" dhe në Udhëzimin të Kryetarit të KLSH, nr. 1, datë 04.11.2016, "Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH", të ushtruar në subjektet:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
4. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
5. Bashkia Tiranë;
6. Bashkia Vlorë;
7. Bashkia Elbasan;
8. Bashkia Korçë;
9. Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural;
10. Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor;
11. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
12. Biblioteka Kombëtare.

## Auditimi u krye nga:

L.B., (*Përgjegjës i Raportit përmbledhës* mbi zbatimin e rekomandimeve);

1- L. B., (*Përgjegjës i grupit* për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë "Efektiviteti dhe efienca e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës " dhe "Menaxhimi i mbetjeve plastike";

- V. G.;
- M. K.

2- A. G., (*Përgjegjës i grupit* për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë "Pastrimi i qytetit" dhe Zhvillimi i turizmit malor";

- S. R.;
- E. K.

3- K. Xh. (*Përgjegjës i grupit* për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë "Ekonomia rurale me fokus agroturizmin" dhe "Efektiviteti i aktivitetit të Bibliotekës Kombëtare";

- J. Zh..

4- E. Ll. (*Përgjegjës i grupit* për zbatimin e rekomandimeve në auditimin me temë "Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimi me peshën dhe matjet" dhe "Efektiviteti i menaxhimit të situatës pandemike Covid 19";

- M. L.;
- E. D.

**Auditimi ka filluar** më, datë 07.07.2022.

**Auditimi ka përfunduar** më, datë 25.07.2022.

**Periudha e auditimit:** për auditimet e evaduara në periudhën **01.07.2021-31.12.2021.**

Nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve me temë

<b>Tema</b>	<b>Subjektet e audituara</b>
1. “Menaxhimi i mbetjeve plastike”	- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Bashkia Tiranë - Bashkia Vlorë - Bashkia Elbasan
2 “Pastrimi i qytetit”	- Bashkia Vlorë
3 “Zhvillimi i Turizmit Malor”	- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Federata shqiptare e alpinizmit dhe turizmit malor
4 “Efektiviteti i menaxhimit të situatës pandemike Covid-19”	- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Ministria e Financave dhe Ekonomisë
5 “Efektiviteti dhe eficaenca e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës”	- Bashkia Tiranë  - Bashkia Vlorë
6 “Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”	- Ministria e Financave dhe Ekonomisë  - Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
7 “Efektiviteti i Bibliotekës Kombëtare”.	- Biblioteka Kombëtare
8 “Ekonomia Rurale me Fokus Agroturizmin”	- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural

Nga auditimi rezultoi që nga ana e këtyre institucioneve janë marrë masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupet e auditimit të KLSH.

Nga auditimi tematik “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet e INTOSAI-t, Manualët e Auditimit të KLSH, për periudhën 01.01.2021 deri më 30.06.2021, rezultoi se **niveli i pranimit të rekomandimeve** nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve, paraqitet sipas tabelës vijon:

*Tabela mbi nivelin e pranimit të rekomandimeve sipas llojit:*

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar	
				Në numër	Në %
1	Organizative	6	5	1	<b>16.67</b>
2	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	152	147	5	<b>3.29</b>
	<b>Total</b>	158	152	6	<b>3.80</b>

Në **16** subjekte të audituara, nga KLSH, janë rekomanduar gjithsej **158** masa për përmirësim ligjor dhe organizative, nga të cilat janë pranuar **152** masa ose **96.2 %** dhe nuk janë pranuar **6** masa ose **3.8 %**.

Në numër dhe në % statusi i zbatimit të masave “Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi “dhe “Organizative” paraqitet sipas tabelës vijon:

*Tabela mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve sipas llojit në total:*

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	158	
2	Pa pranuar	6	3.80
3	Pranuar	152	96.20
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	49	32.24
2	Zbatuar pjesërisht	13	8.55
3	Në proces	50	32.89
4	Pa zbatuar	40	26.32

Nga 152 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 49 prej tyre ose **32.24%**, janë zbatuar pjesërisht 13 ose **8.55%**, janë në proces zbatimi 50 masa ose **32.89 %**, dhe nuk janë zbatuar 40 masa ose **26.32 %**.

**Analizuar sipas llojit të masave të rekomanduara rezulton se:**

- a. Janë rekomanduar gjithsej **6 masa për përmirësim ligjor** (5 janë pranuar nga subjekti), nga të cilat 1 masë ose **16.67 %** e masave të rekomanduara nuk është pranuar. Nga të pranuarat **5** (pesë) janë zbatuar pjesërisht dhe **2** masa ose **40 %** dhe pa zbatuar **3** masa ose **60%**.
- b. Janë rekomanduar **152 masa organizative** nga të cilat janë pranuar **147 masa** ose **96.71%** dhe nuk janë pranuar **5** masa ose **3.29 %**. Nga masat organizative të pranuar (147) janë zbatuar plotësisht **49** prej tyre ose **33.3.3%**, janë zbatuar pjesërisht **11** masa prej tyre ose **7.48 %**, janë në proces zbatimi 50 masa ose **34.01 %**, dhe nuk janë zbatuar 37 masa ose **25.17 %**.

*Në përfundim, grupi i auditimit konkludoi se veprimtaria e 16 subjekteve të audituara, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve, nuk ka qenë plotësisht efektive.*

Të analizuar dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për auditimin e ushtruar për zbatimin e rekomandimeve, 6 mujori i dytë  
2021

### 2- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I SITUATËS PANDEMIKE COVID-19”

#### 1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

##### 2.Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në subjektet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti i menaxhimit të situatës pandemike COVID - 19”, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë:

-Në Ministrinë e Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 205/11, datë 07.10.2021 dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 205/12 datë 07.10.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

**a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

**b.** Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;

**c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë: Nga auditimi u konstatua se MSHMS ka miratuar nga titullari Programin e Punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.698/5 datë 28.10.2021, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë: Nga auditimi u konstatua se, MFE ka miratuar nga planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.2458/5 datë 05.11.2021, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë nuk ka raportuar brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”, në kundërshtim me nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

Ministria e Financës dhe Ekonomisë nuk ka raportuar brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”, në kundërshtim me nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

#### **4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:**

KLSH ka dërguar:

- në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr 205/11, datë 07.10.2021

- dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr.205/12 datë 07.10.2021

Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Efektiviteti i situatës pandemike Covid-19”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 3 masa “Propozime për ndryshime ligjore” dhe 18 masa “Masa organizative” për zbatim. Nga 21 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 18 masa ose pranimi është në masën 85,7 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Rekomanduar</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Pa pranuar</b>
1	Organizative	21	18	3

## **II. HYRJA**

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- E. Ll., Përgjegjës Grupi;
- E. D., Anëtar.
- M. L., Anëtar.

### **II.1. Objekti auditimit:**

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e performancës me temë “Efektiviteti i menaxhimit të situatës pandemike COVID - 19”.

### **II.2. Qëllimi auditimit:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### **II.3. Metodologjia e auditimit:**

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### **II.4. Konkluzioni:**

Në dy subjektet e audituar janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Po kështu nga këto subjekte, nuk janë marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituara Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH<sup>ja</sup>, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

- Nga 21 masa organizative të rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 18 masa ose në masën 85,7 %. Nga 18 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 12 masa ose 66,6 % tyre, janë në proces zbatimi 5 masa ose 27,7 % dhe janë pa zbatuar 1 masë ose 0,05 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	18	12	1	4	1

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	21	100
2	Pa pranuar	3	14,29
3	Pranuar	18	85,7
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	12	66,6
2	Pa zbatuar	1	0,05
3	Në proces	5	27,7

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 66,6 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi i tyre shkon në nivelin 94,44 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara mbeten në masën 19 %. ( duke marrë në konsideratë edhe të pranuarat).

### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

#### REKOMANDIME PËR NDRYSHIME LIGJORE

##### I. Për Pyetjen audituese: A është i plotë dhe i përshtatshëm kuadri ligjor për situatën pandemike COVID-19?

**Gjetje 1:** Në Ligjin nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", po ashtu dhe në Ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", të ndryshuar, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, krijuar me VKM nr. 419, datë 04.07.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", struktura e së cilës është miratuar me Urdhrin e KM Nr. 155, datë 15.10.2018 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", nuk përcaktohet si strukturë kryesore përgjegjëse për



shëndetin publik. Dhe pse në vitin 2019 është rishikuar Ligji nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përsëri kjo strukturë nuk është përfshirë në bazën ligjore, gjë e cila ka ulur efektivitetin e saj.

**Rekomandim 1.1:** MSHMS të marrë masat për të rishikuar VKM-në nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor” dhe Urdhrin nr.18 datë 17.01.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, për përcaktimin e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor si strukturë kryesore përgjegjëse për shëndetin publik, si edhe terminologjinë e përdorur në aktet rregullatorë të sistemit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

#### ***Menjëherë dhe brenda vitit 2021***

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: *Sipas shkresës me nr. prot 698/5.date 28.10.2021 dërguar në KLSH në lidhje me Planin e Masave të marra mbi rekomandimet e lëna sipas RPA nr. 205/1 prot datë 07.10.2021 në lidhje me rekomandimin 1.1 janë marrë këto masa:* Referuar ligjit nr. 10138 datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik” është MSHMS institucioni përgjegjës për përcaktimin, bashkërendimin dhe drejtimin e politikave të shëndetit publik dhe ISHP mbështet MSHMS dhe strukturat e tjera të shëndetit publik, për realizimin e funksioneve dhe shërbimeve të shëndetit publik. Struktura e OSHKSH është e ngarkuar për marrjen e masave për menaxhimin operacional të situatës me strukturat e saj në varësi të shtrira në territor. Në ligjin për shërbimin spitalor miratuar në Kuvend por ende i pabotuar në fletore zyrtare është marrë parasysh rekomandimi dhe institucioni OSHKSH është përfshirë si strukturë për organizimin dhe funksionimin e spitaleve rajonale dhe bashkiake.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i ***pranuar*** dhe i ***zbatuar***.

**Gjetje 2:** Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 11.02.2011 të ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk është rishikuar bazuar në ndryshimet ligjore në vijim.

**Rekomandimi 2.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të rishikojë Urdhrin nr.49 datë 11.02.2011 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë”.

#### ***Menjëherë dhe brenda vitit 2021***

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: *Sipas shkresës me nr prot 698/5.date 28.10.2021 dërguar në KLSH në lidhje me Planin e Masave të marra mbi rekomandimet e lëna sipas RPA nr. 205/1 prot datë 07.10.2021 në lidhje me rekomandimin 1.1 janë marrë këto masa:*

Urdhri nr. 49 datë 11.02.2011 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë” rregullon organizimin dhe funksionimin e shërbimit laboratorik në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk afektohet nga ndryshimet ligjore në Ligjin nr. 10107 datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sapo ka miratuar ligjin për Shërbimin Spitalor dhe MSHMS brenda këtij viti do të rishikojë të gjithë bazën ligjore përfshirë edhe ofrimin e shërbimit laboratorik në sektorin publik dhe privat.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i ***pranuar*** dhe në ***proces***.

**Gjetje 3:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk kanë hartuar udhëzimin e përbashkët për kriteret dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit të institucioneve të kujdesit

shëndetësor, bazuar në pikën 38 të VKM nr. 865 datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”.

**Rekomandim 3.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë udhëzimin e përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kriteret dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor. (pika 38 e VKM nr. 865 datë 24.12.2019).

*Menjëherë dhe brenda vitit 2021*

**Për MSHMS:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: *Sipas shkresës me nr. prot 698/5.date 28.10.2021 dërguar në KLSH në lidhje me Planin e Masave të marra mbi rekomandimet e lëna sipas RPA nr. 205/1 prot datë 07.10.2021 në lidhje me rekomandimin 1.1 janë marrë këto masa:* Nga auditimi i dokumentacionit MSHMS konfirmon se në vitin 2022 ka pasur një organizim të ri të procesit dhe strukturës përgjegjëse për akreditimin e institucioneve shëndetësore me krijimin e Agjencisë së Akreditimit dhe Cilësisë për Shërbimet Shëndetësore dhe Sociale VKM nr.637 datë 27.10.2021”Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror” por ende nuk është hartuar një draft për Udhëzimin e përbashkët me MFE.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe *pjesërisht i zbatuar*.

**Për MFE:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE konfirmoi se në lidhje me hartimin e udhëzimit të përbashkët, për bashkë firmosje “Për kriteret dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor. (pika 38 e VKM nr. 865 datë 24.12.2019) nuk është paraqitur ende një draft nga MSHMS.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe *pjesërisht i zbatuar* .

## **B. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE**

*I. Për Pyetjen audituese: A është i plotë dhe i përshtatshëm kuadri ligjor për situatën pandemike COVID-19?*

**Gjetje 1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Urdhrin nr.71, datë 05.02.2020 “Për miratimin e Planit Operacional të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndaj të gjitha emergjencave” ka miratuar Planin Operacional, në momentin e shfaqjes së pandemisë, por mungon koordinimi me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, sipas Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

**Rekomandim 1.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për koordinimin e Planit Operacional ndaj të gjitha emergjencave shëndetësore me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, duke mbajtur në konsideratë situatat pandemike që mund të paraqiten në vijimësi.

*Brenda vitit 2021 dhe vijimësi*

**Për MSHMS:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: Mbështetur në Planin Operacional të miratuar me Urdhrin nr. 71 datë 05.02.2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka pasur koordinim sipas shkallëve të riskut me të gjithë institucionet shtetërore, të cilat janë aktivizuar në respektimin e të gjitha masave të marra për parandalimin e infeksionit COVID – 19 si me aktin normativ nr. 3 datë “Për

marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19” gjithashtu me Urdhrin e Ministrit nr. 156/2 datë 11.03.2020 është shpallur emergjenca civile ku është kërkuar angazhimi i të gjithë strukturave (bashkëlidhur akti normativ dhe urdhri i sipërcituar). Në lidhje me rekomandimin e mësipërm MSHMS ka hartuar planin e përgjigjes ndaj epidemisë COVID – 19 dhe impaktin post COVID 2021 – 2023 në gusht 202, që pasqyron të gjithë masat e marra për të gjithë emergjencat shëndetësore. Gjithashtu me VKM nr. 210 datë 06.04.2022 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të shëndetësisë 2021 – 2030” ku objektivi nr. 5 i kësaj strategjie është Fuqizimi i reagimit të sistemit ndaj emergjencave.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

**Gjetje 2:** VKM-ja nr. 439, datë 17.05.2017 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2016 –2020” është miratuar jashtë afateve ligjore të parashikuara në SKZHI. Ky dokument Strategjik nuk ka plane konkrete veprimi në nivel strategjik dhe operativ, objektiva SMART, të rishikuara edhe për situata pandemike në vijimësi.

**Rekomandim 2.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për hartimin e një strategjie kombëtare të shëndetësisë, gjithëpërfshirëse, me plane veprimi konkrete në nivel strategjik dhe operativ, objektiva SMART, të rishikuara dhe për situata pandemike në vijimësi. Strategjia e Shëndetit duhet të udhëhiqet nga vlerësimi i shëndetit si një e drejtë e njeriut e cila garantohet nëpërmjet kujdesit shëndetësor efektiv dhe efikas të mirë qeverisur dhe që ofron akses të barabartë dhe parimet e solidaritetit, integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

#### *Brenda gjashtëmuajorit të parë vitit 2022 dhe vijimësi*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: MSHMS sipas Urdhrit të Ministrit nr, 520 datë 23.9.2020 për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021 – 2030, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 210 datë 6.4.2022, ku një nga 5 qëllimet e politikave është “Fuqizimi i reagimit të sistemit ndaj emergjencave” (bashkëlidhur dokumentacioni i cituar).

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

**Gjetje 3:** Në kundërshtim të nenit 10 të Ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM-së Nr. 101, datë 4.2.2015 “Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe Urdhrit nr. 18, datë 17.01.2019 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, mjekët e familjes nuk janë angazhuar paralelisht me Urgjencën Kombëtare Mjekësore.

**Rekomandim 3.1:** MSHMS në bashkëpunim me institucionet e varësisë të rishikojë bazën ligjore për angazhimin e mjekëve të familjes dhe shërbimin e urgjencës lidhur me shërbimin infektiv, për një menaxhim më të mirë të situatave epidemike.

#### *Në vazhdimësi*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: Duke vlerësuar situatën e pandemisë nga rasti i parë i shfaqur në 8 mars, 2020 strukturat e kujdesit parësor u aktivizuan jo vetëm nëpërmjet komunikimit online por dhe bënë diagnostikimin dhe ndjekjen e rasteve COVID – 19. Si një sëmundje e re dhe panjohur aktivizimi i strukturave bëhej në mënyrë të përshkallëzuar bazuar dhe në rekomandimet ndërkombëtare. Për sa më sipër MSHMS ka hartuar dhe miratuar me Urdhrin nr. 413 datë

13.7.2022 Për miratimin e statutit të qendrës shëndetësore, si dhe në vijim të VKM 101, datë 4.2.2015 “Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor” ku një ndër shërbimet kryesore të qendrës shëndetësore është kujdesi për rastet e urgjencës dhe aktivitetet e survejancës për sëmundjet ngjitëse dhe kjo fuqizon rolin e mjekeve të familjes si për urgjencën mjekësore dhe sëmundjet infektive.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

**Gjetje 4:** Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor ka hartuar dhe miratuar formatin tip të rregullores së brendshme të qendrave shëndetësore, por në tetë qendrat shëndetësore në Tiranë, që u audituan nuk paraqitën këto rregullore të miratuara në drejtorinë rajonale brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e Statutit si detyrim ligjor.

**Rekomandimi 4.1:** Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të marrin masat për miratimin e formatit tip të rregullores së brendshme të qendrave shëndetësore.

*Menjëherë deri në fund të vitit 2021*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: OSHKS me shkresën nr. 3350/1 prot. datë 22.12.2021, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore i ka dërguar 4 drejtorive rajonale formatin tip të rregullores së brendshme të qendrave shëndetësore (bashkëlidhur).

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

**Gjetje 5:** Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të Ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ka dalë VKM nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”. Bazuar në pikën b të nenit 5 të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues. Bazuar në aktet ligjore cituar më sipër, ku shprehen qartë kompetencat e institucioneve përgjegjëse për akreditimin e laboratorëve mjekësorë, konstatohet se është përjashtuar DPA-ja nga e drejta e saj ligjore, sanksionuar kjo edhe në konventat ndërkombëtare për akreditimin e laboratorëve, gjë e cila do kishte sjellë njohjen e dokumentacionit dhe rezultateve të lëshuara nga këto laboratorë. Përjashtimi i DPA-së ka sjellë pasoja të mungesës së vërtetësisë së analizave, pasi nuk ka marrë pjesë në akreditimin e aparaturave laboratorike të përdorura për këtë qëllim. Marrja e kompetencave nga Komiteti i Ekspertëve dhe MSHMS-ja, ka sjellë përjashtim të padrejtë të DPA-së duke cenuar vërtetësinë e të dhënave laboratorike për Covid-19. Bazuar në Urdhrin e ministrit nr. 437, datë 23.07.2020 “Për miratimin e procedurës së kryerjes së testeve molekulare RT-PCR për SARS-COV-2 dhe njohjes së laboratorëve jopublikë për kryerjen e testimit për nevoja administrative”, 8 laboratorëve jopublikë u është njohur e drejta për kryerjen e testeve RT-PCR SARS-COV-2 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në bazën ligjore të urdhrit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka cituar asnjë nen të Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i cili i jep të drejtën e njohjes së këtij procesi laboratorëve jopublikë. Grupit të auditimit nuk i’u vu në dispozicion ndonjë relacion shoqërues shpjegues për domosdoshmërinë dhe gjendjen e tyre, kërkuar nëpërmjet pyetësorit. Ky urdher nuk është në përputhje me aktet nënligjore, si

edhe me VKM nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”.

**Rekomandim 5.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për të rishikuar akreditimet e laboratorëve jopublikë për Covid-19, duke kërkuar riakreditimin me pjesëmarrjen e DPA-së dhe zbatimin e plotë të kërkesave ligjore sipas kompetencave të përcaktuara për institucionet përkatëse.

#### ***Menjëherë dhe brenda vitit 2021***

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: MSHMS në lidhje me laboratorët operon sipas Urdhrit të ministrit nr. 437 datë 23.07.2020 sipas të cilit miraton procedurën e kryerjes së testeve molekulare RT – PCR për SARS – COV – 2 dhe njohjes së laboratorëve jopublikë për kryerjen e testimit për nevoja administrative, bazuar në kuadrin ligjor sektorial të shëndetësisë Ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 15.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar dhe Vendimit të Komitetit Teknik të Ekspertëve datë 23.07.2020.

Bazuar në VKM nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore” pika 1 citon se “*të gjithë institucionet e kujdesit shëndetësor, përjashtuar laboratorët mjekësore, duhet të plotësojnë standardet bazë për akreditim*”. Për sa më sipër MSHMS nuk mund të bëjë akreditim të laboratorëve publik dhe jo publik pasi këtë kompetencë e ka DPA.

**Statusi i rekomandimit:** *Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i papranuar dhe i pazbatuar.*

**Gjetje 6:** Ndërmjet institucioneve të varësisë ka funksionuar komunikimi elektronik, por jo sipas pikës 10 të nenit 5 të Ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” citohet: “*Njoftimi, raportimi, informacioni, dërgimi, listat dhe raportet, të cilat kërkohet të jepen me shkrim, mund të komunikohen në mënyrë elektronike nëse: a) ka një marrëveshje me shkrim që njoftimi, raportimi, informacioni, lista ose raporti mund të dërgohen dhe merren nëpërmjet komunikimit elektronik; b) komunikimi realizohet sipas sistemit përkatës, numrit dhe adresës, të specifikuar në marrëveshjen përkatëse*”. Shkëmbimet e informacioneve zyrtare, brenda institucioneve të varësisë, për pajisjen me mjetet e diagnostikimit, tamponët etj., janë kryer elektronikisht, me email, pa një dokument zyrtar të firmosur nga eprorët përkatës dhe bazuar në njoftimet e rastit sipas nevojave. Kjo gjë i është lënë rastësisë dhe është kryer në kundërshtim me Kreun III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, paragrafin “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pikat 34 - 41, të Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandim 6.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të marrin masa për një menaxhim më të mirë të situatave pandemike, brenda dhe jashtë vendit, në zbatim të nenit 53 të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, si edhe nenit 5 të Ligjit 15/2016, të hartojë dhe miratojë marrëveshje kombëtare dhe ndërkombëtare me shkrim që njoftimi, raportimi, informacioni, lista ose raportet mund të dërgohen dhe merren nëpërmjet komunikimit elektronik, i cili realizohet sipas sistemit përkatës, numrit dhe adresës, të specifikuar në marrëveshjet përkatëse.

#### ***Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2022***

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: MSHMS dhe institucionet e varësisë kryejnë raportimin në një sistem të integruar elektronik laboratorik dhe epidemiologjik, të gjithë strukturat shëndetësore publike, si dhe strukturave jopublike të njohura për kryerjen e testit RT – PCR për COVID – 19 dhe testimit

të antigenit raportojnë rastet në sistem elektronik sipas Urdhrit nr. 412 datë 24.09.2021 dhe Udhëzimit nr. 415 datë 27.09.2021 (bashkëlidhur).

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe *në proces*.

**Gjetje 7:** Programi Kombëtar i Imunizimit nuk është rishikuar nga MSHMS për të përmirësuar elementët e tij për sistemin në kuadër të COVID-19. Në faqen e website të MSHMS është publikuar “Plani Kombëtar i vaksinimit ndaj COVID -19” dhe në faqen e ISHP-së paraqitet kalendari aktual i vaksinimit i parashikuar për COVID -19. MSHMS në bashkëpunim me ISHP kanë përgatitur planin kombëtar të vaksinimit ndaj COVID-19, por bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr.15/2016, si edhe në Ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, shërbimi i shëndetit publik ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, nëpërmjet të cilit MSHMS koordinon, pranë Institutit të Shëndetit Publik, zbatimin e imunizimit nga institucionet e kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike.

**Rekomandim 7.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik të rishikojë Programin Kombëtar të Imunizimit dhe të monitorojë zbatimin e imunizimit nga institucionet e kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike, bazuar në nenin 18 të Ligjit 15/2016, si edhe në Ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”.

#### *Menjëhëre dhe brenda vitit 2021*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: MSHMS konfirmon se Programi Kombëtar i Imunizimit ndjek dhe monitoron në mënyrë sistematike kalendarin kombëtar të vaksinimit dhe imunizimit për grup moshën 0 – 18 vjeç. Vaksina e COVID – 19 është një vaksinë e rekomanduar në të gjithë fashat sipas vendimeve të marra nga Komiteti i Ekspertëve për Imunizimin dhe nga Komiteti i Menaxhimit të Pandemisë COVID – 19 dhe nuk është pjesë e kalendarit të vaksinave për grup moshën 0 – 18 vjeç.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe *në proces*.

## **II. Për pyetjen audituese: A kanë qenë efektive masat e marra nga strukturat përgjegjëse për mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes të COVID-19?**

**Gjetje 1:** Nga auditimi u konstatuan vonesa lidhur me sistemin e lajmërimit mbi situatën shëndetësore jo të zakonshme të qytetarëve, të cilëve u është dashur të komunikojnë disa herë me 127, “Linjën e gjelbër për COVID-19” dhe mjekun e familjes për të konfirmuar gjendjen e tyre, në kundërshtim me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit (2005, OBSH), me qëllim zbulimin dhe ndjekjen në kohë të rasteve të dyshuara, izolimin dhe menaxhimin e tyre.

**Rekomandim 1.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik, në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, të rishikojnë planet afat-shkurtra, afat-mesme të miratuara nga Këshilli Shkencor i ISHP-së, në fushën e kontrollit, parandalimit, ndjekjes në kohë të rasteve të dyshuara të sëmundjeve infektive në situata pandemie, për një planifikim të mirëfilltë strategjik.

#### *Dhjetor 2021*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: MSHMS dhe ISHP konfirmojnë se gjatë vitit 2021 është miratuar Plani i Veprimtari 2021 – 2023 për COVID – 19, long and post – covid (bashkëlidhur), mbështetur në ndërveprimin dhe bashkëpunimin e institucioneve të tjera shëndetësore. Gjithashtu janë riparë udhëzuesit sipas vlerësimit të situatës epidemiologjike, si dhe është vijuar me rishikimin e strategjisë së vaksinimit. Është riparë skeda e hetimit epidemiologjik për rastet dhe kontaktet.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

**Gjetje 2:** Për shkak të numrit të vogël të grupeve të terrenit dhe mbingarkesës së tyre, procedura e testimit në disa raste nuk është kryer menjëherë dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në udhëzuesin eurvejancës për rastet specifike të COVID-19, miratuar nga MSHMS.

**Rekomandim 2.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik të marrë masat për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore mbi sistemin e lajmërimit për situatën shëndetësore të qytetarëve në raste pandemie, me qëllim zbulimin, ndjekjen në kohë të tyre dhe rritjen e gatishmërisë emergjente.

*Dhjetor 2021*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: janë aktivizuar skuadrat të hetimit epidemiologjik të terrenit, si dhe referuar raportimit në kohë mbështetur në listën e re të sëmundjeve infektive të raportimit të detyruar të sëmundjeve infektive miratuar me Urdhër Ministri nr. 632 ku citohet se “COVID – 19 është sëmundje e re dhe raportimi duhet të jetë brenda 24 orëve”.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

**Gjetje 3:** Vonesat në kohë të lajmërimit të pacientëve të rezultuar pozitiv nga Instituti i Shëndetit Publik për shkak të mbingarkesës si edhe mosfunktionimi i laboratorëve rajonale sollën rritjen e numrit të pacientëve drejt institucioneve shëndetësore jopublike.

**Rekomandim 3.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik dhe Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të marrin masat për vënien në eficiencë të plotë të laboratorëve të shëndetit publik me pajisjet që nevojiten për të evidentuar shkaqet e sëmundjeve infektive, si edhe rritjen e numrit të tyre për përballimin e epidemive.

**Në vazhdimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: Në vijim të ecurisë së pandemisë janë shtuar kapacitetet diagnostikuese në nivel të aparaturave për PCR dhe kite diagnostikimi në nivel qendror, si dhe në nivel të njërive vendore të kujdesit shëndetësor, qendra shëndetësore, pika testimi, janë shtuar/siguruar kapacitetet diagnostikuese për teste antigen, si dhe për marrjen e tamponëve të PCR për diagnozë në nivel qendror. Aktualisht në ISHP janë kanë 4 (katër) Gene Expert të reja të siguruar vetëm gjatë dy viteve të pandemisë.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

**Gjetje 4:** Situata e COVID-19 nxori në pah se kapacitetet spitalore rajonale, gatishmëria e tyre dhe e qendrave shëndetësore të njërive të vetëqeverisjes vendore, numri i kufizuar i mjekëve të sëmundjeve infektive, problematikat në stokun e materialeve të mbrojtjes personale, pasiguria në vendin e punës për shkak të pamjaftueshmërisë së trajnimeve dhe informimit mbi përdorimin, veshjen, zhveshjen dhe eliminimin e sigurt të MMP-ve etj, ishin të pamjaftueshme për trajtimin e rasteve me COVID-19.

**Rekomandim 4.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të marrin masat për gatishmërinë e, spitaleve rajonale, qendrave shëndetësore të njërive të vetëqeverisjes vendore, kapaciteteve profesionale të specialistëve të sëmundjeve infektive në kujdesin shëndetësor parësor, urgjencës mjekësore duke siguruar rezervat e nevojshme të personelit mjekësor dhe

medikamenteve mjekësore, duke investuar me pajisjet e nevojshme mjekësore mbrojtëse dhe trajnimet, për të rritur efektivitetin e shërbimeve shëndetësore dhe menaxhimin e suksesshëm të situatave epidemike në vijimësi.

#### *Menjëherë*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale konfirmon se në bashkëpunim me të gjithë strukturat janë garantuar investime në pajisje mjekësore, mjetet të mbrojtjes personale, përshtatje të pavijoneve të dedikuara për COVID – 19 në spitalet rajonale (bazuar dhe në Planin e Përgjigjes 2021 – 2023), bashkëlidhur.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe *në proces*.

**Gjetje 5:** Nga verifikimi i kryer në sistemin SISSI në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, grupi i auditimit konstatoi raste ku nuk është kryer gjurmimi i plotë i kontakteve me personat e infektuar ose raste dyshimi me COVID-19, në kundërshtim me udhëzuesin e hetimit të shpejtë të rasteve të dyshuara dhe kontakteve të tyre.

**Rekomandim 5.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë të marrin masat për plotësimin e skedave përkatëse të hetimit marrë nga gjurmimi i kontakteve dhe hetimi epidemiologjik për azhurnimin e regjistrit SISSI të shtetasve të depistuar, bazuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 15/2016.

#### *Menjëherë*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se SISSI është një sistem që pasurohet çdo ditë nga rastet e hetuara nga ana epidemiologjike, si dhe pasurohet me kontakte dhe raste depistimi. Tashmë sistemi i integruar elektronik përmbledh në diagnozën laboratorike dhe të dhënat epidemiologjike, si dhe gjithashtu konfigurohet sipas kohës së testimit rapid testet antigenik dhe PCR në laboratorët qendror.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe *i zbatuar*.

**Gjetje 6:** Urdhri Nr. 545 datë 19.11.2020 për rimbursimin e pacientëve Covid ka dalë 9 muaj pas shfaqjes së pandemisë, duke mos harruar dhe faktin që çmimet e barnave në Shqipëri shpesh janë më të larta se në vendet e tjera të BE-së. Bazuar në Ligjin Nr. 15/2016 për “Parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, dhe Ligjin Nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka detyrimin ligjor ta ofrojë falas shërbimin shëndetësor dhe të marrë të gjitha masat për zbatimin korrekt të tij. Kjo është kosto financiare për qytetarët. Lidhur me informacionin e kërkuar mbi analizat e kostos, si për rimbursimet ashtu dhe VKM -të për paketat e ndihmave ekonomike, nuk na u vu në dispozicion ndonjë e dhënë konkrete, shoqëruar me një relacion shpjegues. Nga inspektimet në 8 (tetë) Qendra Shëndetësore në Tiranë dhe nga intervistat e kryera nga Grupi i Auditimit u konstatua se: Pacientët nuk kanë qenë në dijeni të urdhrit të rimbursimit, pasqyruar kjo dhe nga numri i vogël i recetave të lëshuara nga mjekët e familjes në disa qendra të monitoruara nga grupi i auditimit. Këto qendra nuk kanë bërë informimin e qytetarëve me mjetet e duhura të informacionit, apo afishimin e posterave në mjediset e tyre. Duke konsideruar informimin si një ndër shtyllat kryesore të menaxhimit, në fjalën e vet mbajtur gjatë një komunikimi me median më datë 19.11.2020 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deklaroi se: “Bazuar në Urdhrin Nr. 545 datë 19.11. 2020 do të kryhet rimbursimi 100% i trajtimit ambulator për pacientët me covid 19, të siguruar dhe të pasiguruar”. Kjo rezultoi e përcaktuar.



**Rekomandim 6.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të analizojë zbatimin e Urdhrit Nr. 545 datë 19.11.2020 “Për disa shtesa në Urdhrin nr. 392, datë 01.07.2019 “Për caktimin e kufizimeve në përdorimin, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit me barna të listës së barnave që rimbursohen nga fondi”, i ndryshuar”, nga strukturat përkatëse përgjegjëse, me qëllim informimin publik të qytetarëve, për të garantuar shërbim eficient dhe falas.

*Menjëherë*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të nenit 10 të ligjit 10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ka hartuar paketën e barnave për trajtim ambulator në banesë të personave me COVID – 19 të miratuar me VKM nr. 908 datë 18.11.2020 “Për miratimin e paketës së barnave për trajtim ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID – 19, që do të financohet nga FSDKSH”. Protokollet e trajtimit ambulator të formave të lehta dhe të moderuara janë bazuar nga vendimi i Komitetit të Përkohshëm Teknik me Urdhër të Zv. Ministrit miratoj urdhrin nr. 579 datë 14.10.2020 “Për miratimin e Udhëzuesit për ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion COVID – 19”, ku ndjekja dhe zbatimi i tij është bërë nga OSHKSH nëpërmjet institucioneve përkatëse shëndetësore. MSHMS dhe FSDKSH kanë marrë të gjithë masat për të informuar qytetarët e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet informimit nga mjekët e familjes në qendrat shëndetësore, si dhe nëpërmjet njoftimit në median televizive, si dhe bërjen publike të këtyre urdhrave në faqen zyrtare të MSHMS.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

### **III. Për pyetjen audituese: A ka qenë efektiv funksionaliteti i laboratorëve publik dhe jopublik?**

**Gjetje 1:** Për njohjen e të drejtës së 8 laboratorëve jopublikë për kryerjen e testit RT-PCR për SARS-COV-2, nuk ka referencë ligjore të cituar në Urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 437, datë 23.07.2020 “Për miratimin e procedurës së kryerjes së testimeve molekulare RT-PCR për SARS-COV-2, rrjedhimisht kjo vendim marrje nga MSHMS është e pa bazuar dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 10138, datë 11.05.2009, “Për shëndetin publik” pikat 4 dhe 5 të tij. Në kushtet kur laboratorët rajonalë nuk dispononin pajisjet e nevojshme për të evidentuar shkaqet e sëmundjeve infektive, u miratua urdhri i sipërcituar, i cili nuk është në përputhje me bazën ligjore lidhur me procesin e akreditimit të tyre (pikat 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”).

**Rekomandim 1.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për rishikimin e bazës ligjore për të përcaktuar qartë kompetencat dhe procedurat lidhur me akreditimin e laboratorëve mjekësorë jopublikë për Covid-19, në zbatim të plotë të kërkesave ligjore sipas kompetencave të përcaktuara për institucionet përkatëse.

*Menjëherë*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: MSHMS në lidhje me laboratorët operon sipas Urdhrit të ministrit nr. 437 datë 23.07.2020 sipas të cilit miraton procedurën e kryerjes së testimeve molekulare RT – PCR për SARS – COV – 2 dhe njohjes së laboratorëve jopublik për kryerjen e testimit për nevoja administrative, bazuar në kuadrin ligjor sektorial të shëndetësisë Ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 15.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar dhe Vendimit të Komitetit Teknik të Ekspertëve datë 23.07.2020. Bazuar në VKM nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore” pika 1 citon se “*të gjithë institucionet e kujdesit shëndetësor, përjashtuar laboratorët mjekësore, duhet të plotësojnë*

*standardet bazë për akreditim*”. (bashkëlidhur Urdhri). Për sa më sipër MSHMS nuk mund të bëjë akreditim të laboratorëve publik dhe jo publik pasi këtë kompetencë e ka DPA.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *papranuar dhe i pazbatuar*.

**Gjetje 2:** Bazuar në Nenin 9 të Ligjit Nr. 15/2016, identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve infektive, me qëllim përcaktimin e diagnozës e kryejnë institucionet shëndetësore publike e jopublike të licencuara. Ndonëse MSHMS ka urdhëruar njohjen e laboratorëve të paakredituar për testimin RT-PCR, nuk ka përcaktuar me urdhër administrativ ofrimin falas ose rimbursim të pjesshëm të vizitave dhe mjekimeve në këto institucione, për më tepër që verifikimi i rasteve pozitiv dërgohej për referencë në ISHP.

**Rekomandim 2.1:** Bazuar në Ligjin Nr. 10138/2009, të ndryshuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masat për hartimin dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të një urdhri administrativ (akt nënligjor) për ofrimin falas/ rimbursim qoftë dhe të pjesshëm, të vizitave dhe mjekimeve në institucionet shëndetësore jopublike, rastet COVID-19.

#### ***Brenda vitit 2021***

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale konfirmon se në bazë të ligjit 15/2016 dhe gjithë strukturat e saj publike kanë qene në gatishmëri të plotë për përgjigje të çdo rasti të dyshuar apo konfirmuar me COVID – 19. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të nenit 10 të ligjit 10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ka hartuar paketën e barnave për trajtim ambulator në banesë të personave me COVID – 19 të miratuar me VKM nr. 908 datë 18.11.2020 “Për miratimin e paketës së barnave për trajtim ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID – 19, që do të financohet nga FSDKSH”. Protokollat e trajtimit ambulator të formave të lehta dhe të moderuara janë bazuar nga vendimi i Komitetit të Përkohshëm Teknik me Urdhër të Zv. Ministrit miratoj urdhrin nr. 579 datë 14.10.2020 “Për miratimin e Udhëzuesit për ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion COVID – 19”, ku ndjekja dhe zbatimi i tij është bërë nga OSHKSH nëpërmjet institucioneve përkatëse shëndetësore. MSHMS dhe FSDKSH kanë marrë të gjithë masat për të informuar qytetarët e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet informimit nga mjekët e familjes në qendrat shëndetësore, si dhe nëpërmjet njoftimit në median televizive, si dhe bërjen publike të këtyre urdhrave në faqen zyrtare të MSHMS, por nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë konkrete për hartimin dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të një urdhri administrativ (akt nën ligjor) për ofrimin falas/ rimbursim qoftë dhe të pjesshëm, të vizitave dhe mjekimeve në institucionet shëndetësore jopublike, rastet COVID-19.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar dhe i pazbatuar*.

**Gjetje 3:** Tre prej spitaleve jopublike të njohura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e RT-PCR për SARS-COV-2 u ka mbaruar periudha e akreditimit dhe bazuar në VKM-në nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”, duhet të jenë të akredituara përpara njohjes nga MSHMS për kryerjen e testimit RT-PCR. Spitali Gj. – akreditimi 5 vjeçar 2014-2019; Spitali S.– akreditim 5 vjeçar 2015 – 2020; Spitali A. 1- akreditim 3 vjeçar 2015-2018 .

Laboratori “I.”, sh.p.k është akredituar për periudhën 2014-2021, nga TUV Austria Albania. Bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 10107/ 2009, të ndryshuar, dhe VKM-në nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit

shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”, laboratorët mjekësorë përjashtohen nga kjo VKM, dhe bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, akreditimi i laboratorëve testues, mjekësorë dhe kalibrues kryhet nga DPA.

“N. L.” sh.p.k akredituar për periudhën 2018-2022 figuron i akredituar në fushën (ujë, ajër, ushqime), të cilat nuk kanë lidhje me RT-PCR-SARS-COV-2. Më datë 03.04.2020 është rishikuar akreditimi, duke zgjeruar fushën e akreditimit dhe mbi bazën e kësaj i është njohur e drejta e kryerjes së testimit. “B. D. C.”, është njohur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale më datë 15.12.2020, por nuk figuron në faqen e web-it të DPA-së.

**Rekomandim 3.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për rishikimin e akreditimit të institucioneve shëndetësore dhe laboratorëve jopublikë lidhur me bazën ligjore, afatet kohore të vlefshmërisë dhe fushën e akreditimit të tyre.

#### *Menjëherë*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga MSHMS rezultoi se: MSHMS në lidhje me laboratorët operon sipas Urdhrit të ministrit nr. 437 datë 23.07.2020 sipas të cilit miraton procedurën e kryerjes së testeve molekulare RT – PCR për SARS – COV – 2 dhe njohjes së laboratorëve jopublik për kryerjen e testimit për nevoja administrative, bazuar në kuadrin ligjor sektorial të shëndetësisë Ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 15.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar dhe Vendimit të Komitetit Teknik të Ekspertëve datë 23.07.2020.

Bazuar në VKM nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore” pika 1 citon se “*të gjithë institucionet e kujdesit shëndetësor, përjashtuar laboratorët mjekësorë, duhet të plotësojnë standardet bazë për akreditim*”. (bashkëlidhur Urdhri) Për sa më sipër MSHMS nuk mund të bëjë akreditim të laboratorëve publik dhe jo publik pasi këtë kompetencë e ka DPA.

**Statusi i rekomandimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pa pranuar dhe i pazbatuar*.

#### **IV. Për pyetjen audituese: A është kryer një analizë ekonomike mbi menaxhimin e situatës për pandeminë COVID-19?**

##### **Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.**

**Gjetje 1:** Nga auditimi u konstatua mungesa e një analize lidhur me politikat në nivel makro mbi menaxhimin e aspektit financiar të situatës pandemike, por operim rast pas rasti. Mungesë e një komiteti ekspertësh, i cili do të merrej me hartimin e politikave makroekonomike të cilat më pas të paraqesin input gjatë planifikimit të politikave qeveritare në kuadër të menaxhimit të pandemisë. Këto politika makroekonomike të propozuara duhet të shoqëroheshin edhe me analiza për të shpjeguar efektet e tyre ndaj zhvillimeve ekonomike dhe sociale në vend dhe do të ndihmonin në dhënien e mendimeve për ligjet dhe aktet e tjera dhe dokumentet e propozuara nga Qeveria.

Mungesë e analizës/ave mbi të cilën/at është hartuar plani financiar i përdorur për përballimin e pasojave të COVID-19. Strategjive të rikuperimit të aspektit financiar, e cila të ishte zhvilluar përmes një procesi inkluziv dhe transparent dhe të përfshinte palët e interesuara përkatëse në secilën fazë. Mungesë e një plani masash për rimëkëmbjen e ekonomisë post COVID–19. Deri tani nuk ka akoma ndonjë plan të plotë konkret apo qoftë edhe draft, disamujor apo disavjeçar për rimëkëmbjen ekonomike.

**Rekomandimi 1.1:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat në ngritjen e një komiteti ekspertësh, i cili të bëjë hartimin e politikave makroekonomike, projeksioneve

afatshkurtra dhe afatmesme në lidhje me treguesit kryesorë makroekonomik. Këto politika të jenë shoqëruar edhe me analiza për të shpjeguar efektet e tyre ndaj zhvillimeve ekonomike dhe sociale në vend.

#### *Dhjetor 2021*

**Rekomandimi 1.2:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat në hartimin e një plani veprimi ku të jenë identifikuar role të qarta dhe përgjegjësitë për secilin institucion dhe të përfshijë në një listë të gjitha aktet nënligjore të nevojshme që do të miratohen nga institucionet. Ngritjen e një mekanizmi për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e tij si dhe ngritjen e një komiteti ekspertësh të cilët duhet të luajnë një rol vendimtar në sigurimin e mbikëqyrjes. Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat në hartimin e një plani orientimi për investimet në favor të zbritjes së efekteve negative të pandemisë.

#### *Dhjetor 2021*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 1.1, MFE sipas shkresës 2458/5, datë 05.11.2021 vlerëson që ashtu siç është e përcaktuar në misionin e MFE-së për fushat e përgjegjësisë që ajo mbulon, të gjitha orientimet sipas këtij rekomandimi janë pjesë përbërëse e dokumenteve që hartohen sipas përcaktimeve në VKM nr.15 datë 20.01.2021 “Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2021”. Pjesë e këtij kalendarit janë edhe dokumentet si më poshtë:

- a. Brenda vitit 2021 miratohet dokumenti i “Programit buxhetor afatmesëm” i cili është parashtrimi për tre vjet i planeve të shpenzimeve të buxhetit, 2022-2024, përmes lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve me veprimtaritë, produktet, objektivat dhe qëllimet e politikës.
- b. Brenda vitit 2021 miratohet edhe Ligji “Për buxhetin e vitit 2022”, me tavane trevjeçare, mbi bazën e programit buxhetor afatmesëm.
- c. VKM-te “Për kuadrin makroekonomik e Fiskal”.
- d. VKM nr.4, datë 9.1.2019 “Për Miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për Periudhën 2020 – 2022”;
- e. VKM nr. 53, datë 29.1.2020 “Për Miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për Periudhën 2021 – 2023”;
- f. VKM nr. 574, datë 22.7.2020 “Për Miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për Periudhën 2021 – 2023” e rishikuar;
- g. VKM nr.7, datë 13.1.2021 “Për Miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për Periudhën 2022 – 2024”;

**Statusi i rekomandimit: I pranuar nga MFE dhe i zbatuar.**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Për rekomandimin 1.2, MFE shprehet se ky rekomandim është i ezauruar për sa kohë që në Kalendarin e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2021, janë përcaktuar dokumentet që duhet të hartohen dhe miratohen, krahas institucioneve përgjegjëse për hartimin/miratimin e tyre, si dhe afatet kohore përkatëse. Ndërkohë, Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike i ka shqyrtuar me prioritet dhe ka marrë parasysht kërkesat e ardhura për investime publike nga Ministria e Shëndetësisë.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar nga MFE dhe i zbatuar.**

**Gjetje 2:** Nga auditimi u konstatua mungesa e një analize konkrete mbi ndikimin e pandemisë në investimet publike dhe private nga pandemia, efektin që sjell në nivel makro kjo “prekje”, si dhe mungesa e një plan orientimi për këto investime në favor të zbritjes së efekteve negative të pandemisë. Duke qenë se ishte prezente mundësia që investimet private të binin për shkak të pasigurisë dhe kufizimeve të parave që masat e kontrollit ju shkaktuan bizneseve, që kompani të huaja të cilat do të investonin në vendin tonë ta shtynin për më vonë, apo që projekte të mëdha investimesh publike që pritej të realizoheshin, të mbeteshin pezull duhet të ishte kryer një analizë për të krijuar një pamje më konkrete dhe të qartë se sa

investime qofshin private apo publike do të prekeshin dhe në çmasë, për të llogaritur më tej efektin makro të saj.

**Rekomandimi 2.1:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat për përgatitjen dhe miratimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse të rikuperimit të ekonomisë. Mbi bazën e kësaj strategjie të hartohet një plan konkret i rimëkëmbjes, i cili duhet të bazohet në një vlerësim të rrezikut dhe të pasohet nga një plan veprimi për ndërtimin e ekonomisë më të konsoliduar se më parë. Dokumenti të lëvizë nga kuptimi tradicional dhe burokrat në një pasqyrë gjithëpërfshirëse.

*Dhjetor 2021*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH: Lidhur me rekomandimin 2.1, MFE shprehet se:** në Kalendarin e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike, është përcaktuar që Këshilli i Ministrave përgatit dhe miraton dokumentin e prioriteteve të politikave 2022-2024 me ndikim në tavanet buxhetore”. Gjithashtu, meqenëse Kalendari i Menaxhimit të Shpenzimeve Publike miratohet si pjesë përbërëse e Kalendarit të Planifikimit Strategjik nga Këshilli i Ministrave, në gjykimin tonë janë pikërisht këto dokumente që miratojnë prioritetet e politikave si edhe akte të tjera në zbatim të tyre, duke përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse për hartimin e tyre. Më poshte po paraqesim disa dokumente për të cilat MFE është përgjegjëse dhe pjesë e hartimit apo përditësimit të tyre:

- (i) *Strategjia “Për Menaxhimin e Financave Publike”*
- (ii) *Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA)*
- (iii) *Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB)*

*Shpjegime më të hollësishme për secilën nga këto strategji, janë dhenë nga MFE me shkresën nr. 2458/5, datë 5.11.2021, dërguar KLSH-së.*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar nga MFE dhe i zbatuar.**

## **VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit **ri kërkojmë** nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresat:

- Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën me nr. 205/11, datë 07.10.2021 (hyrë në këtë Ministri me nr. 698/4 Prot datë 08.10.2021).

- Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën me nr. 205/12, datë 07.10.2021.

mbi auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti i situatës pandemike Covid-19”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të papranuara ose në proces, si më poshtë:

### **A. REKOMANDIME PËR NDRYSHIME LIGJORE**

**I. Për Pyetjen audituese: A është i plotë dhe i përshtatshëm kuadri ligjor për situatën pandemike COVID-19?**

**Gjetje 2:** Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë, miratuar me Urdhrin nr. 49, datë 11.02.2011 të ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk është rishikuar bazuar në ndryshimet ligjore në vijim.

**Rekomandimi 2.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të rishikojë Urdhrin nr.49 datë 11.02.2011 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë”.

*Brenda vitit 2022*

**Gjetje 3:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk kanë hartuar udhëzimin e përbashkët për kriteret dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor, bazuar në pikën 38 të VKM nr. 865 datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”.

**Për MSHMS dhe MFE.**

**Rekomandim 3.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë udhëzimin e përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kriteret dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor. (pika 38 e VKM nr. 865 datë 24.12.2019).

*Brenda vitit 2022*

## MASA ORGANIZATIVE

**I. Për Pyetjen audituese: A është i plotë dhe i përshtatshëm kuadri ligjor për situatën pandemike COVID-19?**

**Për MSHMS**

**Gjetje 5:** Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të Ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ka dalë VKM nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”. Bazuar në pikën b të nenit 5 të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues. Bazuar në aktet ligjore cituar më sipër, ku shprehen qartë kompetencat e institucioneve përgjegjëse për akreditimin e laboratorëve mjekësorë, konstatohet se është përjashtuar DPA-ja nga e drejta e saj ligjore, sanksionuar kjo edhe në konventat ndërkombëtare për akreditimin e laboratorëve, gjë e cila do kishte sjellë njohjen e dokumentacionit dhe rezultateve të lëshuara nga këto laboratorë. Përjashtimi i DPA-së ka sjellë pasoja të mungesës së vërtetësisë së analizave, pasi nuk ka marrë pjesë në akreditimin e aparaturave laboratorike të përdorura për këtë qëllim. Marrja e kompetencave nga Komiteti i Ekspertëve dhe MSHMS-ja, ka sjellë përjashtim të padrejtë të DPA-së duke çenuar vërtetësinë e të dhënave laboratorike për Covid-19. Bazuar në Urdhrin e ministrit nr. 437, datë 23.07.2020 “Për miratimin e procedurës së kryerjes së testeve molekulare RT-PCR për SARS-COV-2 dhe njohjes së laboratorëve jopublikë për kryerjen e testimit për nevoja administrative”, 8 laboratorëve jopublikë u është njohur e drejta për kryerjen e testeve RT-PCR SARS-COV-2 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në bazën ligjore të urdhrit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka cituar asnjë nen të Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i cili i jep të drejtën e njohjes së këtij procesi laboratorëve jopublikë. Grupit të auditimit nuk i’u vu në dispozicion ndonjë relacion shoqërues shpjegues për domosdoshmërinë dhe gjendjen e tyre, kërkuar nëpërmjet pyetësorit. Ky urdher nuk është në përputhje me aktet nënligjore, si edhe me VKM nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”.

**Rekomandim 5.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për të rishikuar akreditimet e laboratorëve jopublikë për Covid-19, duke kërkuar ri akreditimin me pjesëmarrjen e DPA-së dhe zbatimin e plotë të kërkesave ligjore sipas kompetencave të përcaktuara për institucionet përkatëse.

*Brenda gjashtëmuajorit të parë 2023*

**Gjetje 6:** Ndërmjet institucioneve të varësisë ka funksionuar komunikimi elektronik, por jo sipas pikës 10 të nenit 5 të Ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” *citohet:* “Njoftimi, raportimi, informacioni, dërgimi, listat dhe raportet, të cilat kërkohet të jepen me shkrim, mund të komunikohen në mënyrë elektronike nëse: a) ka një marrëveshje me shkrim që njoftimi, raportimi, informacioni, lista ose raporti mund të dërgohen dhe merren nëpërmjet komunikimit elektronik; b) komunikimi realizohet sipas sistemit përkatës, numrit dhe adresës, të specifikuar në marrëveshjen përkatëse”. Shkëmbimet e informacioneve zyrtare, brenda institucioneve të varësisë, për pajisjen me mjetet e diagnostikimit, tamponët etj, janë kryer elektronikisht, me email, pa një dokument zyrtar të firmosur nga eprorët përkatës dhe bazuar në njoftimet e rastit sipas nevojave. Kjo gjë i është lënë rastësisë dhe është kryer në kundërshtim me Kreun III “Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, paragrafin “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pikat 34 - 41, të Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandim 6.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të marrin masa për një menaxhim më të mirë të situatave pandemike, brenda dhe jashtë vendit, në zbatim të nenit 53 të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, si edhe nenit 5 të Ligjit 15/2016, të hartojë dhe miratojë marrëveshje kombëtare dhe ndërkombëtare me shkrim që njoftimi, raportimi, informacioni, lista ose raportet mund të dërgohen dhe merren nëpërmjet komunikimit elektronik, i cili realizohet sipas sistemit përkatës, numrit dhe adresës, të specifikuar në marrëveshjet përkatëse.

#### ***Brenda vitit 2022***

**Gjetje 7:** Programi Kombëtar i Imunizimit nuk është rishikuar nga MSHMS për të përmirësuar elementët e tij për sistemin në kuadër të COVID-19. Në faqen e website të MSHMS është publikuar “Plani Kombëtar i vaksinimit ndaj COVID -19” dhe në faqen e ISHP-së paraqitet kalendari aktual i vaksinimit i parashikuar për COVID -19. MSHMS në bashkëpunim me ISHP kanë përgatitur planin kombëtar të vaksinimit ndaj COVID-19, por bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr.15/2016, si edhe në Ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, shërbimi i shëndetit publik ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, nëpërmjet të cilit MSHMS koordinon, pranë Institutit të Shëndetit Publik, zbatimin e imunizimit nga institucionet e kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike.

**Rekomandim 7.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik të rishikojë Programin Kombëtar të Imunizimit dhe të monitorojë zbatimin e imunizimit nga institucionet e kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike, bazuar në nenin 18 të Ligjit 15/2016, si edhe në Ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”.

#### ***Brenda vitit 2022***

**II. Për pyetjen audituese: A kanë qenë efektive masat e marra nga strukturat përgjegjëse për mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes të COVID-19?**

#### **Për MSHMS dhe OSHKSH**

**Gjetje 4:** Situata e COVID-19 nxori në pah se kapacitetet spitalore rajonale, gatishmëria e tyre dhe e qendrave shëndetësore të njësisve të vetëqeverisjes vendore, numri i kufizuar i mjekëve të sëmundjeve infektive, problematikat në stokun e materialeve të mbrojtjes personale, pasiguria në vendin e punës për shkak të pamjaftueshmërisë së trajnimeve dhe informimit mbi përdorimin, veshjen, zhveshjen dhe eliminimin e sigurt të MMP-ve etj., ishin të pamjaftueshme për trajtimin e rasteve me COVID-19.

**Rekomandim 4.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të marrin masa për gatishmërinë e, spitaleve rajonale, qendrave shëndetësore të njësisve të vetëqeverisjes vendore, kapaciteteve profesionale të specialistëve të sëmundjeve infektive në kujdesin shëndetësor parësor,

urgjencës mjekësore duke siguruar rezervat e nevojshme të personelit mjekësor dhe medikamenteve mjekësore, duke investuar me pajisjet e nevojshme mjekësore mbrojtëse dhe trajnimet, për të rritur efektivitetin e shërbimeve shëndetësore dhe menaxhimin e suksesshëm të situatave epidemike në vijimësi.

*Menjëherë*

### **III. Për pyetjen audituese: A ka qenë efektiv funksionaliteti i laboratorëve publik dhe jopublik?**

#### **Për MSHMS**

**Gjetje 1:** Për njohjen e të drejtës së 8 laboratorëve jopublikë për kryerjen e testit RT-PCR për SARS-COV-2, nuk ka referencë ligjore të cituar në Urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 437, datë 23.07.2020 “Për miratimin e procedurës së kryerjes së testeve molekulare RT-PCR për SARS-COV-2, rrjedhimisht kjo vendim marrje nga MSHMS është e pa bazuar dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 10138, datë 11.05.2009, “Për shëndetin publik” pikat 4 dhe 5 të tij. Në kushtet kur laboratorët rajonalë nuk dispononin pajisjet e nevojshme për të evidentuar shkaqet e sëmundjeve infektive, u miratua urdhri i sipërcituar, i cili nuk është në përputhje me bazën ligjore lidhur me procesin e akreditimit të tyre (pikat 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”).

**Rekomandim 1.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për rishikimin e bazës ligjore për të përcaktuar qartë kompetencat dhe procedurat lidhur me akreditimin e laboratorëve mjekësorë jopublikë për Covid-19, në zbatim të plotë të kërkesave ligjore sipas kompetencave të përcaktuara për institucionet përkatëse.

*Brenda vitit 2022*

**Gjetje 2:** Bazuar në Nenin 9 të Ligjit Nr. 15/2016, identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve infektive, me qëllim përcaktimin e diagnozës e kryejnë institucionet shëndetësore publike e jopublike të licencuara. Ndonëse MSHMS ka urdhëruar njohjen e laboratorëve të paakredituar për testimin RT-PCR, nuk ka përcaktuar me urdhër administrativ ofrimin falas ose rimbursim të pjesshëm të vizitave dhe mjekimeve në këto institucione, për më tepër që verifikimi i rasteve pozitiv dërgohej për referencë në ISHP.

**Rekomandim 2.1:** Bazuar në Ligjin Nr. 10138/2009, të ndryshuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masat për hartimin dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të një urdhri administrativ (akt nënligjor) për ofrimin falas/ rimbursim qoftë dhe të pjesshëm, të vizitave dhe mjekimeve në institucionet shëndetësore jopublike, rastet COVID-19.

*Brenda vitit 2022*

**Gjetje 3:** Tre prej spitaleve jopublike të njohura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e RT-PCR për SARS-COV-2 u ka mbaruar periudha e akreditimit dhe bazuar në VKM-në nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”, duhet të jenë të akredituara përpara njohjes nga MSHMS për kryerjen e testimit RT-PCR. S. Gj.– akreditimi 5 vjeçar 2014-2019; S. S. – akreditim 5 vjeçar 2015 – 2020; S.A. 1-akreditim 3 vjeçar 2015-2018 .

Laboratori “I.”, sh.p.k është akredituar për periudhën 2014-2021, nga TUV Austria Albania. Bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 10107/ 2009, të ndryshuar, dhe VKM-në nr. 865, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”, laboratorët mjekësorë përjashtohen nga kjo VKM, dhe bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, akreditimi i laboratorëve testues, mjekësorë dhe kalibrues kryhet nga DPA.

“N. L.” sh.p.k akredituar për periudhën 2018-2022 figuron i akredituar në fushën (ujë, ajër, ushqime), të cilat nuk kanë lidhje me RT-PCR-SARS-COV-2. Më datë 03.04.2020 është



rishikuar akreditimi, duke zgjeruar fushën e akreditimit dhe mbi bazën e kësaj i është njohur e drejta e kryerjes së testimit. “B. D. C.”, është njohur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale më datë 15.12.2020, por nuk figuron në faqen e web-it të DPA-së.

**Rekomandim 3.1:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për rishikimin e akreditimit të institucioneve shëndetësore dhe laboratorëve jopublikë lidhur me bazën ligjore, afatet kohore të vlefshmërisë dhe fushën e akreditimit të tyre.

*Menjëherë*

### 3- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I MASAVE TË MARRA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT NGA ABUZIMET ME PESHËN DHE MATJET”

#### 1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

##### 1.Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në subjektet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë:

- Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 612/10 prot., datë 31.12.2021

- Në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë me shkresën me nr. 612/10 prot., datë 31.12.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;

c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë:** Nga auditimi u konstatua se, MFE ka *miratuar planin e veprimet për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH* duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.13750/9, datë 11.03.2022, jashtë afatit 20 ditor, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja “j”.

**Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka *miratuar planin e veprimet për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH* duke e dërguar në KLSH me shkresë nr.104/1prot, datë 14.01.2022, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja “j”. Subjekti ka përgatitur njoftimin për strukturat përkatëse të saj sipas shkresës të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 103/1 prot, datë 14.01.2022 “Njoftim për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Në lidhje me sa më sipër nga **Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë** ka dërguar raportim të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, gjatë

periudhës që po kryhej auditimi i zbatimit të rekomandimeve dhe konkretisht me shkresën nr 1463/1 datë 18.07.2022, protokolluar në KLSH me nr. 612/13, datë 22.07.2022.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

**Ministria e Financës dhe Ekonomisë** nuk ka raportuar brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”, në kundërshtim me nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

KLSH ka dërguar:

- në **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**, me shkresën nr. 612/10, datë 31.12.2021.  
- në **Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë**, me shkresën nr. 612/10 datë 31.12.2021;  
Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 25 “Masa organizative” për zbatim, nga subjektet janë pranuar 23 masa ose pranimi është në masën 92 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	25	23	2

## II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- E. Ll., Përgjegjës Grupi;
- M. L., Anëtar.
- E. D., Anëtar;

### II.1. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e performancës me temë “Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”.

### II.2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### II.4. Konkluzioni:

Në subjektin e audituar MFE nuk janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për

organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH<sup>në</sup> mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Po kështu nga subjekti MFE, nuk janë marrë masa edhe për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor, afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë janë dërguar respektivisht shkresat për masat e marra në zbatimin e rekomandimeve duke respektuar nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituara Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH<sup>ja</sup>, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Raporti, rezulton se:

- Nga 25 masa organizative të rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 23 masa ose në masën 92 %. Nga 23 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 6 masa ose 26 % tyre, janë në proces zbatimi 13 masa ose 56 % dhe janë pa zbatuar 3 masa ose 13 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	23	6	1	13	3

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	25	100
2	Pa pranuar	2	8
3	Pranuar	23	92
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	6	26
2	Pa zbatuar	3	13
3	Në proces	14	60,86

## II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 26 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi i tyre shkon në nivelin 86,86 %, rekomandimet e pazbatuara në masën 13 %, të cilat i përkasin subjektit MFE.

## III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

### Rekomandime për masa organizative:

#### I. Për pyetjen 4.1.1.1. A është hartuar nga MFE dhe DPM, kuadri rregullator në përputhje me standardet e BE për metrologjinë?

**1. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë periudhës 2018-2020, referuar Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, MFE dhe DPM nuk kanë marrë masa për hartimin dhe miratimin e:

-Projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për etalonët kombëtare të matjes";

-Projektvendimit "Për njësitë tjera të matjes jashtë sistemit SI" në përaftrim të Direktivës nr.

2009/3/KE, e cila bën fjalë për njësitë e temperaturave termodinamike Kelvin<sup>1</sup>;

-Projektvendimit për miratimin e rregullores “Për kërkesat teknike dhe metrologjike të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar”, për harmonizimin me Direktivën nr. 2014/32/KE, në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve matëse<sup>2</sup>. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** MFE dhe DPM të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për etalonët kombëtar të matjes”; “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”; “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara”, me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar të metrologjisë me Guidën nr. 1 versioni 2 (01/2015) EURAMET, Direktivën nr. 2009/3/KE, Direktivën nr. 2014/32/KE, OIML G21 të legjislacionit të BE-së.

#### ***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022***

**Për DPM: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me këtë rekomandim, DPM ka përgatitur njoftimin për strukturat përkatëse të saj sipas shkresës të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 104/1prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, dhe planin e veprimit të MFE për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, miratuar nga Ministri i MFE, me shkresë nr.13750/9, datë 11.03.2022, janë miratuar:

- VKM Nr.324, datë 18.05.2022 “Për përcaktimin e kërkesave dhe kushteve që duhet të plotësojë një standard matjeje për t’u deklaruar etalon kombëtar matjeje;

Linku: <https://www.dpm.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-Nr.324-dt-18.05.2022-Per-percaktimin-e-kerkesave-dhe-kushteve-qe-duhet-te-plotesojne-nje-standard-matjeje-per-tu-deklaruar-etalon-kombetar-matjeje.pdf>

- VKM nr. 261, datë 29.4.2022 “Për njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), që do të përdoren në Shqipëri, njësitë që rrjedhin prej tyre, shumëfishat dhe nënfishat, njësitë shtesë të vendosura ndërkombëtarisht dhe mënyra e përdorimit të tyre”.

Linku: <https://www.dpm.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-Nr.-261-dt-29.04.2022-per-Njesite-Baze-te-Sistemit-Nderkombetar-te-Njesive-SI.pdf>.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar.**

**Për MFE:** Referuar shkresës së KLSH-së me nr.612/10 prot, datë 21.12.2021 “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Performancës, Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” dhe planin e veprimit të MFE për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, miratuar nga Ministri i MFE, me shkresë nr.13750/9, datë 11.03.2022, janë miratuar:

- VKM Nr.324, datë 18.05.2022 “Për përcaktimin e kërkesave dhe kushteve që duhet të plotësojë një standard matjeje për t’u deklaruar etalon kombëtar matjeje;

Linku: <https://www.dpm.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-Nr.324-dt-18.05.2022-Per-percaktimin-e-kerkesave-dhe-kushteve-qe-duhet-te-plotesojne-nje-standard-matjeje-per-tu-deklaruar-etalon-kombetar-matjeje.pdf>

- VKM nr. 261, datë 29.4.2022 “Për njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), që do të përdoren në Shqipëri, njësitë që rrjedhin prej tyre, shumëfishat dhe nënfishat, njësitë shtesë të vendosura ndërkombëtarisht dhe mënyra e përdorimit të tyre”.

Linku: <https://www.dpm.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-Nr.-261-dt-29.04.2022-per-Njesite-Baze-te-Sistemit-Nderkombetar-te-Njesive-SI.pdf>

MFE ka përcjellë në formë zyrtare aktet e miratuara nga Këshilli i Ministrave të sipër përmendura me shkresat datë 26.05.2022 prot 8730/1; datë 08.06.2022 prot 7238/4.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar.**

<sup>1</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009L0003&from=EN>

<sup>2</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0032&from=EN>

**2. Gjetje nga auditimi: a) Përcaktimet në nenin 18** në ligjin nr.126/2020 “Për Metrologjinë” janë në kundërshtim me vetë shkronjën “ç” të nenit 1 “Qëllimi i ligjit”, konkretisht në pikën parashikohet shprehimisht: *ç) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, të cilat janë objekt i markimit CE*<sup>3</sup>. Ky nen lejon lëvizjen e lirë të instrumenteve matës që kanë markimin CE, pavarësisht nëse janë inteligjent ose jo.

Gjithashtu bien në kundërshtim me:

i. Direktivën e BE-së nr.2014/32/EU të datës 26.02.2014 për sa i përket lëvizjes së lirë në treg të instrumenteve matës<sup>4</sup>, paragrafi 13: “Për të siguruar qarkullimin e lirë të instrumenteve matës në Bashkimin Evropian, Shtetet Anëtare nuk duhet pengojnë vendosjen në treg dhe/ose vënien në përdorimi i instrumenteve matëse që mbajnë markën CE dhe shënimi plotësues metrologjik në përputhje me dispozitat e kësaj direktive”.

ii. Direktivën e BE-së nr.2014/31/EU të datës 26.02.2014 për harmonizimin e ligjit të metrologjisë me shtetet anëtare për sa i përket lëvizjes së lirë në treg të instrumenteve jo-automatik të peshave<sup>5</sup>, me parimet e lëvizjes së lirë të mallrave (NAËI), **neni 5 “Lëvizja e lirë e instrumenteve”** - *Shtetet anëtare nuk do të pengojnë vënien në dispozicion të tregut të instrumenteve që plotësojnë kërkesat e kësaj Direktive*. Termi i përdorur “jo inteligjent” nuk ka të bëjë me fushën e metrologjisë.

**b)** Frekuenca e verifikimit periodik të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, referuar praktikave të mira në vendet e rajonit, si: Mali i Zi, Kosova, Serbia, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria<sup>6</sup>, është 1 (një) verifikim në 1-2 vjet, **ndërkohë** sipas **përcaktimeve në pikën 1, të nenit 22** të ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë”, frekuenca e verifikimit në Shqipëri parashikohet 2 (dy) herë në vit, me përcaktimin se në të ardhmen edhe mund të rritet. Rritja e frekuencës së verifikimit metrologjik, sjell rritjen e kostos së subjektit që po përfiton shërbimin e verifikimit, e për rrjedhojë edhe kostot për produkt apo shërbim që do të ofrohet nga ky subjekt ndaj palëve të treta, duke rrezikuar që çmimet e rritura si pasojë e verifikimeve të shpeshta, t’i përballojë hallka e fundit e zinxhirit, që është konsumatori.

**c)** Përcaktimet në **nenin 34, pika 2, të ligjit nr. 126/2020**, trajtojnë ndër të tjera kostot dhe përgjegjësinë pas kryerjes së “*Ekspertizës metrologjike*”. Referuar praktikave të mira, si ligji për metrologjinë në Malin e Zi, në nenin 24<sup>7</sup> të tij, përcaktohet se: “Testimin e jashtëzakonshëm/Ekspertizën Metrologjike” pas një ankese për instrumentin matës, e kryen Byroja e Metrologjisë, si dhe në rast se nga testimi, instrumenti rezulton në rregull, kostot i përballon ankimuesi, ose në rast se ndodh e kundërta, **kostot e testimit i paguan subjekti që ka kryer verifikimin metrologjik**. Për analogji, duke i’u referuar praktikës së mirë, “*Ekspertizën metrologjike/Testimin e jashtëzakonshëm*”, mund ta kryejë Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (dhe jo një trupë ndërkombëtare e akredituar) dhe në rast se nga testimi, instrumenti rezulton në rregull, shpenzimet duhet t’i paguajë ankimuesi, ose në rast se ndodh e kundërta, shpenzimet duhet t’i paguajë koncesionari/subjekti i autorizuar nga DPM, i cili ka kryer verifikimin e instrumentit në fjalë; **ndërkohë** sipas nenit 34 të ligjit të metrologjisë, në rast se, instrumenti nuk rezulton në rregull, **megjithëse jo për shkak të përdoruesit të tij**, kostot i paguan përdoruesi i instrumentit matës, duke përjashtuar kështu rastet kur shkak mund të jetë subjekti privat që ka bërë verifikimin jo të saktë.

**d)** Përcaktimet në **nenin 48 dhe 50** të ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë”, bien në kundërshtim me Kreun II “Qëllimi dhe parimet e inspektimit”; Kreun III “Organizimi dhe

<sup>3</sup> Ligji nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Markim CE” është markimi, me të cilin prodhuesi tregon që produkti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

<sup>4</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0032>

<sup>5</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0031&qid=1635418184908>

<sup>6</sup> <https://ëëë.ëëlmec.org/legal-metrology-information/country-information/country>

<sup>7</sup> [https://metrologija.me/ëp-content/uploads/zakonodavstvo/eng/Laë\\_Metrology.pdf](https://metrologija.me/ëp-content/uploads/zakonodavstvo/eng/Laë_Metrology.pdf)

funksionimi i inspektorateve në nivel qendror dhe vendor”; kreun IV “Rregulla të përgjithshme për programin e inspektimit”, dhe Kreun V “Procedura e inspektimit në ligjin nr.10433”, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: *vetëm institucionet shtetërore të nominuara inspektorate në bazë të ligjit kryejnë detyra inspektimi dhe ndërmarrin sanksione administrative*. Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 48 të ligjit të metrologjisë, ka një trajtim me dy standarde, pasi kur verifikimi metrologjik i instrumenteve matës kryhet nga koncesionari/subjekti i autorizuar, inspektimi metrologjik përfshin vetëm ekzaminimin fizik dhe dokumentar të produkteve apo proceseve objekt të këtij ligji dhe jo atë laboratorik (sikundër ndodh në rast se ky shërbim ofrohet nga DPM), duke implikuar kështu inspektime më pak të thelluara në rastet e subjekteve private. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**2.1 Rekomandimi:** Me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen, si dhe përafrimin e ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë” me direktivat e BE-së, Ministria e Financës dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin rast pas rasti të gjetjeve më sipër, me qëllim propozimin në Këshillin e Ministrave, të ndryshimeve ligjore në ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, konkretisht:

-Në nenin 18, të hiqen pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6.

-Në pikën 1 të nenit 22, të shtohet paragrafi “Analiza e riskut dhe problematikave në treg, lidhur me instrumentet matës, me qëllim dyfishimin e periodicitetit të verifikimit, të bëhet nga një grup i përbashkët pune ndërmjet DPM dhe ISHMT dhe pas miratimit nga ky grup, të vihet në zbatim rritja e periodicitetit të verifikimeve të instrumenteve matës”.

-Në vijim të shtohet paragrafi “Subjektet private juridike të autorizuar me një nga format e legjislacionit në fuqi të raportojnë periodikisht pranë ISHMT dhe DPM, problematikat e ndeshura në treg lidhur me instrumentet matëse”, me qëllim që ky raportim të shërbejë për DPM dhe ISHMT për vlerësimin e riskut.

-Në shkronjën “b” të pikës 2, të nenit 34, të riformulohet paragrafi si vijon: “përdoruesi i instrumentit matës kur nga testimi i jashtëzakonshëm rezulton që instrumenti është jo në përputhje me kërkesat metrologjike, vetëm nëse provohet se, instrumenti nuk është në përputhje me kërkesat metrologjike për shkak të ndërhyrjes së palejuar të vetë përdoruesit.

Në vijim të shtohet shkronja “c” me përmbajtje: “subjekti që ka kryer shërbimin e verifikimit metrologjik, në rastin kur provohet se në instrumentin matës nuk është bërë asnjë ndërhyrje nga përdoruesi i tij”.

-Pika 2 e nenit 48, të riformulohet si vijon: “Kur ka dyshime për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, si pasojë e një informacioni të ardhur nga të tretë, apo ankese, ose një vlerësimi rrisht nga inspektoriati, sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar, inspektimi metrologjik mund të përfshijë edhe ekzaminimin laboratorik për të realizuar kontrollin e përcaktuar në pikën 1 këtij neni”.

-Në vijim në shkronjën “c” të pikës 3, të nenit 48, të hiqet paragrafi: “përveç rasteve të kryerjes së verifikimit nëpërmjet inspektimit nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një format e parashikuara në legjislacionin në fuqi”.

-Në pikën 3 të nenit 50, të hiqet shprehja: “personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi”.

*Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022*

**Për MFE:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE argumenton se: Ligji nr.126/2020 “Për metrologjinë” është miratuar në 15.10.2020. Aktet nënligjore në zbatim të tij janë drejt miratimit, sipas propozimit të DPM dhe në koordinim nga MFE. Ka kaluar vetëm një vit kalendarik nga miratimi i këtij ligji. Institucionet të cilat e hartojnë, implementojnë dhe vlerësojnë ligjin, duhet të kenë kohën e mjaftueshme në dispozicion për të kryer këtë vlerësim, sipas fushës së përgjegjësisë duke parë se ligji i metrologjisë nr.126/2020 do të ketë impakt në treg. Për këtë

arsye, rivlerësimi i ligjit *në një periudhë kaq të shkurtër* është i pamjaftueshëm për të dalë në një vlerësim të qenësishëm. Për sa më sipër, rishikimi i ligjit është planifikuar të bëhet gjatë vitit 2023 – 2024. Lidhur me ndryshimet ligjore të propozuara në nenin 18, MFE informon se, këto formulime sipas pikave të këtij neni të referuara në raport janë bërë nga Komisioni Parlamentar i Veprimtarisë Prodhuese.

**Statusi i rekomandimit: *I pranuar dhe në proces.***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga krahasimi i Projektligjit të publikuar në Web<sup>8</sup> me ligjin e miratuar nr. 126/2020 “Për Metrologjinë”, rezultuan ndryshime në kompetencat e DPM-së. Në Projektligj, në pikat 10 dhe 13 të nenit 8 “Detyrat dhe kompetencat e DPM”, përcaktohet se: “DPM kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar; dhe DPM autorizon dhe monitoron persona juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, ekspertizën metrologjike bazuar në kërkesat e përshkuara”; **ndërsa** referuar ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, në nenin 8, pikat 10 dhe 13, përcaktohet se: “DPM kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjisllacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë privatë; si dhe DPM autorizon dhe monitoron personat juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, bazuar në kërkesat e përshkuara, përveç rasteve kur këto shërbime u janë dhënë personave juridikë privatë me një nga format e parashikuara në legjisllacionin në fuqi”. Ndryshimi i kompetencave të DPM-së nuk ka gjetur reflektim as në raportin e vlerësimit të ndikimit<sup>9</sup>, ku në opsionin respektiv, edhe pse shërbimi i metrologjisë ligjore për karburantin dhe gazin e lëngshëm është dhënë me koncesion, kanë vijuar të reflektohen të ardhurat e krijuara nga DPM për këtë shërbim. Sa më sipër, jo vetëm cenon parimin e transparencës gjatë procesit të njoftimit e konsultimit publik<sup>10</sup>, por gjithashtu nuk jep siguri që vlerësimi ekonomik i skenarëve sipas raportit të vlerësimit të ndikimit, të ketë mbështetur ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”. Në këtë mënyrë, si dhe duke pasur në konsideratë të ardhurat e DPM, realizuar nga shërbimi i mësipërm në një vit kalendarik<sup>11</sup>, përcaktimet e bëra në ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, do të ndikojnë direkt në reduktimin e të ardhurave të DPM-së, e për rrjedhojë në të ardhurat e buxhetit të shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** MFE të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi me qëllim analizën e situatës dhe verifikimin e raportit të analizës ekonomike-financiare të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, me qëllim dokumentimin e plotë të procedurës së hartimit dhe miratimit të këtij ligji dhe publikimin e versionit përfundimtar, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në faqen zyrtare të konsultimit publik, si dhe në faqen zyrtare të MFE-së.

**Menjëherë**

### **Për MFE**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në zbatim të ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, MFE bën me dije se Ligji nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, ku palët e interesuara janë pajisur me informacionin e nevojshëm për t’u krijuar atyre mundësinë të kontribuonin në mënyrën më efektive të mundshme në procesin e përgatitjes së projekt aktit.

<sup>8</sup> [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al)

<sup>9</sup> [www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243](http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243)

<sup>10</sup> Në kundërshtim me (neni 5 i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”)

<sup>11</sup> DPM në një 1 vit kalendarik, ka arkëtuar 76,000,000 lekë, vetëm nga tarifa e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ose 60% të të ardhurave gjithësej, që arkëton DPM.



Ligji “Për Metrologjinë” është publikuar në Regjistrin Elektronik e cila është faqja zyrtare e internetit ku publikohen projekt aktet, sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin Publik”.

Në zbatim të VKM nr.584, datë 28.08.2003 “Për miratim e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, projekt ligji paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, së bashku me relacionin dhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA), në këto kushte Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit 3.1, kur të propozojë ndryshimet ligjore të ligjit “Për metrologjinë”, sipas rekomandimit nr. 2.1. procedurat për analizën ekonomike financiare do të fillojë në vitin 2023.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces.**

**4.Gjetje nga auditimi:** Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ka sjell që, investimet e kryera në DPM në vlerën prej 63,975,994 lekë, për blerjen e auto laboratorëve dhe pajisjeve (**që mund të përdoren vetëm për verifikimin e këtyre instrumenteve**), të mos i shërbejnë më qëllimit për të cilin ato janë shpenzuar, duke i bërë jo efektive dhe jo eficiente, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 24 dhe 25, të nenit 3, shkronjën “ç” të nenit 4, shkronjën “b” të nenit 19, të ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, për transferimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit/Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, të auto laboratorëve dhe pajisjeve në vlerën 63,975,994 lekë, përdorur për kryerjen e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me qëllim shitjen e tyre/vendosjen në përdorim, si dhe eliminimin e efekteve negative financiare.

*Brenda 6 muhujit të parë të vitit 2022*

#### **Për DPM**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Referuar shkresës së KLSH-së me nr.612/10 prot, datë 31.12.2021 “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Performancës, Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së me nr.104/1prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 4.1, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë i është drejtuar Ministres së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përmes shkresës nr.142 prot, datë 19.01.2022, “Për transferimin e Auto laboratorëve të naftës & gazit”. Gjithashtu, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut me shkresën nr.538/1 prot, datë 24.03.2022 “Kthim përgjigje në lidhje me transferimin e auto laboratorëve të naftës dhe gazit të lëngshëm”, refuzon marrjen e auto laboratorëve.

DPM është në pritje të përgjigjes së MFE-së për vazhdimin e procedurës për transferimin ose jo, të auto laboratorëve tek Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë shqyrtimit të ligjit nr. 126/2020 dhe paralelisht me të edhe të kontratës koncesionare, rezultoi se, shoqërisë koncesionare i është dhënë e drejta e inspektimit dhe marrjes së masës administrative të bllokimit të instrumenteve matës, ndërkohë që ajo është shpallur fituese që në krye të herës vetëm për ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës, sepse funksionin e inspektimit metrologjik dhe marrjes së masës administrative, e kryen Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. Theksojmë se, ofrimi i mundësisë ndaj subjektit privat që tashmë kryhen shërbimin e verifikimit metrologjik, që të kryejë edhe inspektimin/bllokimin e instrumenteve matës, mund të krijojë hapësira për konflikt interesi, duke ndikuar negativisht në transparencën, trajtimin e barabartë

dhe jodiskriminues të subjekteve, që tregtojnë karburant, si dhe për rrjedhojë në uljen e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e konsumatorit. Këto përcaktime bien në kundërshtim me pikën 1 të nenit 7 të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, si dhe Kreun II, IV, dhe V në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Për më tepër që arsyeja kryesore e ndarjes së inspektimit metrologjik nga strukturat e DPM-së ishte për arsye që i njëjti institucion që kryen shërbimin e verifikimit, të mos ndërmarrë dhe sanksione administrative, ndërkohë që nëpërmjet kontratës konçesionare, jemi duke u rikthyer në situatën e mëparshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** MFE të marrë masat e nevojshme që pas propozimit në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, të ngrejë një grup pune për të analizuar mbivendosjet e detyrave të koncesionarit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim eliminimin e tyre në kontratën koncesionare nr.15326 prot., datë 21.08.2019.

*Menjëherë*

### **Për MFE**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se nuk e pranon rekomandimin, pasi nuk ka mbivendosje të detyrave të ISHMT-s me kontratën koncesionare.

**Statusi i rekomandimit:** *I pa pranuar dhe i pa zbatuar.*

**6. Gjetje nga auditimi:** Referuar kontratës koncesionare, në lidhje me monitorimin, në nenin 13.2 parashikohet se AK, nëpërmjet NJZP (Njësisë së Zbatimit të Kontratës) **ka të drejtë** që në periudhë kohore prej 24 muajsh, të monitorojë në vend objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Nën gjykimin e pavarur të audituesit, monitorimi, që t’i shërbejë qëllimit, duhet të jetë **detyrim** më shumë se e drejtë; nga ana tjetër neni 13.2.1 parashikon se AK ngre NJZP, si njësi që ngarkohet me mbikëqyrjen e ecurisë së kontratës, por nuk parashikon ekspertizën që duhet të ketë kjo njësi në përbërjen e saj. Konkretisht, NJZP **nuk** ka në përbërjen e saj specialist të fushës, në rastin konkret metrolog, me qëllim mbikëqyrjen nga ana teknike të shërbimit që ofrohet nga subjekti juridik privat, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 8 të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 13, paragrafi 13.2 të kontratës koncesionare dhe Guidave të OIML D1<sup>12</sup>, paragrafi 5.3.5 “Përfshirja e sektorit privat/tregtar në metrologji”, si dhe Weights and Measures Program Requirements – Kërkesat e programit të peshave dhe matjeve, të NIST-Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.<sup>13</sup>”

-Raportet periodike për titullarin e MFE-së, të përgatitura përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 nga njësia e monitorimit të zbatimit të kontratës së dhënies me koncesion të shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, **përmbajnë informacion identik** me informacionin që pasqyrohet në raportet periodike të subjektit juridik privat, çfarë rrezikon që monitorimi i shërbimit të mos ofrojë siguri mbi ecurinë e projektit, cilësinë e shërbimit të ofruar dhe konformitetin në përputhje të mos jetë bërë sipas përcaktimeve të bëra në pikat 13.2 dhe 13.3 të nenit 13, të kontratës nr.15326, datë 21.08.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Me qëllim zbatimin e kontratës koncesionare, lidhur me monitorimin e saj, MFE të marrë masat e nevojshme që të hartojë një **manual të posaçëm për procedurat e monitorimit** të zbatimit të kontratës së shërbimit metrologjik, ku pjesë e tij të jenë edhe procedura dhe metodologjia e monitorimit në terren, të shërbimit të verifikimit metrologjik,

<sup>12</sup>[https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d001-e20.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d001-e20.pdf)

<sup>13</sup> <https://www.nist.gov/system/files/documents/2017/04/28/hb-155-final.pdf>

sipas një analizë risku.

### *Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

#### **Për MFE**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se nuk e pranon rekomandimin, pasi kontrata e koncesionit i ka të parashikuara qartë mekanizmat për monitorimin e kontratës si NJZP dhe Task Force. Pjesë e kësaj Task Force mund të jenë ISHMT, DPM e DPT, si struktura në varësi të MFE të cilat janë të specializuara për kryerjen e monitorimit në terren të aktivitetit të shoqërisë koncesionare.

**Statusi i rekomandimit: I pa pranuar dhe rrjedhimisht i pazbatuar.**

**6.2 Rekomandimi:** Gjithashtu, MFE të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e njësisë së monitorimit pranë MFE, të përfshihen **specialistë metrologë** të DPM-së/ISHMT-së, me qëllim rritjen e garancisë se po jepet shërbimi me cilësinë dhe kriteret e kërkuara, prej subjektit juridik privat.

### *Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se pranon rekomandimin dhe shpreh gatishmërinë për marrjen e masave për zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve monitoruese të kësaj kontrate duke përfshirë edhe përfaqësues të tjerë teknikë të fushës së metrologjisë. Nuk ka masa konkrete nga kjo Drejtori në lidhje me çfarë shprehet në plan veprimin e datës 11.03.2022.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i pa zbatuar.**

**6.3 Rekomandimi:** Të rishikohen:

- neni 13.2.2 i kontratës koncesionare dhe të korrigojohet si vijon: “AK nëpërmjet NJZP **ka detyrimin** që në periudha kohore prej 24 muajsh gjatë gjithë periudhës së koncesionit të monitorojë në vend objektin e koncesionit (...)”;
- neni 13.3 të korrigojohet si vijon: “AK **ka detyrimin** të ushtrojë mbikëqyrje të përgjithshme nëpërmjet shqyrtimit të raporteve që dorëzon Koncesionari (...)”

### *Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se e ka pranuar pjesërisht rekomandimin, pasi rishikimi i neneve specifike të kontratës do të bëhet në bashkëpunim dhe do të vijë si rezultat i negociatave të të dyja palëve që kanë nënshkruar kontratën. Për sa më sipër është ngritur grupi i Punës sipas Urdhrit të Ministrit nr. 207 datë 16.11.2021, për negocimin e kësaj kontrate. Ky grup pune kryesohet në nivel Zëvendës ministri dhe ka në përbërjen e tij: Krye Inspektorin e ISHMT-së, DP e DPM si dhe institucionet përgjegjëse për fushën e metrologjisë i cili pas shqyrtimit, negocimit dhe vendim marrjes me përfaqësuesit e shoqërisë koncesionare lidhur me këtë rekomandim do të dalë me konkluzionet përkatëse. Nuk u paraqitën nga MFE konkluzione konkrete nga grupi i punës deri në korrik 2022.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga DPM nuk janë hartuar kriteret dhe rregullat për përcaktimin e zonës, në të cilën do të ushtrojë veprimtari të metrologjisë ligjore, subjekti privat i autorizuar prej DPM-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të pjesës I të Urdhrit të Ministrit të MZHETS nr.7025, datë 24.08.2017 “Për miratimin e rregullores për autorizimin e personave juridik për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e kriterëve

dhe rregullave për përcaktimin e zonës në të cilën do të ushtrojë veprimtari të metrologjisë ligjore, subjekti i autorizuar.

**Menjëherë**

#### **Për DPM**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Referuar shkresës së KLSH-së me nr.612/10 prot, datë 31.12.2021 “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Performancës, Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së me nr.104/1prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 7.1:

Është miratuar nga Ministri i MFE, urdhri nr.149, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe për monitorimin e aktivitetit/performancës së tyre”, e cila është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë nëpërmjet shkresës nr. 9105/1 prot, datë 28.06.2022 dhe protokolluar në DPM me nr. 1340 prot, datë 29.06.2022. Në vazhdim është planifikuar hartimi dhe miratimi i kriterëve për përcaktimin e zonës në të cilën do të ushtrojë veprimtari të metrologjisë ligjore, subjekti i autorizuar.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar.**

#### **II. Për pyetjen 4.1.1.2. A ka qenë efektive MFE në mbështetjen financiare të DPM-së, për zhvillimin e sistemit të metrologjisë?**

**8. Gjetje nga auditimi:** Produktet si: “Akreditimi”, “Kalibrimi”, dhe “Verifikimi”, përgjatë periudhës 2018-2020, rezultuan të jenë kryer me kosto më të lartë se objektivat e PBA dhe SNMKMT 2014-2020<sup>14</sup>, si dhe treguesit e performancës të DPM nuk janë realizuar me efektivitet, si pasojë e mosrealizimit të: (i) 12 akreditimeve të laboratorëve dhe njohje CMC; (ii) 2,758 kalibrimeve dhe (iii) 54,996 verifikimeve, në kundërshtim me pikat 24 dhe 25 të nenit 3, shkronjën “ç” të nenit 4, shkronjën “b” të nenit 19, të ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar. Kjo situatë është ndikuar edhe për shkak të kalimit tek subjektit privat me koncesion, të shërbimit të verifikimit (12,400 verifikime) të 6200 shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ndërsa për vitin 2020 edhe për shkak të pandemisë Covid 19. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.2, faqet 33-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme që të rishikojë planet strategjike dhe operacionale, si një domosdoshmëri për përmirësimin e performancës dhe të efektivitetit së saj, në realizimin e programit buxhetor.

**Në vijimësi**

#### **Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Referuar shkresës së KLSH-së me nr.612/10 prot, datë 31.12.2021 “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Performancës, Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së me nr.104/1prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 8.1, është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 20, datë 18.01.2022, “Për rishikimin e planeve strategjike dhe operacionale për përmirësimin e performancës dhe efektivitetin e DPM-së”. Gjithashtu, është planifikuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023-2030, përmirësimi i

<sup>14</sup> Sipas PBA 1.3 lekë, ndërkohë sipas faktit 1.5 lekë.

performancës dhe të efektivitetit të DPM-së duke propozuar hapje fushash të reja, zgjerim i fushave ekzistuese, rritje e numrit të kalibrimeve/verifikimeve, akreditim laboratorësh.  
**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces.**

### **III. Për pyetjen 4.1.2.1. A janë realizuar objektivat strategjikë për metrologjinë nga DPM?**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aktivitetit të DPM-së në bashkëpunim me MFE, referuar planit të veprimit afatgjatë 2016-2020 në Strategjinë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut (SNMKMT) dhe Strategjisë Sektoriale “Për zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri” miratuar me VKM nr.272, datë 05.03.2008, rezultoi se, **nuk janë realizuar objektivat strategjikë**, si më poshtë vijon:

- Kryerja e verifikimeve periodike e instrumenteve matës në përdorim në masën 10% më shumë se viti paraardhës. Përfunduar vitin 2020, për shkak të pandemisë Covid-19, numri i verifikimeve është rritur me rreth 7% çdo vit;
- Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për etalonet kombëtare”, aktualisht është në variantin “Draft”, propozuar nga DPM;
- Koordinimi me Institutin e Fizikës Bërthamore, që të ketë matje të rrezatimit jonizues;
- Krijimi i 14 fushave të reja matjesh;
- Sigurimi i shërbimeve elektronike dhe mekanike në universitete dhe në industri në lidhje me riparimin, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të matjeve;
- Kryerja e trajnimeve të rregullta për industrinë, në të pakën 30 fusha, duke përfshirë metrologjinë e përgjithshme dhe vlerësimin e pasaktësive;
- Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorët e termometrisë nga EURAMET;
- Deklarimi në databasën të BIPM<sup>15</sup>-së të fushave të matjes. Aktualisht, DPM ka vetëm 3 fusha të deklaruara (masë, presion dhe volum);
- Përfshirja në skemën e kontrollit metrologjik ligjor të dy instrumenteve matës në fushën e mjekësisë;
- Realizimi i 10,750 kalibrime në fushën e masës, forcës, volumit, gjatësisë, presionit, temperaturës, matjeve elektrike, lagështirës, kohë-frekuencës, densitetit (janë realizuar rreth 7,500 kalibrime);
- Ngritja e laboratorëve të kohë-frekuencës, të kontrollit të zhurmave dhe të kontrollit të instrumenteve matës në fushën e shëndetësisë;
- Realizimi i fushatave ndërgjegjëse për biznesin;
- Akreditimi i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akreditues nënshkrues të MLA me EA në fushën e kalibrimeve;
- Zgjerimi i bazës etalonuese në 7 fusha të reja matje: laboratorin e masës, elektrikut, rrjedhjeve, optikës, përdredhjeve, gjatësisë dhe presionit;
- Hartimi i VKM “Për bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve”;
- Gjithashtu, rezultoi se, nga DPM nuk është hartuar strategjia e zhvillimit të metrologjisë, referuar përcaktimit të bërë në nenin 8 të ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, në fuqi deri në Dhjetor të vitit 2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.1, faqet 38-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** DPM në bashkëpunim me MFE të marrin masat e nevojshme, për hartimin dhe miratimin e strategjisë së posaçme për zhvillimin e metrologjisë, pjesë e të cilës të jenë edhe objektivat e mësipërm, në koherencë me ndryshimet ligjore në fushën e

---

1. <sup>15</sup> Byroja ndërkombëtare e peshave dhe masave, si organizmi më i lartë në të cilin deklarohen aftësitë matëse dhe kalibruese të instrumenteve matës, ç’ka sjellë që certifikatat e kalibrimit të lëshuara nga ky laborator do të njihen ndërkombëtarisht.

metrologjisë, të porealizuar deri në fund të vitit 2020.

**9.2 Rekomandimi:** Gjithashtu DPM të marrë masat e nevojshme, që të kryejë ri kalibrimin e etaloneve kombëtar, në laboratorët e vendeve anëtare të BIPM, duke vlerësuar mundësitë reale për ta kryer vetë këtë shërbim, me qëllim reduktimin e kostove, kohës së realizimit, si dhe rritjen e sigurisë së transportit të etaloneve.

#### *Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi*

##### **Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Referuar shkresës së KLSH-së me nr.612/10 prot, datë 31.12.2021 “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Performancës, Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së me nr.104/1prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pikat 9.1 dhe 9.2 janë realizuar:

Strategjia e zhvillimit të Metrologjisë është përfshirë në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023-2030. DPM ka propozuar emrat e përfaqësuesve të saj në këtë grup (ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 96, datë 10.06.2022) dhe ka nisur puna për hartimin e draftit paraprak. Gjithashtu, Strategjia e Zhvillimit të Metrologjisë është përfshirë në draftin fillestar të Strategjisë Kombëtare “Për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030”(SKZHIE), ngritur me urdhrin e Ministres së MFE-së nr.61, datë 18.02.2022.

##### **Statusi i rekomandimit 9.1: *I pranuar dhe në proces.***

**Në lidhje me rekomandimin 9.2,** nga DPM është miratuar Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 32, datë 24.01.2022, “Për hartimin e strategjisë dhe planin afatgjatë për zhvillimin e etaloneve kombëtar të matjeve”. Janë përgatitur specifikimet teknike dhe fondi limit për listën e instrumenteve matës të laboratorëve të DMSHI-së (referuar planit të kalibrimit të etaloneve për vitin 2022), si dhe ka filluar procesi i tenderimit për këtë shërbim, me fondet e buxhetit të shtetit. Është mbyllur procedura e kalibrimit të një pjese të etaloneve të laboratorit elektrik të DMSHI-së në Institutin e Metrologjisë (EIM), Selanik, Greqi, si dhe janë dërguar një pjesë e etaloneve të laboratorit të masës të DMSHI-së për kalibrim në Institutin e Metrologjisë (INRIM), Torino, Itali. Dy praktikat e fundit janë mbështetur nga projekti rajonal “Fondi i Konsulencës për Infrastrukturën e Cilësisë në Evropën Juglindore”, në bashkëpunim me Institutin e Metrologjisë së Gjermanisë (PTB).Nga sa më sipër grupi i auditimit të KLSH-së arrin në konkluzionin se DPM për ri kalibrimin e etaloneve kombëtar, në laboratorët e vendeve anëtare të BIPM, ka operuar në të njëjtën mënyrë duke filluar procesin e tenderimit për këtë shërbim dhe jo reduktimin e kostove, kohës së realizimit, si dhe rritjen e sigurisë së transportit të etaloneve, sikurse është rekomandimi.

##### **Statusi i rekomandimit 9.2: *I pranuar dhe i pazbatuar.***

#### ***IV. Për pyetjen 4.1.2.2. A janë mirë administruar burimet njerëzore dhe financiare nga DPM në funksion të realizimit të objektivave institucional?***

**10. Gjetje nga auditimi:** Në fund të vitit 2020, të punësuarit në sektorin e Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML), që kryejnë verifikimin metrologjik, që nuk kanë formimin arsimor sipas kërkesave të Urdhrit të Ministrit të METE nr. 192, datë 09.03.2008<sup>16</sup>, janë rreth **25 punonjës nga 53** të punësuar efektivisht, ose rreth 47%.

- Specialistët metrolog të DML nuk janë testuar nëpërmjet provimit të kualifikimit për

<sup>16</sup>Për përcaktimin e kritereve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t'u kualifikuar si metrolog i autorizuar”

njohuri të mjaftueshme në fushën e metrologjisë ligjore, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të METE nr. 192, datë 09.03.2008 “Për përcaktimin e kritereve të përgjithshme, që duhet të përmbushë kandidati për t’u kualifikuar si metrolog i autorizuar”;

- DPM nuk ka një program vjetor të miratuar, për zhvillimin e aftësive profesionale të personelit të saj, kryesisht të specialistëve metrolog të saj, me përjashtim të specialistëve të laboratorëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme, referuar ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 8, pika 15;

- Nga DPM nuk janë miratuar rregullat dhe mënyra për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të saj, referuar ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 8, pika 15;

- Specialistët e laboratorëve të masës, që gjenden pranë Sektorëve Rajonal Lezhë, Fier dhe Korçë (në Sektorin Rajonal të Tiranës, nuk ka ambiente dhe pajisje laboratorike) të DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk kanë kryer asnjë shërbim laboratorik<sup>17</sup>;

- Rregullorja e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014 e DPM-së, **nuk** është rishikuar dhe si pasojë nuk reflekton ndryshimet që ka pësuar DPM në strukturën dhe funksionet e saj, për shkak të ndryshimeve ligjore në ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar. Gjithashtu nga shqyrtimi i saj, rezulton se nuk ka një ndarje të qartë të detyrave sipas pozicionit të punës, ku disa detyra janë të njëjta për pozicionin e drejtorit, përgjegjësit dhe specialistit të sektorit, p.sh., në DMSHI, ku edhe specialisti përgjigjet për propozime të ndryshimeve ligjore, hartimin e materialeve trajnuese, etj. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.2, faqet 40-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme, duke reflektuar ndryshimet në legjislacion, ndryshimet në strukturë, si dhe duke qartësuar detyrat për çdo pozicion pune.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**10.2 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, që të kryejë trajnime për zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive të tyre.

*Në vijimësi*

#### **Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Referuar shkresës së KLSH-së me nr. 612/10 prot, datë 31.12.2021 “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Performancës, Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së me nr.104/1prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pikat 10.1 është realizuar ngritja e grupit të punës sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së nr.22, datë 18.01.2022, “Për hartimin e rregullores së brendshme të DPM-së”. Grupi i punës ka përgatitur draft rregulloren e brendshme të DPM-së, duke u mbështetur në VKM nr. 325, datë 18.05.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë” dhe ka filluar procedurat për miratimin e saj në Ministri.

Linku: <https://www.dpm.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-Nr.325-dt.-18.05.2022-Per-organizimin-dhe-funksionimin-e-DPM.pdf>

**Statusi i rekomandimit:** *I pranuar dhe në proces.*

#### **Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 10.2, është miratuar urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 149, datë 06.04.2022 “Për organizimin e trajnimeve të nevojshme për zhvillimin e aftësive profesionale për specialistët (metrolog të autorizuar) të

<sup>17</sup>Pasqyruar në tabelën nr.1 në Kapitullin Shtojcat.

sektorëve të shërbimeve të DML-së”. Është miratuar urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr.152, datë 08.04.2022 “Për miratimin e programit të trajnimit për punonjësit e rinj të DML-së”. Gjatë 6-mujorit të parë vitit 2022 janë organizuar trajnime në fushën e para paketimeve për punonjësit që ofrojnë këtë shërbim në 4 (katër) sektorët e shërbimeve të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML-së). Në vazhdim janë planifikuar trajnime sipas fushave specifike, në çdo sektor, mbështetur në planet e miratuara.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar.**

**11. Gjetje nga auditimi:** Sektori Rajonal Tiranë (zyra laboratorë dhe ambiente shërbimi-479 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe bodrumi 429,7 m<sup>2</sup>) me vlerë 21,076,136 lekë është në pronësi të DPM-së, por në përdorim të Drejtorisë së Akreditimit. Sektori i shërbimit nr.1 Tiranë, me numrin më të madh të specialistëve metrologë të autorizuar (21 punonjës) dhe që mbulon tre prefekturat Tiranë, Durrës dhe Elbasan, është zhvendosur në një apartament banimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, duke ndikuar ndjeshëm në performancën e veprimtarisë së këtyre specialistëve për mungesë të hapësirave të vendit të punës dhe ruajtjes dhe pajisjeve të nevojshme.

- Në sektorin e shërbimeve nr.2 në Fier, laborator i masës me vlerë 3,606,157 lekë nuk është vendosur në përdorim dhe duke qenë në kushte të tilla, të gjitha pajisjet e punës humbin së shpejti karakteristikat teknike duke dalë jashtë përdorimit. Veç kësaj është jashtë punë pajisja e kontrollit për matje vëllimore me vlerë 1,991,600 lekë.

- Në sektorin e shërbimeve nr.3 në Lezhë, pajisjet laboratorike me vlerë 6,966,960 lekë nuk janë përdorur për qëllime metrologjike, për arsye të mungesës së aplikimeve për shërbime nga palët e treta.

- Në sektorin e shërbimeve nr.4 Korçë, ndodhet pajisja enë vëllimore për kontroll karburanti me vlerë 1,974,000 lekë, për të cilën nuk lind nevoja e përdorimit, pasi është zëvendësuar me auto laboratorë për karburantet, por edhe me ndryshimet ligjore, tashmë këtë lloj verifikimi DPM-ja nuk mund ta kryej më.

- Procedura e faturimit të shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës kryhet sipas një rregulloreje të brendshme të vitit 2010, miratuar me Urdhrin nr.373, datë 20.10.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM në detyrë për atë periudhë, ku në zbatim të saj, në 60-70% të rasteve, është i njëjti punonjës (pra, specialisti metrolog) që kryen verifikimin e instrumentit matës, lëshon faturën për pagesën e shërbimit të verifikimit, si dhe arkëton me para në dorë tarifën e shërbimit, pra jo nëpërmjet bankës. Kjo mënyrë veprimi është në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “c” në pikën 4, të nenit 3 në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; pikat 7, 61, 63 dhe 64 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Theksojmë se të ardhurat që mund të gjenerojë në ditë një metrolog nga verifikimi i instrumenteve matës variojnë nga 1,000 lekë – 20,000 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.2, faqet 40-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e mundësisë së përdorimit/jo të pajisjeve laboratorike pranë Sektorëve Rajonal, si dhe në rast se këto pajisje nuk mund të gjejnë përdorim nga DPM, në kryerjen e funksioneve rutinore të saj, të transferohen pranë rezervave të shtetit.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022*

**11.2 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme për shfuqizimin e Urdhrit nr.373, datë 20.10.2010 “Për plotësimin dhe administrimin e dokumentacionit financiar dhe atij me numër serie që përdoret nga strukturat e DPM-së”, si dhe pagesa e tarifës së shërbimit të bëhet nëpërmjet bankës.

*Menjëherë*



### **Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 11.1, sipas planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 11.1, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së me shkresën nr.104/1prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, është nxjerrë Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 31, datë 24.01.2022 “Për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas SSH ISO/IEC 17020:2012 në metrologjinë ligjore”. Ka nisur procesi i hartimit të Manualit të Cilësisë së DPM, me qëllim krijimin e sistemit të Menaxhimit të Cilësisë për plotësimin e kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012. Është hartuar materiali trajnues për njohjen dhe zbatimin e kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012 “Vlerësimi i konformitetit-Kërkesat për funksionimin e tipeve të ndryshme të trupave që kryejnë inspektim” dhe është planifikuar trajnimi për punonjësit e metrologjisë ligjore. Është në proces rishikimi dokumentacioni teknik për fushën specifike, ku do implementohet ky standard dhe është realizuar kalibrimi i etaloneve të punës të Sektorëve të Shërbimit nr. 1 Tiranë (fusha e volumeve), nr. 3 Lezhë (fusha e masës), nr. 2 Fier (fusha e masës), duke ju referuar planeve të miratuara.

### **Statusi i rekomandimit 11.1: I pranuar dhe në proces**

Në lidhje me rekomandimin 11.2, nga DPM është shfuqizuar Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së nr. 373, datë 20.10.2010, “Për plotësimin dhe administrimin e dokumentacionit financiar dhe atij me numër serie që përdoret nga strukturat e DPM-së”, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së nr. 21, datë 18.01.2022, “Për shfuqizimin Urdhri”. Është përgatitur nga DPM, draft udhëzimi “Për tarifatat dhe mënyrën e pagesës së tarifave” në zbatim të Ligjit 126/2020, dt 15.10.2020 ”Për Metrologjinë “para ardhjes së RPA të KLSH-së, dhe në vazhdimësi të rekomandimeve të grupit të auditimit të KLSH-së ka vazhduar komunikimi me MFE dhe grupet e interesit duke dërguar në MFE për konsultim dhe miratim me shkresat: Nr.318, datë 03.03.2021(draft 1), shkresa me nr. 486, datë 12.04.2021 dhe shkresën 1223/prot, 23.08.2021. MFE/Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik ka filluar procedurën administrative mbi konsultimin e brendshëm në lidhje me projektin “Për tarifatat dhe mënyrën e pagesës së tarifave” dërguar nga DPM, në datë 27 shtator 2021. Aktualisht projekt akti është ende në proces.

### **Statusi i rekomandimit 11.2: I pranuar dhe në proces**

*V. Për pyetjen 4.1.2.3. A ka ndikuar në mbrojtjen e konsumatorëve veprimtaria e metrologjisë ligjore pranë DPM?*

**12. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale nuk ka hartuar një program me tregues të matshëm të performancës për çdo laborator dhe çdo specialist mbi bazën e të cilëve të analizohej performanca e specialistëve dhe e çdo laboratorit ose fushe, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Rregulloren e brendshme të DPM nr.104/1, datë 07.02.2014, si dhe kapitullin 4 në manualin praktik të Departamentit të Administratës Publike, për njësitë e burimeve njerëzore në institucionet e administratës publike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme që të vlerësojë ngarkesën sipas sektorëve dhe specialistëve të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, për një alokim eficient të burimeve njerëzore të kësaj drejtorie. Gjithashtu, të vendosë indikatorë të matshëm për vlerësimin e performancës së tyre, si dhe të implementojë dhe detajojë objektivat strategjik deri në nivel specialisti.

**Në vijimësi**

### **Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 12.1, sipas planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së

me shkresën nr.104/, prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 12.1, është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së nr.23, datë 18.01.2022, “Për vlerësimin e ngarkesës në punë të strukturës dhe specialistëve të DMSHI-së”, të cilët kanë përgatitur argumente të detajuara mbi indikatorë të matshëm të detyrave që ushtrojnë. Gjithashtu, kanë planifikuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023-2030, hapje fushash të reja, zgjerim i fushave ekzistuese, rritje e numrit të kalibrimeve/verifikimeve, akreditim laboratorësh për çdo fushë kalibrimi.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar.**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë përfshirë për verifikim metrologjik periodik fusha kryesore, ku përdorimi i instrumenteve ka ndikim të konsiderueshëm në mbrojtjen e konsumatorit, si: fusha e mjekësisë, ndotjes së mjedisit, sigurisë publike, frekuencave të telefonisë etj, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5, të nenit 3 dhe pikën 9 të nenit 8 në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar.

Nga DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk janë kryer verifikimet periodike të lojërave të fatit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 21 të nenit 8 në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për Metrologjinë” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** DPM në bashkëpunim me MFE, të marrin masat e nevojshme që, duke u bazuar në studime të tregut të instrumenteve matës në vend, peshës së secilit prej tyre në volumin e transaksioneve në ekonomi, të krijojnë kushte për verifikimin e instrumenteve ligjërisht të kontrolluar, si aparaturat mjekësore, ato të mjedisit, aparaturat për sigurinë publike etj., jo vetëm si një detyrim ligjor, por njëkohësisht në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjes së efektivitetit të investimeve në fushën e metrologjisë.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi*

**Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 13.1, sipas planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e DPM-së me shkresën nr.104/, prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 13.1, janë evidentuar, përgatitur, dërguar dhe administruar informacionet e formularëve për identifikim të nevojave për kalibrime dhe verifikime të instrumenteve matës tek laboratorët testues/inspektues të organizmave shtetëror dhe privat në Shqipëri. Aktualisht, pranë DPM-së kanë ardhur të plotësuar (15) pyetësorë, ku janë identifikuar nevojat e tyre për shërbime, trajnime etj. Gjithashtu, ky formular është në faqen e internetit të DPM-së në mënyrë që të plotësohet dhe dërgohet nga çdo i interesuar në linkun <https://www.dpm.gov.al/pyetesor-i-identifikimit-te-nevojave-2/>.

Në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023-2030, për pjesën e metrologjisë janë përfshirë: radarët e shpejtësisë dhe dy instrumente matës të fushës së mjekësisë, pajisje mjekësore.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces.**

**14. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore dhe në të gjithë sektorët rajonal të DPM-së, informacioni mbi punën e kryer përgatitet manualisht, si dhe nuk administrohet në formë elektronike, duke mbartur risk operacional të humbjes/keqpërdorjes.

-Drejtoria e Metrologjisë Ligjore nuk mban informacion të dokumentuar nga specialistët metrologë, mbi bazë ditore ose javore, i cili të jetë në dispozicion të përgjegjësit të sektorit ose drejtorit të DML-së, me qëllim që specialistët metrologë të regjistrojnë kohën e nisjes dhe të mbërritjes në një subjekt tregtar, dhe në këtë mënyrë koha e kërkuar për të kryer verifikimin të jetë e dokumentuar, në kundërshtim me nenin 11 në Ligjin nr.10296, datë

16.09.2016 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Metrologjisë Ligjore të marrë masat e nevojshme, që procesi i punës në terren të metrologëve, të jetë i dokumentuar plotësisht, ku të pasqyrohet i gjithë informacioni i nevojshëm për kryerjen e verifikimit, me qëllim vlerësimin e ngarkesës në punë, planifikimin real të detyrave për secilin metrolog, si dhe vlerësimin e performancës së tyre.

*Në vijimësi*

**Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 14.1, sipas planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së me shkresën nr.104/, prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 14.1, është miratuar urdhri nr.35, datë 24.01.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së “Mbi hartimin dhe ndjekjen e një plani ditor, javor dhe mujor nga sektorët e shërbimit të DML-së për dokumentimin e procesit të punës në terren”. Nga administrimi i raportimeve të dërguara nga sektorët e shërbimeve janë marrë të dhëna konkrete lidhur me vlerësimin e ngarkesës në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve dhe janë marrë si referencë për planifikimin real të detyrave për secilin punonjës në vazhdim. Mbi raportimet e dërguara janë marrë masa për ndryshime planesh dhe riorganizim zonash, si dhe ngarkim me detyrë shtesë sipas rasteve kur ka qenë e nevojshme. Në vazhdim, po realizohet rishikimi i procedurave teknike që do ristrukturojë dokumentimin e plotë të procesit të punës në terren.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar.**

**15. Gjetje nga auditimi:** DPM nuk ka hartuar një program komunikimi me subjektet private dhe publike që përdorin instrumente matës ligjërish të kontrolluar për pjesëmarrjen, ndërgjegjësimin dhe njohjen e rëndësisë dhe detyrimeve të tyre për verifikimin metrologjik të instrumenteve matëse, sipas kërkesave në planin e veprimit afatgjatë të SNMKMT 2014-2020.

-DML nuk ka marrë masa për ngritjen dhe vendosjen në funksion të një sistemi të brendshëm të menaxhimit të cilësisë sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014 dhe rekomandimeve të OIML<sup>18</sup>, për metrologjinë ligjore. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, duke iniciuar procesin, që specialistët metrologë të DML-së, të jenë pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë së institucionit, dhe për të vijuar më tej me akreditimin e trupës verifikuese në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020, me qëllim ngritjen dhe forcimin e shërbimit të verifikimit metrologjik.

*Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2022 dhe në vijimësi*

**15.2 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme që të kryejë fushata ndërgjegjësimi me konsumatorët dhe bizneset, me qëllim rritjen e nivelit të informimit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në marrëdhëniet tregtare.

*Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2022 dhe në vijimësi*

**Për DPM:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Referuar shkresës së KLSH-së me nr.612/10 prot, datë 31.12.2021 “Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Performancës, Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së me nr.104/1prot, datë

<sup>18</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d009-e04.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d009-e04.pdf)

14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, **rekomandimi 15.1**, është miratuar Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 31, datë 24.01.2022 “Për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas SSH ISO/IEC 17020:2012 në metrologjinë ligjore”. Ka nisur procesi i hartimit të Manualit të Cilësisë së DPM, me qëllim krijimin e sistemit të Menaxhimit të Cilësisë për plotësimin e kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012. Është hartuar materiali trajnues për njohjen dhe zbatimin e kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012 “Vlerësimi i konformitetit-Kërkesat për funksionimin e tipeve të ndryshme të trupave që kryejnë inspektim” dhe është planifikuar trajnimi për punonjësit e metrologjisë ligjore. Është në proces rishikimi dokumentacioni teknik për fushën specifike, ku do implementohet ky standard dhe është realizuar kalibrimi i etaloneve të punës të Sektorëve të Shërbimit nr. 1 Tiranë (fusha e volumeve), nr. 3 Lezhë (fusha e masës), nr. 2 Fier (fusha e masës), duke ju referuar planeve të miratuara.

**Në lidhje me rekomandimin 15.2**, gjatë vitit 2022 nga DPM, janë realizuar:

-Konferenca “Rëndësia e Infrastrukturës së Cilësisë dhe Pronësisë Industriale në Tregun e Brendshëm dhe Ndërkombëtar” në bashkëpunim me MFE dhe institucionet e infrastrukturës së cilësisë, në datë 22 shkurt 2022; linku <https://www.dpm.gov.al/ep-content/uploads/2022/04/Buletini-Metrologjik-Nr.-1-2022.pdf>

-Vizitë e përfaqësuesve të Institutit Maqedonas të Metrologjisë (BOM) në ambientet e DPM në datat 23, 24, 25 mars 2022. Shkëmbim informacioni dhe planifikim aktivitetesh të tjera në të ardhmen;

-Sesion informimi mbi rregulloret e reja teknike “Para paketimet dhe shishet enë matëse”, aktivitet në bashkëpunim me MFE, ISHMT, GIZ ne date 17 mars 2022;

-Miratim i një plani aktivitetesh ndërgjegjësuese në fakultete dhe Dhomat e Tregtisë në vendin tonë për vitin 2022, në bashkëpunim me DPA dhe DPS, i cili ka vijuar me:

- Aktivitet ndërgjegjësues dhe promovues, realizuar në datat 23 - 24 maj 2022 mbi rolin, rëndësinë dhe shërbimet e ofruara prej DPM-së në qytetin e Gjirokastrës me studentët, pedagogët e universitetit “Eqerem Çabej” dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë;

- Aktivitet ndërgjegjësues dhe promovues, “Mbi rolin, rëndësinë dhe shërbimet e ofruara prej DPM-së”, realizuar në datat 08 - 09 qershor 2022, në qytetin e Korçës me studentët, pedagogët e universitetit “Fan Noli” dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë;

-Vizitë në laboratorët e DPM-së, në datë 21 qershor 2022, nga një grup studentësh nga Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, dega Inxhinieri Fizike, informacionet e të cilave do të përfshihen edhe në buletinin metrologjik të muajit shtator 2022.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces.**

**16. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë periudhës 2018-2020 sektori dhe laborator i para paketimeve nuk ka kryer asnjë aktivitet, si testim të produkteve të para paketuara/shisheve enë matëse;

-Nga DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk janë kryer trajnime për specialistët e sektorit të para paketimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në rregulloren e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, që punonjësit e sektorit të para paketimeve të vihen në funksion të plotë të realizimit të objektivave institucional, duke i angazhuar në detyrat e këtij sektori/detyra të sektorëve të tjerë brenda DPM, për aq sa është e mundur.

**Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2020 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 16.1, sipas planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së me shkresën nr.104/, prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve

të KLSH-së”, pika 16.1 është nxjerrë Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së nr. 29, datë 19.01.2022 “Për vënien në efencë të plotë të sektorit të para paketimeve”, ku janë miratuar detyra shtesë për këtë sektor gjatë vitit e në vazhdim. Sektori i Para paketimeve ka propozuar rregulloren për shqyrtimin e aplikimeve për miratim, regjistrim dhe monitorim të sistemit të kontrollit sasior të paketimesve të para paketimeve me shenjë konformiteti, e cila është miratuar me urdhrin nr. 45, datë 31.01.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së. Gjithashtu, nga DPM, gjatë 6 mujorit të parë janë realizuar dy trajnime në fushën e para paketimeve, përkatësisht në datë 11-12.04.2022 me specialistin e sektorit të shërbimit nr. 4, Korçë dhe datë 26.05.2022 me specialistë të sektorëve të Shërbimit nr. 1, 2, 3 dhe një paketë trajnimesh, me tema specifike (metrologjia, ashensorët, lodrat, makineritë, etj.) për anëtarët e DPM-së, pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian të Kapitullit 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i zbatuar.**

**17. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë periudhës 2018-2020, verifikimi metrologjik i matësve të ujit, krahasuar me numrin e matësve të ujit në përdorim, nuk është kryer në ritmet e duhura nga subjektet private të autorizuar nga DPM, për ofrimin e këtij shërbimi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.193 datë 09.03.2009 “Mbi frekuencën e verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1 Rekomandimi:** DPM në bashkëpunim me MFE, të marrin masat e nevojshme, që të kryhet verifikimi metrologjik i matësve të ujit, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 17.1, sipas planit të veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së me shkresën nr.104/, prot, datë 14.01.2022 “Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”, pika 17.1, është miratuar urdhri i Ministrit të MFE nr.149, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe për monitorimin e aktivitetit/performancës së tyre.

Linku:[https://www.dpm.gov.al/ep-content/uploads/2022/07/Urdher-Nr.-149\\_dt.19.05.2022.pdf](https://www.dpm.gov.al/ep-content/uploads/2022/07/Urdher-Nr.-149_dt.19.05.2022.pdf).

Aktualisht, nga DPM-ja janë autorizuar 4 (katër) subjekte për kryerjen e verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, matësa uji. DPM ka miratuar me shkresën nr. 297/1 prot, datë 31.01.2022 “Planin vjetor për kryerjen e vizitave monitoruese në subjektet e autorizuar nga DPM”, ku deri më tani janë kryer 2 (dy) vizita monitoruese nga grupet e punës, në subjekte të autorizuar për verifikim të matësve të ujit.

Janë dërguar 58 shkresa gjashtë gjashtëmujorit të I 2022, nga DPM në drejtoritë e Ujësjellës Kanalizimeve, me lëndë “Informacion për të dhëna për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar, matës uji” dhe janë administruar 9 (nëntë) përgjigje të dërguara. Është mbajtur korrespondencë e vazhdueshme me MFE lidhur me masat e marra nga DPM –ja për përmirësimin e situatës së verifikimit të matësve të ujit.

Rezulton se ky shërbim vazhdon të mos kryhet nga subjektet e autorizuar (gjatë vitit 2022 për mungesë fondesh të Ujësjellës Kanalizimeve dhe për arsye të ri organizimit, janë verifikuar vetëm 6 matësa uji) me gjithë masat e marra nga DPM, përgjegjësi kjo e MFE.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe i pa zbatuar.**

**VI. Për pyetjen 4.1.2.4. A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional i DPM?**

**18. Gjetje nga auditimi:** Referuar përcaktimeve të bëra në nenin 8 të Ligjit nr.9875, datë

14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, si dhe objektive strategjike në SNMKMT 2014-2020, **ka munguar bashkëpunimi me:**

- Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit për iniciimin e procedurave të akreditimit të laboratorëve;
- Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut për shkëmbimin e informacionit mbi problematikat e instrumenteve matëse, gjatë verifikimit/inspektimit të tyre;
- Institutin e Fizikës Bërthamore, për kryerjen e matjeve/verifikimeve të instrumenteve matës “dozimetr”, i cili kontrollon dozat e rrezatimit jonizues;
- Universitete dhe Fakultete të ndryshme, si ai: i Politeknikut, i Shkencave të Natyrës, me qëllim sigurimin e shërbimeve elektronike dhe mekanike në lidhje me riparimin, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të matjeve;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim shkëmbimin e informacionit, mbi importet e kryera të instrumenteve matës, duke shërbyer për plotësimin dhe përditësimin e databasës që administrojnë DPM-ja për instrumentet matës dhe në këtë mënyrë rritjen e numrit të verifikimeve të instrumenteve;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë (DPP), me qëllim verifikimin e saktësisë së matjeve të radarëve të shpejtësisë. Theksojmë se, DPM i ka kërkuar informacion DPP-së, për llojin e radarëve që ka në përdorim, me qëllim që të sigurojë pajisjet e nevojshme për kryerjen e kalibrimit dhe verifikimit të tyre, por që nga DPP nuk është kthyer përgjigje, çka do të thotë se deri në fund të vitit 2020 nuk është kryer verifikimi i radarëve që masin shpejtësinë e automjeteve/moto mjeteve;
- Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve, për marrjen e masave konkrete me qëllim verifikimin e aparateve matës të ujit, instrument, i cili deri më sot nuk është verifikuar;
- Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, për kalibrimin e aparaturave që përdoren në analizat laboratorike të ushqimeve, me qëllim rritjen e saktësisë së rezultateve të gjeneruara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.4, faqet 56-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1 Rekomandimi:** MFE të marrë masat e nevojshme, që të ngrejë një grup pune, i cili të hartojë VKM përkatëse duke i'u referuar edhe direktivës së BE-së<sup>19</sup>, për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve që janë pjesë e infrastrukturës së cilësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, si ISHMT, DPA, DPS, KMK, etj, për shkëmbimin e informacionit, zbuluar dhe hetuar shkeljet e legjisllacionit përkatës, me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve.

*Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2022*

**Për MFE:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE argumenton se duke i referuar direktivës së përmendur në rekomandim kjo do të transpozohet dhe është planifikuar në PKIE (Plani Kombëtar i Integritimit Europian) e vitit 2024 ku do të ketë dhe ndryshime ligjore. Deri në transpozimin e direktivës për këtë çështje do të hartohet një memorandum bashkëpunimi midis institucioneve. Aktualisht është hartuar draft - marrëveshja nga sektori i tregut të brendshëm /Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, ku dokumenti do t'i nënshtrohet procedurave administrative si konsultim i brendshëm në MFE dhe me pas dërgimi në institucionet përkatëse nënshkruese.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces**

**19. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë periudhës 2018-2020 nuk ka funksionuar Këshilli i Metrologjisë, referuar përcaktimeve të bëra në nenin 10 të ligjit nr.9875, datë 14.02.2008

<sup>19</sup> Regulation (EU) 2017/2394 of the European Parliament and of the Council of 12 December 2017 parashtrohet kushtet sipas të cilave strukturat kompetente, përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, që mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve, bashkëpunojnë me njeri tjetrin, në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut në përputhje me këto ligje si dhe rritjen e nivelit të mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve.



“Për metrologjinë”, i ndryshuar.

MFE nuk ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, për miratimin e përbërjes nominale dhe funksionimin në kushte normale të Këshillit të Metrologjisë, me arsyetimin se, nuk ka një bazë ligjore, në të cilën të mbështetet pagesa e anëtarëve të Këshillit. Ndodhur në këto kushte nga MFE, me qëllim funksionimin e kësaj strukture, duhet të ishin marrë masat e nevojshme, për propozimin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, ose përfshirjen e Këshillit të Metrologjisë, në VKM nr. 656, datë 31.10.2018<sup>20</sup>, në të cilën përcaktohet masa e shpërblimit për rreth 70 lloje organesh kolegjiale. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.4, faqe 56-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1 Rekomandimi:** MFE në bashkëpunim me DPM të marrin masat e nevojshme, për ngritjen dhe funksionimin normal të Këshillit të Metrologjisë.

*Menjëherë*

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në lidhje me rekomandimin 19.1, është miratuar VKM nr. 152, datë 11.03.2022: “Për përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Metrologjisë”.

*Linku:* <https://www.dpm.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/VKM-Nr.152-dat%C3%AB-11.3.2022-P%C3%ABr-K%C3%ABshillin-e-Metrologjis%C3%AB.pdf>.

Nga DPM janë marrë propozimet për anëtar nga të gjithë institucionet, pjesë e Këshillit të Metrologjisë. Është dërguar në MFE nga DPM, shkresa nr.1095 prot, datë 01.06.2022 “Mbi miratimin e anëtarëve të Këshillit të Metrologjisë” dhe nuk ka asnjë përgjigje nga MFE për përcaktimin e anëtarëve dhe funksionimin normal të Këshillit të Metrologjisë.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar dhe në proces (pjesërisht)**

## **VI. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit *ri kërkimë* nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresat:

- Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.612/10 datë 31.12.2021
  - Në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë me shkresën nr 612/10, datë 31.12.2021.
- mbi auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të papranuara, të pazbatuara ose në proces, si më poshtë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**I. Për Pyetjen: 4.1.1.1. A është hartuar nga MFE dhe DPM, kuadri rregullator në përputhje me standardet e BE për metrologjinë?**

**Për MFE**

**2. Gjetje nga auditimi: a) Përcaktimet në nenin 18** në ligjin nr.126/2020 “Për Metrologjinë” janë në kundërshtim me vetë shkronjën “ç” të nenit 1 “Qëllimi i ligjit”, konkretisht në pikën parashikohet shprehimisht: *ç) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara, të cilat janë objekt i markimit CE<sup>21</sup>*. Ky nen lejon lëvizjen e lirë të instrumenteve matës që kanë markimin CE, pavarësisht nëse janë inteligjent ose jo.

Gjithashtu bien në kundërshtim me:

<sup>20</sup> Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njërive të qeverisjes qendrore.

<sup>21</sup> Ligji nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Markim CE” është markimi, me të cilin prodhuesi tregon që produkti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

i. Direktivën e BE-së nr.2014/32/EU të datës 26.02.2014 për sa i përket lëvizjes së lirë në treg të instrumenteve matës<sup>22</sup>, paragrafi 13: “Për të siguruar qarkullimin e lirë të instrumenteve matës në Bashkimin Evropian, Shtetet Anëtare nuk duhet pengojnë vendosjen në treg dhe/ose vënien në përdorimi i instrumenteve matëse që mbajnë markën CE dhe shënimi plotësues metrologjik në përputhje me dispozitat e kësaj direktive”.

ii. Direktivën e BE-së nr.2014/31/EU të datës 26.02.2014 për harmonizimin e ligjit të metrologjisë me shtetet anëtare për sa i përket lëvizjes së lirë në treg të instrumenteve jo-automatik të peshave<sup>23</sup>, me parimet e lëvizjes së lirë të mallrave (NAËI), **neni 5 “Lëvizja e lirë e instrumenteve”** - *Shtetet anëtare nuk do të pengojnë vënien në dispozicion të tregut të instrumenteve që plotësojnë kërkesat e kësaj Direktive*. Termi i përdorur “jo inteligjent” nuk ka të bëjë me fushën e metrologjisë.

**b)** Frekuenca e verifikimit periodik të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, referuar praktikave të mira në vendet e rajonit, si: Mali i Zi, Kosova, Serbia, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria<sup>24</sup>, është 1 (një) verifikim në 1-2 vjet, **ndërkohë** sipas **përcaktimeve në pikën 1, të nenit 22** të ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë”, frekuenca e verifikimit në Shqipëri parashikohet 2 (dy) herë në vit, me përcaktimin se në të ardhmen edhe mund të rritet. Rritja e frekuencës së verifikimit metrologjik, sjell rritjen e kostos së subjektit që po përfiton shërbimin e verifikimit, e për rrjedhojë edhe kostot për produkt apo shërbim që do të ofrohet nga ky subjekt ndaj palëve të treta, duke rrezikuar që çmimet e rritura si pasojë e verifikimeve të shpeshta, t’i përballojë hallka e fundit e zinxhirit, që është konsumatori.

**c)** Përcaktimet në **nenin 34, pika 2, të ligjit nr. 126/2020**, trajtojnë ndër të tjera kostot dhe përgjegjësinë pas kryerjes së “*Ekspertizës metrologjike*”. Referuar praktikave të mira, si ligji për metrologjinë në Malin e Zi, në nenin 24<sup>25</sup> të tij, përcaktohet se: “Testimin e jashtëzakonshëm/Ekspertizën Metrologjike” pas një ankese për instrumentin matës, e kryen Byroja e Metrologjisë, si dhe në rast se nga testimi, instrumenti rezulton në rregull, kostot i përballon ankimuesi, ose në rast se ndodh e kundërta, **kostot e testimit i paguan subjekti që ka kryer verifikimin metrologjik**. Për analogji, duke i’u referuar praktikës së mirë, “Ekspertizën metrologjike/Testimin e jashtëzakonshëm”, mund ta kryejë Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (dhe jo një trupë ndërkombëtare e akredituar) dhe në rast se nga testimi, instrumenti rezulton në rregull, shpenzimet duhet t’i paguajë ankimuesi, ose në rast se ndodh e kundërta, shpenzimet duhet t’i paguajë koncesionari/subjekti i autorizuar nga DPM, i cili ka kryer verifikimin e instrumentit në fjalë; **ndërkohë** sipas nenit 34 të ligjit të metrologjisë, në rast se, instrumenti nuk rezulton në rregull, **megjithëse jo për shkak të përdoruesit të tij**, kostot i paguan përdoruesi i instrumentit matës, duke përjashtuar kështu rastet kur shkak mund të jetë subjekti privat që ka bërë verifikimin jo të saktë.

**d)** Përcaktimet në **nenin 48 dhe 50** të ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë”, bien në kundërshtim me Kreun II “Qëllimi dhe parimet e inspektimit”; Kreun III “Organizimi dhe funksionimi i inspektorateve në nivel qendror dhe vendor”; Kreun IV “Rregulla të përgjithshme për programin e inspektimit”, dhe Kreun V “Procedura e inspektimit në ligjin nr.10433”, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: *vetëm institucionet shtetërore të nominuara inspektoriate në bazë të ligjit kryejnë detyra inspektimi dhe ndërmarrin sanksione administrative*. Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 48 të ligjit të metrologjisë, ka një trajtim me dy standarde, pasi kur verifikimi metrologjik i instrumenteve matës kryhet nga koncesionari/subjekti i autorizuar, inspektimi metrologjik përfshin vetëm ekzaminimin fizik dhe dokumentar të produkteve apo proceseve objekt të këtij ligji dhe jo atë laboratorik (sikundër ndodh në rast se ky shërbim ofrohet nga DPM),

<sup>22</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0032>

<sup>23</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0031&qid=1635418184908>

<sup>24</sup> <https://www.vvelmec.org/legal-metrology-information/country-information/country>

<sup>25</sup> [https://metrologija.me/wp-content/uploads/zakonodavstvo/eng/Law\\_Metrology.pdf](https://metrologija.me/wp-content/uploads/zakonodavstvo/eng/Law_Metrology.pdf)



duke implikuar kështu inspektime më pak të thelluara në rastet e subjekteve private. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen, si dhe përafrimin e ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë” me direktivat e BE-së, Ministria e Financës dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin rast pas rasti të gjetjeve më sipër, me qëllim propozimin në Këshillin e Ministrave, të ndryshimeve ligjore në ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, konkretisht:

-Në **nenin 18**, të hiqen pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6.

-Në **pikën 1 të nenit 22**, të shtohet paragrafi “Analiza e riskut dhe problematikave në treg, lidhur me instrumentet matës, me qëllim dyfishimin e periodicitetit të verifikimit, të bëhet nga një grup i përbashkët pune ndërmjet DPM dhe ISHMT dhe pas miratimit nga ky grup, të vihet në zbatim rritja e periodicitetit të verifikimeve të instrumenteve matës”.

-Në vijim të shtohet paragrafi “Subjektet private juridike të autorizuar me një nga format e legjislacionit në fuqi të raportojnë periodikisht pranë ISHMT dhe DPM, problematikat e ndeshura në treg lidhur me instrumentet matëse”, me qëllim që ky raportim të shërbejë për DPM dhe ISHMT për vlerësimin e riskut.

-Në **shkronjën “b” të pikës 2, të nenit 34**, të riformulohet paragrafi si vijon: “përdoruesi i instrumentit matës kur nga testimi i jashtëzakonshëm rezulton që instrumenti është jo në përputhje me kërkesat metrologjike, vetëm nëse provohet se, instrumenti nuk është në përputhje me kërkesat metrologjike për shkak të ndërhyrjes së palejuar të vetë përdoruesit.

Në vijim të shtohet shkronja “c” me përmbajtje: “subjekti që ka kryer shërbimin e verifikimit metrologjik, në rastin kur provohet se në instrumentin matës nuk është bërë asnjë ndërhyrje nga përdoruesi i tij”.

-**Pika 2 e nenit 48**, të riformulohet si vijon: “Kur ka dyshime për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, si pasojë e një informacioni të ardhur nga të tretë, apo ankese, ose një vlerësimi rrisht nga inspektoriati, sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar, inspektimi metrologjik mund të përfshijë edhe ekzaminimin laboratorik për të realizuar kontrollin e përcaktuar në pikën 1 këtij neni”.

-Në vijim në shkronjën “c” të pikës 3, të nenit 48, të hiqet paragrafi: “përveç rasteve të kryerjes së verifikimit nëpërmjet inspektimit nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi”.

-Në **pikën 3 të nenit 50**, të hiqet shprehja: “personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi”.

### ***Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2023***

#### **Për MFE**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga krahasimi i Projektligjit të publikuar në [web<sup>26</sup>](http://www.konsultimpublik.gov.al) me ligjin e miratuar nr. 126/2020 “Për Metrologjinë”, rezultuan ndryshime në kompetencat e DPM-së. Në Projektligj, në pikat 10 dhe 13 të nenit 8 “Detyrat dhe kompetencat e DPM”, përcaktohet se: “DPM kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar; dhe DPM autorizon dhe monitoron persona juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, ekspertizën metrologjike bazuar në kërkesat e përshkruara”; **ndërsa referuar ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, në nenin 8, pikat 10 dhe 13, përcaktohet se: “DPM kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë privatë; si dhe DPM autorizon dhe monitoron personat juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, bazuar në kërkesat e përshkruara, përveç rasteve kur këto shërbime u janë dhënë personave juridikë privatë me një nga format e parashikuara në legjislacionin në**

<sup>26</sup> [www.konsultimpublik.gov.al](http://www.konsultimpublik.gov.al)

*fuqi*". Ndryshimi i kompetencave të DPM-së **nuk** ka gjetur reflektim as në raportin e vlerësimit të ndikimit<sup>27</sup>, ku në opsionin respektiv, edhe pse shërbimi i metrologjisë ligjore për karburantin dhe gazin e lëngshëm është dhënë me koncesion, kanë vijuar të reflektohen të ardhurat e krijuara nga DPM për këtë shërbim. Sa më sipër, jo vetëm cenon parimin e transparencës gjatë procesit të njoftimit e konsultimit publik<sup>28</sup>, por gjithashtu nuk jep siguri që vlerësimi ekonomik i skenarëve sipas raportit të vlerësimit të ndikimit, të ketë mbështetur ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë". Në këtë mënyrë, si dhe duke pasur në konsideratë të ardhurat e DPM, realizuar nga shërbimi i mësipërm në një vit kalendarik<sup>29</sup>, përcaktimet e bëra në ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë", **do të ndikojnë direkt në reduktimin e të ardhurave të DPM-së, e për rrjedhojë në të ardhurat e buxhetit të shtetit.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** MFE të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi me qëllim analizën e situatës dhe verifikimin e raportit të analizës ekonomike-financiare të ligjit nr.126/2020 "Për metrologjinë", me qëllim dokumentimin e plotë të procedurës së hartimit dhe miratimit të këtij ligji dhe publikimin e versionit përfundimtar, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në faqen zyrtare të konsultimit publik, si dhe në faqen zyrtare të MFE-së.

*Brenda 6 mujorit të parë 2023*

#### **Për DPM**

**4. Gjetje nga auditimi:** Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ka sjell që, investimet e kryera në DPM në vlerën prej 63,975,994 lekë, për blerjen e auto laboratorëve dhe pajisjeve (që mund të përdoren vetëm për verifikimin e këtyre instrumenteve), të mos i shërbejnë më qëllimit për të cilin ato janë shpenzuar, duke i bërë jo efektive dhe jo eficiente, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 24 dhe 25, të nenit 3, shkronjën "ç" të nenit 4, shkronjën "b" të nenit 19, të ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, për transferimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit/Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, të auto laboratorëve dhe pajisjeve në vlerën 63,975,994 lekë, përdorur për kryerjen e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me qëllim shitjen e tyre/vendosjen në përdorim, si dhe eliminimin e efekteve negative financiare.

*Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022*

#### **Për MFE**

**5. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë shqyrtimit të ligjit nr. 126/2020 dhe paralelisht me të edhe të kontratës koncesionare, rezultoi se, shoqërisë koncesionare i është dhënë e drejta e inspektimit dhe marrjes së masës administrative të bllokimit të instrumenteve matës, ndërkohë që ajo është shpallur fituese që në krye të herës vetëm për ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës, sepse funksionin e inspektimit metrologjik dhe marrjes së masës administrative, e kryen Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. Theksojmë se, ofrimi i mundësisë ndaj subjektit privat që tashmë kryhen shërbimin e verifikimit metrologjik, që të kryejë edhe inspektimin/bllokimin e instrumenteve matës, mund të krijojë hapësira për konflikt interesi, duke ndikuar negativisht në transparencën, trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të subjekteve, që tregtojnë karburant, si dhe për rrjedhojë në uljen e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e konsumatorit. Këto përcaktime bien në kundërshtim me

<sup>27</sup> [www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243](http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243)

<sup>28</sup> Në kundërshtim me (neni 5 i ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik")

<sup>29</sup> DPM në një 1 vit kalendarik, ka arkëtuar 76,000,000 lekë, vetëm nga tarifa e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ose 60% të të ardhurave gjithësej, që arkëton DPM.

pikën 1 të nenit 7 të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, si dhe Kreun II, IV, dhe V në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Për më tepër që arsyeja kryesore e ndarjes së inspektimit metrologjik nga strukturat e DPM-së ishte për arsye që i njëjti institucion që kryen shërbimin e verifikimit, të mos ndërmarrë dhe sanksione administrative, ndërkohë që nëpërmjet kontratës koncesionare, jemi duke u rikthyer në situatën e mëparshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** MFE të marrë masat e nevojshme që pas propozimit në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, të ngrëjë një grup pune për të analizuar mbivendosjet e detyrave të koncesionarit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim eliminimin e tyre në kontratën koncesionare nr. 15326 prot., datë 21.08.2019.

*Brenda vitit 2022*

### **Për MFE**

**6. Gjetje nga auditimi:** Referuar kontratës koncesionare, në lidhje me monitorimin, në nenin 13.2 parashikohet se AK, nëpërmjet NJZP (Njësisë së Zbatimit të Kontratës) **ka të drejtë** që në periudhë kohore prej 24 muajsh, të monitorojë në vend objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Nën gjykimin e pavarur të audituesit, monitorimi, që t’i shërbejë qëllimit, duhet të jetë **detyrim** më shumë se e drejtë; nga ana tjetër neni 13.2.1 parashikon se AK ngre NJZP, si njësi që ngarkohet me mbikëqyrjen e ecurisë së kontratës, por nuk parashikon ekspertizën që duhet të ketë kjo njësi në përbërjen e saj. Konkretisht, NJZP **nuk** ka në përbërjen e saj specialist të fushës, në rastin konkret metrolog, me qëllim mbikëqyrjen nga ana teknike të shërbimit që ofrohet nga subjekti juridik privat, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 8 të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 13, paragrafi 13.2 të kontratës koncesionare dhe Guidave të OIML D1<sup>30</sup>, paragrafi 5.3.5 “Përfshirja e sektorit privat/tregtar në metrologji”, si dhe Weights and Measures Program Requirements – Kërkesat e programit të peshave dhe matjeve, të NIST-Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.<sup>31</sup>”

-Raportet periodike për titullarin e MFE-së, të përgatitura përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 nga njësia e monitorimit të zbatimit të kontratës së dhënies me koncesion të shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, **përmbajnë informacion identik** me informacionin që pasqyrohet në raportet periodike të subjektit juridik privat, çfarë rrezikon që monitorimi i shërbimit të mos ofrojë siguri mbi ecurinë e projektit, cilësinë e shërbimit të ofruar dhe konformitetin në përputhje të mos jetë bërë sipas përcaktimeve të bëra në pikat 13.2 dhe 13.3 të nenit 13, të kontratës nr.15326, datë 21.08.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.1, faqet 20-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Me qëllim zbatimin e kontratës koncesionare, lidhur me monitorimin e saj, MFE të marrë masat e nevojshme që të hartojë një **manual të posaçëm për procedurat e monitorimit** të zbatimit të kontratës së shërbimit metrologjik, ku pjesë e tij të jenë edhe procedura dhe metodologjia e monitorimit në terren, të shërbimit të verifikimit metrologjik, sipas një analize risku.

*Brenda 6 muajorit të parë 2023*

**6.2 Rekomandimi:** Gjithashtu, MFE të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e njësisë së monitorimit pranë MFE, të përfshihen **specialistë metrologë** të DPM-së/ISHMT-së, me qëllim rritjen e garancisë se po jepet shërbimi me cilësinë dhe kriteret e kërkuara, prej subjektit juridik privat.

*Brenda 6 muajorit të dytë 2022*

**6.3 Rekomandimi:** Të rishikohen:

<sup>30</sup>[https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d001-e20.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d001-e20.pdf)

<sup>31</sup> <https://www.nist.gov/system/files/documents/2017/04/28/hb-155-final.pdf>

- neni 13.2.2 i kontratës koncesionare dhe të korrigojohet si vijon: “AK nëpërmjet NJZP **ka detyrimin** që në periudha kohore prej 24 muajsh gjatë gjithë periudhës së koncesionit të monitorijë në vend objektin e koncesionit (...)”;
- **neni 13.3** të korrigojohet si vijon: “AK **ka detyrimin** të ushtrojë mbikqyrje të përgjithshme nëpërmjet shqyrtimit të raporteve që dorëzon Koncesionari (...)”.

*Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022*

## **II. Për pyetjen 4.1.1.2.: A ka qenë efektive MFE në mbështetjen financiare të DPM-së, për zhvillimin e sistemit të metrologjisë?**

### **Për DPM**

**8. Gjetje nga auditimi:** Produktet si: “Akreditimi”, “Kalibrimi”, dhe “Verifikimi”, përgjatë periudhës 2018-2020, rezultuan të jenë kryer me kosto më të lartë se objektivat e PBA dhe SNMKMT 2014-2020<sup>32</sup>, si dhe treguesit e performancës të DPM nuk janë realizuar me efektivitet, si pasojë e mosrealizimit të: (i) 12 akreditimeve të laboratorëve dhe njohje CMC; (ii) 2,758 kalibrimeve dhe (iii) 54,996 verifikimeve, në kundërshtim me pikat 24 dhe 25 të nenit 3, shkronjën “ç” të nenit 4, shkronjën “b” të nenit 19, të ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar. Kjo situatë është ndikuar edhe për shkak të kalimit tek subjektit privat me koncension, të shërbimit të verifikimit (12,400 verifikime) të 6200 shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ndërsa për vitin 2020 edhe për shkak të pandemisë Covid 19. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.1.2, faqet 33-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme që të rishikojë planet strategjike dhe operacionale, si një domosdoshmëri për përmirësimin e performancës dhe të efektivitetit të saj, në realizimin e programit buxhetor.

**Në vijimësi**

## **III. Për pyetjen 4.1.2.1. A janë realizuar objektivat strategjikë për metrologjinë nga DPM?**

### **Për DPM**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aktivitetit të DPM-së në bashkëpunim me MFE, referuar planit të veprimit afatgjatë 2016-2020 në Strategjinë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut (SNMKMT) dhe Strategjisë Sektoriale “Për zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri” miratuar me VKM nr.272, datë 05.03.2008, rezultoi se, **nuk janë realizuar objektivat strategjikë**, si më poshtë vijon:

- Kryerja e verifikimeve periodike e instrumenteve matës në përdorim në masën 10% më shumë se viti paraardhës. Përrjashtuar vitin 2020, për shkak të pandemisë Covid-19, numri i verifikimeve është rritur me rreth 7% çdo vit;
- Hartimi dhe miratimi i VKM-së “Për etalonet kombëtare”, aktualisht është në variantin “Draft”, propozuar nga DPM;
- Koordinimi me Institutin e Fizikës Bërthamore, që të ketë matje të rrezatimit jonizues;
- Krijimi i 14 fushave të reja matjesh;
- Sigurimi i shërbimeve elektronike dhe mekanike në universitete dhe në industri në lidhje me riparimin, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të matjeve;
- Kryerja e trajnimeve të rregullta për industrinë, në të pakën 30 fusha, duke përfshirë metrologjinë e përgjithshme dhe vlerësimin e pasaktësive;
- Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorët e termometrisë nga EURAMET;
- Deklarimi në databasën të BIPM<sup>33</sup>-së të fushave të matjes. Aktualisht, DPM ka vetëm 3

<sup>32</sup> Sipas PBA 1.3 lekë, ndërkohë sipas faktit 1.5 lekë.

<sup>33</sup> Byroja ndërkombëtare e peshave dhe masave, si organizmi më i lartë në të cilin deklarohen aftësitë matëse dhe kalibruese të instrumenteve matës, ç’ka sjellë që certifikatat e kalibrimit të lëshuara nga ky laborator do të njihen ndërkombëtarisht.

fusha të deklaruara (masë, presion dhe volum);

- Përfshirja në skemën e kontrollit metrologjik ligjor të dy instrumenteve matës në fushën e mjekësisë;
- Realizimi i 10,750 kalibrime në fushën e masës, forcës, volumit, gjatësisë, presionit, temperaturës, matjeve elektrike, lagështirës, kohë-frekuencës, densitetit (janë realizuar rreth 7,500 kalibrime);
- Ngritja e laboratorëve të kohë-frekuencës, të kontrollit të zhurmave dhe të kontrollit të instrumenteve matës në fushën e shëndetësisë;
- Realizimi i fushatave ndërgjegjëse për biznesin;
- Akreditimi i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akreditues nënshkrues të MLA me EA në fushën e kalibrimeve;
- Zgjerimi i bazës etalonuese në 7 fusha të reja matje: laboratorin e masës, elektrikut, rrjedhjeve, optikës, përdredhjeve, gjatësisë dhe presionit;
- Hartimi i VKM “Për bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve”;
- Gjithashtu, rezultoi se, nga DPM nuk është hartuar strategjia e zhvillimit të metrologjisë, referuar përcaktimit të bërë në nenin 8 të ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, në fuqi deri në Dhjetor të vitit 2020. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.1, faqet 38-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 9.1:** DPM në bashkëpunim me MFE të marrin masat e nevojshme, për hartimin dhe miratimin e strategjisë së posaçme për zhvillimin e metrologjisë, pjesë e të cilës të jenë edhe objektivat e mësipërm, në koherencë me ndryshimet ligjore në fushën e metrologjisë, të përealizuara deri në fund të vitit 2020.

#### *Brenda 6 mujorit te dytë 2022*

**Rekomandimi 9.2:** Gjithashtu DPM të marrë masat e nevojshme, që të kryejë ri kalibrimin e etalonëve kombëtar, në laboratorët e vendeve anëtare të BIPM, duke vlerësuar mundësitë reale për ta kryer vetë këtë shërbim, me qëllim reduktimin e kostove, kohës së realizimit, si dhe rritjen e sigurisë së transportit të etaloneve.

#### *Brenda 6 mujorit te dytë 2022*

**IV. Për pyetjen 4.1.2.2. A janë mirë administruar burimet njerëzore dhe financiare nga DPM në funksion të realizimit të objektivave institucional?**

#### **Për DPM**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në fund të vitit 2020, të punësuarit në sektorin e Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML), që kryejnë verifikimin metrologjik, që nuk kanë formimin arsimor sipas kërkesave të Urdhrit të Ministrit të METE nr. 192, datë 09.03.2008<sup>34</sup>, janë rreth **25 punonjës nga 53** të punësuar efektivisht, ose rreth 47%.

- Specialistët metrolog të DML nuk janë testuar nëpërmjet provimit të kualifikimit për njohuri të mjaftueshme në fushën e metrologjisë ligjore, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të METE nr. 192, datë 09.03.2008 “Për përcaktimin e kriterëve të përgjithshme, që duhet të përmbushë kandidati për t’u kualifikuar si metrolog i autorizuar”;
- DPM nuk ka një program vjetor të miratuar, për zhvillimin e aftësive profesionale të personelit të saj, kryesisht të specialistëve metrolog të saj, me përjashtim të specialistëve të laboratorëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme, referuar ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 8, pika 15;
- Nga DPM nuk janë miratuar rregullat dhe mënyra për kualifikimin dhe trajnimin e

<sup>34</sup>Për përcaktimin e kriterëve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t’u kualifikuar si metrolog i autorizuar”

personelit të saj, referuar ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 8, pika 15;

- Specialistët e laboratorëve të masës, që gjenden pranë Sektorëve Rajonal Lezhë, Fier dhe Korçë (në Sektorin Rajonal të Tiranës, nuk ka ambiente dhe pajisje laboratorike) të DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk kanë kryer asnjë shërbim laboratorik<sup>35</sup>;

- Rregullorja e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014 e DPM-së, **nuk** është rishikuar dhe si pasojë nuk reflekton ndryshimet që ka pësuar DPM në strukturën dhe funksionet e saj, për shkak të ndryshimeve ligjore në ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar. Gjithashtu nga shqyrtimi i saj, rezulton se nuk ka një ndarje të qartë të detyrave sipas pozicionit të punës, ku disa detyra janë të njëjta për pozicionin e drejtorit, përgjegjësit dhe specialistit të sektorit, p.sh., në DMSHI, ku edhe specialisti përgjigjet për propozime të ndryshimeve ligjore, hartimin e materialeve trajnuese, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.2, faqet 40-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandimi 10.1:** DPM të marrë masat e nevojshme, për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme, duke reflektuar ndryshimet në legjislacion, ndryshimet në strukturë, si dhe duke qartësuar detyrat për çdo pozicion pune.

*Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022*

### **Për DPM**

**11. Gjetje nga auditimi:** Sektori Rajonal Tiranë (zyra laboratorë dhe ambiente shërbimi-479 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe bodrumi 429,7 m<sup>2</sup>) me vlerë 21,076,136 lekë është në pronësi të DPM-së, por në përdorim të Drejtorisë së Akreditimit. Sektori i shërbimit nr.1 Tiranë, me numrin më të madh të specialistëve metrologë të autorizuar (21 punonjës) dhe që mbulon tre prefekturat Tiranë, Durrës dhe Elbasan, është zhvendosur në një apartament banimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, duke ndikuar ndjeshëm në performancën e veprimtarisë së këtyre specialistëve për mungesë të hapësirave të vendit të punës dhe ruajtjes dhe pajisjeve të nevojshme.

- Në sektorin e shërbimeve nr.2 në Fier, laborator i masës me vlerë 3,606,157 lekë nuk është vendosur në përdorim dhe duke qenë në kushte të tilla, të gjitha pajisjet e punës humbin së shpejti karakteristikat teknike duke dalë jashtë përdorimit. Veç kësaj është jashtë punë pajisja e kontrollit për matje vëllimore me vlerë 1,991,600 lekë.

- Në sektorin e shërbimeve nr.3 në Lezhë, pajisjet laboratorike me vlerë 6,966,960 lekë nuk janë përdorur për qëllime metrologjike, për arsye të mungesës së aplikimeve për shërbime nga palët e treta.

- Në sektorin e shërbimeve nr.4 Korçë, ndodhet pajisja enë vëllimore për kontroll karburanti me vlerë 1,974,000 lekë, për të cilën nuk lind nevoja e përdorimit, pasi është zëvendësuar me auto laboratorë për karburantet, por edhe me ndryshimet ligjore, tashmë këtë lloj verifikimi DPM-ja nuk mund ta kryej më.

- Procedura e faturimit të shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës kryhet sipas një rregulloreje të brendshme të vitit 2010, miratuar me Urdhrin nr.373, datë 20.10.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM në detyrë për atë periudhë, ku në zbatim të saj, në 60-70% të rasteve, është i njëjti punonjës (pra, specialisti metrolog) që kryen verifikimin e instrumentit matës, lëshon faturën për pagesën e shërbimit të verifikimit, si dhe arkëton me para në dorë tarifën e shërbimit, pra jo nëpërmjet bankës. Kjo mënyrë veprimi është në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “c” në pikën 4, të nenit 3 në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; pikat 7, 61, 63 dhe 64 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Theksojmë se të ardhurat që mund të gjenerojë në ditë një metrolog nga verifikimi i instrumenteve matës variojnë nga 1,000 lekë – 20,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.2, faqet 40-43, të Raportit*

<sup>35</sup>Pasqyruar në tabelën nr.1 në Kapitullin Shtojcat.

*Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e mundësisë së përdorimit/jo të pajisjeve laboratorike pranë Sektorëve Rajonal, si dhe në rast se këto pajisje nuk mund të gjejnë përdorim nga DPM, në kryerjen e funksioneve rutinore të saj, të transferohen pranë rezervave të shtetit.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022**

**11.2. Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme për shfuqizimin e Urdhrit nr.373, datë 20.10.2010 “Për plotësimin dhe administrimin e dokumentacionit financiar dhe atij me numër serie që përdoret nga strukturat e DPM-së”, si dhe pagesa e tarifës së shërbimit të bëhet nëpërmjet bankës.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022**

**Për DPM**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë përfshirë për verifikim metrologjik periodik fusha kryesore, ku përdorimi i instrumenteve ka ndikim të konsiderueshëm në mbrojtjen e konsumatorit, si: fusha e mjekësisë, ndotjes së mjedisit, sigurisë publike, frekuencave të telefonisë etj., në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5, të nenit 3 dhe pikën 9 të nenit 8 në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar.

- Nga DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk janë kryer verifikimet periodike të lojërave të fatit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 21 të nenit 8 në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për Metrologjinë” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** DPM në bashkëpunim me MFE, të marrin masat e nevojshme që, duke u bazuar në studime të tregut të instrumenteve matës në vend, peshës së secilit prej tyre në volumin e transaksioneve në ekonomi, të krijojnë kushte për verifikimin e instrumenteve ligjërish të kontrolluar, si aparaturat mjekësore, ato të mjedisit, aparaturat për sigurinë publike etj, jo vetëm si një detyrim ligjor, por njëkohësisht në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjes së efektivitetit të investimeve në fushën e metrologjisë.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022**

**Për DPM**

**15. Gjetje nga auditimi:** DPM nuk ka hartuar një program komunikimi me subjektet private dhe publike që përdorin instrumente matës ligjërish të kontrolluar për pjesëmarrjen, ndërgjegjësimin dhe njohjen e rëndësisë dhe detyrimeve të tyre për verifikimin metrologjik të instrumenteve matëse, sipas kërkesave në planin e veprimit afatgjatë të SNMKMT 2014-2020.

-DML nuk ka marrë masa për ngritjen dhe vendosjen në funksion të një sistemi të brendshëm të menaxhimit të cilësisë sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014 dhe rekomandimeve të OIML<sup>36</sup>, për metrologjinë ligjore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme, duke iniciuar procesin, që specialistët metrologë të DML-së, të jenë pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë së institucionit, dhe për të vijuar më tej me akreditimin e trupës verifikuese në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020, me qëllim ngritjen dhe forcimin e shërbimit të verifikimit metrologjik.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**15.2. Rekomandimi:** DPM të marrë masat e nevojshme që të kryejë fushata ndërgjegjësimi me konsumatorët dhe bizneset, me qëllim rritjen e nivelit të informimit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në marrëdhëniet tregtare.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

<sup>36</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d009-e04.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d009-e04.pdf)

**V. Për pyetjen 4.1.2.3. A ka ndikuar në mbrojtjen e konsumatorëve veprimtaria e metrologjisë ligjore pranë DPM?**

**Për MFE dhe DPM**

**17. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë periudhës 2018-2020, verifikimi metrologjik i matësve të ujit, krahasuar me numrin e matësve të ujit në përdorim, nuk është kryer në ritmet e duhura nga subjektet private të autorizuar nga DPM, për ofrimin e këtij shërbimi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.193 datë 09.03.2009 “Mbi frekuencën e verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.3, faqet 43-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** DPM në bashkëpunim me MFE, të marrin masat e nevojshme, që të kryhet verifikimi metrologjik i matësve të ujit, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.

*Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022 dhe në vijimësi*

**VI. Për pyetjen 4.1.2.4. A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstytucional i DPM?**

**Për MFE**

**18. Gjetje nga auditimi:** Referuar përcaktimeve të bëra në nenin 8 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, si dhe objektivave strategjik në SNMKMT 2014-2020, **ka munguar bashkëpunimi me:**

- Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit për iniciimin e procedurave të akreditimit të laboratorëve;
- Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut për shkëmbimin e informacionit mbi problematikat e instrumenteve matëse, gjatë verifikimit/inspektimit të tyre;
- Institutin e Fizikës Bërthamore, për kryerjen e matjeve/verifikimeve të instrumenteve matës “dozimetër”, i cili kontrollon dozat e rrezatimit jonizues;
- Universitete dhe Fakultete të ndryshme, si ai: i Politeknikut, i Shkencave të Natyrës, me qëllim sigurimin e shërbimeve elektronike dhe mekanike në lidhje me riparimin, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të matjeve;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim shkëmbimin e informacionit, mbi importet e kryera të instrumenteve matës, duke shërbyer për plotësimin dhe përditësimin e databasës që administron DPM-ja për instrumentet matës dhe në këtë mënyrë rritjen e numrit të verifikimeve të instrumenteve;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë (DPP), me qëllim verifikimin e saktësisë së matjeve të radarëve të shpejtësisë. Theksojmë se, DPM i ka kërkuar informacion DPP-së, për llojin e radarëve që ka në përdorim, me qëllim që të sigurojë pajisjet e nevojshme për kryerjen e kalibrimit dhe verifikimit të tyre, por që nga DPP nuk është kthyer përgjigje, ç’ka do të thotë se deri në fund të vitit 2020 nuk është kryer verifikimi i radarëve që masin shpejtësinë e automjeteve/motomjeteve;
- Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve, për marrjen e masave konkrete me qëllim verifikimin e aparateve matës të ujit, instrument, i cili deri më sot nuk është verifikuar;
- Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, për kalibrimin e aparaturave që përdoren në analizat laboratorike të ushqimeve, me qëllim rritjen e saktësisë së rezultateve të gjeneruara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.4, faqet 56-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**18.1. Rekomandimi:** MFE të marrë masat e nevojshme, që të ngrëjë një grup pune, i cili të hartojë VKM përkatëse duke i'u referuar edhe direktivës së BE-së<sup>37</sup>, për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve që janë pjesë e infrastrukturës së cilësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, si ISHMT, DPA, DPS, KMK, etj., për shkëmbimin e informacionit, zbuluar dhe hetuar shkeljet e legjislacionit përkatës, me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve.

*Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022*

**Për MFE**

**19. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë periudhës 2018-2020 nuk ka funksionuar Këshilli i Metrologjisë, referuar përcaktimeve të bëra në nenin 10 të ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë", i ndryshuar.

- MFE nuk ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, për miratimin e përbërjes nominale dhe funksionimin në kushte normale të Këshillit të Metrologjisë, me arsyetimin se, nuk ka një bazë ligjore, në të cilën të mbështetet pagesa e anëtarëve të Këshillit. Ndodhur në këto kushte nga MFE, me qëllim funksionimin e kësaj strukture, duhet të ishin marrë masat e nevojshme, për propozimin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, ose përfshirjen e Këshillit të Metrologjisë, në VKM nr. 656, datë 31.10.2018<sup>38</sup>, në të cilën përcaktohet masa e shpërblimit për rreth 70 lloje organesh kolegjiale. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1.2.4, faqe 56-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1. Rekomandimi:** MFE në bashkëpunim me DPM të marrin masat e nevojshme, për ngritjen dhe funksionimin normal të Këshillit të Metrologjisë.

*Brenda vitit 2022*

---

<sup>37</sup> Regulation (EU) 2017/2394 of the European Parliament and of the Council of 12 December 2017 parashtrohet sipas të cilave strukturat kompetente, përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, që mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve, bashkëpunojnë me njëri tjetrin, në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut në përputhje me këto ligje si dhe rritjen e nivelit të mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve. të konsumatorëve, bashkëpunojnë me njëri tjetrin, në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut në përputhje me këto ligje si dhe rritjen e nivelit të mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve.

<sup>38</sup> Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore.

## 4- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI I BIBLOTEKËS KOMBËTARE”

### I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në subjektin Biblioteka Kombëtare, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti i Bibliotekës Kombëtare”, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë në subjekt:

-me shkresën nr.203/9 prot, datë 20.10.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

**a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>-së</sup>, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

**b.** Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;

**c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH<sup>-së</sup>, mbi planin e veprimeve të Bibliotekës Kombëtare për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi se, subjekti ka miratuar nga Drejtori i Bibliotekës Kombëtare, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke e dërguar atë me shkresën **nr. 185/19 prot., datë 19.11.2021**, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se Biblioteka Kombëtare me shkresën nr. 645, datë 18.07.2022, ka raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, rekomandimet e KLSH<sup>-së</sup> dhe ecuria e zbatimit të tyre, jo brenda 6 muajve **por brenda 9 muajve**.

#### 4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

KLSH ka dërguar në Bibliotekën Kombëtare, me shkresën nr.203/9 prot., datë 20.10.2021, (hyrë në këtë institucion me nr.185/17, datë 25.10.2021, Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Efektiviteti i Bibliotekës Kombëtare”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar **1** “Propozim për përmirësim ligjor” dhe **30** “Masa organizative” për zbatim. Nga **31** masat e rekomanduara, nga subjekti, janë pranuar **31** masa ose pranimi është në masën **100 %**.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Propozim për Përmirësim Ligjor	1	1	0
2	Organizative	30	30	0
3	Totali	31	31	0

## II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- K. Xh., Përgjegjës Grupi;
- J. Zh., Anëtar.

### 1. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i Bibliotekës Kombëtare".

### 2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

### 3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### 4. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar Biblioteka Kombëtare, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH<sup>ja</sup>, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

- Nga 1 masë për "Propozim për Përmirësim Ligjor" i rekomanduar është pranuar 1 rekomandim ose në masën 100% dhe është në proces 1 rekomandim ose 0.1 %.
- Nga 30 masa organizative të rekomanduara, nga subjekti janë pranuar 30 masa ose në masën 100 %.
- Nga 30 masat organizative të pranuar janë zbatuar plotësisht 11 masa ose 36.6 % tyre, janë në proces zbatimi 9 masa ose 30 % e tyre, është zbatuar pjesërisht 1 masë ose 3.3 % e tyre dhe janë pa zbatuar 9 masa ose 30 % e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1.	Propozim për përmirësim ligjor	1	0	0	1	0
2.	Masa organizative	30	11	1	9	9

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	30	100%
2	Pa pranuar	0	0%
3	Pranuar	30	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	11	36.6%
2	Pa zbatuar	9	30%
3	Në proces	9	30%
4	Zbatuar pjesërisht	1	3.3%
Nr.	Statusi i masave “Propozim për Përmirësim Ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	1	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		
2.	-Në proces	1	0.1%

### 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 36.6 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi i tyre shkon në nivelin 30.1 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara mbeten nivel relativisht të lartë në masën 30 %.

### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

#### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në lidhje me administrimin e fondit bibliotekar, mbajtjen e evidencave dhe dokumentimin e lëvizjes së fondit e sidomos kryerja e inventarizimit të materialeve bibliotekare, u konstatuan mangësi të cilat e bëjnë të vështirë dokumentimin, verifikimin si dhe ruajtjen e tyre. Kjo për faktin se në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve në BK, nuk ka pasur një udhëzues pune të miratuar dhe të shqyrtuar në Këshillin Administrativ të BK-së, për organizimin e dokumentacionit përkatës shoqërues, norma teknike të përllogaritura sipas llojit të fondit dhe përcaktimi i afateve kohore sipas njësive të kryerjes së inventarëve që duhen mbajtur. Në këtë mënyrë nuk mund të konsiderohet e kryer procedura e inventarizimit sipas rregullave në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi inventarizimi është një element shumë i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, gjendjen fizike si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre.

Domosdoshmëria e një udhëzimi specifik për këto Aktive (Libri) e përbën fakti se “Librat” janë aktive të cilat nuk vlerësohen, nuk janë objekt i përllogaritjes së amortizimit vjetor, dhe afate kohore të përdorimit, sikurse janë aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale, aktive afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave që trajtohen sipas rregullave të vendosura në SKK, në ligjin nr.25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe në UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.Rekomandimi:**BKSH të marrë masa të menjëhershme për iniciimin e hartimit të një udhëzimi specifik për administrim, menaxhim dhe inventarizim të Fondit Bibliotekar, i cili

pasi të shqyrtohet në Këshillin Administrativ të BK duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të menaxhimit bibliotekar, t'i përcillet Ministrisë së Kulturës për miratim.

Në udhëzim duhet të përcaktohet saktë dhe qartë:

-Përkufizimi i aktiveve që përbëjnë materialet bibliotekare pra Fondin e BK. Në tërësinë e materialeve bibliotekare libri zë vend kryesor e të rëndësishëm.

-Marrëdhëniet ndërmjet Sektorit të Buxhetit dhe të Financës dhe Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në lidhje me shkëmbimin e informacioneve, me qëllim evidentimin në kontabilitet pra në pasqyrat financiare të gjendjes së Fondit Bibliotekar në BK. Dokumentimi i lëvizjeve të materialeve bibliotekare, afatet kohore në kryerja e inventarizimit të materialeve bibliotekare ( sipas llojit të tyre), procedurat që duhet të ndiqen gjatë procesit të seleksionimit të materialeve bibliotekare, të cilat të shoqërohen me Urdhrin e Titullarit i cili duhet të përmbajë, përbërjen e komisionit, afatet kohore, listën e materialeve bibliotekare, proces verbalet me informacion e duhur si dhe hartimin e raportit përmbledhës për rezultatet e inventarizimit sipas një formati të caktuar.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimi rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

***I-Për Pyetjen: A janë efektive politikat në lidhje me menaxhimin e veprimtarisë së BK?***

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se: Menaxhimi i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare ka hasur vështirësi të cilat kanë ardhur si rezultat:

-I mungesës ndër vite të hartimit të politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, dhe mos funksionimit prej vitesh të Këshillit Kombëtar të Bibliotekave si organ këshillimor për MK për përmirësimin e aktivitetit të BKSH-së.

-Në Draft Strategjinë për vitet 2016-2021, një pjesë e objektivave të saj nuk kanë mbështetje financiare sikurse është problematika afatgjatë e krizës së krijuar nga mungesa e hapësirave depozituese, të cilat sollën ndërprerje të shërbimeve ndaj përdoruesve nga viti 2017, si dhe problematika në sigurinë e koleksioneve që janë pjesë e trashëgimisë kulturore ndër vite gjë që ka ndikuar në mbylljen e një sërë aktiviteteve të saj. Këtë e dëshmon fakti që dhe në strategjinë e MK për vitin 2019-2025, miratuar me VKM nr.903, datë 24.12.2019, megjithëse në zbatim të misionit të saj ka të parashikuar pas shumë vitesh hartimin e projekt idesë për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore ku përfshihet dhe projekti për ngritjen e një Biblioteke të re Kombëtare, nuk ka gjetur zbatim dhe BKSH vazhdon të zhvillojë aktivitetin e saj në një godinë të amortizuar dhe me shumë risqe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

-Mungesës së planeve strategjike e operacionale vjetorë dhe mujorë nga BKSH, për periudhën në auditim, të cilat janë vendimtare për të vlerësimin dhe arritjen e rezultateve të parashikuara, si dhe për të evidentuar shmangiet nga objektivat e vendosura me prioritet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pika 6.1.3, ku citohet se: Njësitë publike për të ushtruar funksionin e kontrollit duhet që aktivitetet strategjike të markohen me treguesit e performancës dhe objektiva të matshëm/ targeta. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 27-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1. Rekomandimi:** Këshilli Kombëtar i Bibliotekave, si organ këshillimor pranë MK, të marrë masa dhe të forcojë rolin e tij në drejtimin menaxhial nëpërmjet autoritetit që i jep ligji gjatë marrjes dhe shqyrtimit të problematikave në fushën e zhvillimit të bibliotekave

duke dhënë orientime të duhura dhe ndikuar në përmbushjen e objektivave strategjike 2019-2025, si dhe në rritjen e performancës të institucionit të BK dhe të sistemit bibliotekar në vend.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa nga Këshilli Kombëtar i Bibliotekave referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.*

**1.2. Rekomandimi:** BKSH në hartimin e strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë së saj, të përcaktojë qartë hartimin e këtij dokumenti që t'i shërbejë krijimit të një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese, duke përcaktuar drejt dhe saktë politikat e pasurimit, të zhvillimit dhe të arkivimit të koleksioneve bazuar në standardet bashkëkohore por dhe sigurimin me mbështetjen financiare të këtyre projekteve në varësi të Ministrisë së Kulturës.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimi rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**2. Gjetje nga auditimi:** Referuar funksioneve dhe detyrave të BK rezulton se në Draft Strategji nuk janë trajtuar me prioritet problematikat e administrimit dhe inventarizimit të materialeve bibliotekare e në veçanti verifikimi i tyre duke përcaktuar politika të qarta për pasurimin dhe zhvillimin e koleksioneve të mbështetura në akte nënligjore si hartimi i një Udhëzimi specifik kryesisht në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e fondeve të BK në kushtet e instalimit të sistemit informatik në BK (Dixhitalizimit të Fondeve të BK), i cili filloi nga viti 1999. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 27-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1. Rekomandimi:** BKSH gjatë hartimit të strategjisë së zhvillimit të institucionit për vitet 2022 e në vazhdim të ketë një nga prioritet kryesore në objektivat e saj, administrimin e materialeve bibliotekare dhe inventarizimin e tyre, duke përcaktuar politika të qarta në lidhje me pasurimin, zhvillimin dhe verifikimin e koleksioneve dhe duke i dhënë një rëndësi të veçantë informatizimit të këtij procesi në kushtet e standardizimit dhe modernizimit të BK sipas standardeve bashkëkohore.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimi rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se një nga objektivat strategjike të BKSH është modernizimi i Sektorit të restaurimit të BKSH-së, i cili për periudhën në auditim ka punuar në kushte tejet primitive, me pajisje të viteve 30 e 50 të shekullit të kaluar, si rezultat i mos alokimit të fondeve për investime nga MK për periudhën 2018-2019-2020. Gjatë vitit 2020 u zhvillua në këtë drejtim me ndihmën e Bibliotekës së Strasburgut, Francë një kurs formimi 2-javor në ambientet e BKSH-së, për përmbushjen e një nga detyrave kryesore të tij: atë të ruajtjes dhe konservimit fizik të objekteve të trashëgimisë kulturore. Megjithatë krijimi i një laborator modern me pajisje të specializuara bashkëkohore për realizimin me sukses të detyrave funksionale dhe me rëndësi që ky sektor ka në efektivitetin e performancës së BK-së përbën tashmë një domosdoshmëri dhe nevojë urgjente. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 27-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*



**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masa të menjëhershme për akordimin e fondeve për krijimin e një laborator modern të shoqëruar me pajisje të specializuara bashkëkohore për realizimin e detyrave në Sektorin e restaurimit të BKSH-së.

*Brenda vitit 2022*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa nga Ministria e Kulturës referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.*

*I- Për Pyetjen: 4.1.1. A ka siguruar BK zbatimin e kuadrit ligjor/rregullator?*

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga Ministria e Kulturës në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.8576, datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është miratuar asnjë udhëzim specifik në vite “Për menaxhimin e fondit të sistemit kombëtar të bibliotekave përfshirë këtu kryesisht Bibliotekën Kombëtare”, për vetë specifikën që paraqet procesi i inventarizimit në BK, ku të përcaktohen procedura standarde dhe të ketë gjurmë auditimi për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe spastrimin e materialeve bibliotekare e konkretisht të librit apo dhe të materialeve të tjera bibliotekare si një aktiv me veçori të veçanta (i cili nuk ka afate përdorimi dhe nuk vlerësohet) sikurse aktivet e tjera të cilat kanë afate kohore përdorimi, amortizohen (mbi bazën normave përkatëse të amortizimit), dhe i nënshtrohen, një procesi rivlerësimi në bazë të rregullave dhe të standardeve të kontabilitetit të përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; në ligjin nr.25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Mungesa e politikave dhe udhëzimeve në ndihmë të procesit, mangësia e planeve operacionale dhe strategjike të sektorit të zhvillimit të koleksioneve dhe moskryerja e monitorimit nga strukturat drejtuese të BK-së, ka sjellë mos realizimin e detyrave funksionale që janë: verifikimi dhe inventarizimi i koleksioneve, proces i cili rezulton i pa kryer ndër vite duke ndikuar në performancën e dobët të këtij sektori. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1. Rekomandimi :** BKSH të hartojë planin vjetor të veprimtarisë së institucionit, të përbërë nga planet vjetore të sektorëve të BK-së, në bazë të funksioneve dhe specifikave që ata kanë, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë mbështetjes në akte nënligjore si udhëzimeve specifike për Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve, të cilat të shqyrtohen nga Këshilli Shkencor për një gjykim më profesional me qëllim që objektivat të jenë të realizueshme dhe të monitorueshme.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën në auditim, BKSH nuk ka kryer pasurim të fondit bibliotekar, si rezultat i mungesës së fondeve të alokuara nga Ministria e Kulturës për BK, në kundërshtim me nenin 27, paragrafi i dytë i pikës 11, të Ligjit 8576, datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në RSH”, ku përcaktohet se: *Për të realizuar pasurimin e koleksioneve me vlerë kombëtare, Biblioteka Kombëtare kryen blerje me fonde buxhetore të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.* Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të institucionit, të dokumentuara në PBA-të përkatëse të BK-së, ku Ministria e Kulturës për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor,

teknik apo teknologjik të autorëve shqiptarë dhe të huaj, organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në bazë të rekomandimeve të Këshillit Kombëtar të Librit dhe të Nxitjes së Leximit, të përcjella nga ministri, *duhet të kishte krijuar fondet përkatëse në buxhetet respektive për blerjen e një minimumi të titujve të botuar dhe të shtypshkruar në vend, veprime në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”*. Ky minimum përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës në vijim të marrë masa dhe të miratojë në bazë të kërkesave vjetore për buxhet të Bibliotekës Kombëtare, fonde për investime, duke vendosur me prioritet fondet për blerje ndërkombëtare librash për Albano-Balkanologjinë që do t'i shërbejnë pasurimit të koleksioneve bibliotekare duke kontribuar në shtimin e vlerave të trashëgimisë kulturore kombëtare.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa nga Ministria e Kulturës referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në mbështetje të neneve të parashtruara në Ligjin nr. 9616 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “Blerja e librit/librave” duhet të përjashtohet nga procedurat e prokurimit publik, përderisa çmimi i njësuar vendoset/shënohet në çdo botim nga botuesit/entet botuese që zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Meqenëse çmimi i shitjes në publik bëhet i njohur publikisht, duke u shënuar në mbulesën e jashtme të librit me shtyp ose mbi etiketim (edhe në rastet e importimit çdo person fizik ose juridik që importon libra duhet të caktojë një çmim për shitjen e tij; nuk ka libër në librari pa etiketim të çmimit) del qartë që blerja e librit nuk ka përse t'i nënshtrohet prokurimit publik. Në këtë rast procedurat e prokurimit do të rezultonin fiktive. Për këtë është bërë kërkesë nga ish – Titullari i BKSH-së z. X me nr. 184. prot., datë 09.09.2015, drejtuar Ministrit të Kulturës, për zgjidhje ligjore të problemit të blerjes së librave në Shqipëri. Kjo kërkesë nuk ka marrë ende zgjidhje në ditët e sotme, megjithëse nga Ministria e Kulturës është trajtuar në projekt-ligjin e vitit 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9616 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht neni 14 dhe nenin 23, pika 4. Gjithashtu për BK paraqet pengesë juridike edhe pasurimi i koleksioneve bibliotekare nëpërmjet “blerjes ndërkombëtare të materialit bibliotekar” (parashtruar në paragrafin e dytë të pikës 11 të nenit 27 të Ligjit nr. 8576, datë 3.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar): librave me karakter albano-balkanologjik, që botohen jashtë Shqipërisë nga botues të ndryshëm në vende të ndryshme, si dhe veprat e autorëve shqiptarë të botuar jashtë vendit, të cilat nuk gjenden në rrjetin e librarive në vend. Legjislacioni në fushën e prokurimit publik në fuqi nuk lejon Bibliotekën Kombëtare në kryerjen e procedurave të prokurimeve të drejtpërdrejta për “Blerje librash” jashtë Shqipërisë në fushën e Albano-Balkanologjisë.

-Pasurimi i koleksionit bibliotekar për periudhën në auditim ka ardhur nga dhuratat individuale e institucionale dhe nga dorëzimi i detyrueshëm i (5 pesë) kopjeve për çdo botim që duhet të bëjnë të gjithë botuesit apo entet botuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, pa shpërblim, në zbatim të bazë nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, proces i cili ka rezultuar i mangët pasi u konstatua se mungojnë 514 tituj librash me karakter artistik, akademik e historik, të pa dorëzuara në fondin e BK dhe me mungesë penalitetesh - detyrë kjo e Ministrisë së Kulturës,



dhe veprime në kundërshtim me nenin 48, pika 1, b, të Ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr.10238, datë 18.02.2010”. Gjithashtu, dorëzimi i kopjeve të detyruara nga entet botuese është ndërprerë përkohësisht nga BK me një njoftim zyrtar të kryer në 10.03.2020 për periudhën 10.03.2020 – 11.05.2020 si rezultat i situatës pandemike Covid-19. Në vijim dorëzimi i kopjes së detyruar ka vijuar normalisht. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1. faqe 47-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masa për përcjelljen për miratim të projekt-ligjit të vitit 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9616 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, ku parashtrohet përjashtimi i blerjes së librit në Shqipëri nga procedurat e prokurimit publik.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa nga Ministria e Kulturës referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.*

**3.2. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masa për hartimin e kuadrit ligjor që të mundësojë pasurimin e koleksioneve bibliotekare të BK nëpërmjet “blerjes ndërkombëtare të materialit bibliotekar” të librave me karakter albano-balkanologjik, që botohen jashtë Shqipërisë.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa nga Ministria e Kulturës referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.*

**3.3. Rekomandimi:** BKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të kryejnë përmirësimet e nevojshme në kontratën tip të lidhur mes Zyrës së Agjencisë së Numrit Ndërkombëtar Standard për Librin (ISBN) dhe enteve botuese/botuesit; në bazë të Urdhrit nr. 433, datë 30.10.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Botimeve të Librit” duke shtuar: masën e penaltetit për mos depozitim të kopjeve të detyruara brenda afateve ligjore deri në ndërprerje dhëniesh të ISBN dhe CIP enteve botuese/ botuesit, nga BK, si dhe të miratohet struktura e cila do të ndjekë dhe arkëtojë detyrimet për subjektet që rezultojnë debitorë.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe nga ana e vet dhe e ka zbatuar rekomandimin, por Ministria e Kulturës, akoma se ka miratuar rregulloren e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Standardizuar të Botimeve të Librit dhe Kontratës tip.*

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.*

**3.4. Rekomandimi:** BKSH të përcjellë pranë Ministrisë së Kulturës 2 (dy) herë në vit informacion për botuesit/entet botuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk kanë depozituar pranë saj 5 (pesë) kopjet e detyruara në zbatim të bazë nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimin rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**4. Gjetje nga auditimi:** Organizimi dhe mbajtja e librave të inventarit të fondit të BK ndër vite në sektorin e zhvillimit të koleksioneve është bërë sipas standardeve IFLA, rregullave dhe dokumenteve të përshkruara në një tekst shkollor “Koleksionet e bibliotekës”, të përgatitur nga ish punonjës të Sektorit të Studimeve dhe të Kualifikimit viti 2002, por të pa miratuara në institucion nga Titullari, të pa përfshira dhe përditësuara në Rregulloren e Brendshme të BK-së, të miratuar me Urdhër nr.136, datë 15.09.2010, si dhe të pa azhurnuar me kërkesat e ligjit nr.25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Në sektorin e zhvillimit të koleksioneve nuk është organizuar ndër vite mbajtje e veçantë e kartelave të inventarit për materialet bibliotekare sipas vendit të depozitimit dhe personave përgjegjës, referuar kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, pika 35/pika c.

-Nga auditimi u konstatuan se në librat e inventarit janë regjistruar sipas evidencave të paraqitura nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, progresivisht *1,155,557 njësi bibliotekare (deri me 31.12.2020)*. Procesi i skanimit të librave të inventarit vazhdon dhe deri më tani rezultojnë të jenë skanuar vetëm 82 libra inventari. Procesi i inventarizimit paraqitet me mangësi të theksuara në përpilimin e dokumenteve që evidentojnë hyrjen e materialeve bibliotekare të cilat regjistrohen në librat përkatës sikurse është Akti i hyrjes, i mbajtur nga Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve, përveç periodikut që mbahet nga Sektori i Shërbimit dhe i Informacionit. Në këto dokumente vendoset sasia në numër, datë dhe me emër botuesi, ose me emër dhuruesi në sasi, çmim dhe vlerë duke vendosur emrin subjektit botues *por pa vendosur numrin e faturës bashkangjitur*, akte të cilat përpilohen në dy kopje dhe si pasojë në regjistër në inventarin e akt- hyrjeve rezultojnë e pa evidentuar tek kopja e detyruar burimi i ardhjes së librit dhe fatura si dokument justifikues. E njëjta procedurë me mangësi ndiqet edhe nga sektori i Shërbimit dhe Informacionit për materialet periodike të mbërritura në BK ku në Akt Hyrje nuk vendoset burimi i ardhjes dhe çdo dokument tjetër justifikues e shoqëruet. Mangësitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi sektorin e zhvillimit të koleksioneve dhe përgjegjësen e sektorit të Shërbimit dhe Informacionit. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve dhe Sektori i Shërbimit të Informacionit gjatë përpilimit të dokumenteve të hyrjes së materialeve bibliotekare, të marrin masa për pasqyrimin në aktin e hyrjeve të gjithë elementët përkatës që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative, e konkretisht përveç treguesve sasiore dhe ato të vlerës të bashkëlidhin dokumentin vërtetues sikurse është fatura bashkëlidhur dhe çdo dokument tjetër justifikues.

-Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, në bazë të dokumenteve të hyrjes dhe daljes në vendet e depozitimit të materialeve bibliotekare të organizojë mbajtjen e kartelave të inventarit të koleksioneve sipas vendit të depozitimit dhe personave përgjegjës referuar kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, pika 35/pika c.

- Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në bashkëpunim me sektorin e Bibliografisë të marrin masa që të vazhdojë skanimi i librave të inventarit të pa depozituar, duke përcaktuar afate konkrete, me qëllim përfundimin e monitorimin e këtij procesi të rëndësishëm.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se lëvizja e materialeve bibliotekare brenda BKSH-së, dokumentohet me fletë shoqëruese e cila përbën akt-daljen e materialeve bibliotekare dhe përpilohet nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve aktualisht vetëm në tre kopje, cilësuar në sasi e çmim, por **pa vendosur vlerën totale sipas materialeve** përkatëse bibliotekare. Sektori i zhvillimit të koleksioneve nuk mban të depozituar një fletë shoqëruese apo akt-daljen origjinale të firmosur nga të gjithë personat përgjegjës duke krijuar mungesë të gjurmës së auditimit.

-Mungesa e gjurmës së auditimit konstatohet edhe në regjistrin e inventarit tek fondi i përgjithshëm ku nuk evidentohen koleksionet sipas llojit me analiza specifike, duke sjellë mangësi në përpilimin e evidencave të hyrjeve sipas llojit të fondit të BK, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.30, datë 27.12.2011, pika 30.

Këto veprime në organizimin dhe mbajtjen e dokumentimit të lëvizjeve të koleksioneve sjellin që informacioni në lidhje me hyrjet dhe daljet sipas viteve nuk jepet në mënyrë analitike pra sipas llojit të fondit në sasi dhe vlerë, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, në lidhje me procedurat standarde dhe gjurmën e auditimit me qëllim mbrojtjen e aktiveve që në rastin konkret janë materialet bibliotekare. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në BKSH, të marrë masa për të përgatitur në katër kopje Fletë Shoqërimit e materialeve në sektorët përkatës për përpunim (përshkrimin bibliografik të koleksioneve) dhe në fund të këtij procesi me depozitim të tyre në fondin arkivor, në sasi, çmim dhe vlerë të nënshkruar nga sektorët përkatës, të regjistrojë fletë daljen në librin e inventarit duke hartuar kështu dhe kartelat inventariale sipas personave ku janë depozituar koleksionet në mënyrë analitike.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**5.2. Rekomandimi:** Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në BKSH, të marrë masa dhe të organizojë mbajtjen e regjistrave të inventarëve sipas llojit të tyre dhe veprimet që kryhen në librat e inventarëve të bazohen në dokumente origjinale si për hyrjet dhe dalje, sipas llojit me analiza.

-Në këtë sektor të organizohet kryerja e mbajtjes së kartelave sipas vendndodhjes së materialeve bibliotekare dhe sipas personave përgjegjës me analiza sipas llojit të materialeve bibliotekare. Në sektor të mundësohet mbajtja origjinale e akteve si për hyrjet dhe për lëvizjet e koleksioneve nëpërmjet akt-daljeve (apo fletë shoqërimit) të koleksioneve duke u shtuar në katër kopjet e hartuara për këtë qëllim.

*Janar 2022 dhe në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimin rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në BK, procesi i mbajtjes së dokumentacioneve hyrëse dhe lëvizjes së materialeve bibliotekare e regjistrimi i tyre në librat e inventarit dhe të lëvizjes bëhet në mënyrë manuale, pavarësisht se në institucion është instaluar sistemi i përpunimit të përshkrimit bibliografik referuar kontratës së lidhur nga AKSHI me nr. 7442/prot. datë 27.12.2018.

Si rezultat i vonësive të trajnimeve të specialistëve të sektorit të zhvillimit të koleksioneve në lidhje me modulën e pasurimit, nga sektori i studimeve dhe kualifikimit dhe sektori i IT, përgjegjës për këtë funksion në sistemin e ri informatik ALIS, instaluar më 27.12.2018, ka sjellë që procesi i përpunimit fizik të hyrjes dhe lëvizjes së koleksioneve, kryerjes së

verifikimit të koleksioneve (apo inventarizimit fizik të tyre), i pa informatizuar, të përbëjë një volum të madh pune duke kërkuar shumë kohë dhe burime njerëzore dhe duke ndikuar në një proces joefektiv dhe eficient. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1. Rekomandimi:** BK si institucion i shërbimit publik, të marrë masa për qasje informacioni për të gjithë përdoruesit, për koleksionet që arkivohen ndër vite dhe që përbëjnë vlera të rralla për kulturën tonë, si dhe të parashtrohet në objektivat strategjike të BKSH-së, për vitin 2022 e në vijim, mundësia e digjitalizimit në sistemin informatik Alis të modulit të pasurimit të gjithë informacionit që përmbajnë 222 librat, mbi hyrjet dhe lëvizjet e fondit ndër vite me qëllim azhurnimin e këtyre të dhënave me të dhënat dhe gjendjen aktuale të Fondit në institucion.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**6.2. Rekomandimi:** Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në bashkëpunim me Sektorin e Studimeve dhe Kualifikimit, strukturën drejtuese të BKSH-së dhe asistencën e sistemit të IT-së, të informatizojë të gjithë procesin e punës të Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve, i cili fillon nëpërmjet përpilimit të dokumenteve hyrës dhe lëvizës (akt daljet) sipas burimit dhe regjistrimi i tyre në regjistrat përkatës të inventarëve sipas rregullave dhe standardeve përkatëse. E rëndësishme është hartimi i një data bazë për të gjithë pasurinë e koleksioneve ndër vite, sipas llojit, me analiza në sasi e vlerë dhe vendit të depozitimit, duke krijuar kështu mundësinë në çdo kohë të kontrollit dhe të evidentimit të gjendjes së materialeve bibliotekare sipas hyrjeve dhe vendit të depozitimit, e duke garantuar kështu dokumentimin, arkivimin, ruajtjen dhe qarkullimin e koleksioneve sipas procedurave dhe rregullave standarde bashkëkohore.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**6.3. Rekomandimi:** Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve të hartojë periodikisht evidencat për materialet bibliotekare drejtuar Sektorit të financës dhe të buxhetit, për të kryer kontabilizimet në llogaritë përkatëse, të cilat të jenë me analiza sipas llojit të fondit në sasi dhe vlerë të shoqëruar me informacion të hollësishëm mbi gjendjen e koleksioneve sipas hyrjes dhe verifikimit të tyre.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga sektori i zhvillimit të koleksioneve për inventarizimin e fondit bibliotekar, rezultoi se:

Në sektorin e zhvillimit të koleksioneve në BK, nuk ka pasur një udhëzues pune të miratuar dhe të shqyrtuar në Këshillin Administrativ të BK-së, për organizimin e dokumentacionin përkatës shoqëruar, norma teknike të përlllogaritura sipas llojit të fondit dhe përcaktimi i afateve kohore sipas njësive të kryerjes së inventarëve që duhen mbajtur. Në këtë mënyrë nuk mund të konsiderohet e kryer procedura e inventarizimit sipas rregullave në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë

e sektorit publik”, pasi inventarizimi është një element shumë i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, gjendjen fizike si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre. (Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.1 faqe 46-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**7.1. Rekomandimi:** BKSH të marrë masa të menjëhershme për iniciimin e hartimit të një udhëzimi specifik për administrim, menaxhim dhe inventarizim të Fondit Bibliotekar, i cili pasi të shqyrtohet në Këshillin Administrativ të BK duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të menaxhimit bibliotekar, t’i përcillet Ministrisë së Kulturës për miratim.

Në udhëzim duhet të përcaktohet saktë dhe qartë:

-Përkufizimi i aktiveve që përbëjnë materialet bibliotekare pra Fondin e BK. Në tërësinë e materialeve bibliotekare libri zë vend kryesor e të rëndësishëm.

-Marrëdhëniet ndërmjet Sektorit të Buxhetit dhe të Financës dhe Sektorit të Zhvillimit të Koleksioneve në lidhje me shkëmbimin e informacioneve, me qëllim evidentimin në kontabilitet pra në pasqyrat financiare të gjendjes së Fondit Bibliotekar në BK. Kryerja e inventarizimit, duhet të shoqërohet me Urdhrin e Titullarit i cili duhet të përmbajë, përbërjen e komisionit, afatet kohore, listën e materialeve bibliotekare, proces verbalit me informacion e duhur si dhe hartimin e raportit përmbledhës për rezultatet e inventarizimit sipas një formati të caktuar.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimi rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**7.2. Rekomandimi:** Titullari i BKSH-së të ngrajë një grup pune me specialistë të fushës së bibliotekonomisë brenda dhe jashtë institucionit për seleksionimin dhe më pas spastrimin e materialeve bibliotekare kriteret e përzgjedhjes së të cilave do të shqyrtohen më parë në Këshillin Shkencor dhe të miratohen nga Titullari.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimi rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**7.3. Rekomandimi:** BKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të marrë masa konkrete që të sigurohet depozitimi i materialeve bibliotekare në ambiente me kushte të përshtatshme depozitimi dhe sigurie afatgjatë, për ruajtje nga uji, zjarri apo vjedhja, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.8576, datë 03.02.200 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në dispozita ligjore për ruajtjen dhe sigurinë e trashëgimisë kulturore në vite.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe nuk e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.*

**Për pyetjen 4.1.2.:** A janë të mjaftueshme hapësirat bibliotekare për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj përdoruesve të librit?

**1. Gjetje nga auditimi:** Shërbimi i BKSH, me gjithë hapat e ndërmarra, ka mungesa të theksuara; në hapësira për depozitimin, shërbimin ndaj përdoruesit dhe personelin; të kushteve në shërbim të përdoruesit me aftësi të kufizuar; mungesa e hapësirave të pushimit dhe shërbimit; hapësirave për ekspozita; mungesa e kushteve të përshtatshme mjedisore e klimaterike, si dhe të pajisjeve si: tavolina, karrige, kompjuterë; mungesa e orareve të

përshatshme për lexuesin; mungesa të materialeve bibliotekare; etj., në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të IFLA, UNESCO etj., të cilat vazhdojnë të jenë gjithmonë në rënie me rritjen e numrit të lexuesve dhe të përdoruesve.

( Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.2 faqe 73-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës në bashkëpunim me BKSH-në dhe Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, të analizojnë gjendjen aktuale të hapësirave të BK-së, dhe të hartojnë një plan konkret emergjent për zgjidhjen e krizës së ambienteve në bibliotekë.

*Brenda Vitit 2022*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe nuk e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.*

**1.2.Rekomandimi:**Ministria e Kulturës dhe Qeveria Shqiptare të mendojnë, përpunojnë e implementojnë një plan konkret e afatgjatë për ri konceptimin e shërbimit bibliotekar, për vënien në dispozicion të mjediseve shtesë për Bibliotekën Kombëtare, në përputhje me standardet botërore të IFLA-s, për ofrimin e shërbimit cilësor ndaj lexuesve dhe në përmbushje të kërkesave për arkivim të librit dhe koleksioneve, për më shumë qasje në informacion dhe edukim përmes artit dhe kulturës.

*Brenda Vitit 2022*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa nga Ministria e Kulturës referuar zbatimit të këtij rekomandimi.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për shkak të mungesës së një Biblioteke të qytetit të Tiranës, ndërkohë që edhe popullsia shumëfishohet çdo ditë, BKSH nuk mund të kryejë funksionet e një biblioteke publike të Tiranës. Në kushtet kur parimet dhe funksionet e një biblioteke publike janë në thelb të ndryshme nga ato të një biblioteke kombëtare (përcaktuar sipas standardeve të IFLA-s) etj., është përfutur një Institucion “hibrid”, i cili punon i sforcuar për të kryer dy funksione tepër të ndryshme nga njëri tjetri duke vështirësuar dhe rënduar çdo ditë e më tepër proceset funksionale tip të BKSH, prandaj del imediate kjo ndarje e cila për momentin nuk ka “shpresë” të kryhet. (Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.2 faqe 73-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Qeveria Shqiptare të shikojë mundësinë e ndarjes së funksionit publik të BKSH-së nga ai kombëtar sipas modeleve/praktikave botërore, pasi krijimi i një biblioteke për kryeqytetin është një domosdoshmëri dhe kërkesë imediate e kohës.

*Brenda Vitit 2022*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jenë marrë masa nga Ministria e Kulturës referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.*

**Për pyetjen 4.1.3 A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare në përmirësimin e infrastrukturës së BK?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u kostatua se fondet buxhetore nuk i janë akorduar BKSH-së, në bazë të kërkesave të PBA, drejtuar MK-së, për periudhën objekt auditimi.

Fondet e akorduar kanë rezultuar në ulje nga viti 2018 e në vazhdim referuar akt rakordimeve të fondeve buxhetore të mbajtura në fund të vitit me përfaqësuesit e MK. Biblioteka Kombëtare për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2020, është financuar me fonde buxhetore nga Ministria e Kulturës e konkretisht për vitin 2018 në shumën prej 102,459 mijë lekë ose 4,4 % të totalit të fondeve të MK, për vitin 2019 në shumën prej 99,011 mijë lekë ose 4,3% të totalit të fondeve të MK, për vitin 2020 në shumën 99,894 mijë lekë ose 4% të totalit të fondeve të MK, fonde të cilat kanë pësuar ulje ndër vite dhe në mungesë totale të fondeve për investime të kërkuara në PBA-të e Bibliotekës Kombëtare.

Fondet për investime për Bibliotekën Kombëtare janë dhënë për vitin 2018 dhe për vitin 2020, vetëm për raste emergjente si rezultat i dy ngjarjeve të rënda të ndodhura, zjarri dhe përmbytja në sallën P300 në vitin 2017 dhe vitin 2018.

Vlen të theksohet fakti se me gjithë kërkesat e vazhdueshme të BK në domosdoshmërinë për ngritjen e një godine të re bashkëkohore për vitet 2018 e në vazhdim nuk rezultojnë të jenë përcaktuar fonde buxhetore konkrete nga MK, referuar dhe objektivit të Strategjisë së MK 2019-2025 për një projekt të ri godine me standarde bashkëkohore. Mungesa e fondeve buxhetore, veçanërisht të fondeve për investime ka sjellë mosfunksionimin e një pjese të hapësirave të shërbimit ndaj lexuesve, të cilat janë përdorur për mbajtjen e kutive me libra, jashtë çdo standardi të ruajtjes së tyre nga lagështira dhe zjarri.

Nga auditimi u konstatua se godina ku zhvillon aktivitetin institucioni rezultojnë pa status juridik të pronësisë.

Mos lëvrimi i fondeve për blerje librash për albano- Balkanologjinë në BK ka ndikuar negativisht në pasurimin dhe arkivimin e botimeve nga të huajt për Shqipërinë duke mos realizuar dhe objektivat e institucionit bazuar në nenin 17 të ligjit 8576, datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.1.3 faqe 83-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa në rritjen e fondeve të alokuara për investime për BKSH-në, për përmirësimin e ambienteve ekzistuese të Bibliotekës Kombëtare dhe shtimin e tyre brenda Pallatit të Kulturës.

*Brenda vitit 2022*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar përgjigjes nga subjekti i audituar rezultojnë se kjo Ministri ka premtuar të marrë masa referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.*

**1.2. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës për realizimin e objektivave të BK duhet të përcaktojë dhe të lëvrojë fonde për blerje librash për Albano-Balkanologjinë të botuar jashtë Shqipërisë të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore.

*Brenda vitit 2022*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit të audituar ky rekomandim është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, megjithatë referuar përgjigjes nga subjekti i audituar rezultojnë se kjo Ministri ka premtuar të marrë masa referuar zbatimit të këtij rekomandimi

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.*

***Për pyetjet: 4.2. A është kryer digjitalizimi i plotë i shërbimit bibliotekar, për periudhën nën auditim?***

**4.2.1.A ka qenë efektiv procesi i digjitalizimit të të dhënave të Fondit të materialeve bibliotekare?**

#### **4.2.2.A ka qenë efektive Qendra e Digjimit të Trashëgimisë së Shkruar për periudhën 2018-2020?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Konstatohet se sektori i bibliografisë kombëtare në BK vazhdon të punojë me një protokoll formal, konkretisht të datave 21.06.2016 dhe 23.06.2016, të cilat në përmbajtjen e tyre kanë të përshkruar në mënyrë mekanike detyrat funksionale që duhet të kryejë ky sektor. Nuk ka plane specifike mujore e vjetore të punës për periudhën në auditim se si do të kryhet përzgjedhja e materialeve për digjimit, kriteret që janë përdorur për përzgjedhjen e materialeve bibliotekare për digjimit, përparësitë dhe normat mujore të digjimit të koleksioneve të Bibliotekës Kombëtare, për të matur efektivitetin e këtij procesi me rëndësi primare si nga funksionet drejtuese ashtu edhe për ne si auditues të jashtëm. Planet janë në formë e-maileve, apo dokumentesh të pa miratuara dhe të pa firmosura nga Drejtori i Institucionit, si dhe të pa protokolluara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, e cila ka hartuar “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.2.1 dhe 4.2.2 faqe 94-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1 Rekomandimi:** Sektori i Bibliografisë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të marrë masa për hartimin e planeve operacionale vjetore dhe periodike të mirë organizuar, me afate dhe lista përkatëse për digjimit të cilat të marrin miratim nga drejtori i BK-së, me qëllim matjen e efektivitetit të këtij procesi në BK.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**2. Gjetje nga auditimi:** Mungesa e planeve operacionale vjetore dhe mujore, për sektorin e Albano-Balkanologjisë, si sektori bazë për hartimin dhe planifikimin për digjimit të materialeve më rëndësi të veçantë kulturore, dhe si rrjedhim mungesa e gjurmës së auditimit, pasojë e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to, ka sjellë një digjimit në norma shumë të ulëta të antikuarëve, hartave dhe dorëshkrimeve.

Të dhënat statistikore nga BKSH, për sa është digjitur dhe sa ka mbetur për t'u digjitur, janë bazuar në bibliografitë kombëtare të librit shqip dhe të bibliografisë të materialeve albano-balkanologjike. Pra nga asnjë nga dy sektorët kryesorë që janë Sektori i Bibliografisë dhe Sektori i Albano-Balkanologjisë, nuk mund të merret një shifër e saktë apo “e certifikuar” se sa antikuarë apo materiale të tjera bibliotekare ka në tërësi Fondi për t'u digjitur.

Nga sa më sipër ky proces si në raportim ashtu dhe në digjimit paraqitet me mangësi të theksuara pasi asnjë nga sektorët përkatës nuk raporton të saktë, përqindje të punës së kryer në raport me njësitë bibliotekare totale të regjistruara nga sektori i Zhvillimit të Koleksioneve.

Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi përgjegjësit e sektorëve, si dhe nëpunësin autorizues por edhe atë zbatues si dhe janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, si dhe manualin për MFK-në.

(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.2.1 dhe 4.2.2 faqe 94-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga strukturat drejtuese në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të hartohet një strategji digjitale me plane veprimi konkretë, duke dhënë përparësi dhe afate veprimi për çdo muaj.



*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimi rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**3. Gjetje nga auditimi:** Këshilli Shkencor dhe Këshilli Administrativ i Bibliotekës rezultojnë të kenë qenë jo efektiv, duke mos përmbushur detyrat e tyre funksionale në kundërshtim me nenin 16 dhe 17 të Statutit të BK miratuar me Urdhër nr.70, datë 13.02.2015, si dhe nenin 6 të Rregullores nr.136, datë 15.09.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtare”, duke sjellë mungesë në gjurmën e auditimit, mungesë të planeve të veprimtarisë studimore dhe mungesë të efektivitetit të BK-së, në procesin e digjitalizimit.

Nga auditimi u konstatua se Këshilli Shkencor i BK-së, funksionon si organ këshillimor i Drejtorit të BK dhe përbëhet prej 7 anëtarësh. Përbërja e Këshillit Shkencor miratohet nga Ministri i Kulturës me propozim të BK. Mbledhja e Këshillit thirret dhe drejtohet nga Titullari i saj dhe mbledhet jo më pak se 4 herë në vit, bazuar në nenin 16 të Statutit të BK, miratuar me Urdhër nr. 70, datë 13.02.2015. Për periudhën në auditim ky këshill është mbledhur përkatësisht 3 herë për vitin 2018, 0 (zero) për 2019 dhe 1 herë për vitin 2020.

- Nuk rezultojnë të ketë proces verbale të mbledhjeve të kryera nga Këshilli Administrativ i Bibliotekës në BK, për periudhën në auditim, për të parë dhe kuptuar se si janë zbatuar prioritetet kryesore të BK-së dhe konkretisht: Ecurinë e procesit të digjitalizimit dhe normimin e këtij procesi më qëllim matjen e efektivitetit të tij, në kundërshtim me nenin 6 të Rregullores nr.136, datë 15.09.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtare”. Ky këshill duhet të thirret nga drejtori dhe përbëhet nga përgjegjësit e sektorëve dhe si funksion kryesor ka: Shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, që kanë rëndësi primare në aktivitetin e BK-së. Drejtori planifikon dhe organizon veprimtarinë e institucionit mbështetur e ndihmuar nga Këshilli Administrativ dhe Këshilli Shkencor i BK. *(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.2.1 dhe 4.2.2 faqe 94-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Këshilli Shkencor të mbledhet jo më pak se 4 herë në vit në zbatim të nenit 16 të Statutit të BK, miratuar me Urdhër nr. 70, datë 13.02.2015, në bashkëpunim me Drejtorin e Institucionit duke bashkërenduar në fillim të çdo vitit kalendarik një plan pune me tema dhe prioritete konkrete në funksion të përmirësimit të performancës së aktivitetit të BKSH-së.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**3.2. Rekomandimi:** Këshilli administrativ i BKSH i përbëret nga përgjegjësit e sektorëve të thirret çdo fillim muaji nga Drejtori i Institucionit, duke mbajtur proces-verbale të përkatëse në shqyrtimin e çështjeve të ndryshme, që kanë rëndësi primare në aktivitetin e BK-së, si dhe mbajtjen e përgjegjësisë të secilit përgjegjës sipas sektorit që përfaqëson.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtori i Institucionit miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të BK, por ndryshimi i fundit ligjor në organikën e BK-së, i cili daton në datën 17.09.2019 nuk është i shoqëruar me një ndryshim në rregulloren aktuale të brendshme të miratuar nga ish-Drejtori i Institucionit me urdhër nr. 136, datë 15.09.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtare”. Ajo që

konstatohet në vazhdimësi, është mos përditësimi i rregullores së brendshme të Institucionit për një periudhë 10 vjeçare pasi edhe rregullorja e re është akoma draft. Pra BK me gjithë ndryshimet strukturore por edhe teknologjike, ka vazhduar të funksionojë me një Rregullore tashmë “të vjetër”. Pikërisht mungesa e një rregulloreje në funksion të ndryshimit të strukturave ka bërë që mos të realizohet objektivi kryesor i saj që është:

*BK veprimtarinë e saj e ndërton në bazë të Rregullores së Brendshme që përcakton detyrat dhe të drejtat e të gjithë elementëve të strukturës, duke synuar realizimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe shërbimeve të saj.*

Gjithashtu në rregulloren aktuale të brendshme të Institucionit nuk janë reflektuar detyra të mirë përcaktuara si dhe detajim i detyrave për të gjitha strukturat ekzistuese si dhe të bëhet përshkrimi i punës për secilin specialist sipas funksionit që përfaqëson, bazuar në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Mbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mos parashikuar marrëdhëniet e punës. Janë përcaktuar funksionet që ka “përgjegjësi i sektorit”, por nuk janë detajuar objektivat e punës për secilin specialist sipas sektorit përkatës, ndaj nuk është e qartë se kush e kryen këtë funksion dhe kush përgjigjet për realizimet e detyrave për çdo sektor duke krijuar një mungesë llogaridhënie të vazhdueshme dhe jo efikasitet në punën e kryer, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.2.1 dhe 4.2.2 faqe 94-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** BKSH në bashkëpunim me Këshillin Shkencor si organi këshillimor i saj të marrë masa të menjëhershme për miratimin e draft-rregullores së re “Për organizimin, funksionimin detyrat dhe kompetencat e administratës së BKSH-së”, duke kryer ndryshimet e nevojshme në përshtatje dhe në funksion të gjithë elementëve të strukturës, për realizimin në kohë dhe me cilësi të aktiviteteve dhe shërbimeve të saj.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga sektori i studimit dhe kualifikimit në BKSH, janë paraqitur udhëzimet standarde për unifikimin e proceseve të përpunimit të materialeve bibliotekare në bibliotekat e sistemit kombëtar, si faktor me rëndësi për shkëmbimin e informacionit, por ato nuk janë të publikuara në WEB, për t’i shërbyer gjithë sistemit bibliotekar kombëtar

*(Më hollësisht trajtuar në pyetjen 4.2.1 dhe 4.2.2 faqe 94-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** BKSH, sektori i studimit dhe kualifikimit të marrë masa për të publikuar në faqen e internetit të BK-së, të gjitha udhëzimet, metodikat apo përkthimet e ndryshme për t’i ardhur në ndihmë dhe për të pasur një standard pune në të gjithë sistemin kombëtar bibliotekar në Shqipëri.

*Janar 2022 e në vijimësi*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

## **VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit **rikërkojmë** nga Biblioteka Kombëtare, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr.203/9 prot, datë 20.10.2021(hyrë në këtë institucion me nr.185/17 datë 25.10.2021 mbi auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti i Bibliotekës Kombëtare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e

zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht ose në proces, si më poshtë:

## **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në lidhje me administrimin e fondit bibliotekar, mbajtjen e evidencave dhe dokumentimin e lëvizjes së fondit e sidomos kryerja e inventarizimit të materialeve bibliotekare, u konstatuan mangësi të cilat e bëjnë të vështirë dokumentimin, verifikimin si dhe ruajtjen e tyre. Kjo për faktin se në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve në BK, nuk ka pasur një udhëzues pune të miratuar dhe të shqyrtuar në Këshillin Administrativ të BK-së, për organizimin e dokumentacionit përkatës shoqërues, norma teknike të përlogaritura sipas llojit të fondit dhe përcaktimi i afateve kohore sipas njësive të kryerjes së inventarëve që duhen mbajtur. Në këtë mënyrë nuk mund të konsiderohet e kryer procedura e inventarizimit sipas rregullave në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi inventarizimi është një element shumë i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, gjendjen fizike si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre.

Domosdoshmëria e një udhëzimi specifik për këto Aktive (Libri) e përbën fakti se “Librat” janë aktive të cilat nuk vlerësohen, nuk janë objekt i përlogaritjes së amortizimit vjetor, dhe afate kohore të përdorimit, sikurse janë aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale, aktive afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave që trajtohen sipas rregullave të vendosura në SKK, në ligjin nr.25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe në UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**1.Rekomandimi:** BKSH të marrë masa të menjëhershme për iniciimin e hartimit të një udhëzimi specifik për administrim, menaxhim dhe inventarizim të Fondit Bibliotekar, i cili pasi të shqyrtohet në Këshillin Administrativ të BK duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të menaxhimit bibliotekar, t’i përcillet Ministrisë së Kulturës për miratim.

Në udhëzim duhet të përcaktohet saktë dhe qartë:

-Përkufizimi i aktiveve që përbëjnë materialet bibliotekare pra Fondin e BK. Në tërësinë e materialeve bibliotekare libri zë vend kryesor e të rëndësishëm.

-Marrëdhëniet ndërmjet Sektorit të Buxhetit dhe të Financës dhe Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në lidhje me shkëmbimin e informacioneve, me qëllim evidentimin në kontabilitet pra në pasqyrat financiare të gjendjes së Fondit Bibliotekar në BK. Dokumentimi i lëvizjeve të materialeve bibliotekare, afatet kohore në kryerja e inventarizimit të materialeve bibliotekare ( sipas llojit të tyre), procedurat që duhet të ndiqen gjatë procesit të seleksionimit të materialeve bibliotekare, të cilat të shoqërohen me Urdhrin e Titullarit i cili duhet të përmbajë, përbërjen e komisionit, afatet kohore, listën e materialeve bibliotekare, proces verbalet me informacion e duhur si dhe hartimin e raportit përmbledhës për rezultatet e inventarizimit sipas një formati të caktuar.

*Brenda vitit 2022*

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

***I-Për Pyetjen: A janë efektive politikat në lidhje me menaxhimin e veprimtarisë së BK?***

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se: Menaxhimi i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare ka hasur vështirësi të cilat kanë ardhur si rezultat:

-I mungesës ndër vite të hartimit të politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave, dhe mos funksionimit prej vitesh të Këshillit Kombëtar të Bibliotekave si organ këshillimor për MK për përmirësimin e aktivitetit të BKSH-së.

-Në Draft Strategjinë për vitet 2016-2021, një pjesë e objektivave të saj nuk kanë mbështetje financiare sikurse është problematika afatgjatë e krizës së krijuar nga mungesa e hapësirave depozituese, të cilat sollën ndërprerje të shërbimeve ndaj përdoruesve nga viti 2017, si dhe problematika në sigurinë e koleksioneve që janë pjesë e trashëgimisë kulturore ndër vite gjë që ka ndikuar në mbylljen e një sërë aktiviteteve të saj. Këtë e dëshmon fakti që dhe në strategjinë e MK për vitin 2019-2025, miratuar me VKM nr.903, datë 24.12.2019, megjithëse në zbatim të misionit të saj ka të parashikuar pas shumë vitesh hartimin e projekt idesë për ngritjen e institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore ku përfshihet dhe projekti për ngritjen e një Biblioteke të re Kombëtare, nuk ka gjetur zbatim dhe BKSH vazhdon të zhvillojë aktivitetin e saj në një godinë të amortizuar dhe me shumë risqe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

-Mungesës së planeve strategjike e operacionale vjetorë dhe mujorë nga BKSH, për periudhën në auditim, të cilat janë vendimtare për të vlerësimin dhe arritjen e rezultateve të parashikuara, si dhe për të evidentuar shmangiet nga objektivat e vendosura me prioritet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pika 6.1.3, ku citohet se: Njësitë publike për të ushtruar funksionin e kontrollit duhet që aktivitetet strategjike të markohen me treguesit e performancës dhe objektiva të matshëm/targeta.

**1.2. Rekomandimi:** Këshilli Kombëtar i Bibliotekave, si organ këshillimor pranë MK, të marrë masa dhe të forcojë rolin e tij në drejtimin menaxherial nëpërmjet autoritetit që i jep ligji gjatë marrjes dhe shqyrtimit të problematikave në fushën e zhvillimit të bibliotekave duke dhënë orientime të duhura dhe ndikuar në përmbushjen e objektivave strategjike 2019-2025, si dhe në rritjen e performancës të institucionit të BK dhe të sistemit bibliotekar në vend.

*Brenda vitit 2022*

**1.2. Rekomandimi:** BKSH në hartimin e strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë së saj, të përcaktojë qartë hartimin e këtij dokumenti që t’i shërbejë krijimit të një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese, duke përcaktuar drejt dhe saktë politikat e pasurimit, të zhvillimit dhe të arkivimit të koleksioneve bazuar në standardet bashkëkohore por dhe sigurimin me mbështetjen financiare të këtyre projekteve në varësi të Ministrisë së Kulturës.

*Brenda vitit 2022*

**2. Gjetje nga auditimi:** Referuar funksioneve dhe detyrave të BK rezulton se në Draft Strategji nuk janë trajtuar me prioritet problematikat e administrimit dhe inventarizimit të materialeve bibliotekare e në veçanti verifikimi i tyre duke përcaktuar politika të qarta për pasurimin dhe zhvillimin e koleksioneve të mbështetura në akte nënligjore si hartimi i një Udhëzimi specifik kryesisht në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e fondeve të BK në kushtet e instalimit të sistemit informatik në BK (Dixhitalizimit të Fondeve të BK), i cili filloi nga viti 1999.

**2.1. Rekomandimi:** BKSH gjatë hartimit të strategjisë së zhvillimit të institucionit për vitet 2022 e në vazhdim të ketë një nga prioritet kryesore në objektivat e saj, administrimin e materialeve bibliotekare dhe inventarizimin e tyre, duke përcaktuar politika të qarta në lidhje me pasurimin, zhvillimin dhe verifikimin e koleksioneve dhe duke i dhënë një rëndësi të veçantë informatizimit të këtij procesi në kushtet e standardizimit dhe modernizimit të BK sipas standardeve bashkëkohore.

*Brenda vitit 2022*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se një nga objektivat strategjike të BKSH është modernizimi i Sektorit të restaurimit të BKSH-së, i cili për periudhën në auditim ka punuar në kushte tejet primitive, me pajisje të viteve 30 e 50 të shekullit të kaluar, si rezultat i mos alokimit të fondeve për investime nga MK për periudhën 2018-2019-2020. Gjatë vitit 2020 u zhvillua në këtë drejtim me ndihmën e Bibliotekës së Strasburgut, Francë një kurs formimi 2-javor në ambientet e BKSH-së, për përmbushjen e një nga detyrave kryesore të tij: atë të ruajtjes dhe konservimit fizik të objekteve të trashëgimisë kulturore. Megjithatë krijimi i një laborator modern me pajisje të specializuara bashkëkohore për realizimin me sukses të detyrave funksionale dhe me rëndësi që ky sektor ka në efektivitetin e performancës së BK-së përbën tashmë një domosdoshmëri dhe nevojë urgjente.

**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masa të menjëhershme për akordimin e fondeve për krijimin e një laborator modern të shoqëruar me pajisje të specializuara bashkëkohore për realizimin e detyrave në Sektorin e restaurimit të BKSH-së.

*Brenda vitit 2022*

**I- Për Pyetjen: 4.1.1. A ka siguruar BK zbatimin e kuadrit ligjor/rregullator?**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën në auditim, BKSH nuk ka kryer pasurim të fondit bibliotekar, si rezultat i mungesës së fondeve të alokuara nga Ministria e Kulturës për BK, në kundërshtim me nenin 27, paragrafi i dytë i pikës 11, të Ligjit 8576, datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në RSH”, ku përcaktohet se: *Për të realizuar pasurimin e koleksioneve me vlerë kombëtare, Biblioteka Kombëtare kryen blerje me fonde buxhetore të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit*. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të institucionit, të dokumentuara në PBA-të përkatëse të BK-së, ku Ministria e Kulturës për të pasuruar fondet e sistemit bibliotekar kombëtar me vepra me karakter kulturor, shkencor, teknik apo teknologjik të autorëve shqiptarë dhe të huaj, organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në bazë të rekomandimeve të Këshillit Kombëtar të Librit dhe të Nxitjes së Leximit, të përcjella nga ministri, *duhet të kishte krijuar fondet përkatëse në buxhetet respektive për blerjen e një minimumi të titujve të botuar dhe të shtypshkruar në vend, veprime në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”*. Ky minimum përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

**2.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës në vijim të marrë masa dhe të miratojë në bazë të kërkesave vjetore për buxhet të Bibliotekës Kombëtare, fonde për investime, duke vendosur me prioritet fondet për blerje ndërkombëtare librash për Albano-Balkanologjinë që do t'i shërbejnë pasurimit të koleksioneve bibliotekare duke kontribuar në shtimin e vlerave të trashëgimisë kulturore kombëtare.

*Brenda vitit 2022*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në mbështetje të neneve të parashtruara në Ligjin nr. 9616 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “Blerja e librit/librave” duhet të përjashtohet nga procedurat e prokurimit publik, përderisa çmimi i njësuar vendoset/shënohet në çdo botim nga botuesit/entet botuese që zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Meqenëse çmimi i shitjes në publik bëhet i njohur publikisht, duke u shënuar në mbulesën e jashtme të librit me shtyp ose mbi etiketim (edhe në rastet e importimit çdo person fizik ose juridik që importon libra duhet të caktojë një çmim për shitjen e tij; nuk ka libër në librari pa etiketim të çmimit) del qartë që blerja e librit nuk ka përse t'i nënshtrohet prokurimit publik. Në këtë rast procedurat e prokurimit do të rezultojnë fiktive. Për këtë është bërë kërkesë nga ish – Titullari i BKSH-së z. X me nr. 184. prot., datë 09.09.2015, drejtuar Ministrit të Kulturës, për zgjidhje ligjore të problemit të blerjes së librave në Shqipëri. Kjo kërkesë nuk ka marrë ende zgjidhje në ditët e sotme, megjithëse nga Ministria e Kulturës është trajtuar në projekt-ligjin e vitit 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9616 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht

neni 14 dhe nenin 23, pika 4. Gjithashtu për BK paraqet pengesë juridike edhe pasurimi i koleksioneve bibliotekare nëpërmjet “blerjes ndërkombëtare të materialit bibliotekar” (parashtruar në paragrafin e dytë të pikës 11 të nenit 27 të Ligjit nr. 8576, datë 3.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar): librave me karakter albanobalkanologjik, që botohen jashtë Shqipërisë nga botues të ndryshëm në vende të ndryshme, si dhe veprat e autorëve shqiptarë të botuar jashtë vendit, të cilat nuk gjenden në rrjetin e librarive në vend. Legjislacioni në fushën e prokurimit publik në fuqi nuk lejon Bibliotekën Kombëtare në kryerjen e procedurave të prokurimeve të drejtpërdrejta për “Blerje librash” jashtë Shqipërisë në fushën e Albano-Balkanologjisë.

-Pasurimi i koleksionit bibliotekar për periudhën në auditim ka ardhur nga dhuratat individuale e institucionale dhe nga dorëzimi i detyrueshëm i (5 pesë) kopjeve për çdo botim që duhet të bëjnë të gjithë botuesit apo entet botuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, pa shpërblim, në zbatim të bazë nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, proces i cili ka rezultuar i mangët pasi u konstatua se mungojnë 514 tituj librash me karakter artistik, akademik e historik, të pa dorëzuara në fondin e BK dhe me mungesë penaltetesh - detyrë kjo e Ministrisë së Kulturës, dhe veprime në kundërshtim me nenin 48, pika 1, b, të Ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr.10238, datë 18.02.2010”. Gjithashtu, dorëzimi i kopjeve të detyruara nga entet botuese është ndërprerë përkohësisht nga BK me një njoftim zyrtar të kryer në 10.03.2020 për periudhën 10.03.2020 – 11.05.2020 si rezultat i situatës pandemike Covid-19. Në vijim dorëzimi i kopjes së detyruar ka vijuar normalisht.

**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masa për përcjelljen për miratim të projekt-ligjit të vitit 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9616 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, ku parashtrohet përjashtimi i blerjes së librit në Shqipëri nga procedurat e prokurimit publik.

*Brenda vitit 2022*

**3.2. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës të marrë masa për hartimin e kuadrit ligjor që të mundësojë pasurimin e koleksioneve bibliotekare të BK nëpërmjet “blerjes ndërkombëtare të materialit bibliotekar” të librave me karakter albanobalkanologjik, që botohen jashtë Shqipërisë.

*Brenda vitit 2022*

**3.3. Rekomandimi:** BKSHE në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të kryejnë përmirësimet e nevojshme në kontratën tip të lidhur mes Zyrës së Agjencisë së Numrit Ndërkombëtar Standard për Librin (ISBN) dhe enteve botuese/botuesit; në bazë të Urdhrit nr. 433, datë 30.10.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Standardizimit të Botimeve të Librit” duke shtuar: masën e penaltetit për mos depozitim të kopjeve të detyruara brenda afateve ligjore deri në ndërprerje dhëniesh të ISBN dhe CIP enteve botuese/ botuesit, nga BK, si dhe të miratohet struktura e cila do të ndjekë dhe arkëtojë detyrimet për subjektet që rezultojnë debitorë.

*Brenda vitit 2022*

**3.4. Rekomandimi:** BKSHE të përcjellë pranë Ministrisë së Kulturës 2 (dy) herë në vit informacion për botuesit/entet botuese që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk kanë depozituar pranë saj 5 (pesë) kopjet e detyruara në zbatim të bazë nenit 41 dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”.

*Brenda vitit 2022*

**5.2. Rekomandimi:** Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve në BKSHE, të marrë masa dhe të organizojë mbajtjen e regjistrave të inventarëve sipas llojit të tyre dhe veprimet që kryhen në librat e inventarëve të bazohen në dokumente origjinale si për hyrjet dhe dalje, sipas llojit me analiza.



-Në këtë sektor të organizohet kryerja e mbajtjes së kartelave sipas vendndodhjes së materialeve bibliotekare dhe sipas personave përgjegjës me analiza sipas llojit të materialeve bibliotekare. Në sektor të mundësohet mbajtja origjinale e akteve si për hyrjet dhe për lëvizjet e koleksioneve nëpërmjet akt-daljeve (apo fletë shoqërimit) të koleksioneve duke u shtuar në katër kopjet e hartuara për këtë qëllim.

*Brenda vitit 2022*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga sektori i zhvillimit të koleksioneve për inventarizimin e fondit bibliotekar, rezultoi se:

Në sektorin e zhvillimit të koleksioneve në BK, nuk ka pasur një udhëzues pune të miratuar dhe të shqyrtuar në Këshillin Administrativ të BK-së, për organizimin e dokumentacionin përkatës shoqërues, norma teknike të përlllogaritura sipas llojit të fondit dhe përcaktimi i afateve kohore sipas njësive të kryerjes së inventarëve që duhen mbajtur. Në këtë mënyrë nuk mund të konsiderohet e kryer procedura e inventarizimit sipas rregullave në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi inventarizimi është një element shumë i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, gjendjen fizike si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre.

**7.1. Rekomandimi:** BKSH të marrë masa të menjëhershme për iniciimin e hartimit të një udhëzimi specifik për administrim, menaxhim dhe inventarizim të Fondit Bibliotekar, i cili pasi të shqyrtohet në Këshillin Administrativ të BK duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të menaxhimit bibliotekar, t’i përcillet Ministrisë së Kulturës për miratim.

Në udhëzim duhet të përcaktohet saktë dhe qartë:

-Përkufizimi i aktiveve që përbëjnë materialet bibliotekare pra Fondin e BK. Në tërësinë e materialeve bibliotekare libri zë vend kryesor e të rëndësishëm.

-Marrëdhëniet ndërmjet Sektorit të Buxhetit dhe të Financës dhe Sektorit i Zhvillimit të Koleksioneve në lidhje me shkëmbimin e informacioneve, me qëllim evidentimin në kontabilitet pra në pasqyrat financiare të gjendjes së Fondit Bibliotekar në BK. Kryerja e inventarizimit, duhet të shoqërohet me Urdhrin e Titullarit i cili duhet të përmbajë, përbërjen e komisionit, afatet kohore, listën e materialeve bibliotekare, proces verbalet me informacion e duhur si dhe hartimin e raportit përmbledhës për rezultatet e inventarizimit sipas një formati të caktuar.

*Brenda vitit 2022*

**7.2. Rekomandimi:** Titullari i BKSH-së të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës së bibliotekonomisë brenda dhe jashtë institucionit për seleksionimin dhe më pas spastrimin e materialeve bibliotekare kriteret e përzgjedhjes së të cilave do të shqyrtohen më parë në Këshillin Shkencor dhe të miratohen nga Titullari.

*Brenda vitit 2022*

**7.3. Rekomandimi:** BKSH në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të marrë masa konkrete që të sigurohet depozitimi i materialeve bibliotekare në ambiente me kushte të përshtatshme depozitimi dhe sigurie afatgjatë, për ruajtje nga uji, zjarri apo vjedhja, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “ Për librin në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.8576, datë 03.02.200 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në dispozita ligjore për ruajtjen dhe sigurinë e trashëgimisë kulturore në vite

*Brenda vitit 2022*

**Për pyetjen 4.1.2:** A janë të mjaftueshme hapësirat bibliotekare për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj përdoruesve të librit?

**1. Gjetje nga auditimi:** Shërbimi i BKSH, me gjithë hapat e ndërmarra, ka mungesa të theksuara; në hapësira për depozitimin, shërbimin ndaj përdoruesit dhe personelin; të

kushteve në shërbim të përdoruesit me aftësi të kufizuar; mungesa e hapësirave të pushimit dhe shërbimit; hapësirave për ekspozita; mungesa e kushteve të përshtatshme mjedisore e klimaterike, si dhe të pajisjeve si: tavolina, karrige, kompjuterë; mungesa e orareve të përshtatshme për lexuesin; mungesa të materialeve bibliotekare; etj., në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të IFLA, UNESCO etj., të cilat vazhdojnë të jenë gjithmonë në rënie me ritmin e numrit të lexuesve dhe të përdoruesve.

**1.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës në bashkëpunim me BKSH-në dhe Këshillin Kombëtar të Bibliotekave, të analizojnë gjendjen aktuale të hapësirave të BK-së, dhe të hartojnë një plan konkret emergjent për zgjidhjen e krizës së ambienteve në bibliotekë.

*Brenda vitit 2022*

**1.2.Rekomandimi:**Ministria e Kulturës dhe Qeveria Shqiptare të mendojnë, përpunojnë e implementojnë një plan konkret e afatgjatë për ri konceptimin e shërbimit bibliotekar, për vënien në dispozicion të mjediseve shtesë për Bibliotekën Kombëtare, në përputhje me standardet botërore të IFLA-s, për ofrimin e shërbimit cilësor ndaj lexuesve dhe në përmbushje të kërkesave për arkivim të librit dhe koleksioneve, për më shumë qasje në informacion dhe edukim përmes artit dhe kulturës.

*Brenda Vitit 2022*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për shkak të mungesës së një Biblioteke të qytetit të Tiranës, ndërkohë që edhe popullsia shumëfishohet çdo ditë, BKSH nuk mund të kryejë funksionet e një biblioteke publike të Tiranës. Në kushtet kur parimet dhe funksionet e një biblioteke publike janë në thelb të ndryshme nga ato të një biblioteke kombëtare (përcaktuar sipas standardeve të IFLA-s) etj., është përfituar një Institucion “hibrid”, i cili punon i sforcuar për të kryer dy funksione tepër të ndryshme nga njëri tjetri duke vështirësuar dhe rënduar çdo ditë e më tepër proceset funksionale tip të BKSH, prandaj del imediate kjo ndarje e cila për momentin nuk ka “shpresë” të kryhet.

**2.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës dhe Qeveria Shqiptare të shikojë mundësinë e ndarjes së funksionit publik të BKSH-së nga ai kombëtar sipas modeleve/praktikave botërore, pasi krijimi i një biblioteke për kryeqytetin është një domosdoshmëri dhe kërkesë imediate e kohës.

*Brenda Vitit 2022*

**Për pyetjen 4.1.3** A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare në përmirësimin e infrastrukturës së BK?

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se fondet buxhetore nuk i janë akorduar BKSH-së, në bazë të kërkesave të PBA, drejtuar MK-së, për periudhën objekt auditimi. Fondet e akorduar kanë rezultuar në ulje nga viti 2018 e në vazhdim referuar akt rakordimeve të fondeve buxhetore të mbajtura në fund të vitit me përfaqësuesit e MK. Biblioteka Kombëtare për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2020, është financuar me fonde buxhetore nga Ministria e Kulturës e konkretisht për vitin 2018 në shumën prej 102,459 mijë lekë ose 4,4 % të totalit të fondeve të MK, për vitin 2019 në shumën prej 99,011 mijë lekë ose 4,3% të totalit të fondeve të MK, për vitin 2020 në shumën 99,894 mijë lekë ose 4% të totalit të fondeve të MK, fonde të cilat kanë pësuar ulje ndër vite dhe në mungesë totale të fondeve për investime të kërkuara në PBA-të e Bibliotekës Kombëtare.

Fondet për investime për Bibliotekën Kombëtare janë dhënë për vitin 2018 dhe për vitin 2020, vetëm për raste emergjente si rezultat i dy ngjarjeve të rënda të ndodhura, zjarri dhe përmytja në sallën P300 në vitin 2017 dhe vitin 2018.

Vlen të theksohet fakti se me gjithë kërkesat e vazhdueshme të BK në domosdoshmërinë për ngritjen e një godine të re bashkëkohore për vitet 2018 e në vazhdim nuk rezulton të jenë përcaktuar fonde buxhetore konkrete nga MK, referuar dhe objektivit të Strategjisë së MK 2019-2025 për një projekt të ri godine me standarde bashkëkohore. Mungesa e fondeve



buxhetore, veçanërisht të fondeve për investime ka sjellë mosfunksionimin e një pjese të hapësirave të shërbimit ndaj lexuesve, të cilat janë përdorur për mbajtjen e kutive me libra, jashtë cdo standardi të ruajtjes së tyre nga lagështira dhe zjarri.

Nga auditimi u konstatua se godina ku zhvillon aktivitetin institucioni rezulton pa status juridik të pronësisë.

Mos lëvrimi i fondeve për blerje librash për Albano- Balkanologjinë në BK ka ndikuar negativisht në pasurimin dhe arkivimin e botimeve nga të huajt për Shqipërinë duke mos realizuar dhe objektivat e institucionit bazuar në nenin 17 të ligjit 8576, datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**1.1. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa në rritjen e fondeve të alokuara për investime për BKSH-në, për përmirësimin e ambienteve ekzistuese të Bibliotekës Kombëtare dhe shtimin e tyre brenda Pallatit të Kulturës.

*Brenda vitit 2022*

**1.2. Rekomandimi:** Ministria e Kulturës për realizimin e objektivave të BK duhet të përcaktojë dhe të lëvrojë fonde për blerje librash për Albano-Balkanologjinë të botuar jashtë Shqipërisë të cilat janë pjesë e trashëgimisë kulturore.

*Brenda vitit 2022*

**Për pyetjet: 4.2. A është kryer digjitalizimi i plotë i shërbimi bibliotekar, për periudhën nën auditim?**

4.2.1.A ka qenë efektiv procesi i digjitalizimit të të dhënave të Fondit të materialeve bibliotekare?

4.2.2.A ka qenë efektive Qendra e Digjimit të Trashëgimisë së Shkruar për periudhën 2018-2020?

**2. Gjetje nga auditimi:** Mungesa e planeve operacionale vjetorë dhe mujorë, për sektorin e Albano-Balkanologjisë, si sektori bazë për hartimin dhe planifikimin për digjitim të materialeve më rëndësi të veçantë kulturore, dhe si rrjedhim mungesa e gjurmës së auditimit, pasojë e cila bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to, ka sjellë një digjitim në norma shumë të ulëta të antikuarëve, hartave dhe dorëshkrimeve.

Të dhënat statistikore nga BKSH, për sa është digjituuar dhe sa ka mbetur për t’u digjituuar, janë bazuar në bibliografitë kombëtare të librit shqip dhe të bibliografisë të materialeve albano-balkanologjike. Pra nga asnjë nga dy sektorët kryesorë që janë Sektori i Bibliografisë dhe Sektori i Albano-Balkanologjisë, nuk mund të merret një shifër e saktë apo “e certifikuar” se sa antikuarë apo materiale të tjera bibliotekare ka në tërësi Fondi për t’u digjituuar.

Nga sa më sipër ky proces si në raportim ashtu dhe në digjitim paraqitet me mangësi të theksuara pasi asnjë nga sektorët përkatës nuk raporton të saktë, përqindje të punës së kryer në raport me njësitë bibliotekare totale të regjistruara nga sektori i Zhvillimit të Koleksioneve.

Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi përgjegjësit e sektorëve, si dhe nëpunësin autorizues por edhe atë zbatues si dhe janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, si dhe manualin për MFK-në.

**2.1. Rekomandimi:** Nga strukturat drejtuese në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës të hartohet një strategji digjitale me plane veprimi konkretë, duke dhënë përparësi dhe afate veprimi për çdo muaj.

*Brenda vitit 2022*

## 5- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EKONOMIA RURALE ME FOKUS AGROTURIZMIN”

### I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në subjektet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Ekonomia Rurale me fokus Agroturizmin”, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë në subjektet e mësipërme:

-me shkresat nr.204/9 dhe nr. 204/10 prot., datë 24.09.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

**a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

**b.** Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;

**c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të MBZHR dhe AZHBR për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

#### **Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

- Nga auditimi u konstatua se, nga ana e MBZHR nuk janë marrë masa në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të kthyer përgjigje në KLSH mbi planin e masave.

#### **Për Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural**

- Nga auditimi u konstatua se nga ana e AZHBR janë marrë masa në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi planin e masave me shkresën nr.2259/1, datë 08.10.2021.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

#### **Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

-Nga auditimi u konstatua se nga ana e MBZHR **nuk janë marrë masa** për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

## **Për Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural**

- Nga auditimi u konstatua se nga ana e AZHBR janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, me shkresën nr.1256, datë 31.03.2022.

### **4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:**

KLSH ka dërguar:

- në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresën nr.204/9 prot, datë 24.09.2021;  
- në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, me shkresën 204/10 prot, datë 24.09.2021;  
Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Ekonomia Rurale me fokus Agroturizmin”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar **1** “Propozim për përmirësim ligjor” dhe **18** “Masa organizative” për zbatim. Nga **19** masat e rekomanduara, nga subjekti janë pranuar **19** masa ose pranimi është në masën **100 %**.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Rekomanduar</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Pa pranuar</b>
<b>1</b>	Propozim për Përmirësim Ligjor	1	1	0
<b>2</b>	Organizative	18	18	0
<b>3</b>	Totali	19	19	0

## **II. HYRJA**

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- K. Xh., Përgjegjës Grupi;
- J. Zh., Anëtar.

### **1. Objekti auditimit:**

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e performancës me temë “Ekonomia Rurale me fokus Agroturizmin”.

### **2. Qëllimi auditimit:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### **3. Metodologjia e auditimit:**

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### **4. Konkluzioni:**

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituara Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

- Nga 1 masë për “Propozim për Përmirësim Ligjor” i rekomanduar është pranuar 1 rekomandim ose në masën 100% dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim ose 0.1 %. Nga 18 masa organizative të rekomanduara, nga subjekti janë pranuar 18 masa ose në masën 100 %.

- Nga 18 masat organizative të pranuar janë zbatuar plotësisht 11 masa ose 61.1% tyre, janë në proces zbatimi 5 masa ose 27.7 % e tyre, dhe janë pa zbatuar 2 masa ose 11.1 % e tyre.

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1.	Propozim për përmirësim ligjor	1	0	1	0	0
2.	Masa organizative	18	11	0	5	2
3.	Totali	19	11	1	5	2

Në numër dhe në % statusi i masave organizative dhe masës për përmirësim ligjor paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	18	
2	Pa pranuar	0	
3	Pranuar	18	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	11	61.1%
2	Pa zbatuar	2	11.1%
3	Në proces	5	27.7%
Nr.	Statusi i masave “Propozim për Përmirësim Ligjor	Në numër	
1	Totali	1	
	<b>Nga të pranuarat:</b>		
2.	-Pranuar	1	100%
3	-Zbatuar pjesërisht	1	0.1 %

5. Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 61.1 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi i tyre shkon në nivelin 27.7 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara mbeten nivel relativisht të lartë në masën 27.7 %.

### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

#### **B. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi**

Për Pyetjen: 1.1.1 A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit?

##### **Gjetje nr.2:**

MBZHR nuk ka hartuar një ligj specifik për agroturizmin, i cili do të nxisë zhvillimin e këtij sektori, duke vlerësuar potencialin që ky aktivitet ka. (Trajtuar më hollësisht në faqet 16-28 të Raportit Përfundimtar)

##### **Rekomandim nr.2:**

MBZHR, referuar praktikave të mira të vendeve model suksesi në fushën e agroturizmit, të marrë masa për hartimin dhe paraqitjen për miratim të një Ligji specifik për agroturizmin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori, duke ndarë dhe detyrat e përgjegjësitë midis palëve, duke përfshirë pushtetin qendror e atë lokal. Ligji duhet të

përcaktojë qartasi detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të pushtetit qendror e lokal, si dhe mundësitë për subjektet private që do të konsiderojnë agroturizmin si mënyrë për të zhvilluar aktivitetin e tyre bujqësor dhe turistik.

*Qershor 2022*

### **Oëndrimi i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar pjesërisht rekomandimin referuar miratimit të VKM nr. 460 datë 29.6.2022 “Strategjinë për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin 2021 – 2027”, megjithatë referuar rekomandimit të KLSH rekomandohet paraqitja për miratim të një ligji specifik për agroturizmin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori, duke ndarë dhe detyrat e përgjegjësitë midis palëve, duke përfshirë pushtetin qendror e atë lokal.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.*

## **C. MASA ORGANIZATIVE**

### ***Për Pyetjen: 1.1.1 A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit?***

#### ***Gjetje nr. 1:***

Nga auditimi u konstatua se:

1. Ministra e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka përcaktuar objektiva për zhvillimin e agroturizmit në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor;
2. MBZHR nuk ka hartuar plan veprimi mbi Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, që do të shërbente për të përcaktuar në mënyrë qartësisht të identifikueshme strukturat përgjegjëse, afatet, kostot, produktet dhe mënyrën e monitorimit të strategjisë, gjë e cila ka cenuar arritjen e objektivave finale të Strategjisë;
3. Nisur nga shtrirja kohore e Strategjisë, si dhe nga dinamika dhe fokusi që ka patur në zhvillimin rural, sikurse bëhet fjalë në rastin e agroturizmit, MBZHR nuk ka bërë përditësime të Strategjisë, për të reflektuar fokusin e politikë bërjes në diversifikimin e aktiviteteve jobujqësore në zonat rurale, me objektiva konkrete e të matshme;
4. MBZHR nuk ka hartuar plan veprimi vjetor për Programin e Integruar të Zhvillimit Rural, si dhe nuk ka patur monitorim të veprimtarisë mbi realizimin dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Integruar për Zhvillim Rural;
5. Në PIZHR nuk janë të ndara qartësisht detyrat ndërmjet aktorëve palë në zhvillimin e agroturizmit. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 16-28 të Raportit Përfundimtar*)

***Rekomandim nr. 1:*** MBZHR të hartojë një strategji SMART<sup>39</sup> që të konsistojë në zhvillimin e turizmit rural, agroturizmit e bujtinave. Strategjia duhet të synojë të mbështesë e të orientojë diversifikimin e aktiviteteve jobujqësore në zonat rurale, me qëllim që të krijohen mekanizma nxitës që, zonat rurale të mos jenë ekskluzivisht bujqësore, por të nxiten edhe forma të tjera zhvillimi. Me qëllim arritjen e objektivave, strategjia duhet të ketë të mirëpërcaktuar:

- Ndarjen e qartë të detyrave midis palëve të përfshira (aktive e pasive) në zhvillimin e agroturizmit (duke nisur që nga politikat mbështetëse, monitorimet, infrastruktura, burimet njerëzore, e deri te mbledhja e të dhënave e statistikave të vazhdueshme, që do të ndihmonin në politikëbërje të qëndrueshme;
- Përcaktim të objektivave të matshme;
- Komunikim të vazhdueshëm midis palëve, duke krijuar një zinxhir funksional, që do të garantonte bashkëpunim të mirëfilltë, me qëllim arritjen e objektivave;
- Planet e veprimtimit me detyra konkrete për secilën nga palët e përfshira;

<sup>39</sup> Specific, Measurable, Achievable, Realistic, and Timely

- Monitorim të vazhdueshëm të objektivave, me qëllim evidentimin në kohë të risqeve që mund të çojnë në mos përmbushjen e këtyre objektivave.

**Brenda vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

**Gjetje nr. 3:**

MBZHR nuk ka konsoliduar ende Regjistrin e Fermës, Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës, sipas objektivave të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, kapitulli 3 “Politikat kryesore për zhvillimin bujqësor dhe rural”, konkretisht pika 3.3.1 “Kushtet kuadër për zhvillimin e zonave rurale dhe sektorit bujqësor”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 16-28 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 3:** MBZHR të marrë masa që, së bashku me aktorët e përfshirë në proces, të evidentojë problematikat që kanë sjellë mosrealizimin e këtyre objektivave, si dhe të hartojë politika me qëllim konsolidimin e Regjistrit të Fermës, Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës, duke bërë progres në këtë mënyrë në zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS).

**Brenda vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

**Për pyetjen: 1.1.2 A janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe a kanë bashkëpunuar ato për përmbushjen e detyrimeve/arritjen e objektivave?**

**Gjetje nr. 4:**

MBZHR nuk ka ngritur një strukturë të veçantë të dedikuar për agroturizmin, duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimit të këtij sektori, që do të ndihmonte në hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e politikave, si dhe në të cilën do të adresohet çdo problematikë e hasur, nga secili prej aktorëve të përfshirë, përgjatë rritjes së këtij aktiviteti. (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-35 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 4:** MBZHR, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit të agroturizmit, të angazhohet për krijimin e një sektori të dedikuar për agroturizmin.

**Janar 2023**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

**Gjetje nr. 5:**

Nga intervistat e kryera në subjekte gjatë fazës së terrenit, ka rezultuar se MBZHR dhe AZHBR nuk administrojnë të dhëna specifike për sektorin e agroturizmit, si p.sh. numri i të punësuarve në atë sektor, numri i turistëve që kanë frekuentuar atë sektor, ndikimin që ai sektor ka në ekonomi, e çdo të dhënë e statistikë tjetër që mund të lidhet direkt e indirekt me sektorin e agroturizmit. (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-35 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 5:**

MBZHR, në bashkëpunim me AZHBR dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të krijojë një databazë të detajuar me të dhëna specifike e të përditësuara për agroturizmin.

**Brenda vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka në proces zbatimi rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.*

**Për pyetjen: 1.2.1 A është garantuar plotësimi i nevojave/ kërkesave për zhvillimin e agroturizmit?**

**Gjetje nr.6:**

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 3/1 datë 15.04.2019 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kapitulli IX “Kontrolli për administrimin e fondit dhe çështje të tjera”, pika 6, MZHBR dhe AZHBR nuk kanë hartuar një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-42 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 6:**

MZHBR, në bashkëpunim me AZHBR, të hartojë një plan informimi për grupet e interesit, për masat e përfitimit nga skema kombëtare si përcaktohet në Udhëzimin 3/1 datë 15/04/2019 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kapitulli IX “Kontrolli për administrimin e fondit dhe çështje të tjera”, pika 6.

**Brenda vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**Gjetje nr. 7:**

Bazuar në Kap. II të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i Shtetit Nr.1745 datë 19.06.2020, Sektori i Promocionit dhe Komunikimit të AZHBR nuk ka hartuar dhe ndërtohet një strategji komunikimi. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-42 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 7:**

Sektori i Promocionit dhe Komunikimit të hartojë dhe ndërtojë një strategji efektive komunikimi si përcaktohet në Kap. II të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i Shtetit Nr.1745 datë 19.06.2020.

**Dhjetor 2022 e në vazhdim**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**Gjetje nr. 8:**

Bazuar në Kap. II, pika 8 të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit Nr.1745 datë 19.06.2020, Sektori i Promocionit dhe Komunikimit të AHZBR nuk ka kryer hulumtime për pikat e forta dhe të dobëta në drejtim të realizimit të objektivave të AZHBR. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-42 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 8:**

Sektori i Promocionit dhe Komunikimit, referuar Kap. II, pika 8 të Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit Nr. 1745, datë

19.06.2020, të ndërtojë modele anketimi për subjektet që kanë përfituar nga fondet e skemës kombëtare, në fushën e agroturizimit.

#### **Dhjetor 2022 e në vazhdim**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

#### **Gjetje nr. 9:**

Aplikantët kanë vështirësi në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për shkak të kriterëve të përcaktuara për masën e agroturizimit (si investim), në ndryshim nga masat e tjera mbështetëse. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-42 të Raportit Përfundimtar)

#### **Rekomandim nr. 9:**

MZHBR, në bashkëpunim me AZHBR, të shohë mundësinë e krijimit të një sektori, i cili të orientojë dhe asistojë gjithë subjektet e interesuara gjatë procesit të aplikimit.

#### **Janar 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

#### **Gjetje nr. 10:**

Afati i përcaktuar në lidhje me përfundimin e investimit brenda vitit buxhetor, në rastin e masës së agroturizimit është i pamjaftueshëm. Janë evidentuar raste të pamundësisë së kryerjes së investimit brenda vitit ushtrimor të cilat kanë çuar edhe në hartimin e shtesë kontrate me subjektet përfituese, ku palët njohin dhe bien dakord për faktin se ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve thelbësore të kontratës, por duke gjetur të argumentuar dhe të provuar kërkesën e subjekteve kontraktore për afatin e kryerjes së investimit, përcakton se afati përfundimtar i realizimit të pagesave të mbartura do të jetë 6 mujori I i vitit pasardhës. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-42 të Raportit Përfundimtar)

#### **Rekomandim nr. 10:**

MZHBR, në bashkëpunim me MFE, të konsiderojë mundësinë e rishikimit të marrëveshjes dypalëshe për shtyrjen e afatit të përfundimit të investimit për masat mbështetëse në agroturizëm, duke bërë të mundur kalimin e fondit në llogarinë 231 (investime) dhe jo në llogarinë 606.

#### **Brenda vitit 2021**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe nuk e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.*

**Për pyetjen: 1.2.2 A ka monitoruar MBZHR/AZHBR zbatimin e mekanizmit të ngritur për zhvillimin e agroturizimit dhe a janë arritur rezultatet e synuara?**

#### **Gjetje nr. 11:**

MZHBR nuk ka kryer asnjë monitorim në investimet e kryera në sektorin e agroturizimit nëpërmjet skemës kombëtare. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë fazës së terrenit nuk ka evidencë të raportimeve periodike nga AZHBR për MZHBR që lidhen me zhvillimin e sektorit të agroturizimit. Mungesa e monitorimit të investimeve të kryera në sektorin e agroturizimit, mund t'i krijojë vizion jo të qartë politikë bërjes në strategjinë e zhvillimit të agroturizimit si pjesë integrale e zhvillimit rural. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)



**Rekomandim nr. 11:**

MZHBR të vlerësojë mundësinë e kryerjes së monitorimeve mbi investimet e kryera në sektorin e agroturizmit, në funksion të nxitjes së punësimit, rritjen e të ardhurave dhe nxitjen e zhvillimit të ekonomisë rurale.

**Brenda vitit 2021**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe nuk e ka zbatuar rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**.

**Gjetje nr. 12:**

Në Manualin e procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit, nuk është e përcaktuar metodologjia që do të përdoret për matjen e kriterëve dhe mënyrën se si do të monitorohen investimet. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 12:**

AZHBR të vlerësojë mundësinë e hartimit të të metodologjisë së monitorimit të investimeve dhe ta përfshijë atë në Manualin e procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit.

**Brenda vitit 2021**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

**Gjetje nr. 13:**

Në Manualin e Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit, nuk është përcaktuar qartë frekuenca e monitorimeve që duhet të kryhen në subjektet përfituese nga masa e agroturizmit brenda afatit 5 vjeçar. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 13:**

AZHBR të përcaktojë në Manualin e procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit numrin e kontrolleve/monitorimeve që duhet të kryhen pas financimit brenda periudhës 5 vjeçare.

**Brenda vitit 2021**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

**Gjetje nr. 14:**

Drejtoria e Kontrollit në AZHBR, në kundërshtim me nenin 14, pika 14.3 e Udhëzimit Nr. 13, datë 15.10.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, nuk ka kryer detyrat, si më poshtë:

- Organizimi dhe menaxhimi i sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit;
- Aprovimi i programeve të punës dhe programeve të kontrolleve konceptuar nga përgjegjësit e Kontrollit dhe Monitorimit;
- Kontrolli i punës dhe zbatimi i detyrave që ju ngarkohen përgjegjësve të sektorëve dhe inspektorëve të kontrollit;
- Në rastet e parregullsive dhe performancës së ulët në punë nga përgjegjësit dhe inspektorët vë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm dhe propozon marrjen e masave administrative sipas legjislacionit në fuqi. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 14.1:**

Drejtoria e Kontrollit të rishikojë organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Monitorimit, duke vendosur indikatorë të matshëm të performancës së punonjësve, me synim rritjen e efektivitetit të punës në këtë sektor.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar rekomandimin. Përmbushja e plotë e këtij rekomandimi do të vlerësohet në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

**Rekomandim nr. 14.2:**

Drejtoria e Kontrollit duhet të miratojë planin e kontroleve që do të kryhen në subjektet përfituese nga masa e agroturizmit, bazuar në analizën e riskut të kryer në bashkëpunim me Sektorin e Riskut, dhe jo bazuar në analizën e riskut të Sektorit të Monitorimit.

**Janar 2022**

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar rekomandimin. Përmbushja e plotë e këtij rekomandimi do të vlerësohet në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

**Rekomandim nr. 14.3**

Drejtoria e Kontrollit të kontrollojë punën dhe zbatimin e detyrave që i ngarkohen Përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit dhe të raportojë te Drejtori i Përgjithshëm në rast të parregullsive edhe performancës së ulët.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar rekomandimin. Përmbushja e plotë e këtij rekomandimi do të vlerësohet në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

**Gjetje nr. 15:**

Sektorin e Monitorimit nuk ka përgatitur listën e projekteve që do t'i nënshtrohen kontrollit pas financimit, nuk ka hartuar programin e punës dhe nuk e ka firmosur e miratuar si përcaktohet në Manualit të Procedurave për implementimin e masave mbështetëse të financuara nga Buxheti i shtetit Nr. 1745, datë 19.06.2020, Kapitulli B "Procedurat e Kontrollit në terren për skemat e investimeve", iv. Kontrollin pas financimit (ex-post), pika 2, 3 dhe 4. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 15:**

Sektorin e Monitorimit të hartojë planin e punës, listën e projekteve që do t'i nënshtrohen kontrollit pas financimit për gjithë subjektet përfituese nga skema kombëtare, masa agroturizëm dhe ta paraqesë për miratim te Drejtori i Kontrollit.

**Menjëherë dhe në vazhdim**

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

**Gjetje nr. 16:**

Sektorin e Monitorimit nuk ka kryer asnjë monitorim për fondet e përdorura nga skema kombëtare në masën e agroturizmit, përgjatë viteve 2018-2020. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 16:**

AZHBR, nëpërmjet Sektorit të Monitorimit të planifikojë numrin e monitorimeve në subjektet përfituese të masave që konsistojnë në investime, duke ndjekur indikatorët e përcaktuar në planin e biznesit.

**Brenda vitit 2021**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**Gjetje nr. 17:**

Sektori i Monitorimit ka burime njerëzore të pamjaftueshme për të përballuar numrin e lartë të kontrolleve në terren. (Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 17:**

AZHBR të përlllogarisë numrin e punonjësve që duhen shtuar në SM, me qëllim mbulimin më me efektivitet të monitorimeve, dhe të kryejë ndryshimin e strukturës.

**Janar 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar konstatohet se subjekti e ka pranuar dhe e ka zbatuar rekomandimin.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

**VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Për sa më sipër **ri kërkojmë** nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, të marrin masa të zbatojnë të gjitha rekomandimet që rezultuan pazbatuara, të zbatuara pjesërisht ose në proces, si më poshtë, si më poshtë:

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

**Për Pyetjen: 1.1.1 A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit?**

**Gjetje nr.2:**

MBZHR nuk ka hartuar një ligj specifik për agroturizmin, i cili do të nxisë zhvillimin e këtij sektori, duke vlerësuar potencialin që ky aktivitet ka. (Trajtuar më hollësisht në faqet 16-28 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr.2:**

MBZHR, referuar praktikave të mira të vendeve model suksesi në fushën e agroturizmit, të marrë masa për hartimin dhe paraqitjen për miratim të një Ligji specifik për agroturizmin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori, duke ndarë dhe detyrat e përgjegjësitë midis palëve, duke përfshirë pushtetin qendror e atë lokal. Ligji duhet të përcaktojë qartas detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të pushtetit qendror e lokal, si dhe mundësitë për subjektet private që do të konsiderojnë agroturizmin si mënyrë për të zhvilluar aktivitetin e tyre bujqësor dhe turistik.

**Brenda vitit 2022**

**B. MASA ORGANIZATIVE**

**Për Pyetjen: 1.1.1 A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur për zhvillimin e agroturizmit?**

**Gjetje nr. 3:**

MBZHR nuk ka konsoliduar ende Regjistrin e Fermës, Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës, sipas objektivave të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, kapitulli 3 “Politikat kryesore

për zhvillimin bujqësor dhe rural”, konkretisht pika 3.3.1 “Kushtet kuadër për zhvillimin e zonave rurale dhe sektorit bujqësor”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 16-28 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 3:**

MBZHR të marrë masa që, së bashku me aktorët e përfshirë në proces, të evidentojë problematikat që kanë sjellë mosrealizimin e këtyre objektivave, si dhe të hartojë politika me qëllim konsolidimin e Regjistrimit të Fermës, Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave, Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës, duke bërë progres në këtë mënyrë në zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS).

*Brenda vitit 2022*

**Për pyetjen: 1.1.2 A janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve dhe a kanë bashkëpunuar ato për përmbushjen e detyrimeve/arritjen e objektivave?**

**Gjetje nr. 5:**

Nga intervistat e kryera në subjekte gjatë fazës së terrenit, ka rezultuar se MBZHR dhe AZHBR nuk administrojnë të dhëna specifike për sektorin e agroturizmit, si p.sh. numri i të punësuarve në atë sektor, numri i turistëve që kanë frekuentuar atë sektor, ndikimin që ai sektor ka në ekonomi, e çdo të dhënë e statistikë tjetër që mund të lidhet direkt e indirekt me sektorin e agroturizmit. (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-35 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 5:**

MBZHR, në bashkëpunim me AZHBR dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të krijojë një databazë të detajuar me të dhëna specifike e të përditësuara për agroturizmin.

*Brenda vitit 2022*

**Për pyetjen: 1.2.1 A është garantuar plotësimi i nevojave/ kërkesave për zhvillimin e agroturizmit?**

**Gjetje nr. 10:**

Afati i përcaktuar në lidhje me përfundimin e investimit brenda vitit buxhetor, në rastin e masës së agroturizmit është i pamjaftueshëm. Janë evidentuar raste të pamundësisë së kryerjes së investimit brenda vitit ushtrimor të cilat kanë çuar edhe në hartimin e shtesë kontrate me subjektet përfituese, ku palët njohin dhe bien dakord për faktin se ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve thelbësore të kontratës, por duke gjetur të argumentuar dhe të provuar kërkesën e subjekteve kontraktore për afatin e kryerjes së investimit, përcakton se afati përfundimtar i realizimit të pagesave të mbartura do të jetë 6 mujori I, i vitit pasardhës. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-42 të Raportit Përfundimtar)

**Rekomandim nr. 10:**

MZHBR, në bashkëpunim me MFE, të konsiderojë mundësinë e rishikimit të marrëveshjes dypalëshe për shtyrjen e afatit të përfundimit të investimit për masat mbështetëse në agroturizëm, duke bërë të mundur kalimin e fondit në llogarinë 231 (investime) dhe jo në llogarinë 606.

*Brenda vitit 2022*

**Për pyetjen: 1.2.2 A ka monitoruar MBZHR/AZHBR zbatimin e mekanizmit të ngritur për zhvillimin e agroturizmit dhe a janë arritur rezultatet e synuara?**

**Gjetje nr. 11:**

MZHBR nuk ka kryer asnjë monitorim në investimet e kryera në sektorin e agroturizmit nëpërmjet skemës kombëtare. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë fazës së terrenit nuk ka evidencë të raportimeve periodike nga AZHBR për MZHBR që lidhen me zhvillimin e sektorit të agroturizmit. Mungesa e monitorimit të investimeve të kryera në sektorin e

agroturizmit, mund t'i krijojë vizion jo të qartë politike bërjes në strategjinë e zhvillimit të agroturizmit si pjesë integrale e zhvillimit rural. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)*

**Rekomandim nr. 11:**

MZHBR të vlerësojë mundësinë e kryerjes së monitorimeve mbi investimet e kryera në sektorin e agroturizmit, në funksion të nxitjes së punësimit, rritjen e të ardhurave dhe nxitjen e zhvillimit të ekonomisë rurale.

***Brenda vitit 2022***

**Gjetje nr. 14:**

Drejtoria e Kontrollit në AZHBR, në kundërshtim me nenin 14, pika 14.3 e Udhëzimit Nr. 13, datë 15.10.2020 “*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural*”, nuk ka kryer detyrat, si më poshtë:

- Organizimi dhe menaxhimi i sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit;
- Aprovimi i programeve të punës dhe programeve të kontroleve konceptuar nga përgjegjësit e Kontrollit dhe Monitorimit;
- Kontrolli i punës dhe zbatimi i detyrave që ju ngarkohen përgjegjësve të sektorëve dhe inspektorëve të kontrollit;
- Në rastet e parregullsive dhe performancës së ulët në punë nga përgjegjësit dhe inspektorët vë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm dhe propozon marrjen e masave administrative sipas legjislacionit në fuqi. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 42-46 të Raportit Përfundimtar)*

**Rekomandim nr. 14.1:**

Drejtoria e Kontrollit të rishikojë organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Monitorimit, duke vendosur indikatorë të matshëm të performancës së punonjësve, me synim rritjen e efektivitetit të punës në këtë sektor.

***Brenda vitit 2022***

**Rekomandim nr. 14.2:**

Drejtoria e Kontrollit duhet të miratojë planin e kontroleve që do të kryhen në subjektet përfituese nga masa e agroturizmit, bazuar në analizën e riskut të kryer në bashkëpunim me Sektorin e Riskut, dhe jo bazuar në analizën e riskut të Sektorit të Monitorimit.

***Brenda vitit 2022***

**Rekomandim nr. 14.3**

Drejtoria e Kontrollit të kontrollojë punën dhe zbatimin e detyrave që i ngarkohen Përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit dhe të raportojë te Drejtori i Përgjithshëm në rast të parregullsive edhe performancës së ulët.

***Brenda vitit 2022***

## 6- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “MENAXHIMI I MBETJEVE PLASTIKE”

### I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 2.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në subjektet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Bashkitë Tiranë, Vlorë e Elbasan, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Menaxhimi i mbetjeve plastike”, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas programit të auditimit nr.202/4 prot., datë 19.04.2021, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2020, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të përcjellë:

- Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 202/12, datë 21.09.2021;
- Në Bashkinë Tiranë, me shkresën nr. 202/12, datë 21.09.2021;
- Në Bashkinë Elbasan, me shkresën nr.202/14, datë 21.09.2021;
- Në Bashkinë Vlorë, me shkresën nr.202/15, datë 21.09.2021.

duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

**a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-<sup>së</sup>, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

**b.** Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;

**c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-<sup>së</sup>, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka miratuar *planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të cilin e ka dërguar në KLSH* me shkresë nr. 6886/3, datë 13.12.2021, pra jashtë afatit 20 ditor.

**Bashkia Tiranë:** Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Tiranë me anë të shkresës nr. 16660/6 prot., datë 14.10.2021, ka përcjellë planin e masave për zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditorë.

**Bashkia Vlorë:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka *miratuar nga Kryetari i Bashkisë, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH* duke e dërguar në KLSH me shkresën nr. 5957/2, datë 15.10.2021, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

**Bashkia Elbasan:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti ka *miratuar nga Kryetari i Bashkisë, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH* duke e dërguar në KLSH me shkresën nr. 1896/3, datë 20.10.2021, kjo jo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti nuk ka përcjellë shkresë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

**Bashkia Tiranë:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti nuk ka përcjellë shkresë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

**Bashkia Vlorë:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti **nuk ka zbatuar afatin 6 mujor** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

**Bashkia Elbasan:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti **nuk ka zbatuar afatin 6 mujor** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

#### 4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

KLSH ka dërguar:

- Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 202/12, datë 21.09.2021;
- Në Bashkinë Tiranë, me shkresën nr. 202/12, datë 21.09.2021;
- Në Bashkinë Elbasan, me shkresën nr.202/14, datë 21.09.2021;
- Në Bashkinë Vlorë, me shkresën nr.202/15, datë 21.09.2021.

Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë "Menaxhimi i mbetjeve plastike".

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 17 "Masa organizative" për zbatim. Nga 17 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 17 masa ose pranimi është në masën 100 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	17	17	0

## II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- L. B., Përgjegjës Grupi;
- M. K., Anëtar.
- V. G., Anëtar.

### 1. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e performancës me temë "Menaxhimi i mbetjeve plastike".

### 2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda

tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

### 3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### 4. Konkluzioni:

Në dy nga katër subjektet e audituara nuk janë marrë masa për respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH<sup>në</sup> mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Në 4 subjektet e audituara, nuk janë marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituara Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH<sup>ja</sup>, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

- Nga 17 masa organizative të rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 17 masa ose në masën 100 %. Nga 17 masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 masë ose 5,9 % tyre, janë në proces zbatimi 12 masa ose 70,6 % dhe janë pa zbatuar pjesërisht 4 masa ose 23.5 %. Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Statusi i zbatimit			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	17	17	1	4	12	0

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	17	100
2	Pa pranuar	0	0
3	Pranuar	17	100
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	1	5,9
2	Pa zbatuar	0	0
3	Në proces	12	70,6
4	Zbatuar pjesërisht	4	23.5

### 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 5,9 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi i tyre shkon në nivelin 77 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet në proces apo zbatuar pjesërisht mbeten në nivel relativisht të lartë në masën 94 %.

### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:



## A. MASA ORGANIZATIVE

**Për pyetjen: 4.1 A kanë miratuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike?**

### Gjetje

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve, në mos përputhje me nenin 14 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

2. Bashkitë Tiranë dhe Vlorë nuk kanë hartuar dhe miratuar Planet Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë nën juridiksion në shkëlqje të nenit 12 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

3. Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar dhe nuk ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave masat e nevojshme që çdo person juridik ose fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 16 pika 1.

### Rekomandime

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve sipas rrymave, ku parandalimi i krijimit të mbetjeve plastike të jetë një kapitull i veçantë. Hartimi i programeve të parandalimit të realizohet duke i kushtuar rëndësinë që ato kanë në zbatimin e piramidës së menaxhimit të mbetjeve.

### Qershor 2022

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Siç është referuar dhe në shkresën me nr. 6886/3 prot., datë 13.12.2021, që MTM i ka dërguar KLSH, ky rekomandim është planifikuar të realizohet përmes programit IPA III. Ky program është miratuar në 16.12.2021, pjesë e së cilës është dhe Aneksi 4 "BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjellbër" që mbulon fushën e mbetjeve. Për t'u zbatuar aktivitetet e projektit (janë planifikuar një sërë aktivitetesh që lidhen me rekomandimet e sugjeruara nga grupi auditimit të KLSH), nevojitet nënshkrimi i marrëveshjes financiare i cili është parashikuar të ndodhë në fund të vitit 2022 ose në fillim të vitit 2023. Për më shumë informacion rreth programit IPA III, në vijim linku: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/commission-implementing-decision-16122021-financing-annual-action-plan-favour-albania-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/commission-implementing-decision-16122021-financing-annual-action-plan-favour-albania-2021_en)

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i **pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **në proces**.

2. Bashkitë Tiranë dhe Vlorë të marrin masat e nevojshme dhe të iniciojnë procedurën për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e Planeve Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

### Dhjetor 2021

#### Për Bashkinë Vlorë:

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Brendshëm nr. 185, datë 16.07.2021, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane".

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky grup pune ka bërë takime si grup pune dhe me grupet e interesit. Nga ana e grupit të punës është hartuar drafti, por problematike ka qenë përcaktimi i tarifës së pastrimit në vite. Është prezantuar në Këshillin Bashkiak drafti plani vendor i menaxhimit të mbetjeve plastike.

Fotot nga takimi për prezantimin e draftit paraqiten në linkun e mëposhtëm.

<https://www.facebook.com/110963937300272/posts/pfbid02D94SBboi9euLkVTiEFRUWqStJAosiTYQ6Mf2NiuXw7paJtkyVTAPEzY9mA9PoePI/?d=n>

Statusi i rekomandimit: **në proces.**

**Për Bashkinë Tiranë:**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Sqarojmë se: Bashkia Tiranë duhet ta orientojë “Planin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” në funksion të prioriteteve apo orientimeve të identifikuar në planin për MIM të aktivizuar nga Qarku Tiranë, deri më sot nuk e disponojmë, si do qoftë pavarësisht faktit, nga ana jonë është biseduar dhe ndërtaur komunikim me Drejtoritë e Politikave në bashki.

Në këtë kontekst do të përcillnim informacionin që ka të bëjë me ndërtimin e strategjive të orientuara kryesisht me grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, si bateritë e përdorimit familjar dhe të ilaçeve të skeduar, që aktualisht po ndiqet nga Drejtoria e Investimeve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik.

Po në këtë kontekst do të përcjellim dhe aktivizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Promovimit të Qytetit, të Drejtorisë së Politikave dhe Edukimit Mjedisor, angazhim që besojmë që deri në përfundim të vitit 2022 do të bëjë të mundur që dhe Bashkia Tiranë të këtë aktiv planin e saj për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, në funksion të detyrimeve që ligji me Nr. 10463 dt. 22.09.2011, për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” si dhe VKM nr. 418, dt. 25.06.2014 parashtronë.

*Bashkëngjitur shkresa e DPMZHQ datë 18.07.2022 prot. Nr. 26110.*

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **në proces.**

**3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave masat e nevojshme që çdo person juridik ose fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.**

**Qershor 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Përgjigja e institucionit: Siç është referuar dhe në shkresën me nr. 6886/3 prot., datë 13.12.2021, që MTM i ka dërguar KLSH, ky rekomandim është planifikuar të realizohet përmes një akti të ri ligjor “Për zbatimin e Përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për rrymat e veçanta të mbetjeve” që kërkon kohë të konsiderueshme për shkak të konsultimeve që do të kryhen. Aktualisht është përgatitur drafti si dhe është në proces përfundimi RIA. Ky draft ligj është i planifikuar dhe në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE 2022-2024 i miratuar me VKM nr.91, datë 09.02.2022) dhe është parashikuar për t’u miratuar gjatë vitit 2023. Bashkëlidhur gjeni kopjen e PKIE si dhe draft ligjin e përgatitur.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **në proces.**

**Për pyetjen: 4.1.2 A është kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike në harmoni me legjislacionin e BE-së?**

**Gjetje:**

**4.** Në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk janë përcaktuar afatet e vlerësimit dhe rishikimit të Programeve të Parandalimit të krijimit të mbetjeve në mospërputhje me nenin 30 pika 1 të Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet”.

**5.** Legjislacioni shqiptar mbi mbetjet nuk ka asnjë strategji të dedikuar për mbetjet plastike ndryshe nga sa paraqitet në praktikat e mira, si për shembull Komisioni Evropian i cili ka hartuar strategji të dedikuar mbetjeve plastike.

#### **Rekomandime:**

**4.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimin e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” duke përcaktuar afatet e vlerësimit dhe rishikimit të Programeve të Parandalimit të krijimit të mbetjeve në përputhje me nenin 30 pika 1 të Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet”.

**Qershor 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Përgjigja e institucionit: Siç është referuar dhe në shkresën me nr. 6886/3 prot., datë 13.12.2021, që MTM i ka dërguar KLSH, ky rekomandim është planifikuar të realizohet përmes programit IPA III. Ky program është i miratuar në 16.12.2021, pjesë e së cilës është dhe Aneksi 4 “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjellbër” që mbulon fushën e mbetjeve. Për t’u zbatuar aktivitetet e projektit (janë planifikuar një sërë aktivitetesh që lidhen me rekomandimet e sugjeruara nga grupi auditimit të KLSH), nevojitet nënshkrimi i marrëveshjes financiare i cili është parashikuar të ndodhë në fund të vitit 2022 ose në fillim të vitit 2023. Për më shumë informacion rreth programit IPA III, në vijim gjeni linkun: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/commission-implementing-decision-16122021-financing-annual-action-plan-favour-albania-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/commission-implementing-decision-16122021-financing-annual-action-plan-favour-albania-2021_en).

Gjithashtu, hartimi i këtij draft ligji, i cili do të jetë një ligj i ri në përputhje me direktivat e përditësuara evropiane, është i planifikuar dhe në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE 2022-2024 i miratuar me VKM nr.91, datë 09.02.2022) dhe është parashikuar për t’u miratuar gjatë vitit 2024.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **në proces.**

**5.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të hartuar dokumente politike (strategji/plan veprimi) dedikuar vetëm mbetjeve plastike referuar praktikave të mira të BE-së të përshkruara më sipër gjatë shtjellimit të pyetjes.

**Qershor 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Për të hartuar dokumente politike (strategji/plan veprimi) nevojitet autorizimi nga ligji. Ligji i mbetjeve në fuqi (ligji 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”) nuk autorizon hartimin e një strategjie apo plan veprimi kombëtar vetëm për mbetjet plastike, por për të gjithë rrymat e mbetjeve. Në këtë kuadër, Dokumenti i Politikave Strategjike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, i miratuar me VKM 418/2020, i përfshin dhe trajton të gjithë rrymat e mbetjeve.

Deri më tani, në kuadër të ndalimit të mbetjeve plastike, referuar dhe Programit të Qeverisë 2021-2025, për të hequr plastikën njëpërdorimshëm, është miratuar ligji 28/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’”, të ndryshuar, që ka synim ndalimin e përdorimit, importit, prodhimit të qeseve plastike me trashësi nën 70 mikron. Në këtë frymë është miratuar dhe VKM 367/2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme” që përcakton institucionet dhe masat që duhen mbajtur parasysht për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg dhe prodhimit të qeseve plastike mbajtëse.

Në vijim, duke marrë në konsideratë rekomandimin e KLSH, gjatë hartimit të ligjit të ri të mbetjeve në përputhje me direktivat e përditësuara evropiane, që është parashikuar të fillojë me programin IPA III, do të vlerësohet mundësia për të autorizuar hartimin e një strategjie të veçantë për mbetjet plastike.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **në proces.**

## **Gjetje**

**6.** Bashkitë Vlorë dhe Elbasan dhe pjesërisht Bashkia Tiranë nuk kanë ngritur infrastrukturën e duhur për të mundësuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në kundërshtim me VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

**7.** Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu IV pika 1. Afatet 59 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” 60 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu X. Riciklimi dhe Rikuperimi 61 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XII. Monitorimi dhe Raportimi 62 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XII. Monitorimi dhe Raportimi, pika 5-6-7 52 ligjore për ngritjen e infrastrukturës së duhur që ofron grumbullimin e diferencuar të mbetjeve kanë përfunduar pa u përmbushur.

**8.** Kontratat që Bashkitë Elbasan dhe Vlorë, lidhur me kompanitë private që operojnë në këtë fushë, nuk janë ideuar dhe nuk janë mbështetur në Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, duke mos përcaktuar në specifikimet teknike të tyre detyrime për mënyrën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, gjë që do të mundësonte grumbullimin e ndarë të mbetjeve dhe respektimin e të gjithë kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

**9.** Kontratat e shërbimit të pastrimit për të tre Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk parashikojnë në specifikimet teknike grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në përputhje me Ligjin 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

**10.** Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk kanë arritur objektivin specifik të vendosur në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1, germa c, për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike 22.5% të peshës së mbetjeve.

**11.** Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar formatin e raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 11 pika 6.

## **Rekomandime**

**6.** Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë në kontratat për shërbimin e pastrimit të qytetit që do të lidhin në vijimësi me operatorët ekonomikë të marrin masa që të përfshijnë në procedurën e prokurimit dhe të sanksionojnë në këtë kontrata grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, në përputhje me Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” duke përcaktuar qartë në specifikimet teknike vendosjen e kontejnerëve të ndryshëm për të bërë të mundur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim.

### **Me lidhjen e kontratave të reja dhe në vazhdimësi**

#### **Për Bashkinë Elbasan:**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Bashkia Elbasan ka zbatuar ndarjen në burim të 5 akseve rrugore të qytetit ku është dhe dendësia urbane me e lartë, me kontejnerë të dedikuar për mbetjet e riciklueshme dhe veçmas mbetjet organike. Më konkretisht kemi Bulevardin “Aqif Pasha”, Rruga “Qemal Stafa”, Rruga “28 nëntori”, Rruga “Thoma Kalefi” dhe Rruga “Rinia” ku në të 5 akset janë vendosur 119 kontejner në total. Për sa më sipër ka patur disa vonesa në vitin 2020 dhe 2021 pasi në periudha të ndryshme nuk ka patur një kontratë të mirëfilltë shërbimi me kontraktor për shkak të ankimeve për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe është vazhduar puna e shërbimit të pastrimit me procedurë me negociim.

Me përfundimin e procedurës së prokurimit, Bashkia Elbasan e ka të sanksionuar në kontratën publike për shërbime me objekt: "Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e

Elbasanit", të lidhur me kontraktorin " A. – I. G. C." shpk (nr. 1186/17 prot., datë 14.12.2021), në nenin 20, "Specifikimet teknike", ku është përcaktuar se:

" - Në 5 rrugë të qytetit: rruga "Rinia", "Thoma Klefi", "Qemal Stafa", "28 nëntori" dhe "Aqif Pasha", do të pilotohet ndarja në burim për plastikë, qelq dhe letër do pilotohet në 5 super markete ku kontejnerët do të kenë mbishkrimin përkatës sipas ndarjeve.

- vendosja e tyre do të bëhet në përputhje me plan vendosjen dhe hartën në të cilat janë përcaktuar të gjitha koordinatat për çdo vend grumbullim të mbetjeve urbane të përcaktuara nga AK, të cilat janë të pasqyruara në hartat përkatëse, nga ku së bashku me listën janë pjesë e DT".

Statusi i rekomandimit: **Realizuar.**

**Për Bashkinë Vlorë: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se Bashkia Vlorë ka lidhur kontratë të re pastrimi me nr.6229/1, datë 03.07.2020, pra përpara lënies së këtij rekomandimi sipas shkresës së KLSH me nr.202/15, datë 21.09.2021 e prot., në këtë Bashki me nr. 5957/1, datë 24.09.2021. Për rrjedhojë ky rekomandim lihet në fuqi si i pa zbatuar dhe për lidhjen e kontratave të reja.

Statusi i rekomandimit: **I pa zbatuar.**

**Bashkia Tiranë: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Përgjigja e institucionit: Në kuadrin e ndarjes së re territoriale, Bashkia e Tiranës rishikoi dhe përmirësoi të gjitha politikat e saj, në menaxhimin e mbetjeve në qytetin e Tiranës, duke futur dhe konceptin e riciklimit dhe ndarjes në burim të mbetjeve si dhe plotësimin e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e mjedisit.

Në dhjetor të vitit 2016, në qytetin e Tiranës, në "Zonën e Kuqe", ka filluar të operojë shoqëria "E. T." Sh.a, e cila ka filluar procesin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.

Pas muajit Tetor 2017, me lidhjen e kontratave të reja është aktivizuar grumbullimi i diferencuar i mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës.

Në kontratat e shërbimit aktualisht aktive është parashikuar dhe numri i saktë i kontejnerëve që do të shërbejnë për grumbullimin e ndarë të mbetjeve, (shënojmë këtu se në nivel politikash ky shërbim në Bashkinë Tiranë është i orientuar në grumbullimin e mbetjeve në dy rryma, të biodegradueshme veç dhe ato të thata veç, ku futet letra, qelqi dhe plastika veç).

Grupi i auditimit shqyrtoi specifikimet teknike të kontratave të lidhur me operatorët, p.sh. kontrata tip nr. 11036/1, datë 12.03.2021 ku identifikohet përcaktimi për kontejner të ndarë. Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Statusi i rekomandimit: **I zbatuar.**

7. Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë me ngritjen e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të marrin masa për arritjen e objektivit për përdorimin dhe riciklimin e plastikës në përputhje me VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", Kreu V, pika 1, germa c.

**Me lidhjen e kontratave të reja dhe në vazhdimësi**

**Për Bashkinë Elbasan: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Për realizimin e këtij rekomandimi nga auditimi rezultoi sa vijon: Sipas akt themelimit për krijimin e shoqërisë tregëtare "E. –E." sh.a, me ortakë themelues bashkitë Elbasan, Librazhd, Prrenjas, Gramsh, Peqin, Cërrik dhe Belsh, e cila ka si objekt të veprimtarisë: Grumbullimi, rehabilitimi dhe përpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelbërta et., në territorin administrativ të të gjitha bashkive të Qarkut Elbasan, etj., bashkia Elbasan është aksionet me 52% të vlerës së aksioneve.

Bashkia Elbasan ka lidhur kontratë shërbimi publik "Për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan, në impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarku të Elbasanit", me numër 1769/3, datë 12.04.2022, neni 4, pika 4.2/iii.

Në ndarjen fundore të mbetjeve të riciklueshme e cila bëhet pranë "E.. – E." sh.a e cila menaxhon dhe impiantin e trajtimit të mbetjeve ku Bashkia Elbasan është aksionari më i madh kryhet dhe riciklimi përfundimtar ku mbetjet e riciklueshme do t'i shiten kompanive të cilat operojnë në këtë fushë.

Statusi i rekomandimit: **Realizuar.**

**Për Bashkinë Vlorë: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Sipas kontratës me objekt "Ndërtimi i landfillit rajonal", në Sherishtë të Vlorës, e lidhur midis KFW me Bashkitë Vlorë dhe Selenicë, në të cilën është përfshirë edhe prokurimi i pajisjeve për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve bashkiake dhe prokurimi i pajisjeve për pastrimin e rrugëve të qytetit për bashkinë Vlorë dhe Selenicë, kanë ardhur 100 kontejnerë "dopot", të cilat ndodhen në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, për t'u shpërndarë në terren në zonën pilot, i cili është Rajoni nr.3 i Qytetit. Këto kontejnerë nuk janë vënë në funksion pasi nuk ka përfunduar landfilli.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Për Bashkinë Tiranë: Qëndrim i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Është parashikuar që të zëvendësohen të gjitha kontejnerët me kontejner të rinj, rreth 5300 copë, ku 800 copë do të shërbejnë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve (letër, plastikë, qelq dhe metalike).

Në kontratat e shërbimit aktualisht aktive është parashikuar dhe numri i saktë i kontejnerëve që do të shërbejnë për grumbullimin e ndarë të mbetjeve, (shënojmë këtu se në nivel politikash ky shërbim në Bashkinë Tiranë është i orientuar në grumbullimin e mbetjeve në dy rryma, të biodegradueshme veç dhe ato të thata veç, ku futet letra, qelqi dhe plastika veç).

Duhet të pranojmë se deri më sot jemi larg pritshmërisë, situatë kjo që duket dhe në mënyrën se si popullata afron apo depoziton mbetjet në kontejnerët publikë, sidoqoftë ky indikacion nuk na ka ndaluar në politikat tona si Bashki.

Duke filluar nga muaji Korrik i këtij viti Bashkia Tiranë nëpërmjet E. T. Sh.a po rinovon parkun e kontejnerëve që aktualisht ka të shpërndara në territorin e saj, duke vendosur për herë të parë kontejnerët Këmbanë me kapje vertikale dhe hapje fundore, që do të shërbejnë si për mbetjet urbane ashtu dhe për ato të thata. Deri në fund të muajit Shtator janë parashikuar të vendosen 190 copë kontejnerë të tillë sipërfaqësor.

Në këtë plan është parashikuar dhe vendosja e kontejnerëve nëntokësorë,(12 copë), të orientuar këto fillimisht në pikat akses te garantuar, theksojmë se nga indikacionet e para impakti fillestar i kësaj ndërhyrje është pozitiv.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**8. Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të hartuar formatin e raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në përputhje me Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" neni 11 pika 6.**

**Qershor 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Ministria ka në proces, hartimin e formatit të raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Bashkëlidhur drafti parë. Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Për pyetjen: 4.2.2 A kanë marrë MTM dhe bashkitë nisma për të nxitur aktivitete informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre?**

## Gjetje

**12.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka ndërmarrë nisma informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre duke mos përmbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve miratuar me VKM nr. 175 datë 19.01.2011, paragrafi 3.1.2.1 “Fushata për informimin e publikut”.

**13.** Në Bashkinë Tiranë programi i Edukimit Ambiental dhe Edukimit të Publikut është realizuar pjesërisht vetëm nga një kompani (E. T.) nga pesë të tilla që ofrojnë shërbimin e pastrimit në qytetin e Tiranës në kundërshtim kjo me kushtet e kontratës së lidhur me kompanitë kontraktore.

**14.** Në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan kompanitë kontraktore që mbulojnë shërbimin e pastrimit nuk kanë hartuar Programet e Edukimit të Publikut në shkelje të detyrimeve kontraktore dhe si rezultat nuk kanë ndërmarrë nisma informuese, ndërgjegjësuere dhe edukuese lidhur me mbetjet (përfshirë dhe mbetjet plastike) dhe reduktimin e tyre.

**15.** Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë asnjë masë për të informuar përdoruesit e ambalazheve dhe në mënyrë të veçantë konsumatorët, për zbatimin e detyrimeve të VKM-së nr. 177, datë 6.3.2012, 2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XIII.

## Rekomandime

**9.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit menjëherë pas hartimit të Programeve për Parandalimin e prodhimit të mbetjeve, ku mbetjet plastike janë pjesë e këtyre programeve, të hartojë një plan dhe të ndërmarrë fushata për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, lidhur me rëndësinë e parandalimit të prodhimit të mbetjeve, përfshirë këtu edhe mbetjet plastike. Hartimi i planit të edukimit dhe ndërmarrja e fushatave duhet të dokumentohen nga strukturat përkatëse të Ministrisë.

### Qershor 2022 dhe në vazhdimësi

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Në rekomandimin tuaj, duke qenë se hartimi i planit për të ndërmarrë fushatat e ndërgjegjësimit është parashikuar pas hartimit të Programeve për Parandalimin e prodhimit të mbetjeve, për shkak se Programet e Parandalimit të Mbetjeve janë parashikuar të hartohen me fillimin e programit IPA III edhe plani për ndërgjegjësimin e publikut do të hartohet pas fillimit të këtij programi. Megjithatë nga tetori 2021 e në vijim, janë kryer një sërë fushatash pastrimi dhe ndërgjegjësimi, të cilat janë të publikuara në rrjetet sociale (faqe zyrtare e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, facebook dhe instagram), që kanë ndikuar në rritje të ndërgjegjësimit publik për të mbajtur një ambient të pastër.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**10.** Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan të marrin masa që operatorët ekonomikë të hartojnë dhe të zbatojnë programet e “Edukimit të publikut” në përputhje me detyrimet kontraktuale.

### Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi

**Për Bashkinë Elbasan: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Bashkia Elbasan e ka të sanksionuar në kontratën publike për shërbime me objekt: "Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit", të lidhur me kontraktorin "A. – I. G. C." ShPK (nr. 1186/17 prot., datë 14.12.2021), në nenin 9, nën-pika 9/10 në lidhje me këtë rekomandim sa më poshtë vijon:

*"9/10 Kontraktuesi do të zhvillojë një program të edukimit publik për ndërgjegjësimin e qytetarëve për mirëmbajtjen e pastrimit të qytetit dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në drejtim të ruajtjes së pastërtisë së qytetit".*

Është realizuar programi i edukimit në vitin 2021 nga "V. I." sh.p.k, po ashtu dhe nga "A.-I." ShPK për vitin 2022 sipas shkresës me nr. 37 prot., datë 01.04.2022 .

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Për Bashkinë Vlorë: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit në Bashkinë Vlorë rezultoi se janë prodhuar dhe shpërndarë postera dhe fletëpalosje për sensibilizimin e qytetarëve.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Për Bashkinë Tiranë: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Përgjigja e institucionit: Programi për Edukimin Ambiental dhe Mjedisor, (si pjesë e Kontratave të Operatorëve ekonomik), është aktivizuar nga ana jonë dhe është bërë e ditur kompanive lidhur me çfarë dhe si duhet të organizohen. Më i dukshëm ky angazhim reflektohet në kompaninë "E. T." Sh.a. Nga ana jonë si Drejtori Operative është iniciuar komunikim me Drejtoritë e linjës me qëllim promovimin e detyrimeve nëpërmjet këtij programi, (këtu bashkëgjitur pjesë të këtij komunikimi shkresor të aktivizuar si për Operatorët ashtu dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Promovimit të Qytetit si dhe Drejtorisë së Politikave).

Në kuadër të këtij shërbimi do të shënojmë këtu komunikimet e vazhdueshme në rrjetet sociale të ndërtuara nga stafi respektiv i Bashkisë Tiranë.

Po në këtë kontekst po shikojmë mundësinë e garantimit të një fondi të nevojshëm me qëllim ndërtimin e një spoti promovues, ku do të kërkohet bashkëpunim si i popullatës ashtu dhe i bizneseve, kjo në funksion dhe të kontejnerëve të rinj që aktualisht kanë filluar të shtrihen në akset e qytetit të Tiranës.

Shpenzimet për spotin në fjalë do të aktivizohen si detyrim i Operatorëve, i parashikuar në kontratat ekzistuese, në raport me përqindjen e territorit që ato mbulojnë. Ky promovim do të përgatitet dhe aktivizohet brenda këtij viti, duke u aktivizuar në mediat me impakt viziv max., si dhe në oraret më të ndjeshme informative.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Statusi i rekomandimit: **Realizuar.**

**11. Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan të marrin masa për të informuar përdoruesit e ambalazheve sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 177 datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".**

**Dhjetor 2021 dhe në vazhdimësi**

**Për Bashkinë Elbasan: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e Bashkisë janë bërë njoftime dhe kërkesa për informacion mbi rrymat e mbetjeve për subjektet dhe operatorët të cilët përdorin ambalazhe dhe materiale të riciklueshme. Më konkretisht subjekteve "A. E.", Bradashesh, me shkresën nr. 124, datë 13.01.2022, "Inspektorati i Mjedisit në Bashki", me shkresën nr. 2261/1, datë 28.05.2020, "Tatim Taksa", Bashki, me shkresën nr. 6365, datë 24.12.2021.

Të gjithë subjektet sipas listës së Tatimeve dhe Inspektoratit të Mjedisit të Bashkisë janë njoftuar me shkresë nr. 2044 - 2057 prot., datë 22.04.2022.

Bashkëgjitur janë dhe dokumentet përkatëse.

Statusi i rekomandimit: **Realizuar.**

**Për Bashkinë Vlorë: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se nuk ka filluar ende puna për të informuar përdoruesit e ambalazheve.

Statusi i rekomandimit: **Pa zbatuar.**

**Për Bashkinë Tiranë: Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Përgjigja e institucionit: Nga komunikimet e ndryshme me këta Operatorë rezulton se janë në dije të bazës ligjore si dhe të detyrimeve respektive.

Referuar përgjigjes së subjektit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**



## **Për pyetjen: A ka MTM të dhëna lidhur me sasinë, burimin dhe trajtimin e mbetjeve plastike?**

### **Gjetje**

**16.** Nga auditimi u konstatua se të dhënat që Agjencia Kombëtare e Mjedisit disponon dhe që janë publikuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (2017- 2019) lidhur me sasinë totale të mbetjeve plastike që prodhohen në Shqipëri, nuk janë të sakta dhe të plota, sepse jo të gjitha Bashkitë kanë raportuar çdo vit dhe jo të gjitha subjektet private që gjenerojnë mbetje plastike raportojnë rregullisht, në kundërshtim me VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, kreu XII, pika 1 dhe 3.

**17.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka të dhëna të sakta dhe nuk ka publikuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitet 2017-2019, mbi sasinë e riciklimit të mbetjeve plastike, në kundërshtim me VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, pika 6.

**18.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka të dhëna mbi rezultatet e zbatimit të VKM-së nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbjetet e Tyre”, pra nuk ka të dhëna mbi sasinë e ambalazheve të mbetjeve në total për gjithë territorin e vendit.

**19.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka të dhëna të sakta se sa kompani që merren me grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve të plastikës kanë qenë aktive për periudhën 2017-2020.

### **Rekomandime**

**12.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa kundrejt të gjithë subjekteve private të cilat operojnë në aktivitete të tilla si grumbullimi, transferimi dhe riciklimi i mbetjeve plastike për të bërë të mundur që të gjitha subjektet të raportojnë rregullisht në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

### **Qershor 2022 dhe në vazhdimësi**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: AKM ka përgatitur tabelën me të gjithë subjektet e licencuar me licencë III.2.B duke specifikuar secilin kod mbetjesh që operatorët trajtojnë. Në këtë kontekst, AKM ka grumbulluar të dhënat e raportuara nga këto kompani për transfertat e kryera brenda vendit si dhe sasinë e plastikës të eksportuar jashtë Shqipërisë që janë pjesë e RGJM-së 2021, e cila është në fazë botimi (Tabela. Mbjetet e raportuara nga aktivitetet dhe tabela 8 Eksporti i mbetjeve gjatë vitit 2021).

Në RGJM 2020 (faqe 116) është paraqitur në tabelë sasia e mbetjeve plastike nga paketimet për vitin 2020 si dhe objektivat për vitin 2025-2030-2035. Ndërsa në Aneksin 1 janë të dhënat e bashkive që kanë raportuar për sasinë e mbetjeve plastike. (bashkëlidhur materiali).

Krahas sa më sipër, grupi i auditimit shqyrtoi edhe shkresat e dërguara nga AKM, subjekteve private (shkresa nr. 4472 prot., datë 13.06.2022) dhe bashkive (shkresat nr. 1577-1605 prot, datë 03.03.2022), në zbatim të rekomandimit të mësipërm. Rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

**13.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në përputhje me VKM nr. 177, datë 6.3.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbjetet e Tyre”, Kreu XII, pika 9, të krijojë një “data bazë” lidhur me të dhëna e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre dhe ta vendosë në dispozicionin e publikut.

### **Qershor 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: AKM në përmbushje të detyrimit ligjor të VKM nr.177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, ka grumbulluar të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që nga viti 2017. Këto të dhëna janë përpunuar dhe publikuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2020 dhe 2021 (në proces botimi).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në zbatim të rekomandimit të mësipërm, u vlerësua se tabela e përgatitur nga subjekti nuk përmban të gjitha informacionet e nevojshme mbi ambalazhet dhe mbetjet e tyre. Rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**14.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të sigurojë çdo vit informacion të detajuar dhe të përditësuar lidhur me subjektet private të cilat operojnë në sektorin e mbetjeve plastike (grumbullim, transferim, riciklim etj.).

**Qershor 2022 dhe në vazhdimësi**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: AKM ka krijuar data bazën e këtyre subjekteve si dhe ka hedhur të dhënat e raportuara nga subjektet që kanë transferuar dhe grumbulluar mbetjet plastike. Këto të dhëna janë bërë pjesë e RGJM 2021(në proces botimi).

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

## **V. Për pyetjen: 4.3.2 A janë hartuar raporte monitorimi mbi zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve ku përfshihen dhe mbetjet plastike?**

### **Gjetje**

**20.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 11 pika 6.

**21.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka monitoruar dhe nuk ka përgatitur asnjë raport në zbatim të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 66 pika 1.

**22.** Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nuk ka paraqitur për shqyrtim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor në shkallë vendi, për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, për periudhën 2017-2020, në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 15 pika 2.

### **Rekomandime**

**15.** Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme dhe të raportojë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve miratuar me VKM nr. 418, datë 27.05.2020.

**Qershor 2022 dhe në vazhdimësi**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Raporti i parë i monitorimit të strategjisë është konsultuar dhe miratuar në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në datë 23.12.2021. Rekomandimin tuaj, do e mbajmë në konsideratë, për këtë vit dhe në vijim me qëllim dërgimin dhe në KM të raportit për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve miratuar me VKM nr. 418, datë 27.05.2020.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**16.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të përgatitur raportin e zbatimit të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

**Qershor 2022 dhe çdo 3 vjet**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Analizim i akteve të miratuara ose jo, referuar ligjit kuadër të mbetjeve, është kryer nga MTM por nuk është publikuar në faqen

web. Bashkëlidhur gjeni emalin e dërguar për këtë çështje. Rekomandimin tuaj, do e mbajmë në konsideratë, për këtë vit.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**17.** Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve çdo fund viti të paraqesë në Këshillin e Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në përputhje me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 15 pika 2.

**Qershor 2022 dhe në vazhdimësi**

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Përgjigja e institucionit: Për shkak se ligji autorizon dërgimin në fund të çdo viti të këtij raporti, Ministria do ta dërgojë këtë raport në dhjetor 2022.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

### **V.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Për sa më sipër **ri kërkojmë** që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia e Tiranës, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Elbasan, të marrin masa të zbatojnë të gjitha rekomandimet që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:

#### **MASA ORGANIZATIVE**

##### **Për pyetjen:**

**4.1 A kanë miratuar MTM dhe bashkitë kuadrin rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike?**

##### **Gjetje**

**1.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve, në mos përputhje me nenin 14 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

**2.** Bashkitë Tiranë dhe Vlorë nuk kanë hartuar dhe miratuar Planet Vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë nën juridiksion në shkelje të nenit 12 të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

**3.** Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar dhe nuk ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave masat e nevojshme që çdo person juridik ose fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 16 pika 1.

##### **Rekomandime**

**1.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë Programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve sipas rrymave, ku parandalimi i krijimit të mbetjeve plastike të jetë një kapitull i veçantë. Hartimi i programeve të parandalimit të realizohet duke i kushtuar rëndësinë që ato kanë në zbatimin e piramidës së menaxhimit të mbetjeve.

**Dhjetor 2022**

**2.** Bashkitë Tiranë dhe Vlorë të marrin masat e nevojshme dhe të iniciojnë procedurën për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e Planeve Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

**Dhjetor 2022**

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave masat e nevojshme që çdo person juridik ose fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

**Dhjetor 2022**

**Për pyetjen:**

**4.1.2 A është kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve plastike në harmoni me legjislacionin e BE-së?**

**Gjetje:**

4. Në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” nuk janë përcaktuar afatet e vlerësimit dhe rishikimit të Programeve të Parandalimit të krijimit të mbetjeve në mospërputhje me nenin 30 pika 1 të Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet”.

5. Legjislacioni shqiptar mbi mbetjet nuk ka asnjë strategji të dedikuar për mbetjet plastike ndryshe nga sa paraqitet në praktikën e mira, si për shembull Komisioni Evropian i cili ka hartuar strategji të dedikuar mbetjeve plastike.

**Rekomandime:**

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimin e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” duke përcaktuar afatet e vlerësimit dhe rishikimit të Programeve të Parandalimit të krijimit të mbetjeve në përputhje me nenin 30 pika 1 të Direktivës së BE-së 2008/98/EC “Mbi mbetjet”.

**Dhjetor 2022**

5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të hartuar dokumente politike (strategji/plan veprimi) dedikuar vetëm mbetjeve plastike referuar praktikave të mira të BE-së të përshkruara më sipër gjatë shtjellimit të pyetjes.

**Dhjetor 2022**

**Gjetje**

6. Bashkitë Vlorë dhe Elbasan dhe pjesërisht Bashkia Tiranë nuk kanë ngritur infrastrukturën e duhur për të mundësuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në kundërshtim me VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

7. Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu IV pika 1. Afatet 59 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” 60 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu X. Riciklimi dhe Rikuperimi 61 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XII. Monitorimi dhe Raportimi 62 VKM 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XII. Monitorimi dhe Raportimi, pika 5-6-7 52 ligjore për ngritjen e infrastrukturës së duhur që ofron grumbullimin e diferencuar të mbetjeve kanë përfunduar pa u përmbushur.

8. Kontratat që Bashkitë Elbasan dhe Vlorë, lidhur me kompanitë private që operojnë në këtë fushë, nuk janë ideuar dhe nuk janë mbështetur në Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, duke mos përcaktuar në specifikimet teknike të tyre detyrime për mënyrën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, gjë që do të mundësonte grumbullimin e ndarë të mbetjeve dhe respektimin e të gjithë kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

9. Kontratat e shërbimit të pastrimit për të tre Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk parashikojnë në specifikimet teknike grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në përputhje me Ligjin 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim.”

**10.** Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk kanë arritur objektivin specifik të vendosur në VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1, germa c, për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve plastike 22.5% të peshës së mbetjeve.

**11.** Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar formatin e raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 11 pika 6.

#### **Rekomandime**

**6.** Bashkia Vlorë në kontratat për shërbimin e pastrimit të qytetit që do të lidhin në vijimësi me operatorët ekonomikë të marrin masa që të përfshijnë në procedurën e prokurimit dhe të sanksionojnë në këtë kontrata grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, në përputhje me Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” duke përcaktuar qartë në specifikimet teknike vendosjen e kontejnerëve të ndryshëm për të bërë të mundur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim.

#### **Me lidhjen e kontratave të reja dhe në vazhdimësi**

**7.** Bashkitë Tiranë dhe Vlorë me ngritjen e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të marrin masa për arritjen e objektivit për përdorimin dhe riciklimin e plastikës në përputhje me VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1, germa c.

#### **Me lidhjen e kontratave të reja dhe në vazhdimësi**

**8.** Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për të hartuar formatin e raportimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve në përputhje me Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 11 pika 6.

**Dhjetor 2022**

#### **Për pyetjen:**

**4.2.2 A kanë marrë MTM dhe bashkitë nisma për të nxitur aktivitete informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre?**

#### **Gjetje**

**12.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka ndërmarrë nisma informuese dhe edukuese lidhur me mbetjet plastike dhe reduktimin e tyre duke mos përmbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve miratuar me VKM nr. 175 datë 19.01.2011, paragrafi 3.1.2.1 “Fushata për informimin e publikut”.

**13.** Në Bashkinë Tiranë programi i Edukimit Ambiental dhe Edukimit të Publikut është realizuar pjesërisht vetëm nga një kompani (E. T.) nga pesë të tilla që ofrojnë shërbimin e pastrimit në qytetin e Tiranës në kundërshtim kjo me kushtet e kontratës së lidhur me kompanitë kontraktore.

**14.** Në Bashkitë Vlorë dhe Elbasan kompanitë kontraktore që mbulojnë shërbimin e pastrimit nuk kanë hartuar Programet e Edukimit të Publikut në shkelje të detyrimeve kontraktore dhe si rezultat nuk kanë ndërmarrë nisma informuese, ndërgjegjësuere dhe edukuese lidhur me mbetjet (përfshirë dhe mbetjet plastike) dhe reduktimin e tyre.

**15.** Bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Elbasan nuk kanë marrë asnjë masë për të informuar përdoruesit e ambalazheve dhe në mënyrë të veçantë konsumatorët, për zbatimin e detyrimeve të VKM-së nr. 177, datë 6.3.2012, 2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” Kreu XIII.

#### **Rekomandime**

**9.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit menjëherë pas hartimit të Programeve për Parandalimin e prodhimit të mbetjeve, ku mbetjet plastike janë pjesë e këtyre programeve, të hartojë një plan dhe të ndërmarrë fushata për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, lidhur me

rëndësinë e parandalimit të prodhimit të mbetjeve, përfshirë këtu edhe mbetjet plastike. Hartimi i planit të edukimit dhe ndërmarrja e fushatave duhet të dokumentohen nga strukturat përkatëse të Ministrisë.

#### **Dhjetor 2022 dhe në vazhdimësi**

**10.** Bashkitë Vlorë dhe Elbasan të marrin masa që operatorët ekonomikë të hartojnë dhe të zbatojnë programet e “Edukimit të publikut” në përputhje me detyrimet kontraktuale.

#### **Dhjetor 2022 dhe në vazhdimësi**

**11.** Bashkia Vlorë të marrin masa për të informuar përdoruesit e ambalazheve sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 177 datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.

#### **Dhjetor 2022 dhe në vazhdimësi**

#### **Për pyetjen:**

**A ka MTM të dhëna lidhur me sasinë, burimin dhe trajtimin e mbetjeve plastike?**

#### **Gjetje**

**16.** Nga auditimi u konstatua se të dhënat që Agjencia Kombëtare e Mjedisit disponon dhe që janë publikuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (2017- 2019) lidhur me sasinë totale të mbetjeve plastike që prodhohen në Shqipëri, nuk janë të sakta dhe të plota, sepse jo të gjitha Bashkitë kanë raportuar çdo vit dhe jo të gjitha subjektet private që gjenerojnë mbetje plastike raportojnë rregullisht, në kundërshtim me VKM nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, kreu XII, pika 1 dhe 3.

**17.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka të dhëna të sakta dhe nuk ka publikuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitet 2017-2019, mbi sasinë e riciklimit të mbetjeve plastike, në kundërshtim me VKM nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, pika 6.

**18.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka të dhëna mbi rezultatet e zbatimit të VKM-së nr. 177, datë 06.03.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, pra nuk ka të dhëna mbi sasinë e ambalazheve të mbetjeve në total për gjithë territorin e vendit.

**19.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka të dhëna të sakta se sa kompani që merren me grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve të plastikës kanë qenë aktive për periudhën 2017-2020.

#### **Rekomandime**

**13.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në përputhje me VKM nr. 177, datë 6.3.2012, “Për Ambalazhet dhe Mbetjet e Tyre”, Kreu XII, pika 9, të krijojë një “data bazë” lidhur me të dhëna e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre dhe ta vendosë në dispozicionin e publikut.

#### **Dhjetor 2022**

**14.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të sigurojë çdo vit informacion të detajuar dhe të përditësuar lidhur me subjektet private të cilat operojnë në sektorin e mbetjeve plastike (grumbullim, transferim, riciklim etj.).

#### **Dhjetor 2022 dhe në vazhdimësi**

#### **Për pyetjen:**

**4.3.2 A janë hartuar raporte monitorimi mbi zbatimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve ku përfshihen dhe mbetjet plastike?**

#### **Gjetje**

**20.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 11 pika 6.

**21.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka monitoruar dhe nuk ka përgatitur asnjë raport në zbatim të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 66 pika 1.

**22.** Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve nuk ka paraqitur për shqyrtim pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor në shkallë vendi, për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, për periudhën 2017-2020, në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 15 pika 2.

**Rekomandime**

1) **15.** Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme dhe të raportojë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve miratuar me VKM nr. 418, datë 27.05.2020.

**Dhjetor 2022 dhe në vazhdimësi**

**16.** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të përgatitur raportin e zbatimit të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

**Dhjetor 2022 dhe çdo 3 vjet**

**17.** Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve çdo fund viti të paraqesë në Këshillin e Ministrave raportin vjetor për gjendjen dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, në përputhje me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” neni 15 pika 2.

**Dhjetor 2022 dhe në vazhdimësi**

## 7- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “EFEKTIVITETI DHE EFICENCA E MENAXHIMIT TË PARKIMEVE TË MJETEVE MOTORIKE NË RRUGËT E QYTETIT TË TIRANËS DHE KORÇËS”

### I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të EVADUARA në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në bashkitë Tiranë dhe Korçë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti dhe eficaenca e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës”, sipas programit të auditimit nr.201/7 prot., datë 29.04.2021, për veprimtarinë nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12..2020, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë në Bashkinë Tiranë me shkresën nr. 201/12, datë 30.09.2021, dhe në Bashkinë Korçë me shkresën nr.201/13, datë 04.10.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

**Bashkia Tiranë:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti nuk ka përcjellë shkresë mbi planin e zbatimit të rekomandimeve.

**Bashkia Korçë:** Kthim përgjigje KLSH-së, për respektimin e afatit ligjor për 20 ditë është dhënë me shkresën nr.1495/4, datë 08.11.2021 (vonuar për arsye objektive).

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se: **Bashkia Tiranë** dhe **Bashkia Korçë:** nuk kanë kthyer përgjigje për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna për afatin ligjor prej 6 muajsh.

#### 4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Tiranë me shkresën nr. 201/12, datë 30.09.2021 dhe në Bashkinë Korçë me shkresën nr.201/13, datë 04.10.2021, Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Efektiviteti dhe eficaenca e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 32 “Masa organizative” për zbatim. Nga 32 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 32 masa ose pranimi është në masën 100 %.



Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	32	32	0

## II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së", lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- L. B., Përgjegjës Grupi;
- V. G., Anëtar;
- M. K., Anëtar.

### 1. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat përkatësisht në Bashkinë Tiranë me shkresën nr.201/12, datë 04.10.2021 dhe në Bashkinë Korçë me shkresën nr.201/13, datë 04.10.2021, për auditimin e performancës me temë "Efektiviteti dhe eficaenca e menaxhimit të parkimeve të mjeteve motorike në rrugët e qytetit të Tiranës dhe Korçës".

### 2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

### 3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### 4. Konkluzioni:

Në dy subjekte të audituar nuk janë marrë masa për respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH<sup>ne</sup> mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Po kështu nga këto subjekte, nuk janë marrë masa edhe për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituara në bashkitë Tiranë dhe Korçë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH<sup>ja</sup>, në Bashkinë Tiranë me shkresën nr.201/12, datë 04.10.2021 dhe në Bashkinë Korçë me shkresën nr.201/13, datë 04.10.2021, rezulton se:

- Nga 32 masa organizative të rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 32 masa ose në masën 100 %. Nga 32 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 11 masa ose 34.4 % tyre, janë në proces zbatimi 12 masa ose 37.5 % , zbatuar pjesërisht 2 ose 6,3% dhe janë pa zbatuar 7 masa ose 21.9 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	rekomanduar	pranuar	Statusi i zbatimit			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	32	32	11	2	12	7

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	32	
2	Pa pranuar	0	
3	Pranuar	32	100
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	11	34.4
2	Pa zbatuar	7	21.9
3	Në proces	12	37.5
	Zbatuar pjesërisht	2	6.3

### 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 34.4 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi dhe zbatuar pjesërisht tyre shkon në nivelin 78.1 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara mbeten nivel relativisht të lartë në masën 34.4 %.

### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

#### MASA ORGANIZATIVE

**Për pyetjen: A është kryer planifikimi i duhur për menaxhimin e parkimeve publike në qytetet e Tiranës dhe Korçës?**

**Gjetje nr. 1:** Nga dokumenti strategjik, si dhe nga komunikimet me Agjencinë Tirana Parking dhe Drejtoritë e tjera si ajo e Transportit dhe Urbanistikës nuk del qartazi se cila është përgjegjësia specifike e strukturave për aktivitetet e lidhura me objektivin specifik “Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës”. Nga analizimi i planeve vjetore të Tirana Parking rezulton se, janë realizuar 4 nga 5 aktivitete gjithsej të parashikuara në planin strategjik për t’u zhvilluar për periudhën 2018-2021. Konkretisht në planin vjetor 2018 të Tirana Parking është realizuar 1 aktivitet dhe në planet vjetor 2019 dhe 2020 të kësaj agjencie rezulton se janë reflektuar 3 aktivitete. Për aktivitetin i cili nuk është realizuar gjatë periudhës nën auditimi nuk është e qartë se cila është struktura përgjegjëse.

**Rekomandim nr. 1.1:** Bashkia Tiranë të marrë masat e nevojshme që për të gjitha aktivitetet e parashikuara për përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Tiranës, në dokumentin strategjik të saj (SZHQBT), të përcaktohen në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse dhe detyrat specifike të secilës prej tyre.

#### Brenda 6-mujorit të parë 2022

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Bashkia e Tiranës ka filluar punën për rishikimin e dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për krijimin e Strategjisë së re për periudhën 2023 – 2027. Bashkia e Tiranës do të marrë në konsideratë rekomandimet e propozuara nga KLSH në lidhje me këtë Strategji. Aktualisht ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e Grupit të punës për Strategjinë e re me nr. 19387 prot., date 23.05.2022. Aktualisht Grupi i Punës ka filluar punën.

Ndërkohe gjatë kësaj periudhe Tirana Parking ka kryer realizimin e aktivitetit të 5 të pa reflektuar në raportin e mëparshëm, “*Diversifikimi i mënyrave të pagesës së parkimit në shesh*” dhe ky projekt ka filluar procesin e zbatimit që në vitin 2021 dhe aktualisht është përbushur dhe është në proces zbatimi për të vijuar me tej me implementimin e saj nga Tirana Parking.

Nga komunikimi me subjektin, dhe analizimi i SZHQBT 2018-2022, grupi i auditimit identifikoi strukturat përgjegjëse për raportimin mbi realizimin e aktiviteteve strategjike, fokus i këtij auditimi. Në këtë Strategji, strukturat përgjegjëse për raportimin janë përfshirë në Kapitullin nr. 8 “*Monitorimi i strategjisë*”.

Për më tepër [https://tirana.al/uploads/2019/3/20190304142936\\_szhqbt-2018-2022-30-e-miraturar-per-web-finale.pdf](https://tirana.al/uploads/2019/3/20190304142936_szhqbt-2018-2022-30-e-miraturar-per-web-finale.pdf). Referuar përgjigjes së subjektit, si dhe shqyrtimit të dokumentacioneve nga grupi i auditimit, rekomandimi është **i pranuar** dhe **në proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 2:** Në nenin 32, të kreut VI, të Ligjit nr. 68/2017 “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*”, përcaktohet se: “1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik të zhvillimit të njësisë përkatëse, i cili miratohet me vendim nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në Udhëzimin nr. 21, datë. 25.10.2016 “*Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve*”, përcaktohet se me qëllim planifikimin strategjik dhe kontrollin e tij në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, menaxhimi duhet të kryet sipas objektivave SMART<sup>40</sup>. Në këtë pikë paraqitet edhe formati se çfarë duhet të përmbajë një strategji institucionale. Nga krahasimi i parashikimeve të këtij Udhëzimi me planifikimin strategjik të menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

-Nga analizimi i SZHQ 2018-2022 rezulton se, megjithëse është një dokument strategjik, pra afatgjatë, asnjë nga aktivitetet strategjike të vendosura nuk ka të përcaktuar afatin për t’u arritur në vitet në të cilat shtrihet strategjia. Pra nuk është e qartë se ç ‘pjesë e aktivitetit do të kryhet në çdo vit të strategjisë.

-Në Planin strategjik nuk parashikohen përlllogaritje dhe shpërndarje efektive e burimeve financiare si dhe nuk është parashikuar kostimi vit pas viti për aktivitet.

-Për asnjërin prej aktiviteteve dhe treguesve të performancës të parashikuar në SZHQ 2018-2022 nuk janë përcaktuar rezultate të synuar apo targeta për t’u arritur vit pas viti.

-Nga analiza e të dhënave përgjatë procesit të auditimit, nuk del i qartë informacioni mbi mënyrën e matjes së treguesve të performancës të përcaktuar në planin strategjik:

-Nga analizimi i përgjigjeve të marra prej DPSJP përgjatë pyetësorëve zyrtar, nuk rezulton të jenë kryer analiza apo vlerësime lidhur me rëndësinë dhe përshtatshmërinë e indikatorëve të performancës (të përcaktuar për të monitoruar progresin në drejtim të objektivit specifik të strategjisë lidhur me parkimet), apo mundësinë praktike për t’i matur këto tregues.

Mos parashikimi i burimit të financimit, dhe mungesa e kostimit të aktiviteteve dhe projekteve vit pas viti në të cilin shtrihet strategjia, përmban riskun e moszbatimit të tyre, çka do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivit strategjik. Mos përcaktimi i rezultateve të synuar për asnjë prej aktiviteteve/treguesve të performancës të parashikuar në Strategji nuk krijon mundësinë për të krahasuar (*benchmarking*) rezultatet e arritura nga implementimi i aktiviteteve me rezultatet e pritshme, çka e bën të pamundur vlerësimin nëse aktivitetet janë përbushur apo jo. Mungesa e rezultateve të pritshme të matshme (targetave), pas

<sup>40</sup> S – Specifik (objektiva të qartë, përgjegjësi të qarta); M – I matshëm (mund të matet me shifra); A – I arritshëm (masat e marra ndikojnë në arritjen e qëllimit); R – Relevant (objektivi nuk është as shumë i lartë dhe as shumë i ulët); T – Me afat (ka një kohë të caktuar për arritjen e objektivit).

implementimit të 5 projekteve të parashikuara për rritjen e kapacitetit të parkimit në qytetin e Tiranës, nuk siguron rezultate solide mbi të cilat mund të mbështetet monitorimi i vazhdueshëm dhe ndërmarrja në kohë e masave korigjuese nga strukturat drejtuese.

**Rekomandim nr. 2.1:** Bashkia Tiranë, mbështetur në analiza, të ndërmarrë masat e nevojshme që për çdo aktivitet të parashikuar për përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Tiranës, në dokumentin strategjik të saj të përfshihen sa më poshtë:

- kosto e çdo aktiviteti për çdo vit që shtrihet strategjia, si dhe burimi i financimit;
- afati kohorë për përmbushjen e secilit aktivitet;
- indikatorët SMART të performancës;
- targetat e synuara për të arritur për çdo vit.

#### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Kosto: Është e detajuar tek Plani Vjetor i Tirana Parking; Afati kohor - është në strategji; Indikatorët Smart – janë në strategji; Targetet e synuara janë në strategji dhe tek Plani vjetor i TP.

Megjithatë, referuar përgjigjes së rekomandimeve të pikës 1.1 Bashkia e Tiranës do të marrë në konsideratë rekomandimet e KLSH për të përmirësuar më tej Strategjinë që po ripunohet.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 3:** Nga auditimi i kryer, për periudhën objekt auditimi, nga dokumentet dhe informacionet e vendosura në dispozicion nuk rezultojë të ketë gjurmë të kryerjes së analizave për përcaktimin e rezultateve të pritshme operacionale në Tirana Parking. Sikundër, asnjë gjurmë mbi mënyrën se si është operuar për hartimin e planeve vjetore, grupit të punës së ngritur, minutave të analizave etj. Rezultatet e pritshme operacionale të vendosur për vitet 2018-2022 nga TP, janë të hartuar pa patur një analizë institucionale paraprake duke mos siguruar kështu rëndësinë<sup>41</sup> e tyre për të matur arritjen e objektivave operacionale.

**Rekomandim nr. 3.1:** Agjencia Tirana Parking në hartimin e planeve vjetore, duhet të marrë masat e nevojshme që rezultatet e pritshme të përcaktuar për çdo aktivitet lidhur me parkimet, të jenë të mbështetura në analiza për të siguruar se arritja e tyre do t'i shërbejë arritjes së objektivit strategjik.

#### **Brenda vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Në analizën vjetore të kryer për vitin 2021 u analizuan rezultatet e arritura gjatë këtij viti dhe sfidat e hasura për realizimin e tyre. Në vijim u analizuan pritshmëritë dhe risqet për realizimet e objektivave për vitin e ardhshëm, në bazë të këtyre analizave u përcaktuan rezultatet e pritshme për çdo aktivitet, në përputhje me objektivat.

Për hartimin e planit vjetor 2022, është hartuar sipas Planit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2017 – 2022, në përputhje me objektivat strategjike. Bashkangjitur gjendet analiza e grupit të punës për vitin 2021 me Urdhër të Titullarit me nr. 234, datë 31.12.2021 për “Hartimin e Analizës Vjetore të Vitit 2021” si dhe Plani i Punës i realizuar me urdhër për “Ngritjen e Grupit të Punës për Hartimi i Planit Vjetor 2022”.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

**Gjetje nr. 4:** Nga auditimi u konstatua se, tarifat e shërbimit të parkimit me pagesë dhe përcaktimin e përqindjes variabël të tarifës së parashikuar (-/+ 30% të tarifës bazë), nuk janë

<sup>41</sup> Rëndësia është një nga komponentët e objektivave SMART (trajtuar më lartë, në mënyrë të detajuar)

mbështetur në studime apo analiza. Në mungesë të analizave argumentuese, tarifa e vendosur përbën riskun që nuk pasqyron vlerën reale për shërbimin e marrë nga qytetarët.

**Rekomandim nr. 4.1:** Bashkia Tiranë te marrë masat për rishikimin e vlerës së tarifave të parkimit me pagesë duke i mbështetur ato në analiza dhe studime, të cilat argumentojnë vendosjen e tyre në përputhje me shërbimin e ofruar.

#### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Lidhur me tarifat e shërbimit të parkimit me pagesë referuar zonave të shërbimit në Bashkinë e Tiranës, dëshirojmë të informojmë se tarifat aktuale bazë janë vendosur fillimisht me vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.1 datë 17/02/2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës, Nr.7 datë 07/03/2003 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës (Vendimi Nr.1 datë 17/02/2005) dhe janë ende në të njëjtat vlera.

Aktualisht Tirana Parking ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe dhe ka ngritur Master Planin e Tirana Parking dhe ka kryer të gjitha analizat e duhura për përcaktimin e tarifës së parkimit. Nga Bashkia e Tiranës po punohet për të analizuar dhe miratuar në bazë të legjislacionit në fuqi të gjithë analizat e përcaktuara në Master Plan edhe ato të propozimeve të tarifave konkrete dhe janë duke u përgatitur materialet për diskutimet dhe miratimet në Këshillin Bashkiak.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 5:** Në dokumentin Strategjik të Bashkisë Korçë miratuar në vitin 2017, nuk është mirë përcaktuar vizioni i Bashkisë lidhur me perspektivën e parkimeve në këtë qytet si dhe nuk janë parashikuar aktivitete të mirëfillta për menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, si pjesë e objektivave dhe dimensioneve strategjike, në funksion të arritjes së vizionit holistik të bashkisë. Në këtë dokument janë parashikuar vetëm 3 projekte test, të cilat priteshin të kishin ndikim në përmirësimin e situatës së parkimeve në qytet. Gjatë periudhës nën auditim 2018-2020, nuk rezulton të jenë kryer investime me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të parkimeve në këtë qytet. Shpenzimet e bashkisë për zhvillimin e parkimeve në qytet për periudhën shtator 2019- dhjetor 2020 (më përpara është administruar nga koncesionari) kanë qenë për paga/sigurime të punonjësve dhe blerjen e biletave të parkimit.

**Rekomandim nr. 5.1:** Bashkia Korçë, të ndër marrin masat e nevojshme për të zbatuar një qasje strategjike në menaxhimin e parkimeve, duke mirë përcaktuar në dokumentin strategjik të bashkisë vizionin dhe aktivitete e nevojshme për menaxhimin e parkimeve, në funksion të arritjes së vizionit holistik për zhvillimin e qytetit të Korçës.

#### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e Titullarit ka dalë Urdhri nr. 958, datë 18.11.2021 (9893 prot., datë 18.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumentit strategjik për menaxhimin e parkimeve”. Është pranuar, por nga grupi i punës nuk provohet ecuria e tij deri në datën e mbajtjes së këtij akt verifikimi, për hartimin për masat e nevojshme për të zbatuar një qasje strategjike në menaxhimin e parkimeve

Statusi i rekomandimit: **Pa realizuar.**

**Gjetje nr. 6:** Nga auditimi rezultuan mangësi në planifikimin strategjik<sup>42</sup> të menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës, paraqitur si më poshtë:

<sup>42</sup> Kriteret ligjore për planifikimin strategjik janë paraqitur në gjetjen 2, të nën pyetjes audituese nr. 1.1

-Për aktivitet e parkimit të parashikuara në të tre projektet test, të cilat priteshin të promovonin mënyrën e re të drejtimeve prioritete që do të merrte bashkia Korçë, nuk është parashikuar periudha kohore në të cilën ato do të shtriheshin.

-Për dy nga tre projektet test në të cilat janë parashikuar veprime lidhur me parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë nuk është bërë kostimi total i secilit projekt. Për të tre projektet, nuk është bërë as kostimi për çdo vit në të cilin do të shtrihet çdo projekt.

-Për të tre projektet test, në dokumentin strategjik të bashkisë, nuk është parashikuar apo deklaruar burimi i financimit të tyre.

-Për dy nga tre projektet test në të cilat ishin parashikuar veprime lidhur me menaxhimin e parkimeve në Bashkinë e Korçës, nuk janë ndarë qartësi detyrat e strukturave përgjegjëse në bashki për realizimin e këtyre projekteve, apo të aktorëve të tjerë të përfshirë në to.

-Për të tre projektet test në të cilat janë parashikuar veprime lidhur me parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, nuk janë parashikuar indikatorët e performancës si dhe nuk janë parashikuar rezultatet e pritura për çdo vit në të cilin do të shtrihet secili prej projekteve.

Projektet test, të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, prej zbatimit të të cilëve pritej të përmirësoj situatën e parkimeve në këtë qytet, vuajnë nga një planifikim i dobët, pasi nuk është parashikuar periudha kohe në të cilën secili prej tyre do të shtrihet, nuk është bërë kostimi total dhe rrjedhimisht as ai i përvitshëm, nuk janë përcaktuar qartë detyrat e secilit aktor të përfshirë në proces, nuk është parashikuar burimi i financimit, indikatorët e performancës dhe targetat e pritshëm. Kjo situatë nuk siguron zbatimin efektiv, eficient dhe ekonomik të këtyre projekteve, duke rrisur arritjen e rezultateve të pritshëm në përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Korçës nga implementimi i tyre.

**Rekomandim nr. 6.1:** Bashkia Korçë mbështetur në analiza dhe studime, të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar që për çdo aktivitet dhe projekt të parashikuar për menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, të përmbushen sa më poshtë dhe në vijim të përfshihen në dokumentin strategjik të Bashkisë:

- periudha e realizimit të projekteve e përcaktuar saktë;
- projektet të jenë të kostuar për çdo vit në të cilin do të shtrihen, dhe në total;
- financimi i tyre të jetë i siguruar dhe të deklarohet burimi i financimit;
- ndarje e qartë të detyrave të secilit prej aktorëve të përfshirë në proces;
- indikatorët e performancës, targetat e pritshëm vit pas viti dhe rezultati në fund të jenë të përcaktuar qartë.

#### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Është pranuar, por nga grupi i punës nuk provohet ecuria e tij deri në datën e mbajtjes së këtij akt verifikimi, për hartimin për masat e nevojshme për të zbatuar një qasje strategjike në menaxhimin e parkimeve.

Statusi i rekomandimit: **Pa realizuar.**

**Gjetje nr. 7:** Referuar praktikave të mira, mbledhja, përdorimi dhe analizimi i të dhënave lidhur me parkimet i ofron bërësit të politikave informacion objektiv, i cili ndihmon në vendimmarrje efektive.<sup>43</sup> Nga auditimi rezultoi se, Bashkia Korçë nuk ka një sistem të dhënash, si. p.sh. për të identifikuar kërkesën aktuale për vende parkimi, etj. si dhe nuk ka kryer analiza dhe studime që do të ndihmonin për të identifikuar hendeqet në politikat aktuale të menaxhimit të parkimeve, me qëllim vendimmarrjen efektive. Studimi i fundit i kryer mbi situatën e parkimit në qytetin e Korçës është ai i vitit 2013, pra i rreth 8 viteve më parë, dhe pas ndryshimit të mënyrës së menaxhimit në vitin 2019 (kalimi nga koncesionari në menaxhim të Bashkisë Korçë) nuk janë ndërmarrë analiza apo studime të tjera për të

<sup>43</sup> Parkimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane”, Eltis, qershor 2019, fq. 15.

identifikuar mangësitë në politikat aktuale, me qëllimin zhvillimin e politikave të qëndrueshme të parkimit për këtë qytet. Pra, çmimet e vendosura për parkimet me pagesë apo projektin e rezidentëve, zonat e parkimit me pagesë ose zonat ku do të aplikohet projekti i rezidentëve, metodat e pagesës së përzgjedhur dhe vetë sistemi i vendosur për menaxhimin e parkimeve, pas marrjes në administrim nga Bashkia Korçë nuk janë mbështetur në studime apo analiza. Për shkak se studimet dhe analizat e fundit të kryera, mbi situatën e parkimit në qytetin e Korçës, janë të rreth 8 viteve më parë, dhe nuk janë përditësuar në vijim, nuk ofrohet siguri nëse vendimet e marra vitet e fundit, si p.sh., ndryshimi i mënyrës së menaxhimit, reduktimi i vend parkimeve, tarifat e parkimit me pagesë, modaliteti i pagesës, projekti i rezidentëve, tarifat e këtij të fundit, janë efektive, eficientë dhe ekonomike në drejtim të përmirësimit të situatës së parkimeve në qytet.

**Rekomandim nr. 7.1:** Bashkia Korçë të ndër marrë masat e nevojshme për të ngritur dhe përditësuar një sistem të dhënash dhe/apo të kryejë analiza dhe studime lidhur me situatën e parkimeve në qytet, me qëllim identifikimin e hendeqeve në politikat aktuale dhe ndërmarrjen e vendimeve efektive.

#### **Brenda 6-mujorit të dytë 2021 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se është përditësuar sistemi i të dhënave duke mbajtur akt rakordime ditore dhe mujore (sipas raportimeve ditore) midis biletave të parkimit të dhëna nga arka, mandat pagesave sipas numrave serial. Për vitin 2020 janë arkëtuar në shumën 11,335,900 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 14,999,350 lekë.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 8:** Nga konsultimi i praktikave të mira (trajtuar gjerësisht në raportin e këtij auditimi), rezulton se opinioni i publikut ka një rëndësi të veçantë në menaxhimin efektiv të parkimeve në qytet. Referuar përgjigjeve zyrtare të Bashkisë Korçë, si dhe përgjigjeve të intervistave të zhvilluara nga grupi i auditimit me biznese dhe qytetarë në zonat e parkimit me pagesë dhe zonat e parkimit për rezidentët në qytetin e Korçës rezulton se, nuk është marrë mendimi i publikut dhe nuk janë konsultuar me publikun.

**Rekomandim nr. 8.1:** Bashkia Korçë të ndër marrë masat e nevojshme që të konsultojnë opinionin e publikut në mënyrë periodike lidhur me problematikat dhe përmirësimin e mëtejshëm të parkimi në qytetin e Korçës, dhe ta dokumentojnë atë, veçanërisht përpara ndërmarrjes së vendimeve në lidhje me menaxhimin e parkimeve në qytetin e Korçës.

#### **Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se janë formuluar pyetësorët në lidhje me biznesin për sa vijon: numrin e automjeteve që ka në funksion biznesi, nëse zotërojnë vend parkimi, a ka vështirësi për të gjetur vend të lirë parkimi në zonën ku ushtrohet biznesi, kur është më vështirë për të gjetur vend parkimi, sa ndikon në biznes mungesa e një vend parkimi për biznesin dhe klientelën, për dakortësinë që zona rreth biznesit të jetë parkim me pagesë, sa të jetë pagesa. Këto pyetësorë ende nuk janë vënë në zbatim ndërsa konsultimet me opinionin e publikut nuk rezultojnë të aplikuara.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 9:** Në nenin 7, pika IV, të Ligjit Nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit, përcaktohet se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: të çdo dokumenti politikash”*. Nga analizimi i faqes web të Bashkisë Korçë rezulton se në këtë faqe nuk është ngarkuar dokumenti më i fundi strategjik i Bashkisë. Në këtë faqe, gjendet një dokument me titullin Strategjia për Zhvillim e Bashkisë

Korçë, i cili nuk është i miratuar dhe përmbajtja e tij nuk përkon me Strategjinë e miratuar të Bashkisë Korçë.

**Rekomandim nr. 9.1:** Bashkia Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të publikuar në faqen web të saj, dokumentet e politikave të kësaj bashkie, me qëllim sigurimin e transparencës me publikun dhe palët e interesit.

**Brenda vitit 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se është publikuar në faqen web të Bashkisë, dokumentet e politikave të kësaj bashkie, me qëllim sigurimin e transparencës me publikun dhe palët e interesit, konkretisht sipas linqeve:

<https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-korce-nr-111-date-03-08-2019/>

<https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-korce-nr-52-date-03-06-2021/>

Statusi i rekomandimit: **Realizuar.**

**Gjetje nr. 10:** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, strukturë me një rol kyç në zhvillimin e politikave të parkimit në Bashkinë Korçë, ka funksionuar me një staf të reduktuar për të gjithë periudhën nën auditim. Nga 15 punonjës të nevojshëm referuar strukturës së miratuar, kjo drejtori ka funksionuar me 10 punonjës. Më hollësisht, në Sektorin e Planifikimit mungojnë përgjegjësi i sektorit dhe një specialist projektues, në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit mungojnë dy specialiste, ndërsa në Sektorin e Administrimit e Regjistrimit të Territorit mungon një specialist. Ndryshimet në strukturën e menaxhimit të parkimeve që ndodhën në shtator të vitit 2019<sup>44</sup>, nuk ishte të reflektuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Korçë deri në mars të vitit 2021.

**Rekomandim nr. 10.1:** Titullari i Bashkisë Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të plotësuar Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit me stafin e nevojshëm sipas strukturës së miratuar, me qëllim shmangien e riskut të cenimit të cilësisë së punës që kjo drejtori kryen.

**Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se me Urdhrin nr. 46, datë 02.02.2022 (prot., nr.645, datë 01.02.2022), “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë, për vitin 2022”, ka dalë struktura e re. Më hollësisht, në Sektorin e Planifikimit mungojnë përgjegjësi i sektorit dhe dy specialist projektues, në Sektorin e përkrahjes së Zhvillimit të Tokës mungojnë dy specialistë për shqyrtimin e lejeve, ndërsa në Sektorin e Administrimit e Regjistrimit të Territorit mungon një specialist.

Ndërsa në Zyrën e Shërbimit të parkimit me pagesë në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit Bashkia Korçë është plotësuar organika me një mbikëqyrës dhe 14 punëtorë të parkimit me pagesë, nga 19 të përcaktuar në këtë organikë.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Rekomandim nr. 10.2:** Bashkia Korçë të marrë masat e nevojshme, që në çdo rast tjetër të ndryshimeve në strukturën e institucionit, të kryhen menjëherë reflektimet e nevojshme në Rregullore e Brendshme të saj.

**Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se ndryshimeve në strukturën e institucionit, i janë përgjigjur reflektimet e nevojshme në Rregullore e Brendshme.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

**Për pyetjen: A kanë rezultuar aktivitetet e ndërmarrë nga strukturat përgjegjëse, në arritjen e rezultateve të pritshme nga menaxhimi i parkingjeve?**

<sup>44</sup> Me kalimin e menaxhimit të parkimeve nga koncesionari tek Bashkia Korçë në këtë të fundit u ngrit një strukturë për administrimin e parkimeve në qytetin e Korçës.



**Gjetje nr. 11:** Nga 5 projekte të parashikuara për menaxhimin e parkimeve në strategjinë për zhvillimin e qytetit të Tiranës, 1 prej tyre nuk është zbatuar deri më 6 mujin e parë të vitit 2021, duke cenuar kështu, efektivitetin dhe eficiencën e arritjes së objektivave. Moszbatimi i të paktën 1 prej 5 projekte të parashikuara në strategji ka cenuar efektivitetin dhe eficiencën e arritjes së objektivave strategjik “Rritja e kapaciteteve të parkimit në qytetin e Tiranës”.

**Rekomandim nr. 11.1:** Titullari i Bashkisë Tiranë në cilësinë e monitoruesit të zbatimit të projekteve, të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e moszbatimit të projekteve strategjike, me qëllim mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

**Brenda vitit 2021 dhe në vijimësi**

**Përgjigja e institucionit:** Bashkia e Tiranës ka monitoruar Tirana Parking në zbatimin e projektit “*Diversifikimi i mënyrave të pageses së parkimit në shesh*” i cili ishte i përzbatuar gjatë periudhës së auditimit, por ndërkohë që zbatueshmërinë e tij e ka patur deri në fund të vitit 2022. Ky projekt ka filluar procesin e zbatimit që në vitin 2021 dhe aktualisht është përmbushur dhe është në proces zbatimi për të vijuar me tej me implementimin e saj nga Tirana Parking.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**.

**Gjetje nr. 12:** Nga ana e subjekteve investitorë për punimet e kryera në fushën e ndërtimit janë prekur zonat e parkimeve me pagesë, ku nga 18 raste të konstatuara gjatë periudhës nën auditim, vetëm 2 subjekte kanë paraqitur dokumentacionin për njoftim të kryerjes së aktivitetit. Në mungesë të paraqitjes së dokumentacionit nga subjektet private, për të njoftuar kryerjen e punimeve të cilat bllokojnë vendet e parkimit me pagesë, Tirana Parking nuk ka dijeni për bllokimin e vendeve të parkimit të cita ajo menaxhon, mosshfrytëzim i të cilave sjellë mungesë në të ardhura për Tirana Parking.

**Rekomandim nr. 12.1:** Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Tirana Parking të analizojnë lejet e ndërtimit, për mos cenimin e të drejtës së qytetarëve për vend parkimi, gjatë periudhës së bllokimit të zonave për llogari të investitorëve në fushën e ndërtimit, gjë e cila ndikon në një menaxhim eficient të parkimeve.

**Në vijimësi**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Tirana Parking gjatë ushtrimit të detyrave të saj funksionale në kontrollet e punës për ofrimin e shërbimit të parkimit në mënyrë periodike ka verifikuar bllokime/zaptime të vendeve të parkimit publik me pagesë nga subjekte private, të cilët janë të pajisur me leje zhvillimore për ndërtimin ose rikonstruksione e objekteve në qytetin e Tiranës. Nga ana e Tirana Parking janë marrë masat për verifikimin e dokumentacioneve të lejeve të ndërtimit dhe në raste kur sipas lejeve të ndërtimit preken më shumë vende se është parashikuar, Tirana Parking i ka tarifuar për ofrimin e shërbimit të “Parkim i Rezervuar me Kontratë”.

Subjekte të tilla mund të përmendim:

- N. C. – rruga Kavajës – 3 vende parkimi (për periudhën 4.01.2021-03.01.2022)
- T. 1 C.- rruga Kavajës – 3 vende (04.01.2021-03.01.2022)
- A. S. – rruga Liman Kaba – 3 vende (30.08.2021-29.08.2022)

Gjithashtu janë konstatuar raste që për ndërtimin e godinave poli funksionale janë shfrytëzuar vend parkimet për hyrje dalje në kantier për makineritë e rënda të ndërtimit, por këto vende nuk janë tarifuar nga Tirana Parking pasi subjekti në lejen e tij zhvillimore ka të përcaktuar hyrjen dhe daljen, të cilat përkohë me vende parkimi. Këto raste janë me shkresa zyrtare nga subjekti ose nga Drejtoria e Punëve Publike të Bashkisë Tiranë. Mund të përmendim raste:

- P. SHPK – Leje ndërtimi me nr. A- 14369/7 datë 10.10.2019- rruga Tefta Tashko Koco - 5 vende parkimi
- Shkresa me nr. V-24372/1 Prot, datë 03.11.2021 të dërguar nga DPPP Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**.

**Rekomandim nr. 12.2:** Drejtoria e Urbanistikës të marr masa të njoftojë zyrtarisht Agjencinë Tirana Parking për lejet e ndërtimit të dhëna të cilat do të prekin në mënyrë të drejtpërdrejt parkimet me pagesë.

**Në vijimësi**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Referuar rekomandimit 12.2, Bashkia e Tiranës nëpërmjet korrespondencës së saj të brendshme nr. 6071/5, datë 17.12.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit që të merren masat përkatëse për njoftimin e Agjencisë Tirana Parking për lejet e ndërtimit të dhëna që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë parkimin me pagesë.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**.

**Gjetje nr. 13:** Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 11.11.2015 për *“Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës”* pika 2 e nenit 2.4 të Aneksi 3 specifikon si më poshtë vijon:

*... “Tarifat e shërbimit të parkimit mund të paguhen me para në dorë (cash) dhe/ose përmes SMS-ve apo mënyrave alternative të pagesës të mundësuar nëpërmjet telefonisë celulare.”*

Pavarësisht përcaktimit në VKB, në qytetin e Tiranës pagesa aktualisht kryhet vetëm me anë të platformës *SMS payment*, duke mos pasur asnjë metodë tjetër alternative për kryerjen e pagesës së shërbimit të parkimit. Ekzistenca e vetëm një alternative për të kryer pagesën e parkimit në Tiranë, ajo nëpërmjet sms në telefon, nuk krijon mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët apo vizitorët e Tiranës, duke mos krijuar mundësinë e pagesës në mungesë të kreditit të mjaftueshëm në telefon apo mos pasjes së një numri nga operatorët shqiptar. Në këto rrethana bëhen burim i marrjes së penaltiteteve financiare (gjoba).

**Rekomandim nr. 13.1.** Tirana Parking të kryejë studimet dhe analizat e nevojshme për të identifikuar metodat më të përshtatshme të pagesës së parkimit në këtë qytet. Në vijim, të ndërmarrë masat e nevojshme për aplikimin e tyre.

**Mars 2022**

**Përgjigja e institucionit:** Në lidhje me rekomandimin për kryerjen e studimeve, analizave dhe marrjen e masave për metodat e përshtatshme të pagesës së parkimit, Tirana Parking si fillim ka kryer disa takime me kompani të ndryshme të interesuara për bashkëpunim në lidhje me ofrimin e shërbimit të pagesës alternative të parkimit në qytetin e Tiranës, referuar kjo Urdhrit të Titullarit të institucionit me Nr.101, datë 16.06.2021 për *“Pjesëmarrjen në Takim mbi kërkesat për bashkëpunim në lidhje me ofrimin e shërbimit të pagesës alternative të parkimit në qytetin e Tiranës”*. Pas prezantimeve dhe takimeve me operatorët e interesuar, grupi i përcaktuar ka përgatitur një memo me lëndë *“Mbi takimet e zhvilluara me kompanitë që kanë shprehur interes për ofrimin e shërbimit të pagesës alternative të parkimit në rrugë”*. Pas analizës së takimeve me operatorët i është propozuar Bashkisë Tiranë për shtimin e metodave alternative të pagesës së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë me anë të memo-s me nr. prot. 916/5, datë 08.10.2021, me lëndë *“Propozimin për shtimin e metodave alternative të pagesës së shërbimit të parkimit publik me pagesë në rrugë”*. Me anë të memo-s së sipërcituar kemi propozuar miratimin dhe prezantimin e projektit me qëllim vazhdimin e

implementimit të një platforme unike për vjeljen e tarifës së parkimit në rrugë, e cila të jetë aset i Tirana Parking dhe të ofrojë mundësinë çdo kompanie të interesuar që tu ofrojë klientëve të saj këtë shërbim, pagesën e parkimit në rrugë.

Aktualisht jemi në fazën ku Tirana Parking si institucion ka prokuruar procedurën për zhvillimin e metodave alternative të pagesës së parkimit në rrugë, e cila është në proces për të vijuar më tej me implementimin e saj.

Objektivi i këtij projekti është të zhvillojë dhe implementojë një sistem software, i cili menaxhon në mënyrë të shpejtë, të sigurtë dhe të besueshme procesin e parkimit të rezervuar me pagesë në qytetin e Tiranës . Përmes këtij projekti synohet:

1. Krijimi i një sistemi të unifikuar software, me platformë web dhe një aplikacion mobile, në pronësi të Tirana Parking, i cili do të ofrojë informacion rreth shërbimeve të Tirana Parking, mundësojë mënyra shtesë pagese për qytetarët si dhe mundësojë ndërveprimin me palë të treta në të ardhmen.

2. Platforma web do të jetë e hapur për t'u ndërlidhur jo vetëm me operatorët e telekomunikacionit por gjithashtu për të ofruar mundësinë e pagesave nëpërmjet aplikacioneve të palëve të treta online banking (R.ON, B.Smart, C. O., etj), apo platforma të tjera të pagesave (EasyPay, Paysera, etj).

3. Aplikacioni mobile do të shërbejë jo vetëm si një mundësi për të kryer pagesën e parkimit, por gjithashtu do të ofrojë informacione dhe do të mundësojë Tirana Parking të dërgojë komunikime të ndryshme qytetarëve.

4. Kjo platformë do të jetë e hostuar në serverat e Tirana Parking dhe do të mirëmbahet 24/7 për të ofruar kontroll dhe siguri maksimale. Kjo mundëson shumë thjesht shtimin e use-cases apo shërbimeve të reja; suport për institucionet partnere si dhe zgjidhje të shpejtë për ankesat e qytetarëve.

Modulet që do të përmbajë platforma janë si më poshtë vijon:

- Moduli i Administrimit të sistemit;
- Moduli i Raporteve/Dashboard për menaxhimin e Institucionit;
- Moduli i Supervizimit të Inspektorëve të parkimit;
- Moduli i Financës;
- Moduli i Administratorit për Konfigurime/Parametrizime;
- Moduli API për SMS për konsumimin e shërbimit nga operatorët telefonike (Vodafone, One Albtelecom, etj.);
- Moduli Open API për konsumimin e shërbimit për pagesat përmes palëve të treta;
- Moduli i gjenerimit dhe menaxhimit të “vouchers” për qytetarët;
- Moduli për kontrollin e mjetit nga ana e Inspektorëve;
- Zhvillimi dhe Implementimi i Platformës mobile “*Tirana Parking e-Wallet*”;
- Moduli i pagesës së parkimit direkt nga kioskat e Bashkisë Tiranë pa nevojën e aplikacionit mobile.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**.

**Gjetje nr. 14:** Nga analizimi i pagesës së parkimit nëpërmjet sms u konstatuan problematikat e mëposhtme:

-V.A. ka ndërprerë sinjalin në 7 raste për vitin 2019 dhe 6 raste në vitin 2020 (pa përfshirë bllokimin për efekt pandemie), ku të përkthyer në orë pa pagesë në vit janë 23.5 orë për 2019 dhe 41.5 orë për vitin 2020. T. ka ndërprerë sinjalin në 10 raste për vitin 2019 dhe 11 raste në vitin 2020, ku të përkthyer në orë pa pagesë në vit janë 30 orë për 2019 dhe 56 orë për vitin 2020. Nisur nga fakti që në një orë mesatarisht parkojnë 390 makina në zonën A,

187 makina në zonën B dhe 28 makina në zonën C, sipas tarifkimit respektiv të zonave, 100 lekë/ora, 40 lekë/ora dhe 20 lekë/ora, kjo sjell të ardhura të munguara potenciale për vitin 2019 në 3,938,560 lekë dhe për vitin 2020 në 4,376,740 lekë nga të cilat respektivisht sipas kompanive rezultojnë të ardhura të munguara nga T. 4.511.460 lekë dhe nga V. 3.803.840 lekë. Vlerave respektive duhet ti zbritet përqindja e komisionit që kompanitë telefonike mbajnë konkretisht 15%, dhe kjo vlerë shkon konkretisht për vitin 2019 shkon në 3,347,776 lekë dhe për vitin 2020 në 3,720,229 lekë, ose 7,068,005 lekë për periudhën nën auditim. Nga ana e V. A. nuk ka asnjë plan rezervë apo specifikim konkret lidhur me ndërprerjet e sinjalit, apo se si do të kryhet menaxhimi në rast të përballjes me këtë ndërprerje apo bllokime të tjera të sinjalit, sikundër nuk ka asnjë klauzolë në marrëveshje se kush do të përgjigjet për këto të ardhura të munguara duke qenë se nga ana ekonomike kjo ndërprerje normalisht përkthehet në mos arkëtim të parave për këtë shërbim të ndërprerë.

-Nga auditimi u konstatua se nuk ka një analizë kosto/përfitim të kryer nga ana e Bashkisë Tiranë përsa i takon tarifës së komisionit të vendosur nga ana e V. A. dhe as të operatorëve të tjerë.

Nga ana e Bashkisë Tiranë dhe operatoreve telefonik si palë në marrëveshjet e lidhura për pagesën e parkimit nëpërmjet sms, nuk është parashikuar asnjë klauzolë mbi menaxhimin e situatës në rast të ndërprerjes së sinjalit telefonik, sikundër nuk specifikohet cili do të përgjigjet për këto të ardhura të munguara në buxhetin e BT, duke shkaktuar që peshën e të ardhurave të munguara ta mbajë buxheti i shtetit. Vendosja e tarifës që operatorët ekonomik do të përfitojnë për ofrimin e shërbimit të pagimit të parkimeve nëpërmjet telefonit, në mungesë të analizave mbështetëse, nuk siguron *vlerën për para* për shërbimin e marrë nga Tirana Parking.

**Rekomandim nr. 14.1 :** Gjatë rinovimit të kontratave me operatorët telefonikë për pagesat me sms të parkimeve, Bashkia Tiranë të mbajë në konsideratë rastet e ndërprerjes së sinjalit dhe tarifën e komisionit, për të negociuar kushtet më të përshtatshme për adresimin e këtyre çështjeve, me qëllim shmangien e të ardhurave të munguara në buxhetin e Bashkisë dhe shpenzimet pa efektivitet.

#### **Me rinovimin e kontratave me operatorët telefonikë**

**Përgjigja e institucionit:** Tirana Parking gjatë zbatimit të punës se saj ka evidentuar problematika me operatorët për të cilat ka përgatitur një propozim konkret sjellë në Bashkinë e Tiranës për të negociuar me operatorët telefonike elementet teknike, financiare dhe penalitetet për mungesat e ofrimit të shërbimit nga ana e tyre. Paralelisht nga ana e Tirana Parkim po merren masat për implementimin e metodave alternative të pagesave për të mos qene sms e vetmja alternative pagese parkimi.

Bashkia e Tiranës aktualisht ka filluar negociatat për rishikimin e kushteve të kontratës me të gjithë operatorët.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe në proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 15:** Nga vizita në terren në qytetin e Tiranës u konstatuan problematika lidhur me sinjalistikën e parkimit në shumicën e zonave të kontrolluara nga ana e grupit të auditimit, konkretisht sinjalistika horizontale dhe vertikale lidhur me parkimin nuk ishte e plotë, nevojitesh ravijëzim i zonave si për parkim me pagesë ashtu edhe për parkimin pa pagesë.

**Rekomandim nr. 15.1:** Tirana Parking të marrë masat për riparimin e sinjalistikës dhe vijëzimit në zonat të cilat janë evidentuar gjatë kontrollit në terren nga ana e grupit të auditimit si zona me sinjalistikë të dëmtuar, të kryejë kontroll dhe plotësojë me sinjalistikë vertikale dhe horizontale zonat problematike rast pas rasti.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Tirana Parking për mirëmbajtjen e sinjalistikës së parkimit publik me dhe pa pagesë, duke përfshirë rrugët me sistem tarifimi si dhe zonat e dedikuara për rezident, çdo vit ka marrë masat për procedurat për “Shërbime Vijëzime dhe Vendosje Tabelash”, në mënyrë që të mirëmbajë çdo sinjalistikë të shërbimit që ofron.

Në vitin 2022 janë marrë masat për mirëmbajtje të sinjalistikës nga ana e stafit të Drejtorisë së Administrimit të Shërbimit të Parkimit me kontrole dhe mirëmbajtje, duke iu referuar rekomandimeve dhe kontrollit në terren të grupit të punës së auditimit, në rrugët e destinuara për parkim janë kryer rregullime sinjalistike, të cilat janë paraqitur në raportin me Nr. prot 722, datë 07.04.2022 (sipas raporteve).

Gjithashtu për mirëmbajtjen apo riparime të sinjalistikës së parkimit, Tirana Parking ka kryer procedurat e prokurimit, të cilat do të zbatohen gjatë vitit 2022:

**1. “Shërbime Vijëzimesh dhe Vendosje Tabelash”**, me atë të së cilës do të mirëmbahet sinjalistika vertikale dhe horizontale e rrugëve me tarifim, ku në këtë procedure janë të përfshira edhe rrugët e verifikuara nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjatë periudhës së auditimit.

**2. “Plotësimi me sinjalistikë i rrugëve me Tarifim”** me anë të kësaj procedure do të plotësohet me sinjalistikë horizontale dhe vertikale për 12 rrugë për shërbimin e parkimit publik me dhe pa pagesë.

**3. “Plotësimi me Sinjalistikë i Blloqeve të Parkimit për Rezidentin”** me këtë procedure do të përfshihen shtimi i hapësirave të dedikuara “Vetëm për Rezidentët” sipas zonave të administrimit të parkimit (ZAP 1,2,3,4) dhe plotësimi me sinjalistikë horizontale dhe vertikale.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**.

**Gjetje nr. 16:** Nga auditimi rezultoi se, nga 3 projekte test të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë mbi menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, 2 dy prej tyre nuk janë realizuar, për shkak të mungesës së fondeve. Mangësitë e konstatuara në planifikimin<sup>45</sup> e projekteve test për parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, kanë shkaktuar që 67% e tyre të mos realizohen, si rezultat i mungesës së fondeve, duke cenuar efektivitetin e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës.

**Rekomandim nr. 16.1:** Titullari i Bashkisë Korçë, të ndërmarrë masat e nevojshme për të identifikuar dhe analizuar faktorët të cilët kanë shkaktuar moszbatimin e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë. Në përfundim të analizës të ndërmarr masat e nevojshme me qëllim mos përsëritjen e kësaj situatë në të ardhmen.

**Brenda muajit Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga Kryetari i Bashkisë ka dalë Urdhri nr.959, datë 18.11.2021 (9893 prot., datë 18.11.2021), “Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin dhe analizën e mangësive në sistemin aktual të monitorimit dhe kontrollit të parkimit me pagesë në qytetin e Korçës”. Nuk ka ndonjë dokument të hartuar nga ky grup pune për të identifikuar dhe analizuar faktorët të cilët kanë shkaktuar moszbatimin e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë.

Statusi i rekomandimit: **Pa zbatuar**.

**Gjetje nr. 17:** Nga auditimi rezultoi se aktualisht në Bashkinë Korçë aplikohet vetëm një mënyrë pagese për parkimin, ajo nëpërmjet lëshimit të biletës dhe mbledhjes së pagesës nga

<sup>45</sup> Për më shumë, konsultoni gjetjet në nën pyetjen audituese 1.1.1.

punonjësi i bashkisë. Në zonat e parkimit me pagesë nuk u gjetën parkimetra, si një mënyrë alternative për të kryer pagesën. Referuar intervistave që grupi i auditimit realizoi me qytetarët dhe bizneset rezultoi se, mungesave e metodave alternative të pagesës së parkimit është një ndër problematikat kryesore të lidhura me parkimet në këtë qytet. Kryerja e pagesës me *cash* (para në dorë) përmban risk të lartë për abuzime si nga ana e qytetarit edhe nga punonjësi i Bashkisë.

**Rekomandim nr. 17.1:** Bashkia Korçë të kryej studimet dhe analizat e nevojshme për të identifikuar alternativat më të mira të pagesës së parkimit në këtë qytet. Në vijim, të ndërmarrë masat e nevojshme për aplikimin e tyre.

**Brenda muajit Mars 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se nuk ka ndryshuar mënyra e aplikimit të pagesës, është në proces studimi për të identifikuar alternativat më të mira të pagesës së parkimit në këtë qytet.

Statusi i rekomandimit: **Pa zbatuar.**

**Gjetje nr. 18:** Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit së bashku me përfaqësuesit e Bashkisë Korçë u konstatuan raste të mungesës së sinjalistikës vertikale, sinjalistikë vertikale jo e plotë, jo e saktë ose jo e dukshme. Gjithashtu u konstatua, mungesë e sinjalistikë horizontale, sinjalistikë horizontale e fshirë, jo e saktë ose dy vijëzim. Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit rezultoi se zona e parkimit për rezidentët në qytetin e Korçës nuk është e vijëzuar, makinat ishin të parkuara jo në postet e parkimit (pasi ato nuk janë të vijëzuara), duke penguar hyrjen dhe daljen e automjeteve nga kjo zonë.

**Rekomandim nr. 18.1:** Bashkia Korçë të ndërmarr masat e nevojshme për të siguruar sinjalistikë të plotë, të qartë dhe të saktë horizontale dhe vertikale në vend parkimet me pagesë, si dhe në të gjitha zonat e rezidentëve, me qëllim shmangien e parkimit të automjeteve jo në mënyrë të rregullt.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e Bashkisë, nga verifikimi i fotove të terrenit, rezultoi se zona e parkimit për rezidentët në qytetin e Korçës është e vijëzuar, është vendosur sinjalistika vertikale e dukshme.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

**Gjetje nr. 19:** Me përfundimin e kontratës së koncesionarit në qershor të vitit 2019, gjatë muajve me fluksin më të lartë të turistëve në qytetin e Korçës, korrik-gusht 2019, parkimet me pagesë në këtë qytet nuk janë menaxhuar. Bashkia ka nisur të administrojë parkimet me pagesë në muajin shtator 2019. Si rezultat se, Bashkia Korçë nuk ka ndërmarr në kohë masat e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e administrimit të parkimeve me përfundimin e kontratës me koncesionarin, parkimi në këtë qytet gjatë muajve korrik-gusht 2019 (muaj këto me një fluks mjaftë të lartë turistësh) nuk është menaxhuar, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, si dhe mungesë në eficientë e procesit.

**Rekomandim nr. 19.1:** Në raste të tjera në vijim të ndryshimit të mënyrës së menaxhimit të parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, Bashkia të marrë të gjitha masat e nevojshme që gjatë këtij ndryshimi, parkimi në qytet mos të mbetet i pa menaxhuar, me qëllim shmangien e të ardhurave të munguara dhe të problematikave me trafikun.

**Në vijimësi.**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se janë mbajtur akt rakordime ditore dhe mujore (sipas raportimeve ditore) midis biletave të parkimit të dhëna nga arka, mandat pagesave sipas numrave serial. Për vitin 2020 janë arkëtuar në shumën 11,335,900 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 14,999,350 lekë. Nuk ka ndryshuar mënyra e menaxhimit të parkimit në qytetin e Korçës.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 20:** Nga auditimi u konstatuan se në vitin 2019 janë hequr 78<sup>46</sup> vende parkimi me pagesë nga 362 (ose 21%) vende parkimi me pagesë që ishin të tilla që prej vitit 2015. Për heqjen e tyre Bashkia Korçë nuk disponon analiza të kryera, apo dokumente justifikuese që vërtetojnë se kjo vendimmarrje është kosto-eficientë. Nga vizitat në terren u konstatuan 4 vend parkime të hequra nga parkimi me pagesë në një nga zonat më të frekuentuara të qytetit (me një numër të lartë biznesesh private), si dhe lehtësisht të aksesueshme nga punonjësit aktual të parkimit me pagesë, përjashtimi i të cilave nga pagesa, në gjykimin e grupit të auditimit mbetet i paargumentuar. Zvogëlimi i vend parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, në mungesë të një vizioni të qartë të Bashkisë për të ardhmen e menaxhimit të parkimeve në qytet, dhe mos mbështetja e kësaj vendimmarrje me analiza të detajuara për secilin segment të hequr nga parkimi me pagesë, bëhet burim i vendimmarrjeve arbitrare dhe përmban riskun e mungesës së efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet në administrimin e parkimeve në këtë qytet.

**Rekomandim nr. 20.1:** Këshilli Bashkiak i Bashkisë Korçë, në çdo rast vendimmarrje për shtimin apo pakësimin e vend parkimeve me pagesë në qytet, të mbështetet në analiza dhe studime të detajuara, me qëllim për të siguruar përmbushjen e vizionit të Bashkisë, për parkimet dhe vizionit të përgjithshëm të Bashkisë për zhvillimin e qytetit.

**Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se deri në datën e mbajtjes së këtij akt verifikimi nuk ka vendimmarrje tjetër për shtimin apo pakësimin e vend parkimeve me pagesë në qytet, pasi nuk ka ndryshuar mënyra e menaxhimit të parkimit në qytetin e Korçës.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Rekomandim nr. 20.2:** Titullari i Bashkisë të ndërmarrë masat e nevojshme për të analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha vend parkimet e përjashtuara nga pagesa, me Vendimin nr. 111, datë 03.08.2019 të Këshillit Bashkiak. Në përfundim të analizës, në rast identifikimi të segmenteve të përshtatshme dhe rentabël, t'i propozojë Këshillit Bashkiak rikthimin e tyre në poste parkimi me pagesë.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga auditimi rezultoi se deri në datën e mbajtjes së këtij akt verifikimi nuk ka raste të identifikimi të segmenteve të përshtatshme dhe rentabël. Nga diskutimet e kryera rezultoi se për realizimin e këtij rekomandimi kjo Bashki nuk ka ekspertë të fushës, nuk ka fonde në dispozicion për kontraktim ekspertësh.

Statusi i rekomandimit: **Pa zbatuar.**

**Për pyetjen: A është monitoruar në mënyrë të vazhduar performanca e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës dhe Korçës?**

**Gjetje nr. 21:** Përsa i takon bazës ligjore, VKM me nr. 686 datë 22.11.2017 nuk ka asnjë nen apo pikë ku të përcaktohen normat e projektimit të cilat duhet të mbahen në konsideratë lidhur me ndërtimet sikundër ishin në VKM nr. 671 datë 29 korrik 2015 (shfuqizuar).

**Rekomandim nr. 21.1:** Bashkia Tiranë të marrë masat e nevojshme me qëllim që të kryejë përmirësimin e bazës ligjore, e ku konkretisht Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr.686, datë 22.11.2017, të përditësohet duke mbajtur në konsideratë normat e projektimit mbi ndërtimet e reja.

---

<sup>46</sup> Të cilat kryesisht janë vend parkime pa pagesë, ndërsa pjesa tjetër e tyre janë pjesë e rrugës si rezultat i ristrukturimit të rrugëve

### **Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Sa i përket Rekomandimit 21.1 ne lidhje me përmirësimin e VKM nr. 686 date 22.011.2017, megjithëse nuk është kompetence e Bashkisë Tiranë nisma mbi ndryshimet e VKM, do të mbahet në konsiderate të jepen sugjerimet sipas normave të projektimit për ndërtimet e reja, në momentin kur do të merret nisma për ndryshimin e kësaj VKM-je.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 22:** Në pikën 11 të Nenit 57 të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) përcaktohet se: *“Sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private është 25m<sup>2</sup>”*. Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit u konstatua se, në praktikë nuk gjen zbatim pika 11 e nenit 57 Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).

**Rekomandim nr. 22.1:** Nga ana e Bashkisë Tiranë, të rishikohet sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private prej 25 m<sup>2</sup>, e parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, e cila është e pazbatueshme në praktikë.

### **Brenda marsit të vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucioni: Në lidhje me rekomandimin 22.1 sqarojmë se sipërfaqja minimale 25m<sup>2</sup> është bruto dhe bazohet në Planin e Përgjithshëm Vendor. Gjithashtu në nëntor të vitit 2021 Bashkia e Tiranës ka ndërmarre Nismën për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të përsheptuar. Kjo procedure është ende në fazë miratimi dhe rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit është reflektuar.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe në **proces** zbatimi.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Gjetje nr. 23:** Në pikën 12 të Nenit 57 të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) **citohet se:** *“Në njësi strukturore të kategorisë banim, për çdo zhvillim të parashikohet të paktën 1 vend parkimi për çdo njësi banimi..”* Në një qytet si Tirana, ku janë afërsisht 250.000 makina për 852.692 banorë (shifrat për Tiranën referuar vitit 2020), disponohet një total prej 24.000 vende parkimi<sup>47</sup> (duke përfshirë automjetet industriale, autobusët, etj.). Praktikisht për një makinë ka më pak se një vend parkim.

-Përsa i përket parkimit për rezident, nga auditimi rezultojë se, numri i vendeve të parkimit për rezident është më i vogël se numri i rezidentëve të Tiranës (ku përlllogaritjet janë bërë vetëm për një makinë për familje dhe jo më tepër). Sa më sipër nuk mund të plotësohen nevojat për vende parkimi për të gjithë qytetarët e ndaj për këtë arsye nevojitet ndërmarrja e masave për ardhjen në ndihmë të tyre.

**Rekomandimi nr. 23.1:** Tirana Parking në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të analizojë numrin e parkimeve aktuale në qytetin e Tiranës krahasuar me kërkesën për parkim, dhe në vijim të ndërmarrë masa për të siguruar ofertën e nevojshme për vende parkimi në qytet.

### **Brenda marsit të vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Tirana Parking që prej vitit 2021, në kuadër të ushtrimit të detyrave të saj funksionale dhe eksperiencës së administrimit të

<sup>47</sup> Referuar të dhënave të vëna në dispozicion grupit të auditimit nga Tirana Parking.



parkimit publik në Tiranë, ka finalizuar përgjatë vitit 2022 studimin me objekt “Master Plan dhe Plan Biznesi për Parkimet në qytetin e Tiranës” objektivat e të cilit janë:

1. Të mbulojë në mënyrë efëçente territorin e Bashkisë Tiranë me hapësira publike për parkim.
  2. Të lehtësojë aksesin në parkim për qytetarët sa i përket parkimit afatshkurtër, parkimit afatgjatë dhe parkimit për rezidentët.
  3. Të modernizojë administrimin e parkimit publik përmes futjes së teknologjive të reja.
- Ky studim ka përmbushur edhe rekomandimin e mësipërm, të cilin ia kemi vënë në dispozicion Bashkisë Tiranë me shkresën me nr.prot 1245 date 17/07/2022.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**.

**Gjetje nr. 24:** Nga vizitat në terren të kryera në qytetin e Tiranës nga grupi i auditimit u konstatuan të shumta rastet ku edhe ato pak vende që disponohen për rezident, shfrytëzoheshin prej bareve apo bizneseve të ndryshme të zonës. Monitorimi aktual i vendeve të parkimit për rezidentët nuk ka siguruar shfrytëzimin e këtyre vend parkimeve nga banorët e zonës, duke mos realizuar qëllimin e krijimit të tyre.

**Rekomandimi nr. 24.1:** Policia Bashkiake në Bashkinë Tiranë, të intensifikojë kontrollet në zonat e parkimeve për rezidentet, për të siguruar shmangien e parkimit në këto zona të automjeteve pa pullën e rezidentit të zonës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigje e institucionit: Policia Bashkiake në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2021 ka rritur monitorimin dhe kontrollet e inspektimit në zonat e parkimeve për rezident dy herë me shume sesa gjate 6 mujorit të parë. Për të shmangur sa më shumë abuzimet nga mjetet pa pullën e rezidentit të zonës, inspektimet në terren nga një herë në ditë tani janë dy herë.

Gjatë fazës së programit të auditimit nuk u arrit të siguroheshin evidenca mbi sa më sipër. Rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **I pa zbatuar**.

**Gjetje nr. 25:** Lidhur me monitorimin e projekteve për parkimet të parashikuara në Strategjinë e Bashkisë, është operuar në kundërshtim me nenet 8, 22 dhe 24 të Ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk është monitoruar zbatimi i tyre dhe nuk janë hartuar dhe miratuar raportet e monitorimit. Mungesa e monitorimit të projekteve të lidhura me parkimet, të parashikuara në Strategjinë e Bashkisë Tiranë, nuk ka siguruar identifikimin e problematikave të evidentuara nga grupi i auditimit, si mungesa e strukturave përgjegjëse për secilin aktivitet të parashikuar në strategji gjë që ka shkaktuar moszbatimin e një prej 5 projekteve).

**Rekomandim nr. 25.1:** Titullari i Bashkisë Tiranë të ndërmarrë masat e nevojshme me qëllim monitorimin e Strategjisë së Bashkisë Tiranë dhe veçanërisht projektit të parkimeve, duke hartuar dhe miratuar raportet periodike dhe monitoruar zbatimin e tyre. Në vijim, raportet e monitorimit të publikohen në faqet respektive web.

**Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Bashkia e Tiranës me drejtoritë përkatëse kryen edhe publikimin e indikatorëve mbi bazën e raportimeve në faqen e transparencës dhe të open data për t'i bërë ato publike dhe për të monitoruar punën e realizimit të projekteve dhe të të gjithë indikatorëve të institucioneve të varësisë. Tirana Parking aktualisht raporton në mënyrë periodike në Drejtorinë e Buxhetit për çdo projekt të realizuar. Në të njëjtën kohë, në frekuenca të ndryshme kohore raporton me indikatorët e performancës sipas të gjithë indikatorëve të përcaktuar në Planin Strategjik.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Pjesërisht i zbatuar**.

**Gjetje nr. 26:** Në pikën d, të Vendimit nr. 48 datë 11.11.2015 përcaktohet se Tirana Parking ka për detyrë funksionale: *“Të konstatojë dhe të vendos gjoha për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimin përtej orarit të caktuar dhe mos pagesën e tarifës së parkimit”*. Nga ana tjetër, në shkronjën c, të pikës 1, të nenit 12, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr. 9808 datë datë 24.09.2007 *“1. Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore të përcaktuara nga ky Kod i takon: c) Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998” përcaktohet se: policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7..”* Pra, nga sa më sipër rezulton se ka mbivendosje kompetencash mes Policisë Bashkiake dhe Agjencisë Tirana Parking sa i takon vendosjes së masave mbi shkeljet administrative të parkimit në rrugë.

**Rekomandim nr. 26.1:** Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë Tirana Parking të rishikojnë bazën ligjore për të shmangur mbivendosjen e kompetencave mes Policisë Bashkiake dhe Agjencisë Tirana Parking, përsa i takon vendosjes së masave mbi shkeljet administrative të parkimit në rrugë. Si dhe të ushtrohet kujdes i veçantë në mënyrë që të mos ketë mbivendosje dhe penalizime më shumë se një herë për të njëjtën shkelje.

**Brenda marsit të vitit 2022**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përgjigja e institucionit: Për të mos patur mbivendosje mes ATP dhe PB, po përgatitet një proces trajnimi/certifikimi i strukturave të Tirana Parking, i parashikuar në studim projektin përfundimtar *“Master plan dhe master plan biznesi për parkimet në qytetin e Tiranës”*.

Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

Statusi i rekomandimit: **Pjesërisht i zbatuar**.

**Gjetje nr. 27:** Dokumenti më i lartë strategjik i Bashkisë Korçë nuk është monitoruar nga ana Bashkisë Korçë, që prej miratimit të tij në janar të vitit 2017. Pra, për periudhën objekt auditimi 2018-2020, zbatimi i projekteve test të parashikuara në Strategjinë për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë lidhur me përmirësimin e situatës së parkimeve në këtë bashki, nuk është monitoruar. Si rezultat që, prej më shumë se 4 vitesh që është në funksion Strategjia për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë zbatimi i saj nuk është monitoruar asnjëherë, nuk është bërë identifikimi i mangësive ose hapësirave për përmirësim në politikat e Bashkisë Korçë për zhvillimin e qytetit dhe veçanërisht atyre për zhvillimin e parkimeve, duke cenuar efektivitetin e kësaj strategjie dhe arritjen e objektivave.

**Rekomandim nr. 27.1:** Bashkia Korçë, të marrë masat për të monitoruar në mënyrë periodike zbatimin e Strategjisë 15 vjeçare Për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë, ku monitorimi të kryhet nëpërmjet indikatorëve të performancës të parashikuar në këtë strategji. Periodiciteti i monitorimit të deklarohet në Strategjinë për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë (me përditësimin e saj), por jo më pak se një herë në vit. Në përfundim të monitorimeve, të hartohen raportet e monitorimit, të cilat duhet të miratohen dhe publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë.

**Brenda 6-mujorit të parë 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Bashkia Korçë, nuk ka marrë masat për të monitoruar në mënyrë periodike zbatimin e Strategjisë 15 vjeçare Për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë

Korçë, pasi nga institucioni nuk është hartuar ende strategjia për rrjedhoje monitorimi për indikatorët e performancës të parashikuar në këtë strategji nuk mund të kryhet.

Statusi i rekomandimit: **Pa zbatuar.**

**Gjetje nr. 28:** Në të dy vizitat e kryera nga grupi i auditimit në zonat e parkimit me pagesë në qytetin e Korçës u konstatuan bileta, orari për të cilat drejtuesit e automjeteve kishin paguar, kishte mbaruar, dhe me përfundimin e orarit, nuk ishin lëshuar bileta të tjera nga punonjësit e parkimit me pagesë.

-Nga vizitat në terren u konstatua një rast në të cilin, një subjekt privat kishte bllokuar një post parkimi me pagesë, duke vendosur tabelën e biznesit të tij në këtë vend parkim dhe rrjedhimisht duke mos lejuar përdorimin e tij nga qytetarët të cilët nuk do të frekuentonin këtë biznes.

-Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e sinjalistikës dhe rregullave në zonat e parkimit për rezidentët, u konstatuan automjete të parkuara, të pa pajisur me kartën e rezidentit.

Sistemi aktual i monitorimit dhe kontrollit në Bashkinë Korçë është i dobët dhe nuk ka siguruar identifikimin e problematikave kryesore dhe ndërmarrjen në kohë të masave për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor dhe rregullator për parkimet, duke cenuar kështu efektivitetin, eficiencën dhe ekonomicitetin e menaxhimit të parkimeve në këtë qytet.

**Rekomandim nr. 28.1:** Titullari i Bashkisë Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të identifikuar dhe analizuar mangësitë në sistemin aktual të monitorimit dhe kontrollit të parkimit me pagesë në qytetin e Korçës, dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar efektivitetin e tij.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga Kryetari i Bashkisë ka dalë Urdhri nr.959, datë 18.11.2021 (9893 prot., datë 18.11.2021), “Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin dhe analizën e mangësive në sistemin aktual të monitorimit dhe kontrollit të parkimit me pagesë në qytetin e Korçës”. Nuk ka ndonjë dokument të hartuar nga ky grup pune për të identifikuar dhe analizuar faktorët të cilët kanë shkaktuar moszbatimin e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë.

Statusi i rekomandimit: **Në proces.**

**Rekomandim nr. 28.2:** Policia Bashkiake në Bashkinë Korçë, të intensifikojë kontrollet në zonat e parkimeve me pagesë dhe zonat e parkimit për rezidentët, me qëllim shmangien e shfrytëzimit të posteve të parkimit me pagesë nga subjektet private dhe shmangien e parkimit në zonat e rezidentëve, të automjeteve pa pullën e rezidentit të zonës.

**Brenda dhjetorit 2021 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Policia Bashkiake në Bashkinë Korçë, ka intensifikuar kontrollet në zonat e parkimeve me pagesë dhe zonat e parkimit për rezidentët, me qëllim shmangien e shfrytëzimit të posteve të parkimit me pagesë nga subjektet private dhe shmangien e parkimit në zonat e rezidentëve, të automjeteve pa pullën e rezidentit të zonës. Nga ana e Policisë Bashkiake janë urdhrat e shërbimit ditor mbi detyrat e shërbimit në Bashki, në treg, detyrat e shërbimit patrullë këmbësore, detyrat e shërbimit patrullë me mjet.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

## **VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Për sa më sipër **ri kërkohet** që Bashkia e Tiranës dhe Bashkia e Korçës, të marrin masa të zbatueshme të gjitha rekomandimet që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht apo në proces, si më poshtë:

## MASA ORGANIZATIVE:

**Për pyetjen: A është kryer planifikimi i duhur për menaxhimin e parkimeve publike në qytetet e Tiranës dhe Korçës?**

**Gjetje nr. 1:** Nga dokumenti strategjik, si dhe nga komunikimet me Agjencinë Tirana Parking dhe Drejtoritë e tjera si ajo e Transportit dhe Urbanistikës nuk del qartazi se cila është përgjegjësia specifike e strukturave për aktivitetet e lidhura me objektivin specifik “Rritja e kapacitetit të parkimit në Qytetin e Tiranës”. Nga analizimi i planeve vjetore të Tirana Parking rezulton se, janë realizuar 4 nga 5 aktivitete gjithsej të parashikuara në planin strategjik për t’u zhvilluar për periudhën 2018-2021. Konkretisht në planin vjetor 2018 të Tirana Parking është realizuar 1 aktivitet dhe në planet vjetor 2019 dhe 2020 të kësaj agjencie rezulton se janë reflektuar 3 aktivitete. Për aktivitetin i cili nuk është realizuar gjatë periudhës nën auditimi nuk është e qartë se cila është struktura përgjegjëse.

**Rekomandim nr. 1.1:** Bashkia Tiranë të marrë masat e nevojshme që për të gjitha aktivitetet e parashikuara për përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Tiranës, në dokumentin strategjik të saj (SZHQBT), të përcaktohen në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse dhe detyrat specifike të secilës prej tyre.

### Menjëherë

**Gjetje nr. 2:** Në nenin 32, të kreut VI, të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, përcaktohet se: “1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik të zhvillimit të njësisë përkatëse, i cili miratohet me vendim nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në Udhëzimin nr. 21, datë. 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të Gjitha Niveleve”, përcaktohet se me qëllim planifikimin strategjik dhe kontrollin e tij në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, menaxhimi duhet të kryet sipas objektivave SMART<sup>48</sup>. Në këtë pikë paraqitet edhe formati se çfarë duhet të përmbajë një strategji institucionale. Nga krahasimi i parashikimeve të këtij Udhëzimi me planifikimin strategjik të menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

-Nga analizimi i SZHQ 2018-2022 rezulton se, megjithëse është një dokument strategjik, pra afatgjatë, asnjë nga aktivitetet strategjike të vendosura nuk ka të përcaktuar afatin për t’u arritur në vitet në të cilat shtrihet strategjia. Pra nuk është e qartë se ç’pjesë e aktivitetit do të kryhet në çdo vit të strategjisë.

-Në Planin strategjik nuk parashikohen përlllogaritje dhe shpërndarje efektive e burimeve financiare si dhe nuk është parashikuar kostimi vit pas viti për aktivitetet.

-Për asnjërin prej aktiviteteve dhe treguesve të performancës të parashikuar në SZHQ 2018-2022 nuk janë përcaktuar rezultate të synuar apo targeta për t’u arritur vit pas viti.

-Nga analiza e të dhënave përgjatë procesit të auditimit, nuk del i qartë informacioni mbi mënyrën e matjes së treguesve të performancës të përcaktuar në planin strategjik

-Nga analizimi i përgjigjeve të marra prej DPSJP përgjatë pyetësorëve zyrtar, nuk rezulton të jenë kryer analiza apo vlerësime lidhur me rëndësinë dhe përshtshmërinë e indikatorëve të performancës (të përcaktuar për të monitoruar progresin në drejtim të objektivit specifik të strategjisë lidhur me parkimet), apo mundësinë praktike për t’i matur këto tregues.

Mos parashikimi i burimit të financimit, dhe mungesa e kostimit të aktiviteteve dhe projekteve vit pas viti në të cilin shtrihet strategjia, përmban riskun e moszbatimit të tyre, çka do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivit strategjik. Mos përcaktimi i rezultateve të synuar për asnjë prej aktiviteteve/treguesve të performancës të parashikuar në Strategji nuk

<sup>48</sup> S – Specifik (objektiva të qartë, përgjegjësi të qarta); M – I matshëm (mund të matet me shifra); A – I arritshëm (masat e marra ndikojnë në arritjen e qëllimit); R – Relevant (objektivi nuk është as shumë i lartë dhe as shumë i ulët); T – Me afat (ka një kohë të caktuar për arritjen e objektivit).

krijon mundësinë për të krahasuar (*benchmarking*) rezultatet e arritura nga implementimi i aktiviteteve me rezultatet e pritshme, çka e bën të pamundur vlerësimin nëse aktivitetet janë përmbushur apo jo. Mungesa e rezultateve të pritshme të matshme (targetave), pas implementimit të 5 projekteve të parashikuara për rritjen e kapacitetit të parkimit në qytetin e Tiranës, nuk siguron rezultate solide mbi të cilat mund të mbështetet monitorimi i vazhdueshëm dhe ndërmarrja në kohë e masave korrigjuese nga strukturat drejtuese.

**Rekomandim nr. 2.1:** Bashkia Tiranë, mbështetur në analiza, të ndërmarrë masat e nevojshme që për çdo aktivitet të parashikuar për përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Tiranës, në dokumentin strategjik të saj të përfshihen sa më poshtë:

- kosto e çdo aktiviteti për çdo vit që shtrihet strategjia, si dhe burimi i financimit;
- afati kohorë për përmbushjen e secilit aktivitet;
- indikatorët SMART të performancës;
- targetat e synuara për të arritur për çdo vit.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 4:** Nga auditimi u konstatua se, tarifat e shërbimit të parkimit me pagesë dhe përcaktimin e përqindjes variabël të tarifës së parashikuar (-/+ 30% të tarifës bazë), nuk janë mbështetur në studime apo analiza. Në mungesë të analizave argumentuese, tarifa e vendosur përbën riskun që nuk pasqyron vlerën reale për shërbimin e marrë nga qytetarët.

**Rekomandim nr. 4.1:** Bashkia Tiranë të marrë masat për rishikimin e vlerës së tarifave të parkimit me pagesë duke i mbështetur ato në analiza dhe studime, të cilat argumentojnë vendosjen e tyre në përputhje me shërbimin e ofruar.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 5:** Në dokumentin Strategjik të Bashkisë Korçë miratuar në vitin 2017, nuk është mirë përcaktuar vizioni i Bashkisë lidhur me perspektivën e parkimeve në këtë qytet si dhe nuk janë parashikuar aktivitete të mirëfillta për menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, si pjesë e objektivave dhe dimensioneve strategjike, në funksion të arritjes së vizionit holistik të bashkisë. Në këtë dokument janë parashikuar vetëm 3 projekte test, të cilat priteshin të kishin ndikim në përmirësimin e situatës së parkimeve në qytet. Gjatë periudhës nën auditim 2018-2020, nuk rezulton të jenë kryer investime me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të parkimeve në këtë qytet. Shpenzimet e bashkisë për zhvillimin e parkimeve në qytet për periudhën shtator 2019- dhjetor 2020 (më përpara është administruar nga koncesionari) kanë qenë për paga/sigurime të punonjësve dhe blerjen e biletave të parkimit.

**Rekomandim nr. 5.1:** Bashkia Korçë, të ndërmarrin masat e nevojshme për të zbatuar një qasje strategjike në menaxhimin e parkimeve, duke mirë përcaktuar në dokumentin strategjik të bashkisë vizionin dhe aktivitete e nevojshme për menaxhimin e parkimeve, në funksion të arritjes së vizionit holistik për zhvillimin e qytetit të Korçës.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 6:** Nga auditimi rezultuan mangësi në planifikimin strategjik<sup>49</sup> të menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës, paraqitur si më poshtë:

-Për aktivitet e parkimit të parashikuara në të tre projektet test, të cilat priteshin të promovonin mënyrën e re të drejtimeve prioritete që do të merrte bashkia Korçë, nuk është parashikuar periudha kohore në të cilën ato do të shtriheshin.

-Për dy nga tre projektet test në të cilat janë parashikuar veprime lidhur me parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë nuk është bërë kostimi total i secilit projekt. Për të tre projektet, nuk është bërë as kostimi për çdo vit në të cilin do të shtrihej çdo projekt.

-Për të tre projektet test, në dokumentin strategjik të bashkisë, nuk është parashikuar apo deklaruar burimi i financimit të tyre.

<sup>49</sup> Kriteret ligjore për planifikimin strategjik janë paraqitur në gjetjen 2, të nën pyetjes audituese nr. 1.1

-Për dy nga tre projektet test në të cilat ishin parashikuar veprime lidhur me menaxhimin e parkimeve në Bashkinë e Korçës, nuk janë ndarë qartësi detyrat e strukturave përgjegjëse në bashki për realizimin e këtyre projekte, apo të aktorëve të tjerë të përfshirë në to.

-Për të tre projektet test në të cilat janë parashikuar veprime lidhur me parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, nuk janë parashikuar indikatorët e performancës si dhe nuk janë parashikuar rezultatet e pritura për çdo vit në të cilin do të shtrihet secili prej projekteve.

Projektet test, të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, prej zbatimit të të cilëve pritej të përmirësoj situatën e parkimeve në këtë qytet, vuajnë nga një planifikim i dobët, pasi nuk është parashikuar periudha kohe në të cilën secili prej tyre do të shtrihet, nuk është bërë kostimi total dhe rrjedhimisht as ai i përvitshëm, nuk janë përcaktuar qartë detyrat e secilit aktor të përfshirë në proces, nuk është parashikuar burimi i financimit, indikatorët e performancës dhe targetat e pritshëm. Kjo situatë nuk siguron zbatimin efektiv, eficient dhe ekonomik të këtyre projekteve, duke rrisur arritjen e rezultateve të pritshëm në përmirësimin e situatës së parkimeve në qytetin e Korçës nga implementimi i tyre.

**Rekomandim nr. 6.1:** Bashkia Korçë mbështetur në analiza dhe studime, të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar që për çdo aktivitet dhe projekt të parashikuar për menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, të përmbushen sa më poshtë dhe në vijim të përfshihen në dokumentin strategjik të Bashkisë:

- periudha e realizimit të projekteve e përcaktuar saktë;
- projektet të jenë të kostuar për çdo vit në të cilin do të shtrihen, dhe në total;
- financimi i tyre të jetë i siguruar dhe të deklarohet burimi i financimit;
- ndarje e qartë të detyrave të secilit prej aktorëve të përfshirë në proces;
- indikatorët e performancës, targetat e pritshëm vit pas viti dhe rezultati në fund të jenë të përcaktuar qartë.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 7:** Referuar praktikave të mira, mbledhja, përdorimi dhe analizimi i të dhënave lidhur me parkimet i ofron bërësit të politikave informacion objektiv, i cili ndihmon në vendimmarrje efektive.<sup>50</sup> Nga auditimi rezultoi se, Bashkia Korçë nuk ka një sistem të dhënash, si. p.sh. për të identifikuar kërkesën aktuale për vende parkimi, etj. si dhe nuk ka kryer analiza dhe studime që do të ndihmonin për të identifikuar hendeqet në politikat aktuale të menaxhimit të parkimeve, me qëllim vendimmarrjen efektive. Studimi i fundit i kryer mbi situatën e parkimit në qytetin e Korçës është ai i vitit 2013, pra i rreth 8 viteve më parë, dhe pas ndryshimit të mënyrës së menaxhimit në vitin 2019 (kalimi nga koncesionari në menaxhim të Bashkisë Korçë) nuk janë ndërmarrë analiza apo studime të tjera për të identifikuar mangësitë në politikat aktuale, me qëllimin zhvillimin e politikave të qëndrueshme të parkimit për këtë qytet. Pra, çmimet e vendosura për parkimet me pagesë apo projektin e rezidentëve, zonat e parkimit me pagesë ose zonat ku do të aplikohet projekti i rezidentëve, metodat e pagesës së përzgjedhur dhe vetë sistemi i vendosur për menaxhimin e parkimeve, pas marrjes në administrim nga Bashkia Korçë nuk janë mbështetur në studime apo analiza. Për shkak se studimet dhe analizat e fundit të kryera, mbi situatën e parkimit në qytetin e Korçës, janë të rreth 8 viteve më parë, dhe nuk janë përditësuar në vijim, nuk ofrohet siguri nëse vendimet e marra vitet e fundit, si p.sh., ndryshimi i mënyrës së menaxhimit, reduktimi i vend parkimeve, tarifat e parkimit me pagesë, modaliteti i pagesës, projekti i rezidentëve, tarifat e këtij të fundit, janë efektive, eficientë dhe ekonomike në drejtim të përmirësimit të situatës së parkimeve në qytet.

**Rekomandim nr. 7.1:** Bashkia Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të ngritur dhe përditësuar një sistem të dhënash dhe/apo të kryejë analiza dhe studime lidhur me situatën e

<sup>50</sup> Parkimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i lëvizshmërisë urbane”, Eltis, qershor 2019, fq. 15.

parkimeve në qytet, me qëllim identifikimin e hendeqeve në politikat aktuale dhe ndërmarrjen e vendimeve efektive.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nr. 8:** Nga konsultimi i praktikave të mira (trajtuar gjerësisht në raportin e këtij auditimi), rezulton se opinioni i publikut ka një rëndësi të veçantë në menaxhimin efektiv të parkimeve në qytet. Referuar përgjigjeve zyrtare të Bashkisë Korçë, si dhe përgjigjeve të intervistave të zhvilluara nga grupi i auditimit me biznese dhe qytetarë në zonat e parkimit me pagesë dhe zonat e parkimit për rezidentët në qytetin e Korçës rezulton se, nuk është marrë mendimi i publikut dhe nuk janë konsultuar me publikun.

**Rekomandim nr. 8.1:** Bashkia Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme që të konsultojnë opinionin e publikut në mënyrë periodike lidhur me problematikat dhe përmirësimin e mëtejshëm të parkimi në qytetin e Korçës, dhe ta dokumentojnë atë, veçanërisht përpara ndërmarrjes së vendimeve në lidhje me menaxhimin e parkimeve në qytetin e Korçës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nr. 10:** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, strukturë me një rol kyç në zhvillimin e politikave të parkimit në Bashkinë Korçë, ka funksionuar me një staf të reduktuar për të gjithë periudhën nën auditim. Nga 15 punonjës të nevojshëm referuar strukturës së miratuar, kjo drejtori ka funksionuar me 10 punonjës. Më hollësisht, në Sektorin e Planifikimit mungojnë përgjegjësi i sektorit dhe një specialist projektues, në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit mungojnë dy specialiste, ndërsa në Sektorin e Administrimit e Regjistrimit të Territorit mungon një specialist. Ndryshimet në strukturën e menaxhimit të parkimeve që ndodhën në shtator të vitit 2019<sup>51</sup>, nuk ishte të reflektuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Korçë deri në mars të vitit 2021.

**Rekomandim nr. 10.1:** Titullari i Bashkisë Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të plotësuar Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit me stafin e nevojshëm sipas strukturës së miratuar, me qëllim shmangien e riskut të cenimit të cilësisë së punës që kjo drejtori kryen.

#### **Menjëherë**

**Për pyetjen: A kanë rezultuar aktivitetet e ndërmarra nga strukturat përgjegjëse, në arritjen e rezultateve të pritshme nga menaxhimi i parkingjeve?**

**9. Gjetje nr. 14:** Nga analizimi i pagesës së parkimit nëpërmjet sms u konstatuan problematikat e mëposhtme:

-V. A. ka ndërprerë sinjalin në 7 raste për vitin 2019 dhe 6 raste në vitin 2020 (pa përfshirë bllokimin për efekt pandemie), ku të përkthyer në orë pa pagesë në vit janë 23.5 orë për 2019 dhe 41.5 orë për vitin 2020. T. ka ndërprerë sinjalin në 10 raste për vitin 2019 dhe 11 raste në vitin 2020, ku të përkthyer në orë pa pagesë në vit janë 30 orë për 2019 dhe 56 orë për vitin 2020. Nisur nga fakti që në një orë mesatarisht parkojnë 390 makina në zonën A, 187 makina në zonën B dhe 28 makina në zonën C, sipas tarifimit respektiv të zonave, 100 lekë/ora, 40 lekë/ora dhe 20 lekë/ora, kjo sjell të ardhura të munguara potenciale për vitin 2019 në 3,938,560 lekë dhe për vitin 2020 në 4,376,740 lekë nga të cilat respektivisht sipas kompanive rezultojnë të ardhura të munguara nga T. 4.511.460 lekë dhe nga V. 3.803.840 lekë. Vlerave respektive duhet ti zbritet përqindja e komisionit që kompanitë telefonike mbajnë konkretisht 15%, dhe kjo vlerë shkon konkretisht për vitin 2019 shkon në 3,347,776 lekë dhe për vitin 2020 në 3,720,229 lekë, ose 7,068,005 lekë për periudhën nën auditim. Nga ana e V. A. nuk ka asnjë plan rezervë apo specifikim konkret lidhur me ndërprerjet e sinjalit, apo se si do të kryhet menaxhimi në rast të përballjes me këtë ndërprerje apo bllokime të tjera

<sup>51</sup> Me kalimin e menaxhimit të parkimeve nga koncesionari tek Bashkia Korçë në këtë të fundit u ngrit një strukturë për administrimin e parkimeve në qytetin e Korçës.

të sinjalit, sikundër nuk ka asnjë klauzolë në marrëveshje se kush do të përgjigjet për këto të ardhura të munguara duke qenë se nga ana ekonomike kjo ndërprerje normalisht përkthehet në mos arkëtim të parave për këtë shërbim të ndërprerë.

-Nga auditimi u konstatua se nuk ka një analizë kosto/përfitim të kryer nga ana e Bashkisë Tiranë përsa i takon tarifës së komisionit të vendosur nga ana e V.A. dhe as të operatorëve të tjerë.

Nga ana e Bashkisë Tiranë dhe operatoreve telefonik si palë në marrëveshjet e lidhura për pagesën e parkimit nëpërmjet sms, nuk është parashikuar asnjë klauzolë mbi menaxhimin e situatës në rast të ndërprerjes së sinjalit telefonik, sikundër nuk specifikohet cili do të përgjigjet për këto të ardhura të munguara në buxhetin e BT, duke shkaktuar që peshën e të ardhurave të munguara ta mbajë buxheti i shtetit. Vendosja e tarifës që operatorët ekonomik do të përfitojnë për ofrimin e shërbimit të pagimit të parkimeve nëpërmjet telefonit, në mungesë të analizave mbështetëse, nuk siguron *vlerën për para* për shërbimin e marrë nga Tirana Parking.

**Rekomandim nr. 14.1:** Gjatë rinovimit të kontratave me operatorët telefonikë për pagesat me sms të parkimeve, Bashkia Tiranë të mbajë në konsideratë rastet e ndërprerjes së sinjalit dhe tarifën e komisionit, për të negociuar kushtet më të përshtatshme për adresimin e këtyre çështjeve, me qëllim shmangien e të ardhurave të munguara në buxhetin e Bashkisë dhe shpenzimet pa efektivitet.

#### **Me rinovimin e kontratave me operatorët telefonikë**

**Gjetje nr. 16:** Nga auditimi rezultoi se, nga 3 projekte test të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë mbi menaxhimin e parkimeve në këtë qytet, 2 dy prej tyre nuk janë realizuar, për shkak të mungesës së fondeve. Mangësitë e konstatuara në planifikimin<sup>52</sup> e projekteve test për parkimet në dokumentin strategjik të Bashkisë Korçë, kanë shkaktuar që 67% e tyre të mos realizohen, si rezultat i mungesës së fondeve, duke cenuar efektivitetin e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Korçës.

**Rekomandim nr. 16.1:** Titullari i Bashkisë Korçë, të ndërmarrë masat e nevojshme për të identifikuar dhe analizuar faktorët të cilët kanë shkaktuar moszbatimin e projekteve të parashikuara në dokumentin strategjik të Bashkisë. Në përfundim të analizës të ndërmarr masat e nevojshme me qëllim mos përsëritjen e kësaj shtate në të ardhmen.

#### **Menjëherë**

**Gjetje nr. 17:** Nga auditimi rezultoi se aktualisht në Bashkinë Korçë aplikohet vetëm një mënyrë pagese për parkimin, ajo nëpërmjet lëshimit të biletës dhe mbledhjes së pagesës nga punonjësi i bashkisë. Në zonat e parkimit me pagesë nuk u gjetën parkimetra, si një mënyrë alternative për të kryer pagesën. Referuar intervistave që grupi i auditimit realizoi me qytetarët dhe bizneset rezultoi se, mungesave e metodave alternative të pagesës së parkimit është një ndër problematikat kryesore të lidhura me parkimet në këtë qytet. Kryerja e pagesës me *cash* (para në dorë) përmban risk të lartë për abuzime si nga ana e qytetarit edhe nga punonjësi i Bashkisë.

**Rekomandim nr. 17.1:** Bashkia Korçë të kryej studimet dhe analizat e nevojshme për të identifikuar alternativat më të mira të pagesës së parkimit në këtë qytet. Në vijim, të ndërmarrë masat e nevojshme për aplikimin e tyre.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nr. 19:** Me përfundimin e kontratës së koncensionarit në qershor të vitit 2019, gjatë muajve me fluksin më të lartë të turistëve në qytetin e Korçës, korrik-gusht 2019, parkimet me pagesë në këtë qytet nuk janë menaxhuar. Bashkia ka nisur të administrojë parkimet me

<sup>52</sup> Për më shumë, konsultoni gjetjet në nën pyetjen audituese 1.1.1.1.



pagesë në muajin shtator 2019. Si rezultat se, Bashkia Korçë nuk ka ndërmarr në kohë masat e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e administrimit të parkimeve me përfundimin e kontratës me koncesionarin, parkimi në këtë qytet gjatë muajve korrik-gusht 2019 (muaj këto me një fluks mjaftë të lartë turistësh) nuk është menaxhuar, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, si dhe mungesë në eficientësi e procesit.

**Rekomandim nr. 19.1:** Në raste të tjera në vijim të ndryshimit të mënyrës së menaxhimit të parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, Bashkia të marrë të gjitha masat e nevojshme që gjatë këtij ndryshimi, parkimi në qytet mos te mbetet i pa menaxhuar, me qëllim shmangien e të ardhurave të munguara dhe të problematikave me trafikun.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nr. 20:** Nga auditimi u konstatuan se në vitin 2019 janë hequr 78<sup>53</sup> vende parkimi me pagesë nga 362 (ose 21%) vende parkimi me pagesë që ishin të tilla që prej vitit 2015. Për heqjen e tyre Bashkia Korçë nuk disponon analiza të kryera, apo dokumente justifikuese që vërtetojnë se kjo vendimmarrje është kosto-eficientë. Nga vizitat në terren u konstatuan 4 vend parkime të hequra nga parkimi me pagesë në një nga zonat më të frekuentuara të qytetit (me një numër të lartë biznesesh private), si dhe lehtësisht të aksesueshme nga punonjësit aktual të parkimit me pagesë, përjashtimi i të cilave nga pagesa, në gjykimin e grupit të auditimit mbetet i paargumentuar. Zvogëlimi i vend parkimeve me pagesë në qytetin e Korçës, në mungesë të një vizioni të qartë të Bashkisë për të ardhmen e menaxhimit të parkimeve në qytet, dhe mos mbështetja e kësaj vendimmarrje me analiza të detajuara për secilin segment të hequr nga parkimi me pagesë, bëhet burim i vendimmarrjeve arbitrare dhe përmban riskun e mungesës së efektivitet, eficientësisë dhe ekonomicitet në administrimin e parkimeve në këtë qytet.

**Rekomandim nr. 20.1:** Këshilli Bashkiak i Bashkisë Korçë, në çdo rast vendimmarrje për shtimin apo pakësimin e vend parkimeve me pagesë në qytet, të mbështetet në analiza dhe studime të detajuara, me qëllim për të siguruar përmbushjen e vizionit të Bashkisë, për parkimet dhe vizionit të përgjithshëm të Bashkisë për zhvillimin e qytetit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Rekomandim nr. 20.2:** Titullari i Bashkisë të ndërmarrë masat e nevojshme për të analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha vend parkimet e përjashtuara nga pagesa, me Vendimin nr. 111, datë 03.08.2019 të Këshillit Bashkiak. Në përfundim të analizës, në rast identifikimi të segmenteve të përshtatshme dhe rentabël, t'i propozojë Këshillit Bashkiak rikthimin e tyre në poste parkimi me pagesë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Për pyetjen: A është monitoruar në mënyrë të vazhduar performanca e menaxhimit të parkimeve në qytetin e Tiranës dhe Korçës?**

**Gjetje nr. 21:** Përsa i takon bazës ligjore, VKM me nr. 686 datë 22.11.2017 nuk ka asnjë nen apo pikë ku të përcaktohen normat e projektimit të cilat duhet të mbahen në konsideratë lidhur me ndërtimet sikundër ishin në VKM nr. 671 datë 29 korrik 2015 (shfuqizuar).

**Rekomandim nr. 21.1:** Bashkia Tiranë të marrë masat e nevojshme me qëllim që të kryejë përmirësimin e bazës ligjore, e ku konkretisht Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr.686, datë 22.11.2017, të përditësohet duke mbajtur në konsideratë normat e projektimit mbi ndërtimet e reja.

#### **Menjëherë**

---

<sup>53</sup> Të cilat kryesisht janë vend parkime pa pagesë, ndërsa pjesa tjetër e tyre janë pjesë e rrugës si rezultat i ristrukturimit të rrugëve

**Gjetje nr. 22:** Në pikën 11 të Nenit 57 të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) përcaktohet se: *“Sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private është 25m<sup>2</sup>”*. Nga vizitat në terren të kryera nga grupi i auditimit u konstatua se, në praktikë nuk gjen zbatim pika 11 e nenit 57 Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë miratuar me Vendimin Nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).

**Rekomandim nr. 22.1:** Nga ana e Bashkisë Tiranë, të rishikohet sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private prej 25 m<sup>2</sup>, e parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, e cila është e pazbatueshme në praktikë.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 24:** Nga vizitat në terren të kryera në qytetin e Tiranës nga grupi i auditimit u konstatuan të shumta rastet ku edhe ato pak vende që disponohen për rezident, shfrytëzoheshin prej bareve apo bizneseve të ndryshme të zonës. Monitorimi aktual i vendeve të parkimit për rezidentët nuk ka siguruar shfrytëzimin e këtyre vend parkimeve nga banorët e zonës, duke mos realizuar qëllimin e krijimit të tyre.

**Rekomandimi nr. 24.1:** Policia Bashkiake në Bashkinë Tiranë, të intensifikojë kontrollet në zonat e parkimeve për rezidentet, për të siguruar shmangien e parkimit në këto zona të automjeteve pa pullën e rezidentit të zonës.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**Gjetje nr. 25:** Lidhur me monitorimin e projekteve për parkimet të parashikuara në Strategjinë e Bashkisë, është operuar në kundërshtim me nenet 8, 22 dhe 24 të Ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk është monitoruar zbatimi i tyre dhe nuk janë hartuar dhe miratuar raportet e monitorimit. Mungesa e monitorimit të projekteve të lidhura me parkimet, të parashikuara në Strategjinë e Bashkisë Tiranë, nuk ka siguruar identifikimin e problematikave të evidentuara nga grupi i auditimit, si mungesa e strukturave përgjegjëse për secilin aktivitet të parashikuar në strategji gjë që ka shkaktuar moszbatimin e një prej 5 projekteve).

**Rekomandim nr. 25.1:** Titullari i Bashkisë Tiranë të ndërmarrë masat e nevojshme me qëllim monitorimin e Strategjisë së Bashkisë Tiranë dhe veçanërisht projektit të parkimeve, duke hartuar dhe miratuar raportet periodike dhe monitoruar zbatimin e tyre. Në vijim, raportet e monitorimit të publikohen në faqet respektive web.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 26:** Në pikën d, të Vendimit nr. 48 datë 11.11.2015 përcaktohet se Tirana Parking ka për detyrë funksionale: *“Të konstatojë dhe të vendos gjoha për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimin përtej orarit të caktuar dhe mos pagesën e tarifës së parkimit”*. Nga ana tjetër, në shkronjën c, të pikës 1, të nenit 12, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr. 9808 datë 24.09.2007 *“1. Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore të përcaktuara nga ky Kod i takon: c) Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998” përcaktohet se: policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7..”* Pra, nga sa më sipër rezulton se ka mbivendosje kompetencash mes Policisë Bashkiake dhe Agjencisë Tirana Parking sa i takon vendosjes së masave mbi shkeljet administrative të parkimit në rrugë.

**Rekomandim nr. 26.1:** Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë Tirana Parking të rishikojnë bazën ligjore për të shmangur mbivendosjen e kompetencave mes Policisë Bashkiake dhe Agjencisë Tirana Parking, për sa i takon vendosjes së masave mbi shkeljet administrative të parkimit në rrugë. Si dhe të ushtrohet kujdes i veçantë në mënyrë që të mos ketë mbivendosje dhe penalizime më shumë se një herë për të njëjtën shkelje.

#### Menjëherë

**Gjetje nr. 27:** Dokumenti më i lartë strategjik i Bashkisë Korçë nuk është monitoruar nga ana Bashkisë Korçë, që prej miratimit të tij në janar të vitit 2017. Pra, për periudhën objekt auditimi 2018-2020, zbatimi i projekteve test të parashikuara në Strategjinë për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë lidhur me përmirësimin e situatës së parkimeve në këtë bashki, nuk është monitoruar. Si rezultat që, prej më shumë se 4 vitesh që është në funksion Strategjia për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë zbatimi i saj nuk është monitoruar asnjëherë, nuk është bërë identifikimi i mangësive ose hapësirave për përmirësim në politikat e Bashkisë Korçë për zhvillimin e qytetit dhe veçanërisht atyre për zhvillimin e parkimeve, duke cenuar efektivitetin e kësaj strategjie dhe arritjen e objektivave.

**Rekomandim nr. 27.1:** Bashkia Korçë, të marrë masat për të monitoruar në mënyrë periodike zbatimin e Strategjisë 15 vjeçare Për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë, ku monitorimi të kryhet nëpërmjet indikatorëve të performancës të parashikuar në këtë strategji. Periodiciteti i monitorimit të deklarohet në Strategjinë për Zhvillimin e Territorit të Bashkisë Korçë (me përditësimin e saj), por jo më pak se një herë në vit. Në përfundim të monitorimeve, të hartohen raportet e monitorimit, të cilat duhet të miratohen dhe publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje nr. 28:** Në të dy vizitat e kryera nga grupi i auditimit në zonat e parkimit me pagesë në qytetin e Korçës u konstatuan bileta, orari për të cilat drejtuesit e automjeteve kishin paguar, kishte mbaruar, dhe me përfundimin e orarit, nuk ishin lëshuar bileta të tjera nga punonjësit e parkimit me pagesë.

-Nga vizitat në terren u konstatua një rast në të cilin, një subjekt privat kishte bllokuar një post parkimi me pagesë, duke vendosur tabelën e biznesit të tij në këtë vend parkim dhe rrjedhimisht duke mos lejuar përdorimin e tij nga qytetarët të cilët nuk do të frekuentonin këtë biznes.

-Nga kontrolli i kryer mbi zbatimin e sinjalistikës dhe rregullave në zonat e parkimit për rezidentët, u konstatuan automjete të parkuara, të pa pajisur me kartën e rezidentit.

Sistemi aktual i monitorimit dhe kontrollit në Bashkinë Korçë është i dobët dhe nuk ka siguruar identifikimin e problematikave kryesore dhe ndërmarrjen në kohë të masave për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor dhe rregullator për parkimet, duke cenuar kështu efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e menaxhimit të parkimeve në këtë qytet.

**Rekomandim nr. 28.1:** Titullari i Bashkisë Korçë të ndërmarrë masat e nevojshme për të identifikuar dhe analizuar mangësitë në sistemin aktual të monitorimit dhe kontrollit të parkimit me pagesë në qytetin e Korçës, dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar efektivitetin e tij.

### **Menjëherë**

## 8- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “ZHVILLIMI I TURIZMIT MALOR”

### I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në subjektet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Bashkitë Tiranë, Vlorë e Elbasan, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Menaxhimi i mbetjeve plastike”, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë:

- Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 199/11, datë 17.09.2021;

- Në Federatën Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor, me shkresën nr. 199/10, datë 17.09.2021.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

**a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

**b.** Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;

**c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti nuk ka *miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH* dhe nuk e ka dërguar këtë plan në KLSH, kjo në mospërputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja “j”.

**Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti nuk ka *miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH* dhe nuk e ka dërguar këtë plan në KLSH, kjo në mospërputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja “j”.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti nuk ka respektuar afatin *prej 6 muajsh*, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor:** Nga auditimi u konstatua se, subjekti nuk ka respektuar afatin **prej 6 muajsh**, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky në kundërshtim me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

KLSH ka dërguar:

- në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën **nr. 199/11, datë 17.09.2021;**
- në Federatën Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor, me shkresën **nr.199/10, datë 17.09.2021.**

Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Menaxhimi i mbetjeve plastike”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 29 “Masa organizative” dhe 4 “Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi” për zbatim. Nga 33 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 32 masa ose pranimi është në masën 97 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	29	29	-
2	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	4	3	1

## II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së", lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- A. G., Përgjegjës Grupi;
- S. R., Anëtar.
- E. K., Anëtar.

### II.1. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e performancës me temë “Zhvillimi i Turizmit Malor”.

### II.2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### II.4. Konkluzioni:

Në dy subjekte të audituar, përkatësisht **MTM** dhe **FSHALTM**, nuk janë marrë masa për respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të

Shtetit", për të informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Po kështu nga këto subjekte, nuk janë marrë masa edhe për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e audituara Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

- Nga 33 masa e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 32 masa ose në masën 97 %. Nga 32 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 masa ose 21 % tyre, janë në proces zbatimi 7 masa ose 21 % dhe janë pa zbatuar 18 masa ose 55 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	29	7	-	7	15
2	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	3	-	-	-	3

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	29	
2	Pa pranuar	-	0%
3	Pranuar	29	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	7	24,5%
2	Pa zbatuar	15	51%
3	Në proces	7	24,5%

Në numër dhe në % statusi i propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	4	
2	Pa pranuar	1	25%
3	Pranuar	3	75%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	-	-
2	Pa zbatuar	3	75%
3	Në proces	-	-

#### II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 21 % dhe së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi i tyre shkon në nivelin 42 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara mbeten nivel relativisht të lartë në masën 55 %.

#### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**Për pyetjen: 1.1.1. A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?**

### **PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT:**

#### **Gjetje:**

Nga auditimi mbi plotësimin e bazës ligjore, rezultoi se:

Nuk ka dalë Urdhri i Ministrit për miratimin e rregullores së funksionimit të saj, në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”;

Nuk është miratuar Urdhri i Ministrit të Turizmit për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjeve të Projekteve në Turizëm;

Nuk ka dalë urdhri për përcaktimin e kritereve të funksionimit të zyrave e informuese turistike;

Kuadri rregullator për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor ende nuk është i plotë<sup>54</sup>;

Nuk janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore, me qëllim realizimin e objektivit strategjik “Mbështetje për zhvillimin e modelit të menaxhimit të destinacioneve”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit marrë masa që të hartojë dhe miratojë aktet nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Këshillimor i Sipërmarrjeve të Turistike, Zyrave të informacionit turistik, Organizatave për menaxhimin e destinacionit turistik, zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimin e burimeve njerëzore të angazhuara në sektor e turizmit.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MTM nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 66, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e përbërjes nominale të Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit”, ka ngritur KKSP, duke zhvilluar më pas, më datë 15.02.2022 mbledhjen e parë të këtij komiteti.

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

#### **Gjetje:**

Referuar pikës 4 të nenit 5 të VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifatat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar, rezultoi se, nga Ministri i Turizmit nuk është miratuar Udhëzimi për manualin shpjegues të kritereve të klasifikimit të strukturave akomoduese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa që të hartojë dhe miratojë Udhëzimin për manualin shpjegues të kritereve të klasifikimit të strukturave akomoduese.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Është hartuar draft-manuali shpjegues i kritereve të klasifikimit të strukturave akomoduese.

**Statusi i rekomandimit: Në proces**

#### **Gjetje:**

Referuar SKT 2019-2023, si dhe Progres-Raportit për vitin 2020, të BE-së, ku thuhet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave (pasqyrohet si problematikë,

---

<sup>54</sup> Udhëzimet e përbashkëta me MASR për akreditimin e kurseve të trajnimit profesional për sektorin e turizmit.

transmetimi i tyre në EUROSTAT) në përputhje me acquis-në e BE-së, ende nga MTM nuk është përgatitur sistemi i ri i statistikave në fushën e turizmit, hartimi i metodologjisë në përputhje me Rregulloren e BE-së për statistikën në fushën e turizmit (informacion i besueshëm dhe i krahasueshëm, të dhëna mbi turizmin e brendshëm, burimet e të dhënave dhe mënyrat për sigurimin e informacionit)<sup>55</sup>. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe miratojë metodologjinë për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, si dhe të vendosë në funksion sistemin e ri të statistikave, në përputhje me acquis-në e BE-së, por edhe me praktikën e mira të vendeve të rajonit<sup>56</sup>.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Aktet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, përkatësisht: Urdhri i Ministrit nr. 8707, datë 31.10.2016 “Për miratimin e formatit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturat akomoduese; Direktiva e BE-së në lidhje me mbledhjen e të dhënave statistikore është transpozuar në ligjin nr 93/2015 “Për turizmin”; Urdhri i Ministrit nr. 267 datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar, në bashkëpunim me INSTAT, janë akte që nuk i përkasin veprimtarisë institucionale të ndërmarrë në kuadër të rekomandimeve të lëna për projektin auditues “Zhvillimi i Turizmit Malor”.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Gjetje:**

Referuar pikës 8.11 të VKM nr.298, datë 20.04.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, ende nuk është hartuar dhe miratuar Udhëzimi i përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, të lidhura me subjektet “person i stimuluar”, si dhe prej një periudhe më tepër se 10-vjeçare, këto të ardhura nuk janë mbledhur. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, si dhe Agjencinë Kombëtare të Turizmit, të ngrejë një grup pune të përbashkët, me qëllim vlerësimin vlerës së detyrimit që kanë subjektet “person i stimuluar” për sipërfaqet e marra me qera, si dhe të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e tyre (duke lidhur marrëveshje të pagesës me këste/shërbimit të përmbartimit). Pas kësaj, MTM në bashkëpunim me MFE të hartojë dhe miratojë udhëzimin për mënyrën e arkëtimit, me qëllim që në të ardhmen, mos të krijohen detyrime të prapambetura ndaj buxhetit të shtetit.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Agjencia Kombëtare e Turizmit ka kërkuar përmes 3 shkresave<sup>57</sup> ngritjen e një grupi të përbashkët pune. Në zbatim të rekomandimeve të lëna për AKT në “Raportin Përfundimtar të Auditimit të Përfundimit të Performancës “Zhvillimi i Turizmit Malor”,

<sup>55</sup> Regulation (Eu) no 692/2011 of the European Parliament and of the Council of 6 July 2011 Concerning European Statistics on Tourism - Rregullore e Bashkimit Evropian nr.692/2011, në lidhje me Statistikat Evropiane mbi Turizmin;

<sup>56</sup>Statistikat e turizmit në Kroaci, treguesit që përdoren nga Kroacia dhe burimet e informacionit, [https://www.dzs.hr/Hrv\\_Eng/publication/2017/SI-1594.pdf](https://www.dzs.hr/Hrv_Eng/publication/2017/SI-1594.pdf).

<sup>57</sup> Shkresa nr.752.prot date 13.12.2019 me lëndë “Kërkesë”, shkresa nr.438.prot datë 22.12.2020 me lëndë “Kërkesë për ngritjen e një grupi të përbashkët pune për subjektet me titull “Person i Stimuluar” dhe shkresa nr.120.prot date 03.03.2021 me lëndë “Kërkesë për interpretim ligji”



AKT ka dërguar në MTM shkresën nr. 537 prot., datë 19.10.2021 me lëndë “Kërkesë për ngritje grupi të përbashkët pune për subjektet me titull “Person i Stimular”.<sup>58</sup>

### **Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

Për pyetjen 1.1.2: A janë realizuar objektivat strategjikë për turizmin malor nga MTM dhe AKT?

### **PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT:**

#### **Gjetje:**

Referuar SKT 2019-2023, Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar 2030 (PINS 2030) dhe PKST Alpe 2030 nga MTM dhe AKT:

- nuk janë identifikuar, shënjuar dhe dixhitalizuar 5 shtigje të reja rajonale dhe 2 shtigje ndërkuftare të ecjes;
- nuk janë ndërtuar tre shtigjet rajonale dhe dy shtigje kombëtare të çiklizmit;
- nuk ka studim dhe masa të marra për identifikimin, vlerësimin, ndërtimin e pistave të skijimit, me qëllim zhvillimin e këtij sporti, si dhe sporteve të tjera në zonat malore;
- ende nuk janë identifikuar vendndodhjet për zhvillimin e alpinizmit, si dhe për realizimin e këtij objekti, nuk është parashikuar asnjë institucion/organizatë publike/private, ku në këtë rast përmendim Federatën Shqiptare të Alpinizmit, e cila mund të ftohej për bashkëpunim;
- nuk janë marrë masa për përfshirjen e Shqipërisë në guidat ndërkombëtare të ecjes dhe çiklizmit;
- nuk ka një studim për vlerësimin e kërkesës së tregut mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit (dixhitalizimi i shtigjeve malore) dhe alternativat që mund të adaptohen në turizmin vendas;
- nuk është ofruar mbështetje për veprimtaritë sportive që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, ngjitjet alpinistike), si dhe aktualisht nuk disponohet një inventar të zonave, në të cilat ushtrohet/mund të ushtrohet sporti i hedhjes me parashutë apo çiklizmi malor;
- nuk është hartuar dhe miratuar Strategjia Kombëtare e Marketingut për sektorin e turizmit;
- nuk janë ngritur qendrat e vizitorëve për çdo Park Kombëtar, konkretisht nuk janë ngritur në PK Mali i Tomorrit, Bredhi i Drenovës, Bredhi i Hotovës-Dangëlli, Valbonë, Lurë, Butrint, Zall Gjocaj, si dhe qendrat e vizitorëve në Prespë nuk janë funksionale;
- nuk është përgatitur plani i masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore;
- nuk disponohet informacion për zonat e thella malore, në të cilat nuk arrihet të mbulohet me shërbim të telefonisë celulare/internet, ku theksojmë se nga vizitat në terren në zona të ndryshme të Parkut Kombëtar të Llogarasë, Prespë, në zonën e Bogës, si dhe komunikimit të grupit të auditimit me Specialistët e Zonave të Mbrojtura Vlorë dhe Korçë, mungesa e mbulimit me shërbim të telefonisë celulare/internet, është një nga problemet kryesore, të humbjes së turistëve (kryesisht atyre të huaj) gjatë vizitave turistike në shtigje malore;
- nuk është marrë asnjë masë për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik, ose e thënë ndryshme shmangien e sezonalitetit;
- nuk është marrë masë, për të ngritur platformën online të bashkëpunimit, për shoqëruesit/udhërrëfyesit e udhëtimeve, me qëllim koordinimin, bashkëpunimin, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, gjatë shoqërimeve të grupeve të turistëve;
- nuk është përgatitur programi i trajnimit dhe nuk është marrë asnjë masë për trajnimin e burimeve njerëzore që janë të angazhuara në sektorin e turizmit;
- nuk është krijuar struktura menaxhuese për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare;
- nuk është ngritur portali shqiptar i turizmit “e-turizëm”, i lidhur me aplikacione që ofrojnë

<sup>58</sup> Shkresa nr.537.prot datë 19.10.2021 me lëndë “Kërkesë për ngritje grupi të përbashkët pune për subjektet me titull “Person i Stimular”

informacion mbi destinacionet e atraksionet turistike;

- nuk janë marrë masa për ngritjen e zyrave/pikave të informacionit turistik, si dhe nuk është hartuar dhe miratuar rregullorja për pikat e informacionit turistik, por theksojmë se AKT ka vënë në dispozicion të 27 Bashkive, 60 infopoint (tabela informacioni për destinacione turistike). Gjithashtu nga 60 tabelat informuese, të cilat janë bërë kalim kapital nga AKT drejt Bashkive, 21 prej tyre ose 35%, janë të dëmtuara/kanë humbur, pra nuk i shërbejnë qëllimit të tyre;

- nuk janë ngritur strukturat promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë;

- nuk ka një analizë/studim se sa është numri i strukturave akomoduese, që nuk janë të regjistruara/që operojnë në mënyrë informale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.2) faqe (26-32) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, për identifikimin, shënjimin dhe dixhitalizimin e 7 shtigjeve malore të ecjes dhe 4 shtigje të çiklizimit, si dhe përfshirjen e tyre në guidat ndërkombëtare të ecjes.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, MTM shprehet se: *“ky rekomandim është në përputhje me politikat që ndiqen pranë MTM në bashkëpunim me partnerët dhe donatorët”*, megjithatë, pavarësisht këtij fakti MTM nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë evidencë që dëshmon veprimtaritë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

#### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të bëjë një studim, me qëllim vlerësimin e mundësive dhe më pas ndërtimin e pistave të skijimit dhe të zonave të zhvillimit të alpinizmit.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, MTM shprehet se: *“Përveç dokumentave të planifikimit të miratuara (Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit për rajonin e Alpeve Shqiptare Strategjia Sektoriale, Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar (PINS Bregdeti), Planet e Detajuara të Zonave me Përparësi Zhvillimin e Turizmit) apo SKZHQT 2019-2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit përgjatë administrimit të kërkesës së një subjekti privat për zhvillimin e një Resorti Skish në Nikolicë të Korçës, është njohur me një studim fizibiliteti të përgatitur privatisht që merr në analizë situatën dhe perspektivën e këtij sektori në Shqipëri të vendosur në një kontekst rajonal”*. Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, MTM nuk ka vënë në dispozicion asnjë evidencë që dëshmon veprimtaritë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

#### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të sporteve malore, dhe rrjedhimisht tërheqjen e turistëve në këto zona, të ftojë çdo vit Federatën e Alpinizmit, Aeronautikës, dhe të sporteve të tjera që zhvillohen në zonat malore, me qëllim aplikimin në projektet që financohen prej saj, të cilat fokusohen në turizmin malor.

#### **Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MTM shprehet se: *“Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, përgjatë procesit të shpalljes së thirrjeve për Projekt Propozime, ka parashikuar tematika që adresojnë zhvillimin e turizmit malor duke mirëpritur propozimet që do të vijnë edhe nga Federata e Alpinizmit, Aeronautikës dhe të sporteve të tjera që zhvillohen në zonat malore”*. Megjithatë, pavarësisht qëndrimit të parashtruar, MTM nuk i ka bashkëlidhur këtij qëndrimi asnjë evidencë mbështetëse, me qëllim evidentimin e rolit të saj proaktiv për të ftuar

Federatën e Alpinizmit, Aeronautikës, dhe të sporteve të tjera që zhvillohen në zonat malore, me qëllim aplikimin në projektet që financohen prej saj, të cilat fokusohen në turizmin malor.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e planit të masave për sigurinë e turistëve në zonat malore, duke krijuar Skuadrat e Kërkim-Shpëtimit, si dhe përgatitjen e rregullore së ndërhyrjes në mënyrë që çdo pjesëtar i këtyre skuadrave të jetë i qartë për funksionin që do të kryejë, duke shmangur kështu kaosin dhe duke shkurtuar kohën e dhënies së ndihmës të aksidentuarit. Gjithashtu të vlerësohet mundësia, që këto skuadra të kenë edhe mjekë të urgjencës, të cilët të trajnohen për ndërhyrjen në terren dhe mjekimin e të aksidentuarit.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, MTM shprehet se: *“Në përfunim të manualit të shtigjeve do të vijohet me konkludimin e bashkëpunimit me MSH për planin e masave për sigurinë e turistëve në zonat malore”*.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, të përgatisë një program pune, me qëllim realizimin e objektivit strategjik “Regjistrimin e 80% të strukturave akomoduese të vogla familjare”, duke ndërmarrë masa konkrete, fushatë të koordinuar midis DPT-së dhe MTM-së, përcaktuar afate, si dhe burimet njerëzore dhe financiare që do të angazhohen.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, MTM shprehet se: *“Ju informojmë që, me ndryshimet ligjore të nevojshme që i klasifikojnë edhe strukturat jo tregtare si dhoma, apartamente si struktura akomoduese, do të ndërmeren të gjitha veprimet që sigurojnë regjistrimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi”*. Megjithatë, pavarësisht qëndrimit të pasqyruar, MTM nuk i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit asnjë evidencë që dëshmon rolin e saj proaktiv me qëllim bashkëpunimin me MFE për përgatitjen e një programi pune.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit të hartojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare të Marketingut, si dhe ngritjen e strukturave promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** AKT ka propozuar buxhetimin e zërit të investimit “Hartimi i Startegjisë Kombëtare të Marketingut dhe ngritjen e strukturave promovuese pranë përfaqësive diplomatike, në projekt fishat e PBA 2022 – 2024 si dhe PBA 2023 – 2025.

**Statusi i rekomandimit: Në proces**

**Për pyetjen 1.1.3: A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM-së, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?**

**PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT:**

**Gjetje:**

Nga auditimi i shpenzimeve të AKT për pjesëmarrjen në panaiet ndërkombëtare (transaksionet në valutë të huaj, shpenzimet e taksive dhe hotelit), përgjatë periudhës 2019-

2020, rezultoi se janë përdorur pa ekonomikitet rreth 38,150 euro ose 4,740,395 lekë. Theksojmë se kjo situatë është krijuar edhe për arsye se nga AKT nuk janë marrë masat për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të posaçme, për organizimin e punës dhe sigurimin e hoteleve me kosto sa më të ulët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrë masa që, të nxjerrë një urdhër të brendshëm, për përcaktimin e procedurave, për veprimet në valutë të huaj, sigurimin e hoteleve me kosto të ulët, si dhe reduktimin e shpenzimeve të panevojshme për transportin e stafit të saj, gjatë pjesëmarrjes në panairët dhe trajnimet jashtë vendit, me qëllim eliminimin e përdorimit pa ekonomikitet, efieciencë dhe efektivitet të fondeve buxhetore, alokuar për këto aktivitete.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** AKT ka hartuar Urdhrin nr. 100 me nr. 553.prot, datë 22.10.2021 “Për procedurat gjatë pjesëmarrjes në panairë dhe trajnime brënda dhe jashtë vendit”, ku përcaktohen të gjitha procedurat e nevojshme për pjesëmarrjet në panairë dhe trajnime të ndryshme duke specifikuar po ashtu dhe kostot dhe mënyrat e përzgjedhjes së akomodimeve dhe transporteve përkatëse.

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**Gjetje:**

Referuar nenit 30 të Ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit”, ende nuk janë përgatitur planet e zhvillimit dhe të veprimit për të gjitha zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, ku nga këto zona citojmë: Mali i Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshamë-Krastë; Vargmali i Moravës; Alpet; dhe Parku Kombëtar i Llogarasë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Turizmit, si dhe planeve të zhvillimit dhe veprimit për disa nga zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si ajo e Malit të Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshamë-Krastë Vargmalit të Moravës.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Për zonat Mali i Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafshamë-Krastë, Vargmali i Moravës nuk ka plan të hartuar.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Gjetje:**

Referuar nenit 4 të Ligjit të Turizmit, edhe pse kanë kaluar 5 vite nga miratimi i ligjit, ende nuk është publikuar dhe as nuk është finalizuar regjistri qendror i turizmit, i cili duhet të listojë në mënyrë të konsoliduar veprimtaritë në fushën e turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për publikimin e regjistrimit qendror të turizmit, si dhe përditësimin e informacionit të tij.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Regjistri qendror është i publikuar në faqen zyrtare të MTM-së

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**Gjetje:**

Ende nga MTM, nuk është miratuar Udhëzimi për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e

shtigjeve për turistët, megjithëse ka kaluar rreth 1 vit nga hartimi i tij, kjo në kuadër edhe të objektivave të SKT 2019-2023, mbi ndërtimin e shtigjeve rajonale dhe kombëtare si dhe Ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, në të cilin parashikohet gjenerimi i të ardhurave, nga turistët, që vizitojnë destinacione turistike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për miratimin e udhëzimit për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve për turistët.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Është miratuar udhëzuesi “Për standardizimin e rrjetit të shtigjeve dhe përdorimin e tyre”.

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**Gjetje:**

Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, ende nuk është hartuar dhe miratuar Plani Kombëtar i Turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Turizmit.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Deri tani është punuar me plane sektoriale të turizmit. MTM nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim hartimin dhe miratimin e një Plani Kombëtar Turizmi.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Gjetje:**

Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, MTM nuk ka një bazë të dhënash të ankesave të konsumatorëve ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për krijimin e databazës me informacionin për ankesat e konsumatorëve ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MTM, nëpërmjet përgjigjes së dërguar, i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit databasën me informacion për ankesat e konsumatorëve ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike.

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**Gjetje:**

Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit, nenit 7 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, rezultoi se:

- Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit nuk funksionojnë sipas referencave ligjore të bëra më sipër, pra ato nuk janë të pozicionuara pranë Qarqeve, në mënyrë që të shërbejnë si ndërmjetës të bashkëpunimit dhe koordinimit, midis MTM dhe institucioneve të pushtetit vendor dhe subjekteve private, për zhvillimin e turizmit;
- Nga Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit nuk janë kryer këshillime, të sipërmarrjeve turistike, me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, përgjatë periudhës 2019-2020;
- Nuk ka databasë për ankesat ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike, si dhe për burimet turistike;
- Nuk janë organizuar seminare, konferenca, takime të Degëve Territoriale me sipërmarrjet

turistike, për periudhën 2019-2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme që Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit, të pozicionohen me zyra pranë prefekturave, si dhe të sigurojë funksionimin e plotë të tyre për organizimin e seminareve, konferencave, këshillimeve të sipërmarrjeve turistike me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit turistik të ofruar.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Aktualisht, degët territoriale të shërbimit turistik vzhdojnë të jenë të organizuara si struktura, pjesë të aparatit të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Gjetje:**

Referuar nenit 18 dhe 45 të Ligjit të Turizmit, si dhe VKM nr.730, datë 20.20.2016, rezulton se:

-MTM nuk e ka bërë ende kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese megjithëse është shtytur 3 herë afati për aplikimin për kategorizim e tyre (hotel, bujtinë, motel, hostel, resort), dhe nga MTM në bashkëpunim me Inspektoratin që mbulon fushën e turizmit, nuk është marrë asnjë masë për ndëshkimin e atyre subjekteve që nuk janë të pajisur me certifikatën e kategorizimit;

-Portali elektronik për të lehtësuar këtë regjistrim dhe klasifikim nuk është ende aktiv. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për përsheptimin e procesit të kategorizimit dhe klasifikimit të strukturave akomoduese, si dhe për çdo subjekt që nuk është i pajisur me certifikatën e kategorizimit, të vendosë masa administrative ndaj tyre.

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për aktivizimin e portalit elektronik për procesin e regjistrimit dhe klasifikimit të strukturave akomoduese.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** AKB përmes inspektoriatit të turizmit, ka zhvilluar inspektime në terren për strukturat akomoduese. Në portalin e- Albania, është tashmë i aksesueshm regjistrimi/ aplikimi për kategorizimin e strukturave akomoduese.

**Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**Gjetje:**

Referuar nenit 53 dhe nenit 66 të Ligjit të Turizmit dhe Urdhrit nr.8707, datë 31.10.2016 “Për miratimin e formatit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturat akomoduese”, rezulton se përgjatë periudhës 2019-2020, agjencitë, operatorët dhe strukturat akomoduese nuk kanë raportuar çdo muaj statistikën e turizmit, pranë MTM-së, dhe nga kjo e fundit nuk është marrë asnjë masë<sup>59</sup>, për moszbatimin e ligjit nga subjektet private. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Inspektoratin përgjegjës për turizmin, të marrë masat e nevojshme për identifikimin e subjekteve që nuk kanë respektuar detyrimin ligjor për raportimin e të dhënave statistikore, si dhe paralajmërimin e tyre për respektimin e këtij detyrimi ligjor.

<sup>59</sup> Neni 71, pika 1, shkronja d, në Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

## **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e MTM, grupit të auditimit i është vënë në dispozicion tabela me masat e nevojshme, në zbatim të rekomandimit të sipërcituar.

### **Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

#### **Gjetje:**

Nga shqyrtimi i procedurës së pjesëmarrjes së Agjencisë Kombëtare të Turizmit në panaiet ndërkombëtare, përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-AKT nuk ka indikatorë/tregues të miratuar, mbi të cilët të bëjë vlerësimin e dobishmërisë/efektit në turizëm, të fondeve të shpenzuara për një panair;

-AKT nuk ka studim për monitorimin e tregut, mbi prirjet dhe preferencat e konsumatorëve, se çfarë ata kërkojnë nga turizmi në tërësi dhe ai malor në veçanti, me qëllim pjesëmarrjen në panair sipas tematikës së tyre, me qëllim rritjen e efektivitetit të promovimit, si dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit të turizmit malor;

-Për vendosjen e kriterëve fituese për panaiet e vitit 2019, që janë publikuar në portalin e-albania, nuk ka një analizë, mbi mënyrën e përcaktimit të tyre;

-Nuk ka një afat të përcaktuar, se sa ditë para zhvillimit të panairit, duhet të bëhet publikimi në portalin e-albania për konkurrim;

-Kriteri i përcaktuar për numrin e pjesëmarrësve (operator/agjenci turistike) në panair, nuk është respektuar, për shembull, për sipërfaqen 20-40 m<sup>2</sup> lejohet të marrin pjesë 5-8 subjekte, ndërkohë kanë marrë pjesë 10 subjekte, ose për sipërfaqen mbi 100 m<sup>2</sup> lejohet të marrin pjesë deri 23 subjekte, por që faktikisht kanë marrë pjesë 26 subjekte. Gjithashtu nuk ka një analizë, për mënyrën e përcaktimit të kriterëve mbi numrin e pjesëmarrësve, pasi kjo shoqërohet me rritje të kostos financiare të panairit, (pasi për një numër të lartë pjesëmarrësish, duhet një hapësirë më e madhe, më tepër tavolina, karrige, materiale promocionale, kostoja e regjistrimit);

-Në muajin Dhjetor të vitit **2019** janë kryer shpenzime në vlerën **3,507,438 lekë**, për llogari të 3 panaiereve që zhvillohen në vitin **2020** (Madrid, Holandë dhe Vjenë), ndërkohë që për vitin 2019, këta 3 panair nuk kanë qenë të miratuar nga Ministri përgjegjës për turizmin, si dhe nuk ka patur planifikim të fondeve buxhetore, pra nga AKT është bërë rishpërndarje e fondeve përtej datës 15 Nëntor, në mungesë të një arsytimi, si dhe pa marrë miratimin e Nëpunësit Autorizues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit<sup>60</sup>.

-Nuk administrohen njoftimet e subjekteve fituese, procesverbalet e shpalljes së fituesve;

-Nuk administrohen deklaratat e ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit, të anëtarëve të grupit, që ka bërë vlerësimi e aplikimeve deri në shpalljen e fituesve;<sup>61</sup>

-Nuk administrohen dokumentet e dorëzuara nga subjektet që kanë marrë pjesë (kryesisht mungojnë Vërtetimi nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit, Kopje të materialeve promocionale të prodhuara nga Operatori Turistik, Listëpagesat e 6 muajve të fundit të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar me Formularin E-SIG 025/a);

-Nga stafi i AKT-së, i cili ka marrë pjesë në panair, nuk është mbajtur procesverbali, mbi marrjen në dorëzim të stendës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara;

-Nga operatorët/agjencitë turistike që kanë marrë pjesë në panair, nuk është respektuar detyrimi i akt-marrëveshjes, për dorëzimin e raportit përmbledhës të panairit pranë AKT, raport, i cili ka informacion mbi numrin e kontratave që ka lidhur në panair, numrin e turistëve që kanë blerë paketë turistike nga ky panair, të ardhurat e realizuara, etj;

-Vlerësimi i aplikimeve nuk është bërë në grup, i cili të dali me një vendim përfundimtar, për çdo aplikim, por bëhet në mënyrë individuale;

<sup>60</sup> Udhëzim nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

<sup>61</sup> Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

-Kanë marrë pjesë subjekte të ndryshme të cilat nuk kanë qenë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit si operator/agjenci turistike. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandim:**

Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrë masa, që në rregulloren e procedurës së pjesëmarrjes në panair të përcaktojë afatin e publikimit të njoftimit, hartimin e deklaratave të ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit nga grupi i vlerësimit, si dhe në çdo rast, stafi pjesëmarrës në panair, të mbajë procesverbalin mbi marrjen në dorëzim të standës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, AKT shprehet se: “AKT ka miratuar rregulloren përmes urdhrit nr. 100, nëpërmjet shkresës me nr.553 prot., datë 22.10.2021 “Për procedurat gjatë pjesëmarrjes në panair dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit”.<sup>62</sup> AKT përmes shkresës nr. 594. Prot datë 19.11.2021 ka dërguar kërkesën, “Mbi pjesëmarrjen në panairt ndërkombëtare të turizmit për vitin 2022”, ku mos aprovimi i kësaj shkrese solli pezullimin e pjesëmarrjes së AKT në panairt e turizmit për vitin 2022.<sup>63</sup> Për shkak se AKT është në një moment ristrukturimi pjesëmarrja në panairt ndërkombëtare është pezulluar dhe procesi i mësipërm për plotësimin e kuadrit ligjor në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH do të reflektohet dhe plotësohet në vijimësi gjatë akteve të reja nënligjore të ristrukturimit të institucionit”.

#### **Statusi i rekomandimit: Në proces**

##### **Gjetje:**

Nga auditimi i veprimtarisë së Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT), Qarku Vlorë, Korçë dhe Shkodër, rezultoi se:

-Në Qarkun Vlorë, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit nuk ka funksionuar<sup>64</sup>;

-Për KRZHT Korçë, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, është ngritur si strukturë, por nuk ka funksionuar sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e Ministrit përgjegjës për turizmin nr.8502, datë 24.10.2016, sepse përfaqësuesit e Komitetit<sup>65</sup>, nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e mësipërm, konkretisht nuk ka përfaqësues të shoqatave që operojnë në sektorin e turizmit (të cilët janë burimi kryesor i identifikimit të problematikave të ndryshme që ka sektori i turizmit në Qarkun e Korçës), ose janë përcaktuar si anëtarë të këtij Komiteti, institucione të cilat nuk parashikohen në Udhëzimin e mësipërm;

-Për KRZHT Korçë, rezulton se nuk është bërë asnjë diskutim për turizmin malor, por kryesisht diskutimet janë të fokusuara në menaxhimin e sezonit turistik veror, sigurinë në plazhe;

-Nuk administrohet informacioni i raportuar në AKT, për çështje që lidhen me turizmin sipas territorit administrativ përkatës<sup>66</sup>. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandim:**

MTM në bashkëpunim me Prefektët e 12 Qarqeve në RSH, në rolin e Kryetarëve të Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit, të marrin masat e nevojshme për funksionimin e plotë të kësaj strukture dhe sipas qëllimit për të cilin janë krijuar.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

<sup>62</sup> Urdhër nr.100 me nr.553.prot datë 22.10.2021 “Për procedurat gjatë pjesëmarrjes në panairt dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit”

<sup>63</sup> Shkresë nr.594 prot., datë 19.11.2021 me lëndë: “Mbi pjesëmarrjen në panairt ndërkombëtare të turizmit për vitin 2022”, shkresë e domosdoshme për miratimin e panairëve ndërkombëtare për vitin 2022.

<sup>64</sup> Neni 20 i Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

<sup>65</sup> Rregullore për funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, nr.420 prot., datë 08.03.2019.

<sup>66</sup> Ligji nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, neni 20;



**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në përgjigjen e kthyer grupit të auditimit, MTM shprehet se: “Komitetet Rajonale të Zhvillimit të Turizmit funksionojnë në mënyrë të rregullt dhe thirren nga drejtuesit e Komitetit të cilët janë Prefektët e Qarkut respektiv”, duke mos vënë në dispozicion të grupit asnjë evidencë që dëshmon këtë qëndrim.

#### **Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

##### **Gjetje:**

Nga auditimi i veprimtarisë së AKT përgjatë periudhës 2019-2020, si dhe zbatimit të Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019 të Kryeministrit, “Për planin e masave për sezonin turistik, viti 2019”, rezultoi se:

-Referuar planeve vjetore të punës së AKT për periudhën 2019-2020, nga ky institucion, nuk janë përgatitur materiale audiovizive me qëllim promovimin e turizmit malor, si dhe nuk është kryer asnjë aktivitet që të ketë patur fokus zhvillimin e turizmit natyror/malor;

-Referuar VKM nr.298, datë 20.4.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, AKT përgjatë periudhës 2019-2020, nëpërmjet kanaleve sociale on-line ([www.albania.al](http://www.albania.al)), është fokusuar më tepër në promovimin e ecjes në natyrë, si një sport që zhvillohet kryesisht në zonat malore në Shqipëri, ndërkohë që për sporte të tjera si, hedhja me parashutë, çiklizmi malor, trekking, ngjitjet alpinistike dhe shëtitje me kuaj, nuk ka patur promovime;

-Nuk është përgatitur programi për vendosjen e sinjalistikës informuese dhe promovuese në destinacionet turistike më të frekuentuara;

-Nuk janë organizuar dhe mbështetur veprimtari argëtuese në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, shoqata apo subjekte private, me qëllim promovimin e turizmit;

-Nuk është marrë asnjë masë për pajisjen me materiale informuese të standave promovuese, që janë ngritur pranë pikave kufitare dhe në përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë vendit, me qëllim informimin e vizitorëve dhe zhvillimin e produkteve të ndryshme turistike (detar, **malor**, historik, kulturor, etj.);

-Nuk ka asnjë komunikim dhe bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore për hapjen dhe vënien në funksion të zyrave të informimit të turistëve;

-Databasa me destinacionet turistike që administrohet nga AKT, e cila në zbatim të Urdhrit nr.65, datë 01.04.2019, i është vënë në dispozicion Autoritetit të Rrugor Shqiptar, me qëllim që këto destinacione të pajisen me sinjalistikën informuese dhe promovuese, nuk është e plotë, për arsye se ka mangësi në numër destinacionesh, në krahasim me regjistrin e burimeve turistike që administrohet nga MTM, por edhe me ato që administrohen në qendrat e vizitorëve/zyrave të informacionit për turistët. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

##### **Rekomandim:**

Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrë masa për përgatitjen e materialeve audiovizive për turizmin malor, kryerjen e aktiviteteve në bashkëpunim me institucioneve të pushtetit vendor, si dhe promovimin e sporteve që zhvillohen në zonat malore (hedhja me parashutë, çiklizmi malor, trekking, ngjitjet alpinistike dhe shëtitje me kuaj) me qëllim promovimin e turizmit malor.

##### **Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** AKT në kuadër të një fushate promovionale ka prodhuar në fillim të viti 2022 një material audioviziv mbi hedhjet me parashutë. Gjithashtu, AKT ka pasur postime promovuese në rrjetet e saj sociale rreth turizmit malor si dhe sporteve malore siç janë: ngjitjet alpinistike, trekking dhe çiklizmit malor. Në vijim të punës së saj, AKT në projekt fishën e PBA 2022 – 2024 në vijim të promovimit të Turizmit/Branding ka kërkuar ndër të tjera dhe promovimin e paragliding, hiking, kamping, biking, trekking, kayaking. Ndërsa në projekt fishën e PBA 2023 – 2025 është kërkuar buxhetimi i një zëri studimi dhe krijim i shtigjeve për biçikleta.

## **Statusi i rekomandimit: I zbatuar**

**Për pyetjen 1.1.4: A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?**

### **PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT:**

#### **Gjetje:**

Nga auditimi mbi bashkëpunimin ndërinstitucional të MTM dhe AKT me institucionet të tjera publike/jo publike, me qëllim marrjen e masave për zhvillimin e turizmit malor, rezultoi se, përgjatë periudhës 2019-2020, ka munguar bashkëpunimi i MTM dhe AKT:

-Me federata/shoqata të ndryshme sportive, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarive sportive që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, etj.), me qëllim tërheqjen e turistëve në zonat malore;

-Me Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për përgatitjen e planit të masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore, krijimin e skuadrave të shpëtimit;

-Me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik;

-Me NJVQV-të, si dhe me aktorë të tjerë që kanë në administrim burime turistike, me qëllim përditësimin e regjistrit të burimeve turistike, ku theksojmë se në këtë regjistër, nuk ka asnjë shteg malor të pasqyruar, megjithëse është edhe objektiv strategjik ndërtimi, shënjimi dhe dixhitalizimi i tyre;

-Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për përgatitjen e një plan-veprimi, me qëllim përcaktimin e masave konkrete, afateve, strukturave përgjegjëse, për reduktimin e nivelit të informalitetit në sektorin e turizmit;

-Ministrinë e Infrastrukturës për krijimin e stacioneve të transportit turistik, i cili është detyrim ligjor dhe strategjik njëkohësisht. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.4) faqe (56-58) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrin masa që të fuqizojnë nivelin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke ndërmarrë dhe konkretizuar aktivitete të përbashkëta, që të kenë si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor.

#### **Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Agjencia Kombëtare e Turizmit në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit ka marrë pjesë së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në shumë aktivitete me bashkitë e vendit për çeljet e sezonit të turistik, tryeza të përbashkëta pune<sup>67</sup>, me partnerë dhe donatorë si GIZ për zhvillimin e shtigjeve për biçikletat malore (mounting biking).

## **Statusi i rekomandimit: I zbatuar.**

**Për pyetjen 1.2.1: A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur siç duhet ato?, si dhe për pyetjen 1.2.2: A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?**

### **PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT:**

<sup>67</sup> Ftesa të dërguara nga Bashkitë, foto të eventeve në bashkitë malore dhe pasqyrim mediatik në rrjetet sociale promovuese të AKT

## **Gjetje:**

Nga auditimi i veprimtarisë së Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor (FSHALT), për ndikimin e saj në zhvillimin e turizmit malor përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-Pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore të akorduara për FSHALT, në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht edhe në aktivitetin e kësaj Federate, pasi është ulur, numri i aktiviteteve vjetore, ku nga 6 aktivitete në vit, janë zhvilluar vetëm 2 aktivitete në dy vjet, numri i sportistëve që marrin pjesë në aktivitete, për shkak të pamundësisë së pagesës së trajtimit ushqimor, ku nga 100 sportist që merrnin pjesë në 1 aktivitet, për vitin 2019 dhe 2020 kanë marrë pjesë rreth 40 sportist në 1 aktivitet, nuk është marrë pjesë në asnjë aktivitet ndërkombëtar, si dhe nuk është krijuar mundësia në hapjen e shtigjeve malore apo të shtigjeve për kacaverje, etj.

-Midis FSHALT si dhe Ministrisë së Turizmit apo Agjencisë Kombëtare të Turizmit, nuk ka patur asnjë aktivitet të përbashkët, me qëllim promovimin e aktiviteteve sportive në zonat malore. Theksojmë se një aktivitet i tillë (Panairi i Turizmit Malor) ndërmjet FSHALT dhe AKT, për herë të fundit, është zhvilluar në muajin Dhjetor të vitit 2013, në të cilin kanë qenë të pranishëm rreth 400 persona si dhe media ndërkombëtare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.2.1 dhe 1.2.2) faqe (58-61 dhe 61-63) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

## **Rekomandim:**

Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin e mundësisë për krijimin e kurseve dhe trajnimin e personave që bëjnë guida alpinistike, që sot shihet si domosdoshmëri për të gjithë ata që shoqërojnë grupe turistësh në zonat malore.

## **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MTM në përgjigjen dërguar grupit të auditimit, shprehet se: *“Përgjigja lidhur me këtë rekomandim jepet nga Federata Shqiptare e Alpinizmit”*. Nga sa më sipër, referuar rekomandimit të lënë nga grupi i auditimit në përfundim të procesit auditues, MTM duhej të kishte luajtur një rol proaktiv me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional. Fakt ky i cili nuk evidentohet nga dokumentet e parashtruara grupit të auditimit.

## **Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

### **Të Tjera:**

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në pikën 11 të VKM nr. 115 datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, e ndryshuar, i kërkojmë Ministrinë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, fillimin e procedurës, për marrjen e masës disiplinore ndaj: 1. Z. A.K, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MTM-së, për mos vendosjen në dispozicion të grupit të auditimit, të dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr.3002 prot., datë 04.05.2021, trajtuar në faqen nr.17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MTM nuk ka parashtruar asnjë qëndrim institucional për rekomandimin e sipërcituar.

## **Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

## **PËR FEDERATËN SHQIPTARE TË ALPINIZMIT DHE TURIZMIT MALOR:**

### **Gjetje:**

Pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore të akorduara për FSHALT, në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht edhe në aktivitetin e kësaj Federate, pasi është ulur, numri i

aktiviteteve vjetore, ku nga 6 aktivitete në vit, janë zhvilluar vetëm 2 aktivitete në dy vjet, numri i sportistëve që marrin pjesë në aktivitete, për shkak të pamundësisë së pagesës së trajtimit ushqimor, ku nga 100 sportist që merrnin pjesë në 1 aktivitet, për vitin 2019 dhe 2020 kanë marrë pjesë rreth 40 sportist në 1 aktivitet, nuk është marrë pjesë në asnjë aktivitet ndërkombëtar, si dhe nuk është krijuar mundësia në hapjen e shtigjeve malore apo të shtigjeve për kacavarje, etj.

Midis FSHALT si dhe Ministrisë së Turizmit apo Agjencisë Kombëtare të Turizmit, nuk ka patur asnjë aktivitet të përbashkët, me qëllim promovimin e aktiviteteve sportive në zonat malore. Thëksojmë se një aktivitet i tillë (Panairi i Turizmit Malor) ndërmjet FSHALT dhe AKT, për herë të fundit, është zhvilluar në muajin Dhjetor të vitit 2013, në të cilin kanë qenë të pranishëm rreth 400 persona si dhe media ndërkombëtare. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.2.1 dhe 1.2.2) faqe (58-61 dhe 61-63) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandim:**

Rekomandimi: Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor të hartojë dhe miratojë një program strategjik 3-5 vjeçar, duke përcaktuar objektivat që synon të arrijë, kostot dhe afatet e realizimit të tyre, identifikuar fuqitë, shanset dhe kërcënimet që rrezikojnë realizimin e tyre, si dhe një vlerësim mbi kontributin që mund të ofrojë Sporti i Alpinizmit në zhvillimin e turizmit malor, dhe t'ia përcjelli MASR-së dhe MTM-së për njohje, duke u bërë më konkrete në aktivitetin e saj dhe rritjen e besueshmërisë së këtij sporti, që edhe ai mund të jetë pjesë e zhvillimit të turizmit malor.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

#### **Qëndrimi i audituesit të KLSH:**

Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor ka përpiluar planin strategjik 4 vjeçar, ku paraqitet zhvillimi i alpinizmit si sport por dhe si aktivitet rekreacional dhe rrjedhimisht turistik. Ky plan është në proces miratimi dhe ende nuk ka fuqi juridike.

Federata ka marrë pjesë aktivisht në konferenca mbi turizmin malor si dhe se fundmi është bërë pjesë e komitetit drejtues të shtegut "High Scardus Trail", një shteg crossboarder midis Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Kosovës, i cili do sjellë rritje të turizmit malor.

Federata në bashkëpunim me GIZ është duke konceptuar një projekt të përbashkët mbi identifikimin, klasifikimin, si dhe fizibilitetin e gjithë shtigjeve malore të zhvilluara në Shqipëri nga donatore të ndryshëm, me qëllim krijimin e një harte dixhitale të shtigjeve malore, dhe potencialin e zhvillimit të mëtejshëm të tyre.

#### **Statusi i rekomandimit: Në proces**

#### **Rekomandim:**

Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin e mundësisë për krijimin e kurseve dhe trajnimit të personave që bëjnë guida alpinistike, që sot shihet si domosdoshmëri për të gjithë ata që shoqërojnë grupe turistësh në zonat malore.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

#### **Qëndrimi i audituesit të KLSH:**

Pavarësisht faktit se në takimin e zhvilluar dhe përgjigjet e gjeneruara për grupin e auditimit, subjekti shprehet se: *"Federata ka filluar punën për shkollën e parë verore të alpinizmit dhe jemi në përgatitje edhe të shkollës dimërore të alpinizmit e cila do të mbahet në 2023. Në planin tone, kemi ngritjen e kapaciteteve lokale në trajnimin e guidave alpine dhe guidave turistike malore. Në pamundësi të përsheptimit të procesit, ne po fillojmë nga baza për të ngritur nivelin e alpinizmit në vend, me qëllim dhe krijimin e kapaciteteve njerëzore që me pas mund të bëhen guida malore. Mbetemi të hapur për bashkëpunim me MAS dhe MTM por jemi dhe në kontakt me donatore të tjerë që mund të financojnë trajnime trajnerësh."*, FSHALTM nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë dokumentacion ku bazon

qëndrimin institucional të saj. Për rrjedhojë veprimtaria institucionale e ndërmarrë me qëllim implementimin e rekomandimit të sipërcituar nuk është e evidentuar dhe përgjigja e subjektit konsiderohet jo e plotë dhe shteruese dhe e pa bazuar në evidenca.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandim:** Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor të marrë masat e nevojshme, për botimin çdo 6-mujor, të një reviste/broshure dhe publikimin e saj në median elektronike dhe atë të shkruar, për prezantuar.

**Brenda 6 muajve të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:**

Pavarësisht faktit se në takimin e zhvilluar dhe përgjigjet e gjeneruara për grupin e auditimit, subjekti shprehet se: “Federata ka disa vite që mbështet një festival ndërkombëtar për kacavarje i cili ka formatin e tij të marketingut ndërkombëtar. Për momentin website-t janë në proces mirëmbajtjeje për përditësimet e përmirësimet e nevojshme. Në bashkëpunim drejtpërdrejt me mediat ndërkombëtare për publikimin e artikujve të ndryshme mbi turizmin malor. Në të ardhmen po shohim dhe mundësinë e krijimit të një publikimi periodik dixhital në website mbi të rehat e turizmit malor në Shqipëri.”, FSHALTM nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë dokumentacion ku bazon qëndrimin institucional të saj. Për rrjedhojë veprimtaria institucionale e ndërmarrë me qëllim implementimin e rekomandimit të sipërcituar nuk është e evidentuar dhe përgjigja e subjektit konsiderohet jo e plotë dhe shteruese dhe e pa bazuar në evidenca.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

**Për pyetjen 1.1.1: A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?**

**PËR MINISTRINË E MJEDISIT DHE TURIZMIT:**

**Gjetje:**

Nga auditimi mbi plotësimin e bazës ligjore, rezultoi se:

Referuar nenit 71 të Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”, si dhe nenit 10 pika 2 të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, në ligjin e turizmit nuk ka asnjë masë administrative të parashikuar, për strukturat akomoduese, që nuk kanë certifikatën e kategorizimit;

Në Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin” dhe VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, duke marrë në konsideratë praktikën e miratimit të vendeve të rajonit, nuk parashikohen në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit edhe dhomat/apartamentet/vilat, të cilat ofrojnë akomodim për turistët. Mungesa e parashikimit në kuadrin ligjor, të këtyre ambienteve, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në gjykimin e grupit të auditimit, sjell rritjen e numrit të tyre e për pasojë mund të ndikojë negativisht në informalitetin e sektorit të turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për propozimin e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, me qëllim përfshirjen e dhomave/apartamenteve/vilave, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit të tyre, si

dhe të nenit 71, me qëllim përfshirjen e masës administrative, për strukturat akomoduese të cilat nuk kanë certifikatën e kategorizimit.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Pavarësisht faktit se me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 186, datë 27.5.2022 është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e legjislacionit sektorial të turizmit dhe hartimin e propozimeve për ndryshimin e tij, mbledhja e këtij grupi dhe propozimet e tij për ndryshime legjislative nuk pasqyrohen në asnjë nga dokumentet bashkëlidhur grupit të auditimit.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

#### **Gjetje:**

Nga shqyrtimi i VKM nr.162, datë 2.3.2016 “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, si dhe VKM nr.298, datë 20.04.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, rezultoi se përcaktimi ligjor i bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016, krijon mbivendosje të detyrave funksionale me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë 20.04.2016, pasi kompetenca e monitorimit të kontratave për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me subjektin investues, sipas VKM-së nr.162, i jepet MTM-së, ndërkohë sipas VKM-së nr.298, i jepet AKT-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, duke propozuar në Këshillin e Ministrave, ndryshimin e përcaktimit ligjor të bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016 me përcaktimin ligjor në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë 20.04.2016, ku të ndahet qartë (duke shmangur mbivendosjen) kompetenca e monitorimit të kontratave të lidhura me subjektin investues, për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MTM, në takimet e zhvilluara me grupin e auditimit gjatë fazës së terrenit, si dhe në qëndrimin zyrtar të përcjellë prej saj në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, shprehet se: *“Person i stimuluar, përcaktohet në nenin 1, të Ligji nr. 7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të dispozitave të Ligjit nr. 9734, datë 14.05.2007 “Për turizmin” dhe më pas me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, duke mbajtur në legjislacion parashikimet përkatëse për monitorimin e veprimtarisë dhe mbledhjen e të ardhurave nga marrëveshjet e qirasë me këto subjekte;*

*Sa më sipër, e konsiderojmë të panevojshme rishikimin për përcaktimin ligjor mbi kompetencat e monitorimit të kontratave të lidhura me subjektin investues, për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit dhe me subjektet «Person i stimuluar», pasi flasim për subjekte të cilët kanë përkufizime dhe referenca ligjore të ndryshme.”* Pavarësisht interpretimit të bërë nga ana e MTM-së aktet ligjore e nënligjore në fuqi duhet të jenë në përputhje me njëra tjetrën dhe të mos krijojnë koonfondim në implementimin e tyre. Ky është parim i teknikës legjislative, gjatë hartimit të teksteve zyrtare.

**Statusi i rekomandimit: I papranuar**

**Për pyetjen 1.1.3: A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM-së, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?**

## **PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT:**

### **Gjetje:**

Nga shqyrtimi i procedurës së pjesëmarrjes së AKT në panairët ndërkombëtare përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-E gjithë procedura e pjesëmarrjes në panair të agjencive/operatorëve turistik, përjashtuar shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, mbulohet nga fondet buxhetore të AKT-së, detyrim ky që, **nuk është i përcaktuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor, pra që me fondet e buxhetit të shtetit**, të përballohen shpenzimet e subjekteve private në panairët ndërkombëtare. Theksojmë se vetëm **për vitin 2019** nga AKT, për pjesëmarrjen e saj dhe të agjencive/operatorëve turistik në panairë ndërkombëtare, janë shpenzuar (hapësira me qera, ndërtimi dhe dizenjimi i stendës, kostot e regjistrimit, **pa përfshirë shpenzimet e udhëtimit, dietave, hotelit të stafit të AKT-së**), rreth **44,514,645 lekë për 10** panairë ndërkombëtare, ose **rreth 60% e fondeve buxhetore** (paga, investime, shpenzime të ndryshme operative). Nëse do t'i referoheshim **Shtetit të Sllovenisë**<sup>68</sup>, për mënyrën se si vepron në organizimin dhe mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në panairët ndërkombëtare, ku **60% të shpenzimeve** mbulohen nga fondi buxhetor dhe **40%** nga buxheti i subjekteve private, për vitin 2019 në rastin e AKT, do të kishim **26,708,787 lekë**, që do të shpenzoheshin nga AKT dhe **17,808,858 lekë** nga subjektet private që kanë marrë pjesë në panair, ose e thënë ndryshe **AKT do të kursente 17,808,858 lekë**, të cilat mund t'i shpenzonte në mënyra/mjete të tjera, për rritjen e efektivitetit të promovimit të turizmit shqiptar;

-Në VKM nr.298, datë 20.04.2016<sup>69</sup>, nuk përcaktohet si mjet promovues, pjesëmarrja në panairët ndërkombëtare, por AKT e përdorë këtë mënyrë promovimi, bazuar në eksperiencat e mëparshme institucionale. (*Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, të marrin masat e nevojshme për propozimin në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në VKM nr.298, datë 20.04.2016<sup>70</sup>, me qëllim përcaktimin e pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare dhe kombëtare si një mjet promovimi.

Në vijim të rekomandimit të mësipërm, Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, që nëpërmjet një akti nënligjor, të miratojë procedurën e organizimit të panairëve (nga faza e planifikimit të panairëve ku do të merret pjesë deri në zhvillimin e tij), duke përcaktuar detyrimet për të dyja palët (AKT dhe subjektet pjesëmarrës në panair) për financimin, sjelljen dhe raportimin e të dhënave statistikore, si dhe të përcaktohet si kriter s'kualifikues për të marrë pjesë në panairin e radhës, rasti kur subjekti nuk respekton detyrimet e përbashkëta.

### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MTM, në takimet e zhvilluara me grupin e auditimit gjatë fazës së terrenit, si dhe në qëndrimin zyrtar të përcjellë prej saj në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, shprehet se: *"Është miratuar Urdhri i Ministrisë nr. 8707, datë 31.10.2016 "Për miratimin e formatit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturat akomoduese. Direktiva e BE-së në lidhje me mbledhjen e të dhënave statistikore është transpozuar në ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin". Me Urdhrin e Ministrisë nr. 267 datë 24.7.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", i ndryshuar, në*

<sup>68</sup>[https://www.slovenia.info/uploads/dokumenti/program\\_dela\\_sto\\_2018-2019-en\\_tabele\\_s\\_prevodi\\_slik.pdf](https://www.slovenia.info/uploads/dokumenti/program_dela_sto_2018-2019-en_tabele_s_prevodi_slik.pdf) - Programi i punës për turizmin 2018-2019.

<sup>69</sup> Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së

<sup>70</sup> Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së.

*bashkëpunim me INSTAT, është miratuar formulari i deklaramit të të dhënave statistikore për strukturat akomoduese”.*

#### **Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Ministria e turizmit dhe Mjedisit është paraqitur observacioni me shkresë nr. 676/22 prot. datë 08.08.2022 “Mbi Projekt raportin e Auditimit” për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, për auditimin me temë “Zhvillimi i turizmit malor”.

**Pretendimi i subjektit:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka vënë në dispozicion dokumente për rekomandime të cilat pjesa më e madhe e tyre janë zbatuar por nuk ka sjellë dokumente apo evidenca për të ndryshuar statusin e rekomandimeve të përcaktuar qysh në Projekt Raportin e zbatimin të rekomandimeve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Observacionet e MTM në tërësinë e tyre nuk ndryshojnë situatën e përshkruar në këtë raport. Pjesa më e madhe e observacioneve i referohen rekomandimeve për të cilat grupi i auditimit është shprehur që ato janë zbatuar ose për dokumente të cilat janë vënë edhe më përpara në dispozicion të grupit të auditimit.

#### **VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit **ri kërkohet** nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresat:

- Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 199/11, datë 17.09.2021;
- Në Bashkinë Tiranë, me shkresën nr. 199/10, datë 17.09.2021.

mbi auditimin e performancës me temë: “Zhvillimi i Turizmit Malor”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të papranuar, pazbatuar ose në proces, si më poshtë:

#### **PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT:**

**Për pyetjen: 1.1.1. A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe në përputhje me direktivat e BE-së?**

#### **Gjetje:**

Nga auditimi mbi plotësimin e bazës ligjore, rezultoi se:

Referuar nenit 71 të Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”, si dhe nenit 10 pika 2 të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, në ligjin e turizmit nuk ka asnjë masë administrative të parashikuar, për strukturat akomoduese, që nuk kanë certifikatën e kategorizimit;

Në Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin” dhe VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifet, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, duke marrë në konsideratë praktikën e mira të vendeve të rajonit, nuk parashikohen në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit edhe dhomat/apartamentet/vilat, të cilat ofrojnë akomodim për turistët. Mungesa e parashikimit në kuadrin ligjor, të këtyre ambjentëve, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në gjykimin e grupit të auditimit, sjell rritjen e numrit të tyre e për pasojë mund të ndikojë negativisht në informalitetin e sektorit të turizmit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat për propozimin e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, me qëllim përfshirjen e dhomave/apartamenteve/vilave, që ofrojnë shërbimin e akomodimit, në procesin e kategorizimit dhe klasifikimit të tyre, si dhe të nenit 71, me qëllim përfshirjen e masës administrative, për strukturat akomoduese të cilat nuk kanë certifikatën e kategorizimit.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023****Gjetje:**

Nga shqyrtimi i VKM nr.162, datë 2.3.2016 “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, si dhe VKM nr.298, datë 20.04.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, rezultoi se përcaktimi ligjor i bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016, krijon mbivendosje të detyrave funksionale me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë 20.04.2016, pasi kompetenca e monitorimit të kontratave për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me subjektin investues, sipas VKM-së nr.162, i jepet MTM-së, ndërkohë sipas VKM-së nr.298, i jepet AKT-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, duke propozuar në Këshillin e Ministrave, ndryshimin e përcaktimit ligjor të bërë në pikën 3 të Kreut V, të VKM nr.162, datë 2.3.2016<sup>71</sup> me përcaktimin ligjor në pikën 8.12 të Kreut I të VKM nr.298, datë 20.04.2016, ku të ndahet qartë (duke shmangur mbivendosjen) kompetenca e monitorimit të kontratave të lidhura me subjektin investues, për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023****Gjetje:**

Referuar pikës 4 të nenit 5 të VKM nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar, rezulton se, nga Ministri i Turizmit nuk është miratuar Udhëzimi për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit të strukturave akomoduese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa që të hartojë dhe miratojë Udhëzimin për manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit të strukturave akomoduese.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023****Gjetje:**

Referuar SKT 2019-2023, si dhe Progres-Raportit për vitin 2020, të BE-së, ku thuhet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave (pasqyrohet si problematikë, transmetimi i tyre në EUROSTAT) në përputhje me acquis-në e BE-së, ende nga MTM nuk është përgatitur sistemi i ri i statistikave në fushën e turizmit, hartimi i metodologjisë në përputhje me Rregulloren e BE-së për statistikën në fushën e turizmit (informacion i besueshëm dhe i krahasueshëm, të dhëna mbi turizmin e brendshëm, burimet e të dhënave dhe mënyrat për sigurimin e informacionit)<sup>71</sup>. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë dhe miratojë metodologjinë për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, si dhe të vendosë në funksion sistemin e ri të

<sup>71</sup> Regulation (Eu) no 692/2011 of the European Parliament and of the Council of 6 July 2011 Concerning European Statistics on Tourism - Rregullore e Bashkimit Evropian nr.692/2011, në lidhje me Statistikat Evropiane mbi Turizmin;

statistikave, në përputhje me acquis-në e BE-së, por edhe me praktikat e mira të vendeve të rajonit<sup>72</sup>.

### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

#### **Gjetje:**

Referuar pikës 8.11 të VKM nr.298, datë 20.04.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”, ende nuk është hartuar dhe miratuar Udhëzimi i përbashkët (MTM-MFE) për mënyrën e grumbullimit dhe përdorimit të të ardhurave nga marrëveshjet e qerasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, të lidhura me subjektet “person i stimuluar”, si dhe prej një periudhe më tepër se 10-vjeçare, këto të ardhura nuk janë mbledhur. (Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.1) faqe (23-26) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, si dhe Agjencinë Kombëtare të Turizmit, të ngrejë një grup pune të përbashkët, me qëllim vlerësimin vlerës së detyrimit që kanë subjektet “person i stimuluar” për sipërfaqet e marra me qera, si dhe të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e tyre (duke lidhur marrëveshje të pagesës me këste/shërbimit të përmbartimit). Pas kësaj, MTM në bashkëpunim me MFE të hartojë dhe miratojë udhëzimin për mënyrën e arkëtimit, me qëllim që në të ardhmen, mos të krijohen detyrime të prapambetura ndaj buxhetit të shtetit.

### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

***Për pyetjen 1.1.2: A janë realizuar objektivat strategjike për turizmin malor nga MTM dhe AKT?***

#### **Gjetje:**

Referuar SKT 2019-2023, Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar 2030 (PINS 2030) dhe PKST Alpe 2030 nga MTM dhe AKT:

- nuk janë identifikuar, shënjuar dhe dixhitalizuar 5 shtigje të reja rajonale dhe 2 shtigje ndërkufitare të ecjes;
- nuk janë ndërtuar tre shtigjet rajonale dhe dy shtigje kombëtare të çiklizmit;
- nuk ka studim dhe masa të marra për identifikimin, vlerësimin, ndërtimin e pistave të skijimit, me qëllim zhvillimin e këtij sporti, si dhe sporteve të tjera në zonat malore;
- ende nuk janë identifikuar vendndodhjet për zhvillimin e alpinizmit, si dhe për realizimin e këtij objekti, nuk është parashikuar asnjë institucion/organizatë publike/private, ku në këtë rast përmendim Federatën Shqiptare të Alpinizmit, e cila mund të ftohej për bashkëpunim;
- nuk janë marrë masa për përfshirjen e Shqipërisë në guidat ndërkombëtare të ecjes dhe çiklizmit;
- nuk ka një studim për vlerësimin e kërkesës së tregut mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit (dixhitalizimi i shtigjeve malore) dhe alternativat që mund të adaptohen në turizmin vendas;
- nuk është ofruar mbështetje për veprimtaritë sportive që zhvillohen në natyrë, kryesisht në zonat malore (hedhje me parashutë, çiklizmi malor, ngjitjet alpinistike), si dhe aktualisht nuk disponohet një inventar të zonave, në të cilat ushtrohet/mund të ushtrohet sporti i hedhjes me parashutë apo çiklizmi malor;
- nuk është hartuar dhe miratuar Strategjia Kombëtare e Marketingut për sektorin e turizmit;
- nuk janë ngritur qendrat e vizitorëve për çdo Park Kombëtar, konkretisht nuk janë ngritur në PK Mali i Tomorrit, Bredhi i Drenovës, Bredhi i Hotovës-Dangëlli, Valbonë, Lurë, Butrint, Zall Gjocaj, si dhe qendrat e vizitorëve në Prespë nuk janë funksionale;
- nuk është përgatitur plani i masave për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore;

<sup>72</sup>Statistikat e turizmit në Kroaci, treguesit që përdoren nga Kroacia dhe burimet e informacionit, [https://www.dzs.hr/Hrv\\_Eng/publication/2017/SI-1594.pdf](https://www.dzs.hr/Hrv_Eng/publication/2017/SI-1594.pdf).

- nuk disponohet informacion për zonat e thella malore, në të cilat nuk arrihet të mbulohet me shërbim të telefonisë celulare/internet, ku theksojmë se nga vizitat në terren në zona të ndryshme të Parkut Kombëtar të Llogarasë, Prespë, në zonën e Bogës, si dhe komunikimit të grupit të auditimit me Specialistët e Zonave të Mbrojtura Vlorë dhe Korçë, mungesa e mbulimit me shërbim të telefonisë celulare/internet, është një nga problemet kryesore, të humbjes së turistëve (kryesisht atyre të huaj) gjatë vizitave turistike në shtigje malore;
- nuk është marrë asnjë masë për krijimin e paketës turistike për aktivitetet dimërore, me qëllim rritjen e sezonit turistik, ose e thënë ndryshme shmangien e sezonalitetit;
- nuk është marrë masë, për të ngritur platformën online të bashkëpunimit, për shoqëruesit/udhërrëfyesit e udhëtimeve, me qëllim koordinimin, bashkëpunimin, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar, gjatë shoqërimeve të grupeve të turistëve;
- nuk është përgatitur programi i trajnimit dhe nuk është marrë asnjë masë për trajnimin e burimeve njerëzore që janë të angazhuara në sektorin e turizmit;
- nuk është krijuar struktura menaxhuese për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial Turizmit në Rajonin e Alpeve Shqiptare;
- nuk është ngritur portali shqiptar i turizmit “e-turizëm”, i lidhur me aplikacione që ofrojnë informacion mbi destinacionet e atraksionet turistike;
- nuk janë marrë masa për ngritjen e zyrave/pikave të informacionit turistik, si dhe nuk është hartuar dhe miratuar rregullorja për pikat e informacionit turistik, por theksojmë se AKT ka vënë në dispozicion të 27 Bashkive, 60 infopoint (tabela informacioni për destinacione turistike). Gjithashtu nga 60 tabelat informuese, të cilat janë bërë kalim kapital nga AKT drejt Bashkive, 21 prej tyre ose 35%, janë të dëmtuara/kanë humbur, pra nuk i shërbejnë qëllimit të tyre;
- nuk janë ngritur strukturat promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë;
- nuk ka një analizë/studim se sa është numri i strukturave akomoduese, që nuk janë të regjistruara/që operojnë në mënyrë informale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.2) faqe (26-32) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, për identifikimin, shënjimin dhe dixhitalizimin e 7 shtigjeve malore të ecjes dhe 4 shtigje të çiklizimit, si dhe përfshirjen e tyre në guidat ndërkombëtare të ecjes.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të bëjë një studim, me qëllim vlerësimin e mundësive dhe më pas ndërtimin e pistave të skijimit dhe të zonave të zhvillimit të alpinizmit.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të sporteve malore, dhe rrjedhimisht tërheqjen e turistëve në këto zona, të ftojë çdo vit Federatën e Alpinizmit, Aeronautikës, dhe të sporteve të tjera që zhvillohen në zonat malore, me qëllim aplikimin në projektet që financohen prej saj, të cilat fokusohen në turizmin malor.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

**Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e planit të masave për sigurinë e turistëve në zonat malore, duke krijuar Skuadrat e Kërkim-Shpëtimit, si dhe përgatitjen e rregullore së ndërhyrjes në mënyrë që çdo pjesëtar i këtyre skuadrave të jetë i qartë për funksionin që do të kryejë, duke shmangur kështu kaosin dhe duke shkurtuar kohën e dhënies së ndihmës të aksidentuarit. Gjithashtu të vlerësohet mundësia, që këto skuadra të kenë edhe

mjekë të urgjencës, të cilët të trajnohen për ndërhyrjen në terren dhe mjekimin e të aksidentuarit.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

##### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, të përgatisë një program pune, me qëllim realizimin e objektivit strategjik “Regjistrimin e 80% të strukturave akomoduese të vogla familjare”, duke ndërmarrë masa konkrete, fushatë të koordinuar midis DPT-së dhe MTM-së, përcaktuar afate, si dhe burimet njerëzore dhe financiare që do të angazhohen.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

##### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit të hartojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare të Marketingut, si dhe ngritjen e strukturave promovuese të turizmit, pranë përfaqësive diplomatike të Shqipërisë.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

***Për pyetjen 1.1.3: A janë plotësisht funksionale strukturat e MTM-së, KRZHT, dhe AKT, si dhe a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për realizimin e detyrave institucionale, me qëllim zhvillimin e turizmit malor?***

##### **Gjetje:**

Nga shqyrtimi i procedurës së pjesëmarrjes së AKT në panairët ndërkombëtarë përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-E gjithë procedura e pjesëmarrjes në panair të agjencive/operatorëve turistik, përjashtuar shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, mbulohet nga fondet buxhetore të AKT-së, detyrim ky që, **nuk është i përcaktuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor, pra që me fondet e buxhetit të shtetit**, të përballohen shpenzimet e subjekteve private në panairët ndërkombëtarë. Theksojmë se vetëm **për vitin 2019** nga AKT, për pjesëmarrjen e saj dhe të agjencive/operatorëve turistik në panairë ndërkombëtarë, janë shpenzuar (hapësira me qera, ndërtimi dhe dizajnimi i stendës, kostot e regjistrimit, **pa përfshirë shpenzimet e udhëtimit, dietave, hotelit të stafit të AKT-së**), rreth **44,514,645 lekë për 10** panairë ndërkombëtarë, ose **rreth 60% e fondeve buxhetore** (paga, investime, shpenzime të ndryshme operative). Nëse do t'i referoheshim **Shtetit të Sllovenisë**<sup>73</sup>, për mënyrën se si vepron në organizimin dhe mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në panairët ndërkombëtarë, ku **60% të shpenzimeve** mbulohen nga fondi buxhetor dhe **40%** nga buxheti i subjekteve private, për vitin 2019 në rastin e AKT, do të kishim **26,708,787 lekë**, që do të shpenzoheshin nga AKT dhe **17,808,858 lekë** nga subjektet private që kanë marrë pjesë në panair, ose e thënë ndryshe **AKT do të kursente 17,808,858 lekë**, të cilat mund t'i shpenzonte në mënyra/mjete të tjera, për rritjen e efektivitetit të promovimit të turizmit shqiptar;

-Në VKM nr.298, datë 20.04.2016<sup>74</sup>, nuk përcaktohet si mjet promovues, pjesëmarrja në panairët ndërkombëtarë, por AKT e përdorë këtë mënyrë promovimi, bazuar në eksperiencat e mëparshme institucionale. (*Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

##### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, të marrin masat e nevojshme për propozimin në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në VKM nr.298, datë 20.04.2016<sup>75</sup>, me qëllim përcaktimin e pjesëmarrjes në panairë

<sup>73</sup>[https://www.slovenia.info/uploads/dokumenti/program\\_dela\\_sto\\_2018-2019-en\\_tabele\\_s\\_prevodi\\_slik.pdf](https://www.slovenia.info/uploads/dokumenti/program_dela_sto_2018-2019-en_tabele_s_prevodi_slik.pdf) - Programi i punës për turizmin 2018-2019.

<sup>74</sup> Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së

<sup>75</sup> Për organizimin dhe funksionimin e AKT-së.

ndërkombëtare dhe kombëtare si një mjet promovimi.

Në vijim të rekomandimit të mësipërm, Ministri i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, që nëpërmjet një akti nënligjor, të miratojë procedurën e organizimit të panairëve (nga faza e planifikimit të panairëve ku do të merret pjesë deri në zhvillimin e tij), duke përcaktuar detyrimet për të dyja palët (AKT dhe subjektet pjesëmarrës në panair) për financimin, sjelljen dhe raportimin e të dhënave statistikore, si dhe të përcaktohet si kriter s'kualifikues për të marrë pjesë në panairin e radhës, rasti kur subjekti nuk respekton detyrimet e përbashkëta.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

##### **Gjetje:**

Referuar nenit 30 të Ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit”, ende nuk janë përgatitur planet e zhvillimit dhe të veprimit për të gjitha zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, ku nga këto zona citojmë: Mali i Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafështame-Krastë; Vargmali i Moravës; Alpet; dhe Parku Kombëtar i Llogarasë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

##### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Turizmit, si dhe planeve të zhvillimit dhe veprimit për disa nga zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si ajo e Malit të Dajtit-Bizë-Martanesh-Qafështamë-Krastë Vargmalit të Moravës.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

##### **Gjetje:**

Referuar nenit 9 të Ligjit të Turizmit, ende nuk është hartuar dhe miratuar Plani Kombëtar i Turizmit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

##### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Turizmit.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

##### **Gjetje:**

Referuar nenit 10 të Ligjit të Turizmit, nenit 7 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Urdhrit nr.8657, datë 28.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit”, rezultoi se:

- Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit nuk funksionojnë sipas referencave ligjore të bëra më sipër, pra ato nuk janë të pozicionuara pranë Qarqeve, në mënyrë që të shërbejnë si ndërmjetës të bashkëpunimit dhe koordinimit, midis MTM dhe institucioneve të pushtetit vendor dhe subjekteve private, për zhvillimin e turizmit;

- Nga Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit nuk janë kryer këshillime, të sipërmarrjeve turistike, me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, përgjatë periudhës 2019-2020;

- Nuk ka databasë për ankesat ndaj subjekteve që ofrojnë shërbime turistike, si dhe për burimet turistike;

- Nuk janë organizuar seminare, konferenca, takime të Degëve Territoriale me sipërmarrjet turistike, për periudhën 2019-2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

##### **Rekomandim:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme që Degët Territoriale të Shërbimit të Turizmit, të pozicionohen me zyra pranë prefekturave, si dhe të sigurojë

funksionimin e plotë të tyre për organizimin e seminareve, konferencave, këshillimeve të sipërmarrjeve turistike me qëllim përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit turistik të ofruar.

## **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

### **Gjetje:**

Nga shqyrtimi i procedurës së pjesëmarrjes së Agjencisë Kombëtare të Turizmit në panairin ndërkombëtar, përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-AKT nuk ka indikatorë/tregues të miratuar, mbi të cilët të bëjë vlerësimin e dobishmërisë/efektit në turizëm, të fondeve të shpenzuara për një panair;

-AKT nuk ka studim për monitorimin e tregut, mbi prirjet dhe preferencat e konsumatorëve, se çfarë ata kërkojnë nga turizmi në tërësi dhe ai malor në veçanti, me qëllim pjesëmarrjen në panair sipas tematikës së tyre, me qëllim rritjen e efektivitetit të promovimit, si dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit të turizmit malor;

-Për vendosjen e kriterëve fituese për panairin e vitit 2019, që janë publikuar në portalin e-albania, nuk ka një analizë, mbi mënyrën e përcaktimit të tyre;

-Nuk ka një afat të përcaktuar, se sa ditë para zhvillimit të panairit, duhet të bëhet publikimi në portalin e-albania për konkurrim;

-Kriteri i përcaktuar për numrin e pjesëmarrësve (operator/agjenci turistike) në panair, nuk është respektuar, për shembull, për sipërfaqen 20-40 m<sup>2</sup> lejohet të marrin pjesë 5-8 subjekte, ndërkohë kanë marrë pjesë 10 subjekte, ose për sipërfaqen mbi 100 m<sup>2</sup> lejohet të marrin pjesë deri 23 subjekte, por që faktikisht kanë marrë pjesë 26 subjekte. Gjithashtu nuk ka një analizë, për mënyrën e përcaktimit të kriterëve mbi numrin e pjesëmarrësve, pasi kjo shoqërohet me rritje të kostos financiare të panairit, (pasi për një numër të lartë pjesëmarrësish, duhet një hapësirë më e madhe, më tepër tavolina, karrige, materiale promocionale, kostoja e regjistrimit);

-Në muajin Dhjetor të vitit **2019** janë kryer shpenzime në vlerën **3,507,438 lekë**, për llogari të 3 panairëve që zhvillohen në vitin **2020** (Madrid, Holandë dhe Vjenë), ndërkohë që për vitin 2019, këta 3 panairë nuk kanë qenë të miratuar nga Ministri përgjegjës për turizmin, si dhe nuk ka patur planifikim të fondeve buxhetore, pra nga AKT është bërë rishpërndarje e fondeve përtej datës 15 Nëntor, në mungesë të një arsytimi, si dhe pa marrë miratimin e Nëpunësit Autorizues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit<sup>76</sup>.

-Nuk administrohen njoftimet e subjekteve fituese, procesverbalet e shpalljes së fituesve;

-Nuk administrohen deklaratat e ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit, të anëtarëve të grupit, që ka bërë vlerësimi e aplikimeve deri në shpalljen e fituesve;<sup>77</sup>

-Nuk administrohen dokumentet e dorëzuara nga subjektet që kanë marrë pjesë (kryesisht mungojnë Vërtetimi nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë 3 viteve të fundit, Kopje të materialeve promocionale të prodhuara nga Operatori Turistik, Listëpagesat e 6 muajve të fundit të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar me Formularin E-SIG 025/a);

-Nga stafi i AKT-së, i cili ka marrë pjesë në panair, nuk është mbajtur procesverbali, mbi marrjen në dorëzim të stendës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara;

-Nga operatorët/agjencitë turistike që kanë marrë pjesë në panair, nuk është respektuar detyrimi i akt-marrëveshjes, për dorëzimin e raportit përmbledhës të panairit pranë AKT, raport, i cili ka informacion mbi numrin e kontratave që ka lidhur në panair, numrin e turistëve që kanë blerë paketë turistike nga ky panair, të ardhurat e realizuara, etj;

-Vlerësimi i aplikimeve nuk është bërë në grup, i cili të dali me një vendim përfundimtar, për çdo aplikim, por bëhet në mënyrë individuale;

<sup>76</sup> Udhëzim nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

<sup>77</sup> Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

-Kanë marrë pjesë subjekte të ndryshme të cilat nuk kanë qenë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit si operator/agjenci turistike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Agjencia Kombëtare e Turizmit të marrë masa, që në rregulloren e procedurës së pjesëmarrjes në panair të përcaktojë afatin e publikimit të njoftimit, hartimin e deklaratave të ekzistencës/mosekzistencës së konfliktit të interesit nga grupi i vlerësimit, si dhe në çdo rast, stafi pjesëmarrës në panair, të mbajë procesverbalin mbi marrjen në dorëzim të standës, karrigeve, tavolinave, dizenjimit të saj, sipas specifikimeve të kontraktuara .

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

**Gjetje:**

Nga auditimi i veprimtarisë së Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT), Qarku Vlorë, Korçë dhe Shkodër, rezultoi se:

-Në Qarkun Vlorë, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit nuk ka funksionuar<sup>78</sup>;

-Për KRZHT Korçë, për periudhën 2019-2020, Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, është ngritur si strukturë, por nuk ka funksionuar sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e Ministrisë përgjegjëse për turizmin nr.8502, datë 24.10.2016, sepse përfaqësuesit e Komitetit<sup>79</sup>, nuk janë sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzimin e mësipërm, konkretisht nuk ka përfaqësues të shoqatave që operojnë në sektorin e turizmit (të cilët janë burimi kryesor i identifikimit të problematikave të ndryshme që ka sektori i turizmit në Qarkun e Korçës), ose janë përcaktuar si anëtarë të këtij Komiteti, institucione të cilat nuk parashikohen në Udhëzimin e mësipërm;

-Për KRZHT Korçë, rezulton se nuk është bërë asnjë diskutim për turizmin malor, por kryesisht diskutimet janë të fokusuara në menaxhimin e sezonit turistik veror, sigurinë në plazhe;

-Nuk administrohet informacioni i raportuar në AKT, për çështje që lidhen me turizmin sipas territorit administrativ përkatës<sup>80</sup>. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.1.3) faqe (32-56) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

MTM në bashkëpunim me Prefektët e 12 Qarqeve në RSH, në rolin e Kryetarëve të Komiteteve Rajonale të Zhvillimit të Turizmit, të marrin masat e nevojshme për funksionimin e plotë të kësaj strukture dhe sipas qëllimit për të cilin janë krijuar.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

***Për pyetjen 1.2.1: A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur siç duhet ato?, si dhe për pyetjen 1.2.2: A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?***

**Gjetje:**

Nga auditimi i veprimtarisë së Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor (FSHALT), për ndikimin e saj në zhvillimin e turizmit malor përgjatë periudhës 2019-2020, rezultoi se:

-Pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore të akorduara për FSHALT, në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht edhe në aktivitetin e kësaj Federate, pasi është ulur, numri i

<sup>78</sup>Neni 20 i Ligjit nr.93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

<sup>79</sup>Rregullore për funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, nr.420 prot., datë 08.03.2019.

<sup>80</sup> Ligji nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, neni 20;

aktiviteteve vjetore, ku nga 6 aktivitete në vit, janë zhvilluar vetëm 2 aktivitete në dy vjet, numri i sportistëve që marrin pjesë në aktivitete, për shkak të pamundësisë së pagesës së trajtimit ushqimor, ku nga 100 sportist që merrnin pjesë në 1 aktivitet, për vitin 2019 dhe 2020 kanë marrë pjesë rreth 40 sportist në 1 aktivitet, nuk është marrë pjesë në asnjë aktivitet ndërkombëtar, si dhe nuk është krijuar mundësia në hapjen e shtigjeve malore apo të shtigjeve për kacaverje, etj.

-Midis FSHALT si dhe Ministrisë së Turizmit apo Agjencisë Kombëtare të Turizmit, nuk ka patur asnjë aktivitet të përbashkët, me qëllim promovimin e aktiviteteve sportive në zonat malore. Theksojmë se një aktivitet i tillë (Panairi i Turizmit Malor) ndërmjet FSHALT dhe AKT, për herë të fundit, është zhvilluar në muajin Dhjetor të vitit 2013, në të cilin kanë qenë të pranishëm rreth 400 persona si dhe media ndërkombëtare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.2.1 dhe 1.2.2) faqe (58-61 dhe 61-63) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **Rekomandim:**

Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin e mundësisë për krijimin e kurseve dhe trajnimin e personave që bëjnë guida alpinistike, që sot shihet si domosdoshmëri për të gjithë ata që shoqërojnë grupe turistësh në zonat malore.

#### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në pikën 11 të VKM nr. 115 datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, e ndryshuar, i kërkojmë Ministrinë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, fillimin e procedurës, për marrjen e masës disiplinore ndaj: 1. Z. A.K, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MTM-së, për mosvendosjen në dispozicion të grupit të auditimit, të dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr.3002 prot., datë 04.05.2021, trajtuar në faqen nr.17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **PËR FEDERTËN SHQIPTARE TË ALPINIZMIT DHE TURIZMIT MALOR:**

*Për pyetjen: 1.2.1.A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe logjistika, për realizimin e detyrave nga Federata Shqiptare e Turizmit dhe Alpinizmit Malor dhe a janë përdorur siç duhet ato?, si dhe 1.2.2: A ka kryer FSHALT aktivitete, të cilat kanë patur ndikim në zhvillimin/promovimin e turizmit malor?*

#### **Gjetje:**

Pamjaftueshmëria e fondeve buxhetore të akorduara për FSHALT, në gjykimin e grupit të auditimit, ka ndikuar negativisht edhe në aktivitetin e kësaj Federate, pasi është ulur, numri i aktiviteteve vjetore, ku nga 6 aktivitete në vit, janë zhvilluar vetëm 2 aktivitete në dy vjet, numri i sportistëve që marrin pjesë në aktivitete, për shkak të pamundësisë së pagesës së trajtimit ushqimor, ku nga 100 sportist që merrnin pjesë në 1 aktivitet, për vitin 2019 dhe 2020 kanë marrë pjesë rreth 40 sportist në 1 aktivitet, nuk është marrë pjesë në asnjë aktivitet ndërkombëtar, si dhe nuk është krijuar mundësia në hapjen e shtigjeve malore apo të shtigjeve për kacaverje, etj.

Midis FSHALT si dhe Ministrisë së Turizmit apo Agjencisë Kombëtare të Turizmit, nuk ka patur asnjë aktivitet të përbashkët, me qëllim promovimin e aktiviteteve sportive në zonat malore. Theksojmë se një aktivitet i tillë (Panairi i Turizmit Malor) ndërmjet FSHALT dhe AKT, për herë të fundit, është zhvilluar në muajin Dhjetor të vitit 2013, në të cilin kanë qenë të pranishëm rreth 400 persona si dhe media ndërkombëtare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (1.2.1 dhe 1.2.2) faqe (58-61 dhe 61-63) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



**Rekomandim:**

Rekomandimi: Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor të hartojë dhe miratojë një program strategjik 3-5 vjeçar, duke përcaktuar objektivat që synon të arrijë, kostot dhe afatet e realizimit të tyre, identifikuar fuqitë, shanset dhe kërcënimet që rrezikojnë realizimin e tyre, si dhe një vlerësim mbi kontributin që mund të ofrojë Sporti i Alpinizmit në zhvillimin e turizmit malor, dhe t'ia përcjelli MASR-së dhe MTM-së për njohje, duke u bërë më konkrete në aktivitetin e saj dhe rritjen e besueshmërisë së këtij sporti, që edhe ai mund të jetë pjesë e zhvillimit të turizmit malor.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

**Rekomandim:**

Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin e mundësisë për krijimin e kurseve dhe trajnimin e personave që bëjnë guida alpinistike, që sot shihet si domosdoshmëri për të gjithë ata që shoqërojnë grupe turistësh në zonat malore.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

**Rekomandim:** Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor të marrë masat e nevojshme, për botimin çdo 6-mujor, të një reviste/broshure dhe publikimin e saj në median elektronike dhe atë të shkruar, për prezantuar.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023**

## 9- PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “PASTRIMI I QYTETIT”.

### I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr.676, datë 26.07.2022, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021", ushtroi auditim në subjektin Bashkia Vlorë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, lidhur me auditimin e performancës me temë: “Pastrimi i qytetit”, të realizuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë: në Bashkinë Vlorë, me shkresën nr. 645/8, datë 15.09.2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në 6 mujorin e dytë të vitit 2021, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi: se, subjekti nuk ka miratuar nga Kryetari i Bashkisë, planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, kjo në mospërputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se: subjekti **nuk ka zbatuar afatin 6 mujor** mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

KLSH ka dërguar: në Bashkinë Vlorë, me shkresën nr. 645/8, datë 15.09.2021.

Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Pastrimi i qytetit”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 12 “Masa organizative” për zbatim. Nga 12 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar masa ose pranimi është në masën 100 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	12	12	0

## II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

- A. G., Përgjegjës Grupi;
- S.R., Anëtar.
- E. K., Anëtar.

### 1. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e performancës me temë "Pastrimi i qytetit".

### 2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

### 3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### 4. Konkluzioni:

Subjekti i audituar, Bashkia Vlorë nuk ka marrë masa për respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Po kështu ky subjekt, nuk ka marrë masa edhe për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

- Nga 12 masa organizative të rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 12 masa ose në masën 100 %. Nga 12 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 1 masë ose 9 % tyre, janë në proces zbatimi 4 masa ose 33 % dhe janë pa zbatuar 7 masa ose 58 %.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	12	1	4		7

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali		
2	Pa pranuar	0	

3	Pranuar	12	
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	1	9
2	Pa zbatuar	4	33
3	Në proces	7	58

### 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 9 % dhe së bashku me rekomandimet që janë zbatuar pjesërisht 33% shkon në nivelin 42 %. Megjithë përpjekjet e subjektit, rekomandimet e zbatuara pjesërisht, të cilat nuk kanë evidencë e cila garanton vijueshmërinë e procesit si dhe niveli i lartë i rekomandimeve të pazbatuara, 58%, tregojnë masa të pamjaftueshme nga ana e subjektit

### III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

#### MASA ORGANIZATIVE

#### Për pyetjen: A është mbështetur procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në plane/rregullore për këtë qëllim?

##### Gjetje:

Në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit nr. 8094, datë 01.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, nenin 22 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Vlorë, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve në Bashki nuk ka hartuar dhe miratuar:

- a) metodat dhe teknologjitë për largimin e mbeturinave;
- b) planet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- c) rregulloren e shërbimit të pastrimit publik;
- d) rregulloren higjieno-sanitare dhe ekologjike;
- e) tregues të performancës së shërbimit dhe indikatorë për matjen e cilësisë së shërbimit; dhe
- f) objektiva specifike për shërbimin e pastrimit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

##### Rekomandim:

Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, në bashkëpunim me ekspertë të fushës të marrë masa për hartimin dhe miratimin e metodologjive dhe rregulloreve të munguara prej kohësh, ku të përshkruhen qartë çdo element që lidhet me këtë shërbim dhe parametra/standarde të cilat duhet të aplikohen;

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Bashkia Vlorë nëpërmjet Urdhrit të Kryetarit Nr. 10750 prot., datë 16.07.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane”, ka përcaktuar përbërjen e grupit të punës.

Nuk ka evidenca të vëna në dispozicion nga subjekti për hartimin dhe miratimin :

- a. metodat dhe teknologjitë për largimin e mbeturinave;
- b. planet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- c. rregulloren e shërbimit të pastrimit publik;
- d. rregulloren higjieno-sanitare dhe ekologjike;
- e. tregues të performancës së shërbimit dhe indikatorë për matjen e cilësisë së shërbimit;
- f. objektiva specifike për shërbimin e pastrimit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

## **Për pyetjen: A është bazuar procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në analiza financiare në përputhje me burimet në dispozicion?**

### **Gjetje:**

Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme dhe parimin e transparencës, Bashkia Vlorë nuk mbështet përllogaritjen e tarifës së pastrimit në metodologji përllogaritjeje dhe as nuk bën publike analizën e ndjekur për gjenerimin e vlerës përfundimtare të kësaj tarife;

Në asnjë rast për periudhën objekt auditimi, Bashkia Vlorë nuk ka mbledhur 100% të tarifës së “pastrim, gjelbërim, ndriçim”;

Në kundërshtim me Kreun VI të Ligjit nr. 8094, datë 01.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, të ardhurat nga vjelja e tarifës për “pastrim, gjelbërim, ndriçim” nuk mbulojnë as shërbimin e pastrimit brenda qytetit, ku mesatarisht ky shërbim është në vlerën e 145% të tarifës përkatëse;

Mesatarisht për periudhën objekt auditimi, të ardhurat nga tarifa për “pastrim, ndriçim, gjelbërim” përbëjnë 6.9% të të ardhurave totale të Bashkisë (duke marrë parasysh se kjo tarifë mbulon tre shërbime), ndërkohë që shpenzimi për shërbimin e pastrimit vetëm brenda qytetit zë 9.8% të të ardhurave totale të BV;

Në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës, përllogaritja e fondit të nevojshëm për shërbimin e pastrimit bazohet në eksperiencën 15 vjeçare që Bashkia ka patur për këtë për këtë shërbim, si dhe duke përfshirë vetëm kostot operative të shërbimit;

Për automjetet në funksion të shërbimit është parashikuar zëvendësimi rregullisht çdo vit i gomave dhe nuk janë përmendur normat e konsumit për secilin lloj automjeti;

Për shkak të mungesës së peshores, Bashkia Vlorë nuk ka asnjë informacion mbi sasinë e mbetjeve që prodhon në një ditë.

### **Rekomandime:**

Bashkia Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për kryerjen e analizave të kostos së shërbimeve mbështetur në udhëzues apo metodologji të caktuara për këtë qëllim, si dhe të mbajë parasysh elementët e kostos të përcaktuar në VKM nr. 319 datë 31/05/2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Njëkohësisht, të merren masa për mbledhjen e vlerës së plotë të të ardhurave nga tarifa e pastrimit.

### **Në hartimin e kontratave të ardhshme**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në hartimin e kontratës së re Nr.6227/1 prot, dt.03.07.2020 “Shërbimi i pastrimit në qytetin Vlorë”, realizimi i analizës së kostos është kryer mbështetur edhe në shtojcën 1 Udhëzues për llogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve, shtojcës 2, Modelet e llogaritjes së tarifave për menaxhimin e mbetjeve, duke mbajtur parasysh elementë të kostos përcaktuar në VKM Nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Por subjekti nuk ka marrë masa për përfshirjen në analizën e kostos të udhëzuesve apo metodologjive të caktuara për këtë qëllim si edhe nuk ka marrë asnjë masë për mbledhjen e vlerës së plote të të ardhurave nga tarifa e pastrimit.

### **Statusi i rekomandimit: Zbatuar Pjesërisht**

### **Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për identifikimin e saktë të volumeve të mbetjeve që gjenerohen dhe të përdorë këto të dhëna gjatë planifikimeve financiare që kryen.

### **Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e subjektit Bashkia Vlorë nuk është marrë asnjë masë lidhur me identifikimin e saktë të volumeve të mbetjeve që gjenerohen me synimin që të përdoren këto të dhëna gjatë planifikimeve financiare që kryen.

### **Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për llogaritjen e kostos së shërbimit së pari jo në vlera të konsiderueshme mbi mundësitë e saj financiare dhe së dyti duke bërë pjesë të këtyre përlllogaritjeve elementët thelbësor që janë pjesë e shërbimit të pastrimit si rritja e popullsisë, shtimi i bizneseve, flukset e sezoneve, etj.

**Në hartimin e kontratave të ardhshme**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e subjektit nuk është marrë asnjë masë lidhur me llogaritjen e kostos së shërbimit jo në vlera të konsiderueshme mbi mundësitë e saj financiare si edhe nuk janë marrë në konsideratë në përlllogaritje elementë thelbësor që janë pjesë e shërbimit të pastrimit si rritja e popullsisë, shtimi i bizneseve, flukset e sezoneve, etj.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar****Për pyetjen: A ka kryer BV mbikëqyrjen e duhur të zbatimit të kontratës?**

**Gjetje:** Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Bashkisë dhe përcaktimeve të kontratës së shërbimit nr. 4558, datë nr. 4558, datë 31.10.2014:

Procesi i mbikëqyrjes realizohej në mëngjes herët rreth orës 06:00-10:00 dhe jo në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit;

Puna e mbikëqyrësit të kontratës është e dokumentuar vetëm nëpërmjet disa akt kontrolleve të thjeshta ditore ku konfirmohet realizimi i punëve të parashikuara sipas volumeve;

Nuk identifikohen në asnjë rast indikator matës të cilësisë së pastrimit, pra me çfarë treguesish mbikëqyrësi del në përfundimin se cilësia është e mirë, e keqe, apo mesatare;

OE nuk e shoqëron dokumentacionin e mbajtur ditore me detaje mbi punët e kryera, p.sh. me proces-verbale për sasinë e mbushjes së autoboteve me ujë për secilin proces, me adresat se cilat zona janë më problematike duke gjetur vazhdimisht hedhjen e mbetjeve të papranueshme jashtë kontenierëve, etj;

Nuk u konstatua asnjë komunikim i dokumentuar mes mbikëqyrësit dhe Drejtorit të Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, qoftë lidhur me miratimin e grafikëve të punimit, me shkëmbim informacionesh mbi problematika që mund të lindin gjatë punës, mbi raportimet ditore brenda orarit të përcaktuar në rregullore, etj;

Nuk u konstatua i dokumentuar asnjë adresim i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve qoftë në instanca më të larta brenda institucionit, ashtu dhe drejt OE që ofron shërbimin, mbi problematika të hasura vazhdimisht për çështjen e pastrimit dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre, si p.sh. mungesa e vazhdueshme e ndërjegjësimit të popullsisë për hedhjen e mbetjeve të pa pranueshme, neglizhenca e tyre për reduktimin e mbetjeve, problematika të mbledhjes së plastikave nga persona të pa autorizuar, etj;

Mbikëqyrësi nuk përmbush detyrimin për kontrollin e mjeteve dhe fuqisë punëtore të angazhuar nëpërmjet kësaj kontrate, si dhe nuk kryen një verifikim të detajuar të gjendjes teknike të mjeteve apo dokumentacionit që konfirmon këto elementë të mjeteve, apo shërbimet dhe mirëmbajtja që i bëhet atyre. Dëshmitë e vetme që pranohen për gjendjen e mjeteve janë kontrollet teknike të përvitshme që kryen çdo mjet në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që mbikëqyrësi kryen vizita në parkun e mjeteve dy herë në vit për të verifikuar prezencën dhe gatishmërinë e tyre, por ky proces është i pa dokumentuar.

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve në bashkëpunim me mbikëqyrësin e kontratës, të marrin masa për menaxhimin e kapaciteteve për të kryer një proces të plotë mbikëqyrës për të gjithë shërbimin e pastrimit dhe mbi të gjitha ky proces të kryhet në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit dhe jo në përfundim të tij.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Urdhri i Brendshëm i Kryetarit të Bashkisë Vlorë, Nr.198, dt.10.09.2020 “ Mbi kontrollin e realizimit të shërbimit të pastrimit në qytetin e Vlorës”,

ngarkon administratorët e Rajoneve Administrative të Bashkisë Vlorë që brenda hapësirës territoriale ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre të kontrollojnë realizimin e shërbimeve të përcaktuara në kontratën për shërbimin e pastrimit dhe në fund të çdo dite të raportojnë me shkrim pranë Drejtorisë së Shërbimeve.

Nuk ka evidencë të paraqitur nga subjekti për raportimin ditor të administratorëve të Rajoneve Administrative mbi kontrollin e shërbimit të pastrimit.

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar pjesërisht**

**Rekomandime:**

Drejtorja e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve dhe mbikëqyrësi të garantojnë realizimin e një inspektimi më serioz dhe mbajtjen e dokumentacionit të detajuar për punimet e kryera. Ky dokumentim të shoqërohet edhe me komunikime shkresore zyrtare me eprorë, operatorin ekonomik, apo dhe ankesa të qytetarëve. Në këtë kontekst, të kërkohet më tepër llogaridhënie në dokumentimin e procedurave që kryen operatori ekonomik për elementë të ndryshëm të ofrimit të shërbimit, si p.sh. procesverbale të sasisë së ujit që mbushen autobotet çdo ditë, faturime dhe dokumente të tjera justifikuese për çdo riparim, mirëmbajtje apo ndërhyrje të kryer në mjetet në dispozicion të kontratës, për të cilat paguan Bashkia, etj.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Qëllimi i rekomandimit të lënë ka qenë garantimi i realizimit të inspektimit më serioz dhe mbajtja e dokumentacionit të detajuar për punimet e kryera si dhe rritja e nivelit të llogaridhënies në procesin e dokumentimit të procedurave që kryen operatori ekonomik për element të ndryshëm të ofrimit të shërbimit, si p.sh. procesverbale të sasisë së ujit që mbushen autobotet çdo ditë, faturime dhe dokumente të tjera justifikuese për çdo riparim, mirëmbajtje apo ndërhyrje të kryer në mjetet në dispozicion të kontratës, për të cilat paguan bashkia, etj.

Supervizori i kontratës mban çdo ditë Akt Kontroll, i cili i përcillet operatorit të shërbimit nëpërmjet postës elektronike, ndërkohë që nuk ka asnjë evidencë tjetër mbi dokumentimin e detajuar për punimet e kryera, apo dokumentimin e procedurave të kryera nga operatori i shërbimit.

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar pjesërisht**

**Për pyetjen: A janë zbatuar me përpikmëri detyrimet e kontratës nr. 4558, datë 31.10.2014 sa i takon largimit të mbetjeve/fshirjes dhe larjes së rrugëve/edukimit publik?**

**Gjetje:**

Mbi procesin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, dezinfektimit të zonës dhe gjendjes së kontejnerëve:

- Bashkia Vlorë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nuk ka operuar me grafikë për shërbimin e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve, duke mos pasqyruar oraret dhe mjetet përkatëse për mbledhjen e tyre në secilën pikë;
- Në akt kontrollet e mbajtura nuk pasqyrohen rastet e mbledhjes së mbetjeve edhe gjatë ditës sipas nevojave(krahas detyrimit për mbledhjen gjatë natës);
- Në shumë raste dhe të përsëritura, kontejnerët ishin të tej mbushur që në orët e para të paradites;
- AK nuk ka kryer identifikimin e kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit me një numër përkatës dhe lehtësisht të dukshëm për komunitetin, si dhe oraret e shërbimit;
- Në disa raste kontejnerët ishin të deformuar, pa rrota dhe në të gjitha rastet pa kapakë;
- Mungon dokumentimi për procesin e larjes dhe pastrimit të automjeteve dhe mjeteve të punës, si dhe raportimet për gjendjen e tyre;

- Gjatë periudhës objekt auditimi, mbledhja e mbeturinave është kryer jo me numrin e deklaruar prej 1045 kontejnerë, por në disa raste më tepër se ky numër dhe në disa raste më pak;
- Në lagje apo rrugë jo kryesore dezinfektimi nuk kryhej në rezen prej 10m<sup>2</sup> ose nuk kryhej fare;
- Përgjatë rrugëve të lagjes 24 maji u konstatuan mbetje të depozituara kudo përgjatë rrugës;
- ✓ Mbi procesin e larjes dhe fshirjes së rrugëve e trotuareve:
  - Grafikut e punës për shërbimin e fshirjes nuk miratohen çdo vit dhe nuk përmbajnë detajet e parashikuara në kontratë si rrugët që fshihen me autofshesë dhe ato me fshesë, oraret e operimit në secilën rrugë dhe numrin e punëtorëve që do të veprojnë në çdo rrugë;
  - Në pjesën më të madhe të rrugëve ato janë të zëna nga parkimet e makinave nga njëri krah dhe në më pak raste në të dyja krahët. Në rrugët e zëna nga parkimet u konstatua prani e madhe pluhuri dhe nuk ishte kryer gërryerja e kunetave apo e baltës;
  - Rrugë të tilla si Sokrat Leka, Damian Humariti, Hajredin Danushi, Osman Haxhiu, Andrea Varfi, Dervish Hekali, Jeronim de Rada apo Dëshmorët nuk ishin të përfshira në listën e rrugëve që lahen dhe fshihen edhe pse të njëjtës tipologji, sipërfaqe etj me rrugët e miratuara për këtë shërbim;
  - Referuar afateve të kryerjes së shërbimeve, konstatohet se procesi i fshirjes së pluhurave vijon edhe 2 orë pas përfundimit të afatit për larjen;
  - Në asnjë rast nuk dokumentohet asnjë nga përcaktimet e kontratës lidhur me larjen dhe pastrimin e mjeteve dhe automjeteve të punës, me kushtet hijeno-sanitare të pikës së grumbullimit të punëtorëve dhe as me kontrollin për inventarin dhe gjendjen e këtyre mjeteve dhe pajisjeve çdo 6 muaj;
  - Në përcaktimet e kontratës procesi i larjes përfundon në orën 04:00 dhe menjëherë në orën 06:00 fillon procesi i lag'jes, pa përcaktuar në grafikë se çfarë intervali i takon çdo rrugë nga njëri proces në tjetrin;
  - Procesi i lag'jes i orës 06:00-08:00 përveç se shumë pranë procesit të larjes, kryhet dhe në një orar në të cilin nuk ka trafik mjetesh;
  - Për të pasqyruar mundësinë e motit me shi, Bashkia Vlorë nuk kryen larjen e rrugëve për dy muaj radhazi (janar-shkurt), dhe lag'jen e tyre për 3 muaj radhazi në dy intervale (janar-mars dhe tetor-dhjetor). Për këtë rast, në vitin 2017 Bashkia Vlorë ka kërkuar shërbim shtesë për larjen e rrugëve në muajt janar-shkurt kur nuk janë parashikuar në kontratë;
  - Mbikëqyrësi ka të drejtë të propozojë ndryshime të sipërfaqeve të rrugëve ku operohet, në rastet kur ka shtesa të tyre si pasojë e kryerjes së investimeve në qytet, por pa ndryshuar volumet totale të sipërfaqeve të përcaktuara në kontratë;
- ✓ Mbi nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarëve:
  - Në llogaritjen e fondit limit dhe as në kontratë nuk ka asnjë përllogaritje për zërin “Edukimi publik”, i përcaktuar në kontratë për zhvillimin e programeve të edukimit, spoteve televizive, apo fletë palosjeve dhe broshurave informuese;
  - Në 3 modelet e posterave/broshurave të hartuara për edukimin publik përgjithësisht bëhet thirrje për mbajtjen pastër të qytetit por nuk ofrohet informacion në ndihmë të qytetarëve se në cilat pika duhen hedhur mbetjet e pa pranueshme, çfarë penaltitësh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj;
  - Nuk ka një përcaktim se në çfarë mënyre dhe mbi vlerësimin e cilëve elementë mbikëqyrësi do të monitorojë përmbushjen e detyrimit mbi edukimin publik e ambiental;
  - Bashkia Vlorë nuk ndërmerr zhvillimin e sondazheve apo pyetësorëve lidhur me kënaqësinë e qytetarëve mbi nivelin e pastrimit, apo mbulimin e zonave të tyre të banimit nga ky shërbim;
  - Në akt kontrollet e mbajtura nga palët, vihet re se rregullisht çdo ditë deklarohet për mbledhje të mbetjeve të pa pranueshme të hedhura jashtë kontenierëve. Penalizimet me anë të



gjobave janë të rralla dhe përgjithësisht për rastet e ndotjeve madhore, si p.sh. derdhjet e naftës. Mbikëqyrësi dhe Operatori Ekonomik nuk kanë marrë asnjë masë për penalizimin e ndotësve edhe pse e kanë të parashikuar këtë detyrim në kontratë, por janë mjaftuar me këshillimin verbal të tyre.

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për sigurimin e objekteve të caktuara për matjen e sasisë së mbetjeve, në mënyrë që të kryhet identifikimi i saktë i volumeve të mbetjeve që gjenerohen çdo ditë dhe dokumentimi i tyre të bëhet sipas sasive specifike dhe jo në formatin fiks prej 140 ton/ditë. Ky element do të ndihmonte edhe në procesin e planifikimit të volumeve dhe kostove në të ardhmen.

**Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e subjektit nuk janë masa për sigurimin e objekteve të caktuara, të cilat do të shërbejnë për matjen e sasisë së mbetjeve, në mënyrë që të kryhet identifikimi i saktë i volumeve të mbetjeve që gjenerohen çdo ditë dhe më pas dokumentimi i tyre të bëhet sipas sasive specifike dhe jo në formatin fiks prej 140 ton/ditë.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për studimin e zonave të cilat vazhdimisht kanë kontenierë të tej mbushur dhe zonave ku kontenierët qëndrojnë edhe të zbrazur dhe mbi këtë bazë të bëjë një riplanifikim dhe rishpërndarje të kontenierëve për çdo pike sipas nevojës.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e subjektit nuk rezultojnë evidenca të cilat lidhen me studimin e zonave me kontenierë të tej mbushur dhe zonave ku kontenierët qëndrojnë edhe të zbrazur, në mënyrë që të kryhet një riplanifikim dhe rishpërndarje të kontenierëve për çdo pike sipas nevojës.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa dhe të kërkojë që Operatori Ekonomik përgjegjës për ofrimin e shërbimit të pastrimit, të përmbushë përcaktimet e nenit 21.1.6 sa i takon riparimit të të gjithë deformimeve apo zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të kontenierëve të dëmtuar dhe në të ardhmen, kjo drejtori të rrisë kërkesën e llogarisë ndaj detyrimeve që Operatori Ekonomik ka lidhur me mirëmbajtjen e kontenierëve.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e subjektit nuk janë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj detyrimeve që Operatori Ekonomik ka lidhur me mirëmbajtjen e kontenierëve sa i takon riparimit të të gjithë deformimeve apo zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të kontenierëve të dëmtuar.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandime:**

Bashkia Vlorë dhe Drejtoritë përkatëse brenda saj, të marrin masa për mundësinë e vendosjes së orareve të caktuara kufizuese gjatë natës për parkimin e mjeteve në anë të rrugës. Këto orare kufizimi për secilën rrugë të përputhen me oraret e kalimit të mjeteve pastruese në këto rrugë rast pas rasti sipas përcaktimeve në grafikë; për këtë qëllim, mbikëqyrësi i kontratës të marrë masa për hartimin e grafikëve me të gjitha detajet që parashikon kontrata për çdo zë, duke përfshirë orën e kalimit në secilën rrugë, mjetet në dispozicion në çdo operacion, targat e tyre, si dhe numri i punëtorëve për secilin prej tyre.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Ka patur diskutime të ndryshme gjatë mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për mënyrën e parkimit të mjeteve në rrugë në mënyrë që të mos bëhen pengesë për shërbimin e pastrimit të qytetit, por nuk janë finalizuar me vendime konkrete.

**Statusi i rekomandimit: I pazbatuar**

**Rekomandime:**

Duke pasur si qëllim parandalimin e ngritjes së pluhurit dhe eliminimin e tij, grupi i punës për hartimin e grafikëve për këtë shërbim, të marrë masa për shmangien e kryerjes së procesit të larjes dhe lagjes në një diferencë fare të vogël oraresh mes tyre. Për këtë qëllim të vlerësohet mundësia e një shpërndarje të koordinuar të orareve për të dy proceset (lagjes dhe larjes) sipas nevojës dhe në periudha gjatë ditës në të cilat frekuentimi dhe prania e pluhurit në ajër janë më të larta, si dhe të përcaktohen specifikisht në këto grafikë orari i larjes dhe lagjes së secilës rrugë.

**Në çdo kontratë pas ardhëse**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Në kontratën “Shërbimi i pastrimit në qytetin Vlorë”, Nr. 5229/1 datë 03.07.2020, Seksioni 10.3 Shërbim 3” Larja e shesheve dhe rrugëve me ujë”, pika 10.3.2 (a) përcaktohet orari i larjes me presion me ujë i rrugëve kryesore natën prej orës 01.00-06.00 për një periudhë 10 mujore.

Gjithashtu në pikën 10.3.3 Shërbimi i lagjes me ujë (a) përcaktohet orari i cili është prej orës 15.00-18.00, për një periudhë 10 mujore.

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar**

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve dhe mbikëqyrësi i kontratës të marrin masa për angazhimin efektiv dhe me përgjegjshmëri të të gjitha strukturave përgjegjëse në çështjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi pastrimin e qytetit. Për këtë qëllim, të merren masa për aplikimin e penalteteve të parashikuara në ligj për rastet e përsëritura të shkelësve të ligjit. Po kështu, të merren masa për realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit me karakter informues mbi detyrimet e qytetarëve ndaj këtij shërbimi që bashkia ofron, apo të dhëna se në cilat pika duhen hedhur mbetjet e pa pranueshme, çfarë penaltetesh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj, si dhe vendosjen e një numri jeshil ku qytetarët të kenë mundësi të paraqesin ankesat dhe denoncimet e tyre.

**Dhjetor 2021**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** Nga ana e subjektit janë paraqitur disa postera të cilët përmbajnë mesazhe ndërgjegjësuëse për qytetarët dhe bizneset, si edhe sugjerime lidhur me oraret e hedhjes së mbeturinave në mënyrë që të sigurohet një qytet i pastër. Megjithatë përprjekjet e bëra nga ana e subjektit mbetet akoma shumë për tu bërë në çështjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi pastrimin e qytetit. Mungojnë evidenca për fushatat ndërgjegjësuëse, të cilat përvec karakterit informues për qytetarët duhet të përmbajnë edhe të dhëna për pika të caktuara për hedhjen e mbetjet e pa pranueshme, çfarë penaltetesh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj., si dhe vendosjen e një numri jeshil ku qytetarët të kenë mundësi të paraqesin ankesat dhe denoncimet e tyre.

Nuk rezultojnë evidenca lidhur me masa të marra për aplikimin e penalteteve të parashikuara në ligj për rastet e përsëritura të shkelësve të ligjit

**Statusi i rekomandimit: Zbatuar pjesërisht**

**VI. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit ri kërkimë nga Bashkia Vlorë, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën Nr. 645/8, datë 15.09.2021, mbi

auditimin e performancës me temë: “Pastrimi i qytetit”, i cili nga auditimi i kryer për verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve në auditimin e mëparshëm, rezultuan të pazbatuara ose në proces, si më poshtë:

**Për pyetjen: A është mbështetur procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në plane/rregullore për këtë qëllim?**

**Gjetje:**

Në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit nr. 8094, datë 01.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, nenin 22 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Vlorë, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve në Bashki nuk ka hartuar dhe miratuar:

- g) metodat dhe teknologjitë për largimin e mbeturinave;
- h) planet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- i) rregulloren e shërbimit të pastrimit publik;
- j) rregulloren higjeno-sanitare dhe ekologjike;
- k) tregues të performancës së shërbimit dhe indikatorë për matjen e cilësisë së shërbimit; dhe
- l) objektiva specifike për shërbimin e pastrimit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

**Rekomandim:**

Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, në bashkëpunim me ekspertë të fushës të marrë masa për hartimin dhe miratimin e metodologjive dhe rregulloreve të munguara prej kohësh, ku të përshkruhen qartë çdo element që lidhet me këtë shërbim dhe parametra/standarde të cilat duhet të aplikohen;

**Dhjetor 2022**

**Për pyetjen: A është bazuar procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në analiza financiare në përputhje me burimet në dispozicion?**

**Gjetje:**

Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme dhe parimin e transparencës, Bashkia Vlorë nuk mbështet përllogaritjen e tarifës së pastrimit në metodologji përllogaritjeje dhe as nuk bën publike analizën e ndjekur për gjenerimin e vlerës përfundimtare të kësaj tarife;

Në asnjë rast për periudhën objekt auditimi, Bashkia Vlorë nuk ka mbledhur 100% të tarifës së “pastrim, gjelbërim, ndriçim”;

Në kundërshtim me Kreun VI të Ligjit nr. 8094, datë 01.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, të ardhurat nga vjelja e tarifës për “pastrim, gjelbërim, ndriçim” nuk mbulojnë as shërbimin e pastrimit brenda qytetit, ku mesatarisht ky shërbim është në vlerën e 145% të tarifës përkatëse;

Mesatarisht për periudhën objekt auditimi, të ardhurat nga tarifa për “pastrim, ndriçim, gjelbërim” përbëjnë 6.9% të të ardhurave totale të Bashkisë (duke marrë parasysh se kjo tarifë mbulon tre shërbime), ndërkohë që shpenzimi për shërbimin e pastrimit vetëm brenda qytetit zë 9.8% të të ardhurave totale të BV;

Në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës, përllogaritja e fondit të nevojshëm për shërbimin e pastrimit bazohet në eksperiencën 15 vjeçare që Bashkia ka patur për këtë për këtë shërbim, si dhe duke përfshirë vetëm kostot operative të shërbimit;

Për automjetet në funksion të shërbimit është parashikuar zëvendësimi rregullisht çdo vit i gomave dhe nuk janë përmendur normat e konsumit për secilin lloj automjeti;

Për shkak të mungesës së peshores, Bashkia Vlorë nuk ka asnjë informacion mbi sasinë e mbetjeve që prodhon në një ditë.

**Rekomandime:**

Bashkia Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për kryerjen e analizave të kostos së shërbimeve mbështetur në udhëzues apo metodologji të caktuara për këtë qëllim. Njëkohësisht, të merren masa për mbledhjen e vlerës së plotë të të ardhurave nga tarifa e pastrimit.

**Në hartimin e kontratave të ardhshme****Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për identifikimin e saktë të volumeve të mbetjeve që gjenerohen dhe të përdorë këto të dhëna gjatë planifikimeve financiare që kryen.

**Dhjetor 2022****Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për llogaritjen e kostos së shërbimit së pari jo në vlera të konsiderueshme mbi mundësitë e saj financiare dhe së dyti duke bërë pjesë të këtyre përlllogaritjeve elementët thelbësor që janë pjesë e shërbimit të pastrimit si rritja e popullsisë, shtimi i bizneseve, flukset e sezoneve, etj.

**Në hartimin e kontratave të ardhshme****Për pyetjen: A ka kryer BV mbikëqyrjen e duhur të zbatimit të kontratës?**

**Gjetje:** Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Bashkisë dhe përcaktimeve të kontratës së shërbimit nr. 4558, dat nr. 4558, datë 31.10.2014:

Procesi i mbikëqyrjes realizohej në mëngjes herët rreth orës 06:00-10:00 dhe jo në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit;

Puna e mbikëqyrësit të kontratës është e dokumentuar vetëm nëpërmjet disa akt kontrolleve të thjeshta ditore ku konfirmohet realizimi i punëve të parashikuara sipas volumeve;

Nuk identifikohen në asnjë rast indikator matës të cilësisë së pastrimit, pra me çfarë treguesish mbikëqyrësi del në përfundimin se cilësia është e mirë, e keqe, apo mesatare;

OE nuk e shoqëron dokumentacionin e mbajtur ditore me detaje mbi punët e kryera, p.sh. me proces-verbale për sasinë e mbushjes së autoboteve me ujë për secilin proces, me adresat se cilat zona janë më problematike duke gjetur vazhdimisht hedhjen e mbetjeve të papranueshme jashtë kontenierëve, etj;

Nuk u konstatua asnjë komunikim i dokumentuar mes mbikëqyrësit, apo administratorëve rajonalë dhe Drejtorit të Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, qoftë lidhur me miratimin e grafikëve të punimit, me shkëmbim informacionesh mbi problematika që mund të lindin gjatë punës, mbi raportimet ditore brenda orarit të përcaktuar në rregullore, etj;

Nuk u konstatua i dokumentuar asnjë adresim i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve qoftë në instanca më të larta brenda institucionit, ashtu dhe drejt OE që ofron shërbimin, mbi problematika të hasura vazhdimisht për çështjen e pastrimit dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre, si p.sh. mungesa e vazhdueshme e ndërgjegjësimit të popullsisë për hedhjen e mbetjeve të pa pranueshme, neglizhenca e tyre për reduktimin e mbetjeve, problematika të mbledhjes së plastikave nga persona të pa autorizuar, etj;

Mbikëqyrësi nuk përmbush detyrimin për kontrollin e mjeteve dhe fuqisë punëtore të angazhuar nëpërmjet kësaj kontrate, si dhe nuk kryen një verifikim të detajuar të gjendjes teknike të mjeteve apo dokumentacionit që konfirmon këto elementë të mjeteve, apo shërbimet dhe mirëmbajtja që i bëhet atyre. Dëshmitë e vetme që pranohen për gjendjen e mjeteve janë kontrollet teknike të përvitshme që kryen çdo mjet në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që mbikëqyrësi kryen vizita në parkun e mjeteve dy herë në vit për të verifikuar prezencën dhe gatishmërinë e tyre, por ky proces është i pa dokumentuar.

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve në bashkëpunim me mbikëqyrësin e kontratës, të marrin masa për menaxhimin e kapaciteteve për të kryer një proces të plotë mbikëqyrës për të gjithë shërbimin e pastrimit dhe mbi të gjitha ky proces të kryhet në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit dhe jo në përfundim të tij.

**Dhjetor 2022**

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve dhe mbikëqyrësi të garantojnë realizimin e një inspektimi më serioz dhe mbajtjen e dokumentacionit të detajuar për punimet e kryera. Ky dokumentim të shoqërohet edhe me komunikime shkresore zyrtare me eprorë, operatorin ekonomik, apo dhe ankesa të qytetarëve. Në këtë kontekst, të kërkohet më tepër llogaridhënie në dokumentimin e procedurave që kryen operatori ekonomik për elementë të ndryshëm të ofrimit të shërbimit, si p.sh. procesverbale të sasisë së ujit që mbushen autobotet çdo ditë, faturime dhe dokumente të tjera justifikuese për çdo riparim, mirëmbajtje apo ndërhyrje të kryer në mjetet në dispozicion të kontratës, për të cilat paguan Bashkia, etj.

**Dhjetor 2022**

**Për pyetjen: A janë zbatuar me përpikmëri detyrimet e kontratës nr. 4558, datë 31.10.2014 sa i takon largimit të mbetjeve/fshirjes dhe larjes së rrugëve/edukimit publik?**

**Gjetje:**

Mbi procesin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, dezinfektimit të zonës dhe gjendjes së kontenierëve:

- Bashkia Vlorë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nuk ka operuar me grafikë për shërbimin e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve, duke mos pasqyruar oraret dhe mjetet përkatëse për mbledhjen e tyre në secilën pikë;
- Në akt kontrollet e mbajtura nuk pasqyrohen rastet e mbledhjes së mbetjeve edhe gjatë ditës sipas nevojave(krahas detyrimit për mbledhjen gjatë natës);
- Në shumë raste dhe të përsëritura, kontenierët ishin të tej mbushur që në orët e para të paradites;
- AK nuk ka kryer identifikimin e kontenierëve dhe pikave të grumbullimit me një numër përkatës dhe lehtësisht të dukshëm për komunitetin, si dhe oraret e shërbimit;
- Në disa raste kontenierët ishin të deformuar, pa rrota dhe në të gjitha rastet pa kapakë;
- Mungon dokumentimi për procesin e larjes dhe pastrimit të automjeteve dhe mjeteve të punës, si dhe raportimet për gjendjen e tyre;
- Gjatë periudhës objekt auditimi, mbledhja e mbeturinave është kryer jo me numrin e deklaruar prej 1045 kontenierë, por në disa raste më tepër se ky numër dhe në disa raste më pak;
- Në lagje apo rrugë jo kryesore dezinfektimi nuk kryhej në rezen prej 10m<sup>2</sup> ose nuk kryhej fare;
- Përgjatë rrugëve të lagjes 24 maji u konstatuan mbetje të depozituara kudo përgjatë rrugës;
- ✓ Mbi procesin e larjes dhe fshirjes së rrugëve e trotuareve:
- Grafikët e punës për shërbimin e fshirjes nuk miratohen çdo vit dhe nuk përmbajnë detajet e parashikuara në kontratë si rrugët që fshihen me autofshesë dhe ato me fshesë, oraret e operimit në secilën rrugë dhe numrin e punëtorëve që do të veprojnë në çdo rrugë;
- Në pjesën më të madhe të rrugëve ato janë të zëna nga parkimet e makinave nga njëri krah dhe në më pak raste në të dyja krahet. Në rrugët e zëna nga parkimet u konstatua prani e madhe pluhuri dhe nuk ishte kryer gërryerja e kunetave apo e baltës;

- Rrugë të tilla si Sokrat Leka, Damian Humariti, Hajredin Danushi, Osman Haxhiu, Andrea Varfi, Dervish Hekali, Jeronim de Rada apo Dëshmorët nuk ishin të përfshira në listën e rrugëve që lahen dhe fshihen edhe pse të njëjtës tipologji, sipërfaqe etj me rrugët e miratuara për këtë shërbim;
- Referuar afateve të kryerjes së shërbimeve, konstatohet se procesi i fshirjes së pluhurave vijon edhe 2 orë pas përfundimit të afatit për larjen;
- Në asnjë rast nuk dokumentohet asnjë nga përcaktimet e kontratës lidhur me larjen dhe pastrimin e mjeteve dhe automjeteve të punës, me kushtet hijeno-sanitare të pikës së grumbullimit të punëtorëve dhe as me kontrollin për inventarin dhe gjendjen e këtyre mjeteve dhe pajisjeve çdo 6 muaj;
- Në përcaktimet e kontratës procesi i larjes përfundon në orën 04:00 dhe menjëherë në orën 06:00 fillon procesi i lag'jes, pa përcaktuar në grafikë se çfarë intervali i takon çdo rrugë nga njëri proces në tjetrin;
- Procesi i lag'jes i orës 06:00-08:00 përveç se shumë pranë procesit të larjes, kryhet dhe në një orar në të cilin nuk ka trafik mjetesh;
- Për të pasqyruar mundësinë e motit me shi, Bashkia Vlorë nuk kryen larjen e rrugëve për dy muaj radhazi (janar-shkurt), dhe lag'jen e tyre për 3 muaj radhazi në dy intervale (janar-mars dhe tetor-dhjetor). Për këtë rast, në vitin 2017 Bashkia Vlorë ka kërkuar shërbim shtesë për larjen e rrugëve në muajt janar-shkurt kur nuk janë parashikuar në kontratë;
- Mbikëqyrësi ka të drejtë të propozojë ndryshime të sipërfaqeve të rrugëve ku operohet, në rastet kur ka shtesa të tyre si pasojë e kryerjes së investimeve në qytet, por pa ndryshuar volumet totale të sipërfaqeve të përcaktuara në kontratë;
- ✓ Mbi nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarëve:
- Në llogaritjen e fondit limit dhe as në kontratë nuk ka asnjë përllogaritje për zërin “Edukimi publik”, i përcaktuar në kontratë për zhvillimin e programeve të edukimit, spoteve televizive, apo fletë palosjeve dhe broshurave informuese;
- Në 3 modelet e posterave/broshurave të hartuara për edukimin publik përgjithësisht bëhet thirrje për mbajtjen pastër të qytetit por nuk ofrohet informacion në ndihmë të qytetarëve se në cilat pika duhen hedhur mbetjet e pa pranueshme, çfarë penaltetesh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj;
- Nuk ka një përcaktim se në çfarë mënyre dhe mbi vlerësimin e cilëve elementë mbikëqyrësi do të monitorojë përmbushjen e detyrimit mbi edukimin publik e ambiental;
- Bashkia Vlorë nuk ndërmerr zhvillimin e sondazheve apo pyetësorëve lidhur me kënaqësinë e qytetarëve mbi nivelin e pastrimit, apo mbulimin e zonave të tyre të banimit nga ky shërbim;
- Në akt kontrollet e mbajtura nga palët, vihet re se rregullisht çdo ditë deklarohet për mbledhje të mbetjeve të pa pranueshme të hedhura jashtë kontenierëve. Penalizimet me anë të gjobave janë të rralla dhe përgjithësisht për rastet e ndotjeve madhore, si p.sh. derdhjet e naftës. Mbikëqyrësi dhe Operatori Ekonomik nuk kanë marrë asnjë masë për penalizimin e ndotësve edhe pse e kanë të parashikuar këtë detyrim në kontratë, por janë mjaftuar me këshillimin verbal të tyre.

#### **Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për sigurimin e objekteve të caktuara për matjen e sasisë së mbetjeve, në mënyrë që të kryhet identifikimi i saktë i volumeve të mbetjeve që gjenerohen çdo ditë dhe dokumentimi i tyre të bëhet sipas sasive specifike dhe jo në formatin fiks prej 140 ton/ditë. Ky element do të ndihmonte edhe në procesin e planifikimit të volumeve dhe kostove në të ardhmen.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për studimin e zonave të cilat vazhdimisht kanë kontenierë të tej mbushur dhe zonave ku kontenierët qëndrojnë edhe të zbrazur dhe mbi këtë bazë të bëjë një riplanifikim dhe rishpërndarje të kontenierëve për çdo pike sipas nevojës.

**Dhjetor 2022****Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa dhe të kërkojë që Operatori Ekonomik përgjegjës për ofrimin e shërbimit të pastrimit, të përmbushë përcaktimet e nenit 21.1.6 sa i takon riparimit të të gjithë deformimeve apo zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të kontenierëve të dëmtuar dhe në të ardhmen, kjo drejtori të rrisë kërkesën e llogarisë ndaj detyrimeve që Operatori Ekonomik ka lidhur me mirëmbajtjen e kontenierëve.

**Nëntor 2022****Rekomandime:**

Bashkia Vlorë dhe Drejtoritë përkatëse brenda saj, të marrin masa për mundësinë e vendosjes së orareve të caktuara kufizuese gjatë natës për parkimin e mjeteve në anë të rrugës. Këto orare kufizimi për secilën rrugë të përputhen me oraret e kalimit të mjeteve pastruese në këto rrugë rast pas rasti sipas përcaktimeve në grafikë; për këtë qëllim, mbikëqyrësi i kontratës të marrë masa për hartimin e grafikëve me të gjitha detajet që parashikon kontrata për çdo zë, duke përfshirë orën e kalimit në secilën rrugë, mjetet në dispozicion në çdo operacion, targat e tyre, si dhe numri i punëtorëve për secilin prej tyre.

**Dhjetor 2022****Rekomandime:**

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve dhe mbikëqyrësi i kontratës të marrin masa për angazhimin efektiv dhe me përgjegjshmëri të të gjitha strukturave përgjegjëse në çështjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi pastrimin e qytetit. Për këtë qëllim, të merren masa për aplikimin e penalteteve të parashikuara në ligj për rastet e përsëritura të shkelësve të ligjit. Po kështu, të merren masa për të bërë më tepër përpjekje me fokus realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit me karakter informues mbi detyrimet e qytetarëve ndaj këtij shërbimi që bashkia ofron, apo të dhëna se në cilat pika duhen hedhur mbetjet e pa pranueshme, çfarë penaltetesh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj., si dhe vendosjen e një numri jeshil ku qytetarët të kenë mundësi të paraqesin ankesat dhe denoncimet e tyre.

**Dhjetor 2022**

## KONTROLI LARTË I SHTETIT





**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**Raport për auditimin e ushtruar për zbatimin e rekomandimeve, 6 mujori i dytë  
2021**10- ANEKSE****Aneksi përmbledhës i masave sipas llojit.**

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	%	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa për përmirësim ligjor	6		5		1		83.33		0		2		0				3			
2	Masa organizative	152		147		5		96.71		49		11		50				37			
3	Masa shpërblim dëmi																				
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
5	Për eliminimin e efekteve ....																				
6	Masa disiplinore																				
7	Masa Administrative																				
<b>TOTALI</b>		<b>158</b>		<b>152</b>		<b>6</b>				<b>49</b>		<b>13</b>		<b>50</b>				<b>40</b>			

**Aneksi nr.1**

**PËR AUDITIMIN ME TEMË “EFEKTIVITETI I SITUATËS PANDEMIKE COVID-19” NË SUBJEKTET MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, DREJTORIA QENDRORE E OPERATORIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar	Shkalla e pranimit	Statusi I rekomandimeve te pranuar
-----	-----------------	-------------	---------	------------	--------------------	------------------------------------

		gjithsej		subjekti		nga subjekti															
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	21		18		3		18		12		1		4				1			
2	Masa shpërblim dëmi																				
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
4	Për eliminimin e efekteve ....																				
5	Masa disiplinore																				
6	Masa Administrative																				
<b>TOTALI</b>																					

## Aneksi nr.2

### AUDITIMI “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUARA NË 6 MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021, PËR AUDITIMIN ME TEMË “EFEKTIVITETI I MASAVE TË MARRA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT NGA ABUZIMET ME PESHËN DHE MATJET”

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	25		23		2		23		6		1		13				3			
2	Masa shpërblim dëmi																				
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
4	Për eliminimin e efekteve ....																				
5	Masa disiplinore																				
6	Masa Administrative																				
<b>TOTALI</b>																					

**ANEKSI NR.3**

**AUDITIMI TEMATIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUARA NË 6 MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021, PËR AUDITIMIN ME TEMË “EFEKTIVITETI I BIBLOTEKËS KOMBËTARE”, NË SUBJEKTIN BIBLOTEKA KOMBËTARE TIRANË.**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	30	-	30	-	0	-	30	-	11	-	1	-	9	-	-	-	9	-	-	-
2	Masa për Përmirësim Ligjor	1	-	1	-	0	-	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>31</b>	<b>-</b>	<b>31</b>	<b>-</b>	<b>0</b>	<b>-</b>	<b>31</b>	<b>-</b>	<b>11</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>10</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>9</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**ANEKSI NR.4**

**AUDITIMI TEMATIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUARA NË 6 MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021, PËR AUDITIMIN ME TEMË “EKONOMIA RURALE ME FOKUS AGROTURIZMIN”, NË SUBJEKTET: MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE RURAL**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	18	-	18	-	-	-	18	-	11	-	0	-	5	-	-	-	2	-	-	-
2	Masa Përmir. Ligj	1	-	1	-	-	-	1	-	0	-	1	-	0	-	-	-	0	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>19</b>	<b>-</b>	<b>19</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>19</b>	<b>-</b>	<b>11</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>5</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**AUDITIMI TEMATIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUARA NË 6 MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021, PËR AUDITIMIN ME TEMË “MENAXHIMI I MBETJEVE PLASTIKE”, NË SUBJEKTET MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT DHE BASHKITË TIRANË, VLORË, ELBASAN.**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	17		17		0		17		1		4		12				0			
2	Masa shpërblim dëmi																				
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
4	Për eliminimin e efekteve ....																				
5	Masa disiplinore																				
6	Masa Administrative																				
<b>TOTALI</b>																					

**PËR AUDITIMIN ME TEMË “EFEKTIVITETI DHE EFICENCA E MENAXHIMIT TË PARKIMEVE TË MJETEVE MOTORIKE NË RRUGËT E QYTETIT TË TIRANËS DHE KORÇËS”, NË SUBJEKTET BASHKIA TIRANË DHE KORÇË.**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	32		32		0		32		11		2		12				7			
2	Masa shpërblim dëmi																				
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
4	Për eliminimin e efekteve ....																				

5	Masa disiplinore																			
6	Masa Administrative																			
<b>TOTALI</b>																				

**AUDITIMI TEMATIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUARA NË 6 MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021, PËR AUDITIMIN ME TEMË “ZHVILLIMI I TURIZMIT MALOR”, NË SUBJEKTET MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT DHE FEDERATA SHQIPTARE E ALPINIZMIT DHE TURIZMIT MALOR.**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	29		29		-				7				7				15			
2	Masa për përmirësim ligjor	4		3		1												3			
<b>TOTALI</b>		<b>33</b>		<b>32</b>		<b>1</b>				<b>7</b>				<b>7</b>				<b>18</b>			

**AUDITIMI TEMATIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUARA NË 6 MUJORIN E DYTË TË VITIT 2021, PËR AUDITIMIN ME TEMË “PASTRIMI I QYTETIT”, NË SUBJEKTIN BASHKIA VLORE.**

**Aneksi 1**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera

1	Masa organizative	12		12		0		12		1		4						7			
2	Masa shpërblim dëmi																				
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
4	Për eliminimin e efekteve ....																				
5	Masa disiplinore																				
6	Masa Administrative																				
<b>TOTALI</b>		<b>12</b>		<b>12</b>		<b>0</b>		<b>12</b>		<b>1</b>		<b>4</b>						<b>7</b>			